

Omer Hasan El-Kijjam

# Karakteri letrar i tekstit Kur'anor





# KARAKTERI LETRAR I TEKSTIT KUR'ANOR

Omer Hasen Kijjam



©LOGOS·A  
S H K U P  
PRISHTINË  
TIRANË  
2 0 2 2

**BOTON: LOGOS-A**  
BIBLIOTEKA: MENDIMI ISLAM

Për botuesin: Adnan Ismaili  
Kryeredaktor: Husamedin Abazi  
Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahimimi

Redaktor gjuhësor: Shkëlzen Halimi  
Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjishi  
Redaktor teknik: Sedat Halimi  
Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili  
Shtypi: Focus Print, Rr. Pellagonia 3 - Shkup

ISBN 978-9989-58-980-5 Paperback

Copyright © Logos-A, 2022  
© Center for Advanced Studies  
© The International Institute of Islamic Thought (IIIT),  
First Edition 1444AH / 2022CE

Translated into Albanian from the Arabic Title:  
Adabiyat al-Naṣṣ al-Qur’āni: baḥth fi Naẓarīyat al-tafsīr  
Omar Hasan al-Qiyam

Copyright © The International Institute of Islamic Thought (IIIT), First Edition  
1432AH / 2011CE, ISBN: 978-1-56564-453-3 Paperback

IIIT	IIIT London Office
P.O. Box 669	P.O. Box 126
Herndon, VA 20172, USA	Richmond, Surrey
www.iiit.org	TW9 2UD, UK
	www.iiituk.com


Tirazhi: 700

**www.logos-a.com**

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe joftimprurës.

Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi.  
Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të botuesve.



# KARAKTERI LETRAR I TEKSTIT KUR'ANOR

Omer Hasen Kijjam

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:  
Ziber Lata

TITULLI I ORIGJINALIT:  
Omar Hasan al-Qiyam,  
Adabiyat al-naṣṣ al-qur’ānī: baḥth fi naẓarīyat al-tafsīr  
أدبيّة النص القرآني: بحث في نظرية التفسير  
Copyright © The International Institute of Islamic Thought (IIIT),  
First Edition, 1432AH / 2011CE  
ISBN: 978-1-56564-453-3 Paperback



Ky libër u botua me mbështjen e  
Institutit Ndërkombëtar të Mendimit Islam (IIIT)



## PËRMBAJTJA:

Një vështrim për botimin shqip.....	7
Parathënie .....	11
Hyrje .....	19
KREU I PARË .....	25
Themelimi dhe ballafaqimi .....	27
Muhamed Abduhu dhe barra e themelimit .....	27
Shembull praktik nga komenti i Muhamed Abduhusë.....	48
Emin Huli dhe udhëheqja e pionierëve .....	51
Shembull praktik nga komenti i Emin Hilit.....	70
KREU I DYTË.....	81
Dy kritikë nga shkolla “Umena” (besnikët).....	83
Aishe Abdurrahman dhe tefsiri sqarues (retorik) .....	83
Shukri Ajjadi dhe aplikimi i leximit letrar.....	94
KREU I TRETË .....	133
Muhamed Arkuni: lëkundja e konceptit të shenjtërisë .....	135
A- Leximi besimor (teologjik) .....	136
B- Leximi historik-filologjik .....	138
C- Leximet linguistike, semiotike dhe letrare .....	140
Arkuni dhe leximi (komentimi) i sures El-El-Fatiha .....	158
KREU I KATËRT .....	173
Nasr Hamid Ebu Zejd: Koncepti i tekstit dhe karakteri i gjuhës fetare .	175
Koncepti i tekstit .....	175
Natyra e gjuhës fetare .....	196
Përfundimi.....	209
Literatura e konsultuar.....	217



# Një vështrim për botimin shqip

Shpallja e Kur'ani qysh në fillim ka tërhequr vëmendjen e shumë palëve, edhe të diturve edhe të paditurve, edhe të atyre që e pranuan atë me entuziazëm edhe të atyre që e refuzuan atë me pezëm.

Edhe pse arabët posedonin afinitet për poezi, të karakterit epik, lirik, elegjiak e tjerë, *Kitabi i Kur'anit* ishte i ndryshëm, as poezi e pastër as prozë e pastër, që joshte por edhe mposhtë të gjithë. Ai ishte superior përballë të gjithëve, madje edhe përballë Pasuesve të Librit (Ehl'ul-kitab), edhe përballë kulturave e filozofive të botës së atëhershme. Ai ishte i jashtëzakonshëm (mu'xhize), absolutisht i mrekullueshëm (i paimitueshëm). Kjo gjendje e re vuri në lëvizje dijetarët e kohës brenda dhe jashtë Arabisë. Filloi zhvillimi i stilistikës (belaga), metaforës (mexhaz) por edhe i gramatikës, lingistikës, metrikës etj. Studimi i këtyre fushave ishte kusht për ta kuptuar Librin e Zotit, të cilën sfidë e pranuan dijetarët e epokave klasike dhe si rezultat kemi një varg veprash kulmore.

Fenomeni i Kur'anit ishte sfidues edhe në kohët e mëvonshme, sidomos në 2-3 shekujt e fundit (XIX-XXI), kur evropërendimi drejtëpërdrejt dhe nëpërmjet ndikimit shkencor e letrar te vetë arabëve imponoi një varg sfidash, provokimesh të vjetra/të reja, si reforma të ndryshme në mësimet islame, në trashëgiminë muslimane. Reforma të tillë u imponuan edhe në rrafshin letrar, epistemologjik, metodologjik etj.

Një aspekt të kësaj çështjeje e hulumtoi dhe rezultatet i bëri publike profesori jordanez Omer Hasan El-Kijjam me veprën e vet me titull "Karakteri letrar i tekstit kur'anor" (*Edebijjet' un-nass 'il-kur'aniji – bahthun fi nadharijjet'* it-

tefsiri), e në botim të Logos-A, me një përkthim të saktë e të rrjedhshëm të profesor Ziber Latës.

Autori, Dr. Omer Hasan El-Kijjam (lindi 1963) është profesor universitar jordanez. Ai ka doktoruar në gjuhësi në Universitetin Jermuk në Jordani dhe punon si profesor i retorikës në Universitetin Jadara në Jordani. Ai ka disa vepra letrare, vepra shkencore dhe studime. Ndër veprat kryesore është përgatitja shkencore e botimit të veprës së Imam Bakil-laniut, El-Intisar ‘ul-Kur’an. Vepra e Bakil-laniut, sipas autorit, u përgjigjet dyshimeve të vjetra dhe bashkëkohore, që qarkullojnë rreth historisë dhe strukturës së Kur'anit, dhe transcendencës së tij unike semantike.

Për veprën “*Karakteri letrar i tekstit kur'anor*” foli pozitivisht edhe intelektuali i njohur dr. Taha Xhabir Alvani. Ai e vlerësoi shumë dhe rekomandoi leximin e tij, duke këshilluar autorin që me të njëjtën qasje dhe thellësi të përfundojë studimin e pjesës tjeter të leximeve bashkëkohore të Kur'anit.

Vepra ka hyrjen, katër kapituj, përfundimin dhe literaturën e shfrytëzuar. Në kapitujt e cekur autorri Omer Hasen El-Kijjam ka trajtuar dijetarët klasikë (për shembull: Imam Bakil-lani) por edhe bashkëkohorë (për shembull: M. Abduhu), qasjet e tyre, idetë dhe zhvillimin e ideve dhe qëndrimet e tyre karshi opozitarëve, dijetarëve që ata i quajnë “konservatorë”. Nuk janë lënë pas dore as orientalistët dhe veprat e tyre.

Shpjegimet në poshtëshënimë dhe literatura e dhënë i sigurojnë veprës një seriozitet dhe themelësi, një qasje analitike: retorike (stilistike) dhe hermeneutike. Idenë reformatorë autorri e ka parë sidomos në studimet linguistike, duke u bazuar edhe në Muhammed Abduhunë, i cili pohon se “avancimi i shkencës së tefsirit duhet të fillojë nga reanimimi i hulumtimeve linguistike dhe zhvillimi i shijes letrare.”

Është analizuar intelektuali në zë, Emin Huli, është theksuar kontributi i tij në metodat interpretuese, të gjuhës dhe

stilistikës, éshtë cekur mendimi i tij se "Kur'ani éshtë vepra më e shenjtë letrare-artistike" dhe apeli i tij që Kur'ani të studiohet në kontekstin gjithëpërfshirës.

Autori thekson edhe nxënësen (e më vonë edhe gruan) e Hulit, Aishe Abdurrahman, e cila vazhdoi zhvillimin e mendimeve të tij.

Vend me rëndësi në trajtim i dha edhe nxënësit tjetër, Shukri Ijjadit, i cili tentoi të depërtojë në intencat e Kur'anit, sidomos në synimet humaniste dhe shoqërore të Kur'anit, që e çoi atë në studimin e lidhjes mes fesë dhe artit, dhe ndihmoi në komentimin letrar të Kur'anit. Pastaj, autori shqyrton qëndrimet e M. Arkunit, nevojën siç pretendon Arkuni që Kur'anit t'i qasemi sidomos duke e lexuar në aspektin semiotik dhe linguistik. Në këtë qasje, duhet përdorur konceptet metodologjike të afërt apo të ngjashme që janë përdorur edhe në analizat e Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re, duke përfshirë edhe të arriturat nga fusha e religjioneve krahasimtare, historisë së religjonit, historisë së tefsirit dhe teologjisë, duke konsultuar edhe semiotikën, linguistikën, historiografinë, sociologjinë dhe antropologjinë.

Në pjesën e fundit, autori O. H. El-Kijjam, e trajton Nasr Hamid Ebu Zejdin dhe të kuptuarit të tij të Kur'anit, përkatësisht konceptin e tekstit dhe natyrën e gjuhës fetare. Ai mbanë qëndrimin se Kur'ani éshtë i krijuar (sikurse mu'tezilitët) dhe se qasja ndaj Kur'anit mund të jetë letrare, si produkt kulturor dhe kjo qasje nuk e mohon prejardhjen hyjnore të Kur'anit.

Pastaj ai e mbylli librin e tij me një përfundim që përbledh rezultatet e librit, të cilat në përgjithësi mund të përmblidhen në veprën "*Karakteri letrar i tekstit kur'anor*", analizohen tre rrafshe të përdorimit të gjuhës në komentimin bashkëkohor të Kur'anit:

- 1) Përdorimi i gjuhës me qëllim të komentimit ekzoterik të Kur'anit;
- 2) Përdorimi i gjuhës me qëllim të komentimit ezoterik të Kur'anit dhe;
- 3) Përdorimi i gjuhës me qëllim të shpjegimit të i'xhazit (mrekullisë) të Kur'anit.

Edhe pse vepra ka mangësi të caktuara doktrinore, si favorizimin e teorive të autorëve që trajton, vepra paraqet risi për lexuesin e arsimuar fetarisht, sidomos ata të dhënë pas tefsirit dhe teorive të qasjes dhe metodologjisë. Vepra është shkruar në një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë shkençore, pa komplekse, ndërsa trajton një temë plot terma të ardhur. Një studiues i specializuar i Kur'anit dhe shkencave të tij duhet ta lexojë këtë libër dhe të përfitojë prej tij.

Përkthyesi dhe botuesi meritorjnë çdo lëvdatë për punën e tyre dhe dhënien e mundësisë që studentët e fesë islame dhe studiuesit e lirë shqiptarë të kenë qasje në lëvizjet ideo-re në çështjet e Kur'anit, tefsirit dhe Islamit në përgjithësi.

*Nexhat Ibrahim  
Gusht, 2022, Prizren*

# Parathënie

Falënderimet i takojnë Allahut. Atij falje dhe udhëzim i kërkojmë! Përshëndetjet dhe salavatet ia dedikojmë të Dërguarit të Allahut, Muhamedit të birit të Abdullahut, pastaj familjes, shokëve dhe të gjithë atyre që e ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykit.

Instituti Botëror i Mendimit Islam më dërgon shpesh libra për të marrë mendimin tim, për t'i botuar në grupin e veprave të tyre dhe për të mësuar nivelin e përshtatjes së tyre me objektivat e Institutit, megjithatë pak janë librat që më gjëzojnë dhe që kanë tematika të kënaqshme. Ndonjëherë i paraqes Institutit ndonjë vepër para se ata të ma kërkojnë. Në mesin e këtyre pak librave është edhe ky libër, të cilin kur e lexova, aty hasa kontributin e studiuesit të mirëfilltë, diturinë, shkaktësinë, prirjen letrare dhe aftësitë e një kritiku vizionar dhe të thellë. Fillova ta lexoj dhe nuk e hoqa nga dora derisa e përfundova, bile kisha dashur të zgjaste, të vazhdonte dhe të mos ndalonte te metoda dhe te modeli i vetëm dy dijetarëve, veprat e të cilëve i ka diskutuar. Metodat që i ka trajtuar duket sikur ka spikatur një domethënie dhe një detyrim (metodologjik) për metodat që nuk i ka theksuar. Kjo hedh mbi supet e lexuesit përgjegjësinë e leximit të thelluar, ekzaminues dhe të thukët të këtij studimi, në mënyrë që përmes kësaj që ka potencuar të arrijë tek ajo që nuk e ka theksuar.

Në veprën “Karakteri letrar i tekstit kur'anor”, ku unë preferoj konceptin “diskurs” në vend të konceptit “tekst” për shkaqe të cilat nuk është vendi për t'i shpalosur. Vështrimi në këtë vepër buron nga ajetet fisnike, të cilat janë

zbritur në Kur'an në kontekste të ndryshme. Janë zbritur "Në gjuhën arabe të pastër" (Esh-Shuara: 195) dhe në gjuhën që s'ka shtrembërimë dhe as kundërshti. Kur'ani Fisnik e ka sfiduar mbarë njerëzimin, xhinet dhe veçanërisht arabët që të sjellin diçka të ngjashme si ajo që zbritej. Pastaj vija sfiduese u ul në dhjetë sure apo edhe në një sure të vetme. Kështu, u konfirmua paaftësia e arabëve dhe e të tjerëve për ta bërë diçka të tillë. Në këtë mënyrë sfida mbeti pa përgjigje, edhe pse pretendimet ishin të ndryshe. Studiuësit dhe letrarët bënë prononcime të ndryshme për shkakun e kësaj paaftësie. Disa thanë se shkaku i pamundësisë (për ta sfiduar Kur'anin) fshihet në stilin e lartë të Kur'anit. Disa thanë se shkak është retorika kur'anore, disa elokuanca kur'anore, disa të tjerë e pandehën thurjen poetike si shkak, kurse një grup tjeter i potencuan të gjitha këto. Thanë e çfarë s'thanë, por "karakteri letrar i këtij ligjërimi" e kalon pikën kulmore të asaj që predikon "teksti letrar arab", qoftë ajo poezi, prozë apo ndonjë krijim tjeter letrar i rimuar përgjatë etapave të lulëzimit të historiografisë arabe.

Kur'ani ka vënë re ndërhyrjen e Zbritësit për t'ia lehtë-suar arbit soditjen dhe meditim e Kur'anit. Kështu, ligjërimi kur'anor e ringjall kujtesën dhe potencialin e vetëdijes. Allahu xh.sh. thotë: "Ne e lehtësuam atë me gjuhën tënde, e me çka përkujtoni?" (Ed-Duhan: 58). Zoti i Gjithëfuqishëm thotë: "Ne e lehtësuam Kur'anin për përkujtim, a ka ndonjë përkujtues?!" (El-Kamer: 17) Pavarësisht lehtësimit hyjnor dhe ofrimit të mundësisë së sfidës, nuk pati reaksion dhe u konfirmua mrekullia e Kur'anit. Kjo bëri që të kooperojnë paralelisht teoria e mrekullisë (i'xhazit) dhe karakteri letrar i ligjëritimit (kur'anor) për ta ofruar këtë libër të përhershëm si një mrekulli madhështore dhe të përjetshme deri në Ditën e Kiametit. Ky kooperim konfirmon vërtetësinë e asaj që ka ardhur me të vërtetën dhe është konfirmuar si e tillë. Konfir-

mon urtësinë dhe universalizmin e këtij libri, përjetësinë e shariatit dhe të rrugës së tij. Gjithashtu, ky kooperim konshtaton gjithë-përfshirjen e veçorive universale të sheriati, të cilat janë të vlefshme për çdo kohë dhe për çdo vend.

Diskutimi që u provokua në historinë dhe në trashëgiminë tonë kulturore rrëth “krijimit të Kur'anit” dhe rrëth tezave se në Kur'an përfshihen huazime të arabizuara, homonime, sinonime, figura metonimike, figura metaforike, paronomazi, kiraetet (leximet) e parregullta, përsëritje dhe të tjera, nuk e dobësuan qenien mrekullore dhe as fuqinë sfiduese të Kur'anit. Megjithatë, betejat e Kur'anit Fisnik kundër armiqve të tij vazhdojnë qysh në fillimet e zbritjes dhe deri më sot, madje nuk do të pushojnë deri në Kiamet. Çdokush që tregon armiqësi ndaj Kur'nit Fisnik, sfidohet dhe poshtërohet.

Në dy shekujt e kaluar dolën në skenë shumë dyshime të paqena më parë, ku gjuha arabe u mor si objektiv për t'u margjinalizuar dhe u bë cak i shpifësve, të cilët kërkonin të shpërfilltet dhe të tejkalohet. E konsideruan atë si gjuhë të dalë nga përdorimi (gjuhë e vdekur), e cila nuk përmban asnjë element shkencor, argumentues, kulturor dhe qytetërures, kurse poseduesit dhe folësit e saj si “dukuri tingullore” (d.m.th. si njerëz që vetëm flasin dhe dinë asgjë). Qëllimi i krejt kësaj ishte të ulin vlerën e Kur'anit Fisnik, “i cili e garanton dhe e mbikëqyr gjuhën arabe”. Dikush thoshte: “Mesazhi islam është nacional, ligjërimi i tij është i kufizuar dhe nuk është universal. Gjuha e tij është gjithashtu nacionale (vendore), mbështetur në ajetin “*Nuk kemi dërguar asnjë pejgamber, përvëç se me gjuhën e popullit të vet, në mënyrë që t'u sqaron atyre. Allahu e humb atë që do dhe e udhëzon atë që do. Ai është i Gjithëfuqishëm, i Urtë*” (Ibrahim: 4) Disa të tjerë thanë se Kur'ani zbriti në gjuhën e të Dërguarit për t'i dedikuar atij dhe popullit të tij, pa iu dedikuar joarabëve. Popujt

analfabetë, bile edhe ata që dinin shkrim e lexim, hynë në Islam me dhunë. Pra, ai që nuk i takon etnikumit arab, Kur'ani nuk i drejtohej atij, prandaj nuk ka pse të humb jetën në mësimin e saj apo duke i shërbyer një gjuhe që i takon një etnie tjeter dhe mbi të gjitha nuk renditet në mesin e "gjuhëve të gjalla". Sipas pikëpamjes së tyre, gjuha arabe nuk meriton dhe nuk është e aftë të jetë "gjuhë shkencore".

Gjithashtu u përhapën shumë operacione për uljen e vlerës së gjuhës arabe në mesin e atyre që pritej të ishin xhelozë për të, të ngriheshin për ta mbrojtur atë dhe t'i ofrojn asaj të gjitha mjetet për t'i dhënë asaj karakter e një gjuhë mbarë botërore, sepse Allahu xh.sh. i ka falur potential dhe specifike që ajo të jetë gjuhë komunikuese e përbashkët për gjithë popujt e tokës, veçanërisht sot kur Allahu i ka furnizuar arabët me pasuri dhe njerëz, dhe u ka mundësuar të jenë në epërsi nëse do të posedonin vullnet të singertë dhe vetëdije të mjaftueshme.

Arabët duhej të krenoheshin me gjuhën e tyre, t'i ndihmojnë popujt muslimanë që kanë dëshirë ta mësojnë atë, sepse ajo cilësohet gjuhë e Kur'anit Fisnik, dhe të zgjoheshin vrullshëm për ta ngritur atë në nivelin e gjuhës universale (botërore). Në vend të kësaj, shumica e arabëve iu përgjigjën thirrjeve të armiqve për ta marginalizuar dhe për ta anashkaluar atë, ku u thuhej atyre: "Nëse jeni të vendosur për ta ruajtur atë dhe për të mos e lënë anash, atëherë bëjeni atë pjesë të trashëgimisë suaj dhe përdorni dialektet në vend të saj, sepse dialektet janë të pasura me stilistikë dhe me retorikë që i shërbejnë gjuhës standarde." Me këtë anashkalim të gjuhës standarde mbërriti puna deri në atë nivel, saqë sot folësi arab ndjehet i huaj në shumë vende arabe dhe nuk mund të merret vesh me njerëzit, sepse e ka shpërfillur arabishten dhe nuk i ka dhënë asaj rëndësi në detyra dhe punë të llojullojshme. Ata flasin për ringjallje, për rene-

sancë, për reformim, e qajnë krijimtarinë (e mëhershme) dhe bisedojnë për regresin e potencialeve intelektuale, shpirtërore dhe logjike të popujve arabë dhe muslimanë. Flasin gjerësisht dhe për sintetizime të ndryshme për shkaqet e krejt kësaj, por në mesin e këtyre shkaqeve nuk e theksojnë shpërfilljen e gjuhës së umetit, marginalizimin dhe largimin e saj nga familjet dhe shtëpitë e tyre, pos në raste shumë të rralla, edhe pse ky është shkaku kryesor i prapambetjes, i regresit dhe i krizave që i jeton umeti.

Leximet bashkëkohore kanë lindur në hijen e izolimit të gjuhës standarde arabe dhe në intensifikimin e sulmeve shpërfillëse dhe marginalizuese ndaj saj. Pavarësisht nëse këto kanë nisur në vrullin e drejtimeve të modernizmit apo të postmodernizmit, sepse të dyja këto drejtime bashkëveprorjnë në nismën për heqjen e shenjtërisë së tekstit (hyjnor). Parimi i "heqjes së shenjtërisë nga teksti (hyjnor)" dhe qasja ndaj tij pa respekt të madh, gjë e cila i jep lexuesit dhe interpretuesit liri më të madhe ndaj tij, është një parim i lashtë, i cili i ka rrënjet në trashëgiminë tonë. Ndoshta problemi i "krijimit të Kur'anit", i cili qarkullonte në qarqet e mutezilitëve është një reflektim dhe një aspekt i këtij parimi. Çdo diskutim që zhvillohet rreth hollësive të këtij parimi, me krejt atë që lidhet me të, paraqet edhe efektet e atij parimi në studimet e llojlojshme kur'anore. Këtu bëjnë pjesë edhe studimet letrare, kritike dhe stilistike. Për këtë arsy, ky parim kishte efekt të dukshëm në qëndrimet e dijetarëve të kelamit dhe në fraksionet që i takonin atij, si në prizmin e tekstit kur'anor, ashtu edhe në mënyrën e qasjes së tyre ndaj tij.

Ibn Kutejbe (vdiq në vitin 276 h.) filloi me veprën "Te'vilu mushkili el-Kur'ani", mirëpo kjo nuk e shoi këershërinë e Xhahidhit (i vdekur më 255 h.), ngase ai nuk shihte të mjaf-tueshëm këtë qasje "për t'i pastruar të gjitha shpifjet ndaj

Kur'anit". Pastaj Kadi Abdulxhebbari (i vdekur më 415), këtë emërtim "Tenzihu el-Kur'an an el-metaini", e përzgjodhi për titull të veprës së tij. Xhahidhi ka shkruar studime të rëndësishme në "kompozimin kur'anor", ka bërë përpjekje serioze të zhvillojë një "teori të kompozimit" dhe kështu ka hapur një rrugë të pa trasuar më parë. Ajo teori thoshte se "kompozimi është garantuesi i brendshëm i Kur'anit dhe ai që në një anë e shfaq mrekullinë e Kur'anit, kurse në anën tjetër e mbron atë nga depërtimi i elementeve (relative). Në kuqtim të kësaj teorie është ajeti kur'anor "*Atij nuk i avitet e kota as nga para e as nga pas*" (Fussilet: 42). Në rast të tejkalimit apo të shpërfilljes së "teorisë së kompozimit", kjo ndjell fjalë anësore atëherë. Ky është interpretimi i vetëm i "teorisë së mrekullisë". Mendimtarët mutezilitë, pasi e adaptuan idenë e "krijimit të Kur'anit", nuk patën mundësi ta përkrahin "teorinë e mrekullisë gjuhësore dhe retorike" të Kur'anit famëlartë.

Një sërë leximesh bashkëkohore erdhën brenda projektit të reformimit islam. Këto lexime u ofruan nga reformistët të cilët ishin të njobur për përkushtimin e tyre ndaj Islamit si nismë e ripërtëritjes së umetit, e ringjalljes së efikasitetit të tij dhe e vendosjes së tij në rrugën e riformimit dhe të ixhi-hadit. Gjithashtu, këto lexime nisin nga parimi se interpretimi i Kur'anit patjetër të reformohet në korrelacion me kohën, sepse njerëzit e çdo kohe duan ta shohin Kur'anin si t'u jetë zbritur atyre. Kjo kërkon që fillimisht ata ta kuptojnë dhe ta interpretojnë vetë atë, pastaj të mos ia imponojnë vetes interpretimet klasike, sepse ajo mund t'i privojë nga zbulimi i raportit të ngushtë të Kur'anit fisnik me vetë ata dhe me problemet e tyre dhe të kohës së tyre. Ndërsa iniciuesit tjerë të projekteve ndryshuese, të cilat nuk u ngritën mbi themelit islame dhe nuk e kishin pikënisje Islamin, përpinqeshin të ofrojnë interpretime dhe tefsire që lejonin

funktionalizimin e tekstit (hyjnor) për t'u dhënë legjitimitetin e nevojshëm projekteve moderne dhe shuarjen e përpjekjeve që kishin nevojë për operacionet modernizuese, por që nuk mbështeteshin në dogmën perëndimore.

Përpjekjet tefsirike dhe interpretuese të Kur'anit, qysh në fillim të kontaktit tonë me Perëndimin, cilësohen si "avitje" e ngritur për dëshirën e përafrimit me rrymat perëndimore. Pastaj cilësohen si "krahasim" me të cilin kërkonin të shfaqin epërsinë e parimeve islame dhe të Kulturës islame, kur ajo lulëzonte mbi kulturën bashkëkohore të Perëndimit. Në të dy rastet referencë është Perëndimi. Autorët e "leximeve bashkëkohore" të Kur'anit janë thjesht përkthyes, sepse ata përkthyen atë që shkruan mendimtarët dhe teologët perëndimorë, dhe atë që shkruan linguistët që njihnin Dhiatën e Re dhe të Vjetrën ..... Në studimin vijues, Omer Hasen El-Kijjami do të na informojë për rrjedhën e mendimeve të "autorëve të leximeve" bashkëkohore.

Ky hulumtim është i lidhur me "teorinë e tefsirit", i cili duke iu qasur atij nga këndi "letrar i tekstit kur'anor", plotëson një zbrazëtirë të paplotësuar nga shumë shkrime të publikuara në sferën e kritikës së leximeve bashkëkohore. Ky tip i vrojtimit të çështjeve sipas metodës së Muhamed Abduhusë dhe Emin Hilit, si dhe vrojtimi që lanë Nasr Hamid Ebu Zejd dhe Muhammed Arkun, do të ngjall tek lexuesi ndjesinë e krahasimit dhe do ta përgatitë atë intelektualisht dhe shpirtërisht të perceptojë dallimet thelbësore mes leximit që nis nga pikëpamja e përmrbajtjes së (fondamentit) islam dhe të trashëgimisë islame të shoqëruar nga "qëndresa epistemologjike" në njëren anë, dhe të leximit që pretendon "objektivizmin" nga ana tjeter. Ky krahasim nuk sheh ndonjë antagonizëm mes këtij pretendimi objektivist dhe përshtatjes së leximeve të Dhiatës së Re dhe të Vjetër në leximin e Kur'anit Fisnik. Po ashtu, ky krahasim do të evitojë edhe

shumë dallime të tjera në favor të një pike të vetme të përbashkët, në faktin ku të tre librat cilësohen si libra fetarë.

Allahu e shpërbleftë me gjitha të mirat autorin e këtij studimi me vlerë, për të cilin shpresojmë të shndërrohen në një projekt ku do të vazhdojë të derdh mundin e vet! Allahu na mundësoftë ne dhe atij të arrijmë atë që e kënaq Atë!

*Dr. Taha Xhabir Alvani*

# Hyrje

Kërshëria e shkrimit në këtë tematikë (karakteri letrar i tekstit kur'anor) lindi gjatë redaktimit të librit "El-Intisaru li el-Kur'an" të Imam Bakilaniut (El-Bakil-lani). Ky libër më aviste jehonën e shumë dyshimeve bashkëkohore të cilat i adresohen historisë së Kur'anit, strukturës dhe mësimeve semantike unike të tij. Isha shumë i magjepsur me paraqitjen kritike që shpaloste Bakilani në diskutimet me kundërshtarët, si u përgjigjej dyshimeve të tyre për pretendimin e elementëve shtesë apo mangësive në tekstin kur'anor. I inspiruar nga kjo mbrojtje e denjë e Kur'anit, më erdhi ndër mend ideja e shkoqitjes së leximeve bashkëkohore të Kur'anit, veçanërisht leximeve që shkëlqyen brenda metodologjike gjuhësore me theks të veçantë.

Leximi letrar i Kur'anit është një nga reaksionet epistemologjike që i përgjigjet mendësisë së muslimanit arab brenda logjikës së kohës dhe sfidave të saj. Pavarësisht rrënësive të thella të letërsisë në trashëgiminë e hershme (arabe), veçanërisht te interpretuesit e Kur'anit dhe te ata që janë preokupuar me teorinë e i'xhazit (mrekullisë) së Kur'anit, përsëri ekzistojnë dallime rrënësore mes metodës së leximit letrar klasik dhe modern. Këto dallime lindin nga transformimet thelbësore që janë zhvilluar në konceptet gjuhësore, letrare dhe interpretuese. Detyra themelore e këtij libri është të përbledh thelbin e natyrës së leximit letrar bashkëkohor. I trajton mjetet e këtij leximi, aspektet reformuese që shkëlqejnë në kontekstin e saj. Ky lexim dallohet me tre nivele gjuhësore, të cilat e përbëjnë ligamentin e këtij leximi bashkëkohor. I pari është niveli i cili e vë gjuhën në funk-

sion të tefsirit (komentimit), pastaj është niveli që e vë gjuhën në funksion të te'vilit (interpretimit më të thellë) dhe së fundmi është niveli i cili e vë gjuhën në funksion të sqarimit të mrekullisë së Kur'anit. Siç shihet, këto nivele janë të përbashkëta në sferën e gjuhës, e pastaj përmes tyre fitohen mjetet dhe njohuritë gjuhësore. Duke u bazuar në këtë dallim, do të ndaloj te studimi dhe analizimi i këtyre niveleve se si ato paraqiten në leximet letrare të tekstit kur'anor në kulturën arabe bashkëkohore.

Ky studim spikat dy drejtime themelore të leximit bashkëkohor të Kur'anit: drejtimi stilistik dhe drejtimi interpretues. Pavarësisht kryqëzimeve të dukshme mes këtyre dy drejtimeve, ato kanë një ndryshim vizionar të thellë nga njëra-tjetra. Nuk gabohet nëse thuhet se drejtimi i parë është drejtim kuptimor i kërkon të ngulitë leximin imanor (besimor) të Kur'anit dhe hulumton horizonte të reja të teorisë së i'xhazit (mrekullisë) së Kur'anit nën ombrellën e horizontit epistemologjik modern, pa e inkuadruar këtu leximin honorifik, i cili nuk le as hapësirën më të vogël të veprimtarisë kritike. Në anën tjeter, drejtimi tjeter u inkorporua në një tip leximi i cili ngríhej mbi bazën e dyshimeve dhe të tendencës kritike. Ky drejtim (drejtimi interpretues), në esencë e cilëson tekstin kur'anor si tekst gjuhësor, i cili u formësua brenda një konteksti kulturor që u nënshtrohet instrumenteve të analizës dhe e lë mënjanë konceptin e shenjtërisë fetare ndaj tekstit (kur'anor).

Në kreun e parë (të librit) jam ndalur te përpjekjet themeltare të Muhamed Abduhusë pér ta shpëtuar teorinë e tefsirit (komentimit) të Kur'anit dhe pér ta mbrojtur atë përballë horizontit të kohës. Muhamed Abduhu ishte shumë i vetëdijshëm pér rëndësinë e gjuhës arabe në ripërtëritjen e ndjesisë kohore përballë tekstit kur'anor. Me vizionin e tij të mprehtë kishte mundësi të përzgjedhë tekstet orientuese

nga trashëgimia arabe, tekste të cilat do të ishin në gjendje të krijojnë një ndjesi më të kristalizuar dhe një atrim të Kur'anit fisnik me prirjen gjuhësore, e cila në natyrë dallon nga prija gjuhësore arabe e përgjithshme, dhe atë në aspektet e mjeshtërisë gjuhësore dhe në finesat shprehëse, të cilat qëndrojnë si barrierë mes unit lexues dhe vetë tekstit. Këtu mund ta spikatim mendjemprehtësinë e theksuar të Muhammed Abduhusë, veçanërisht kur ai iu qas trashëgimisë së Abdulkadir Xhurxhanit të përfaqësuar në dy librat unik të tij, "Delailu el-i'xhaz" dhe "Esraru el-belagati". Në këto libra del në sipërfaqe vendosmëria e tij për ta aktualizuar stilistikën arabe, ngase përpjekjet e klasikëve arritën kulmin e mundshëm, kurse periudha pasuese ishte një rrugëtim drejt degradimit të stilistikës arabe, ngase atëbotë iu turrën asaj problemet komplekse filozofike dhe logjike. Kështu, ajo u izolua në tunelin e regresit duke pritur që dikush t'ia kthejë estetikën letrare dhe gjuhësore.

Teoria e komentimit (tefsirit) u kristalizua te Muhammed Abduhu përmes ndjesisë që krijonte shtypja e mendësisë moderne dhe shtypja e pyetjeve komplekse, të cilat ballafqohen me mendësinë fetare në nivel njerëzor. Gjithashtu, ka dhënë kontribut të madh në rrugën e mbrojtjes së të vërtetave fetare universale. Krahas besimit të thellë të tij se Kur'ani fisnik është libër udhëzues, ai rrëshqiti në ritmin e shpejtë të kohës, prandaj e përdori gjuhën alegorike në interpretimin e shumë ajeteve kur'anore, të cilat e goditën edhe mendësinë moderne. Megjithatë, kjo nuk e zvogëlon faktin e të qenit pionier modern, ku pastaj këto lëvizje moderniste vërshuan në thellësinë e komentimit të Kur'anit. Ai u përpoq me sinqueritet dhe përkushtim të theksuar të ndryshojë karakterin e të menduarit te lexuesi modern i Kur'anit Fisnik.

Pas Muhammed Abduhusë erdhi Emin Huli, i cili cilësohet si një pionier i zellshëm dhe i pajisur me inteligjencë dhe

dituri. Emin Huli ishte i përkushtuar në potencialin e vet për ta ripërtërirë leximin kur'anor. Ishte i mbështjellë fund e krye me kulturën burimore arabe dhe me kulturën perëndimore, të cilën e kishte studuar në dy gjuhë: në gjuhën gjermane dhe italiane. Në këtë mënyrë, me shumë maturi iu turr betejës së reformimit. Ideja e reformimit të leximit kur'anor dominonte dukshëm në mendimin e tij, prandaj ofroi një vështrim të leximit, i cili bazohej në faktin se Kur'ani është teksti më i arrirë letrar përballë të gjitha teksteve të tjera të kulturës arabe, dhe se "karakteri i tij letrar" shumë madhështor i bëri arabët oratorë që t'i nënshtrohen mrekullisë së tij shprehëse. Nisur nga kjo, Emin Huli bëri thirrje për një studim metodologjik i cili pikënisje dhe pikë përfundimi e ka gjuhën. Në këtë mënyrë konstatoi se mrekullia thelbësore e Kur'anit është mrekullia gjuhësore, kurse prova fetare në mendjen njerëzore ndërtohet mbi bazën e kësaj (mrekullisë gjuhësore). Po ashtu, në bazë të kësaj pastaj paraqiti mendimin e tij të prerë për mospërkthimin e Kur'anit fisnik dhe largimin nga vardisja pas teorive shkençore dhe shpikjeve moderne, për të cilat pretendohej se e afrojnë Kur'anin me mendësinë humane moderne.

Emin Huli ishte i vetëdijshëm për rolin prijatar, prandaj e themeloi grupin "El-Umenau" (Besnikët), në të cilën u anëtarësua një numër i konsiderueshëm i studiuesve. Në krye të tyre qëndronte Muhamed Ahmed Halefullah, Shukri Ajadi, Aishe Abdurrahman. Të gjithë këta kontribuuan dukshëm në teorinë e komentimit bashkëkohor, pavarësisht dallimeve të theksuara mes tyre, veçanërisht në rrafshin praktik. Në kreun e dytë studimi është përqendruar në dy anëtarë të grupit "El-Umena", gjegjësisht tek: Aishe Abdurrahman dhe Shukri Ajjad, ku janë analizuar komponentët metodologjikë dhe leximi praktik i dy kritikëve të lartpërmendur, kuptohet, duke i shkoqitur aspektet e origjinalitetit shken-

cor, të cilat tregojnë se Shkuri Ajadi ishte më i prirë për t'i zbatuar propozimet teorike të propozuara nga mësuesi i tij Huli, për zhvillimin e teorisë së komentimit (të Kur'anit) dhe shtimin në të. Nuk u mor në konsideratë disertacioni që provokoi shumë debat, i shkruar nga Muhamed Ahmed Halefullah, me titull "El-Fennu el-kisasiju fi el-Kur'ani el-krimi", i cili ishte edhe shkak i kthesës së theksuar që ndodhi në metodën e komentimit letrar (të Kur'anit).

Sa i përket drejtimit tjeter (drejtimit interpretues), në kreun e tretë dhe të katërt janë ndalur te kontributi i Muhammed Arkun dhe i Nasir Hamid Ebu Zejdit për zhvillimin e leximit bashkëkohor të Kur'anit. Krahas reflektimit të tmerrshëm që paraqesin te vetë lexuesi shkrimet e Arkunit në nivelin epistemologjik, ato nuk paraqesin ndonjë prurje madhështore në leximin modest të ofruar në këtë kontekst. Arkuni e hodhi krejtësisht teorinë klasike të komentimit dhe i kritikoi me theks thumbues studimet filologjike, të cilat shkëlqyen në kontekstin e studimeve orientaliste rreth tekstit kur'anor. Në të njëjtën kohë proklamoi një lexim që i flakte leximet e mëparshme, saqë kur hidhej në mjedisin e komentimit, e kuptonte se prirja e tij e zbehtë historike e shtyri atë të flasë me këtë gjuhë të kompleksuar nga njohuritë moderne, e cila pastaj kundërshtohet nga vetë teksti kur'anor, ky tekst i cili në fillim ishte bazuar në idenë e "sqarimit" gjuhësor dhe larg nga simbolizmi i gjuhës fetare apo nga interpretimi që mund t'i bëhet nga leximi gnostik.

Në kreun e katërt kam ndaluar te përpjekjet e Nasr Hamid Ebu Zejdit, i cili ka vepruar në sferën e zhvillimit të afërsisë letrare me Kur'anin. Pavarësisht problemeve të diskutueshme të nxitura nga ky studiues në kontekstin e kulturës bashkëkohore arabe, prurjet e tij shkencore janë të qarta, të realizuara me një përvojë të thukët në teorinë tradicionale të komentimit dhe me një pasion të dukshëm përfi-

tues nga teoria "hermeneutike" e interpretimit, e cila ka shkëlqyer në kontekstin e kulturës perëndimore. Gjithashtu, me shumë kujdes e paraqet mendimin e vet, i inspiruar nga shkolla e mësuesit të tij, Emin Hulit. Ndërsa, kontradiktat e theksuara në botëkuptimet teorike të Nasr Hamid Ebu Zejidit e bëjnë të vështirë renditjen e tij në radhët e kësaj shkolle. Ai është një lexues skeptik me tendencë kritikuese, i cili me një inteligjencë të fshehur përputhet me synimin themelor të Muhammed Arkunit. Ky synim është lëkundja e konceptit të shenjtërisë së tekstit kur'anor. Këtu del në shesh edhe çarja më e madhe mes Nasr Hamid Ebu Zejidit dhe grupit "El-Umena", sepse këta të fundit nisen nga ideja e sublimimit (madhështisë) letrare të tekstit kur'anor, dhe në këtë mënyrë konfirmojnë mrekullinë e tij me të cilën mund të depërtohet në zemrën njerëzore dhe të ndriçohet shpirti që gjurmon qëllimin kryesor të ekzistencës së njeriut.

Në këtë studim, në rrafshin metodologjik kam folur për teorinë e kontekstualizmit. I kam shpalosur mendimet teorike dhe i kam analizuar veprat praktike. Këtë e kam bërë në fryshtë e zbulimit të kontekstit që është përfaqur në to, pavarësisht nëse ishte kontekst modern apo klasik. Teoria e kontekstualitetit ndihmon në studimin e dukurive që kthehen në rrënjet e para. Kritika historike i detyrohet kësaj teorie për rezultatet që i ka ofruar, sepse veprat letrare, mendimet gjuhësore dhe kritike nuk mund të perceptohen, të kuptohen dhe as të vlerësohen të ndara nga konteksti i drejtpërdrejtë apo i tërthortë.

Falënderimi i takon Allahut, me begatitë e të Cilit plotësohen punët e mbara!

Omer Hasen Kijjami,  
Jordani, Irbid  
24 dhulhixhe 1431 h. / 30 nëntor 2010 gr.

**KREU I PARË**



# Themelimi dhe ballafaqimi

## Muhamed Abduhu dhe barra e themelimit

Muhamed Abduhu (1849-1905) konsiderohet si vazhduesi kritik dhe i vetëdijshëm i personalitetit të profesorit të tij, i reformatorit islamik të njohur, Xhemaludin Afganiut (1839-1897). Pavarësisht dallimeve thelbësore mes këtyre dy personalitetet, ndikimi i fuqishëm dhe efektiv i Afganiut te nxënësi i tij vazhdon të jetë një nga supozimet historike në kontekstin e marrëdhënieve mes atyre dyve. Për këtë çështje mund të mbështetemi në analizën gjurmuese dhe të thelluar të Albert Hauranit për karakterin e të menduarit te këta dy burra dhe nivelin e kontributit të tyre në zgjimin e prirjes fetare skolastike në Botën Islame, dhe atë brenda një konteksti kulturor shumë kompleks. Në këtë studim zbulohet paafësia kulturore e përgjithshme e Lindjes përballë Perëndimit, të pajisur deri në dhëmb me dije, me forcë dhe me sistem.

Kauzë themelore e Afganiut ishte ajo që e formësoi mendimin e tij, apo siç shprehet Albert Haurani, ishte mënyra për t'i bindur muslimanët se duhet ta kuptojnë drejt fenë dhe të jetojnë sipas mësimeve të saj.<sup>1</sup> Nëse e lexojmë me shumë vëmendje mendimin e Afganiut, atëherë do të shohim se ai me termin fe nuk nënkupton vetëm ritet dhe adhurimet individuale, por një kod etik social, i cili e paraqet Islamin si një qytetërim të mirëqenë në botën e moderuar. Ai “konsideron se veprat e njerëzve nuk janë vetëm në

<sup>1</sup> Albert Haurani, *El-Fikru el-arabiju fi asri en-nehdati* (1798-1939), përkthyer nga: Kerim Azkul, Beirut, Daru En-Nehari, botimi IV, 1986 m., f. 142; Ignasio Goldziher, *Medhahibu et-tefsiri el-islamiji*, përkthyer nga: Abdulhalim En-Nexhxhar, Beirut, Daru Ikre', botimi III, 1985 m., f. 348, ku për Afganiun thotë: “Ishte luftëtar i paepur dhe shumë aktiv në sferën e sistemit fetar dhe me përfaqësuesit fetarë. Ishte thirrës me përvojë në sqarimin e lëvizjes reformuese islamë fund e krye.”

shërbim të Allahut, por kërkojnë të krijojnë një qytetërim mbarënjëzor në të gjitha sferat.”<sup>2</sup> Albert Haurani konfirmon se ideja e “qytetërimit” në Lindje depërttoi përmes Afganiut, i cili, promotorin e parë të kësaj ideje, Guizion, e citoi në ligjëratat e veta për historinë e qytetërimit në Evropë. Pastaj Afgani i inspiroi nxënësit e tij, si Muhamed Abduhunë, me shkrimin e një artikulli ku e sqaron teorinë e librit (të Guizios), gjithashtu ia propozon të përkthehet në gjuhën arabe në vitin 1877. Koncepti i “përparimit” ishte ndër idetë më të rëndësishme të shtruara në këtë libër.

Idea e “përparimit” te disa reformatore pararendës të Afganiut, si p.sh. te Hajrudin Tunisiu (vdiq 1890 m.), ishte e lidhur me rolin e aparateve shtetërorë, administrativë, ligjorë dhe ushtarakë,<sup>3</sup> ndërsa Afgani e kundërshtonte këtë mënyrë të të menduarit dhe u kthye kah roli i fondamentit në procesin e përparimit. Fehmi Xhud’ani e ka sqaruar këtë dallim thelbësor mes këtyre dy studiuesve dhe e ka treguar edhe rolin heroik të realizuar nga Afganiu në këtë kontekst. Roli i fondamentit në procesin e përparimit ishte “një detyrë e këtij burri madhështor (e Xhemaludin Afganiut), i cili prej një vendi të largët erdhi në kryeqytetin e Hilafetit Osman. U end në çdo anë të shtetit (osman) dhe anekënd botës duke i rënë kambanës së rrezikut, duke i alarmuar të përgjumurit, duke i zgjidhur problemet, duke i provokuar potencialet (e ngujuara) dhe duke lënë gjurmët e veta të pashlyeshme në arsyet, mendjet dhe vullnetet (e besimtarëve)...”<sup>4</sup>

Ankthi i epërsisë perëndimore dominonte te vetë arsyaja dhe metodat e të menduarit te Afganiut. Në këtë kontekst, Afganiu konsiderohej si përballues i Perëndimit. Këtu vlen të theksohet dialogu i njohur i Afganiut me orientalistin

<sup>2</sup> Albert Haurani, *El-Fikr el-arabiju fi asri en-nehdati*, vep. e cit., f. 144

<sup>3</sup> Fehmi Xhud'an, *Esesu et-tekadadumi inde mufekkiri el-islami*, Aman, Daru Esh-Shuruki, botimi III, 1998, f. 156

<sup>4</sup> Po aty, f. 156-157

francez, Ernest Renan (1823-1892), i cili mbajti një ligjëratë në Universitetin e Sorbonës në vitin 1883 me titullin "Islami dhe shkenca", ku shkon deri aty saqë mban qëndrimin se Islami dhe shkenca "nuk përputhen, qëndrim i cili rezulton fjalën se Islami dhe qytetërimi nuk shkojnë bashkë."<sup>5</sup> Madje, kjo botë e degjeneruar, sipas pikëpamjes së Renanit, "nuk meriton që t'i kushton vëmendje mbetjeve fisnike të gjenialitetit grek, romak dhe të Palestinës hebraike."<sup>6</sup>

Në këtë kontekst, Albert Haurani transmeton nga Ernest Renani një nga idetë përcmuese ndaj kulturës islame, ku shprehet: "Çdokush që e vështron me vëmendje gjendjen e kohës, do të vërejë qartë dekadencën e shteteve islame aktuale, zmbrapsjen e tyre dhe mungesën e shenjave të mendimit te këta popuj, të cilët ishin të fokusuar vetëm në këtë fe, gjegjësisht në kulturën dhe edukatën e saj. Të gjithë ata që i prinë Lindjes dhe Afrikës janë të cekët në mendim, por me imazhin e një besimtari të vërtetë. Qarkorja e hekurt me të cilën e kanë mbështjellë kokën, ka bërë që të janë të myllur përballë shkencës dhe të paaftë pér të pranuar ndonjë ide të re."<sup>7</sup>

Pavarësisht ngurtësisë metodologjike të Renanit, ligjërrata e tij në esencë dhe në hollësi mbështetet në arrogancë dhe në racizëm kulturor. Këtë e përsërishte disa herë,<sup>8</sup> shtuar këtu edhe disa gabime shkencore që buronin nga tendanca fanatike, si p.sh. fjalët: "Mensuri, Harun Reshidi dhe Memuni, gjithashtu ishin njerëz që falnin namaz (me mllef)."<sup>9</sup>

<sup>5</sup> Albert Haurani, *El-Fikru el-arabiju fi asri en-nehdati*, vep. e cit., f. 151

<sup>6</sup> Xhait Hisham, *Urubba ve el-islamu: sadamu eth-thekafeti ve el-hadatheti*, përkthyer nga Talal Atrisi, Beirut, Daru Et-Taliati, vëllimi I, 1995, f. 33

<sup>7</sup> Albert Haurani, *El-Fikru el-arabiju fi asri en-nehdati*, vep. e cit., f. 151; Shiko prononcimin e Renanit në: Renani dhe Afgani, *El-Islamu ve el-ilmu munadheretu Renan dhe El-Afgani*, përkthim dhe studim i Mexhdi Abdulhafidhit, Kajro, El-Mexhlisu El-A'la li Eth-Thekafeti, vëllimi I, 2005, f. 34

<sup>8</sup> Xhait Hisham, *Urubba ve el-islamu: sadamu eth-thekafeti ve el-hadatheti*, vep. e cit., f. 36. Afganiu tregon se edhe disa personalitetë të zgjedhura të popullit francez ishin prej të parëve që u deshpëruan nga ligjëratë e Renanit. Afganiu e shfrytëzoi këtë reagim dhe e ktheu në replikë të parë kundër Renanit. Shih: *El-Islamu ve el-ilmu*, ligjëratë e Renanit dhe Afganiut, f. 51

<sup>9</sup> *El-Islamu ve el-ilmu*, f. 36-37

Kjo ligjëratë e provokoi zemërimin e Afganiut, prandaj u përvesh për ta kundërshtuar fuqishëm, "kundërshtim të thellë".<sup>10</sup> Afganiu, sipas Goldziherit, synon të "shpëtojë krenarinë e Islamin dhe fuqinë elastike të tij përballë qytetërimit"<sup>11</sup> Qëllimi themelor me këtë reagim ishte konfirmimi i të vërtetës, se "thelbi i Islamit është vetë thelbi i racionalizmit modern."<sup>12</sup> Ky është një pohim i rrethuar me rreziqe, prandaj ndolli jo pak kritika nga bashkëkohësit, të cilët e akuzuan se kjo ishte një parapërgatitje për ta fliuar realitetin islam në emër "të rehatisë së supozuar të muslimanëve."<sup>13</sup> Pavarësisht entuziazmit me të cilën kritikonte Afganiu, përsëri ekzistonte një ndjenjë e fshehur e dobësisë (muslimane) përballë epërsisë madhështore perëndimore. Kjo e detyroi Afganiun ta rikthejë të kaluarën e ndritur të qytetërimit arab-islam për ta treguar madhështinë e krenarisë islame. Pastaj i drejtonte sytë kah e ardhmja në mënyrë që Islami të dalë nga ngërçi kulturor. Pikërisht mes këtyre dy qëndrimeve formësohet defekti brendshëm dhe i dukshëm i realitetit të botës së prapambetur islame.

U ndala te qëndrimi i Afganiut ndaj kulturës perëndimore, sepse shumë lexime kur'anore bashkëkohore do të vazhdojnë të jenë të gjykuara me këtë qëndrim, kurse komentuesi modern do të vazhdojë të jetojë me ankthin e racionalizmit perëndimor dhe me metodologjitet e tij reformuese. Këtu veçohen vetëm disa lexime, të cilat burojnë nga bindjet e thella në Islam e të cilat mbërrinjnë deri në skajet e larta kulturore, si p.sh. leximi rrënjosor i Sejjid Kutubit në komentimin e tij të njojur "Fi dhilali el-Kur'an" (Nën hijen e Kur'anit), mirëpo ky përjashtim ndoshta është konfirmim i fondamentit paraprak, se komentuesi bashkë-

<sup>10</sup> Albert Haurani, *El-Fikru el-arabiju fi asri en-nehdati*, vep. e cit., f. 152

<sup>11</sup> Ignacio Goldziher, *Medhahibu et-tefsiri el-islamiji*, vep. e cit., f. 350

<sup>12</sup> Albert Haurani, *El-Fikru el-arabiju fi asri en-nehdati*, vep. e cit., f. 154

<sup>13</sup> Po aty, f. 154

kohor është i preokupuar me triumfet epistemologjike të mendësisë moderne. Sado të përpinqet të çlirohet prej tyre, ai nuk mund të prodhojë një lexim bashkëkohor të pavarur nga epistemologjia moderne e cila sundon në Perëndim.

Në këtë kontekst kulturor kompleks duhet folur për përpjekjet e Muhamed Abduhusë në themelimin e konceptit të leximit bashkëkohor të Kur'anit dhe të modernizimit të pikëpamjes së komentuesit, dhe të mjeteve të tij sipas nevojave dhe transformimeve që i dikton realiteti jetësor. Ky është një themelim (nismë) që buron nga pikëpamja e përgjithshme për reformë dhe ripërtëritje. Sipas Nasr Hamid Ebu Zejdit, "Preokupimi kryesor i Abduhusë është ta rihipë derën e ixthihadit në të gjitha aspektet e jetës sociale dhe intelektuale."<sup>14</sup> Prej gjërvave që e joshnin ishte ideja e profesorit të tij, e Afganiut, gjegjësisht ideja e botëkuptimit modern dhe të ri të Islamit.<sup>15</sup> Akkadi e pa përbledhur thelbin e këtij botëkuptimi me këto fjalë: "Gjëja më madhështore që përfitoi arsyja e shëndoshë dhe e ndritur nga ideja e profesorit (Afganiut) për çështjet e reformimit dhe të lirisë njerëzore, është se ai ia ktheu asaj besimin në doktrinë në kohën moderne, ia hoqi nga rruga praktike barrierat e regresit, të prapambetjes dhe të imitimit të verbër, sepse ai e ngriti atë mbi fondamentet e fesë dhe e pajisi me filozofinë e jetës, me të cilën ballafaqohen edhe filozofitë perëndimore."<sup>16</sup>

Muhamed Abduhu, në reformimin e disiplinës së tefsirit nis nga nevoja e ringjalljes së prirjes gjuhësore dhe mprehenj e ndjesisë letrare. Nuk e la pas dore përpjekjen për ta avancuar prirjen letrare dhe pastrimin e saj nga elementët e shumtë zbukurues gjuhësorë, të cilat i kanë mbërthyer

<sup>14</sup> Nasr Abu Zayd, "The Dilemma of the Literary Approach to the Quran," *Alif: Journal of Comparative Poetics*, no. 23 (2003): 19

<sup>15</sup> Po aty, f. 19

<sup>16</sup> Abbas Mahmud Akkad, *Muhamed Abduhu, Vezaretu eth-Thekafeti ve El-Irshadi El-Kaumiji, Silsiletu A'lami el-Arabi*, Kajro: Mektebetu Misre, f. 257

rrugët e mendimit dhe krijim (letrar) në epokat e mëvonshme. Bazuar në këtë pikëpamje, iu qas fondamenteve të trashëgimisë, me të cilat mund të krijohet një prirje gjuhësore e dëlirë dhe një ndjesi stilistike e mprehtë. Në vigjilje të këtyre fondamenteve qëndrojnë dy veprat të kritikut të njojur Abdulkadir Xhurxhani (vdiq 471 h.) "Delailu el-i'xhazi" dhe "Esraru el-belagati", në të cilat personifikohet kulmi i mendimit stilistik, i cili është i ndërtuar mbi bazën e stilit të teksteve (klasike themelore), si p.sh. Kur'ani, poezia dhe proza. Këto tekste e kanë të konfirmuar karakterin e lartë dhe të veçantë letrar. Pavarësisht karakterit të tyre partikular brenda standardeve të reja kritike,<sup>17</sup> Muhamed Abduhu u inspirua prej tyre në komentimin e Kur'anit Fisnik. Sipas Nasr Hamid Ebu Zejdit, "Dija universale të cilën Muhamed Abduhu e ka bartur nga mendimet e Xhurxhanit, është personifikuar në veprën "Tefsiru el-menar"<sup>18</sup>, e cila historikisht lidhet me përpjekjet e Muhamed Reshid Ridasë (i vdekur 1935), kryeredaktorit të revistës së njojur "El-Menar", gjegjësisht me njërin nga nxënësit më të denjë, më inteligjent dhe më të kujdeshëm ndaj mendimeve dhe trashëgimisë së Abdusë. Në këtë tefsir, Muhamed Reshid Rida i përmblodhi fjalët e profesorit të vet dhe në shumë raste edhe bëri shtesa. Pastaj, pas ajetit 125 të sures Nisa, gjegjësisht pas vdekjes së mësuesit të vet në vitin 1905, filloi të punojë me stil të pavarur.

Reshid Rida i sqaroi paqartësitet e kësaj pune të përbashkët kështu: "Filova të shkruaj përbledhjen e komentimit dhe ta publikoj në revistën "El-Menar", kuptohet vetëm pasi ia paraqitja vazhdimesht dhe pasi merrja miratimin e tij. Pastaj u zgjerova në tefsir sipas kësaj metode, ku fillova të sjell edhe atë që dija nga të tjerët dhe atë që më inspironte

<sup>17</sup> Ihsan Abbas, *Tarihu en-nekdi el-ebediji iinde el-arabi*, Beirut, Daru Eth-Thekafeti, botimi IV, 1983, f. 419

<sup>18</sup> Abu-Zayd, "The Dilemma of the Literary Approach to the Quran," f. 19

Allahu i Madhërishëm, bashkë me mësimet dhe urtësitë që nxirrja prej ajeteve. Mirëpo, edhe kur shkruaja diçka vetë, nuk dilja nga metoda e tij, por çdoherë kisha miratimin (indirekt) paraprak të tij.”<sup>19</sup>

Muhamed Abduhu e përcaktoi synimin e vet në komentimin e Kur'anit, synim të cilin e përmblodhi në këto fjalë: “Kuptimi i Librit është vetë feja e cila i udhëzon njerëzit në lumturinë e kësaj dhe të botës tjeter. Ky është objektivi më i lartë, kurse krejt hulumtimet dhe studimet tjera janë pësuese apo mjete të arritjes së këtij objektivi.”<sup>20</sup> Me theks kumbues pohon se “dispozitat praktike të cilat në terminologjinë islame i quajmë fikh, janë potencuar rrallë në Kur'an. Kur'ani më shumë përban edukim dhe motivim të shpirtrave kah lumturia, ngritjen e tyre prej llimit të injorancës dhe vendosjen në piedestalin e dijes. Po ashtu, Kur'ani i udhëzon njerëzit në jetën sociale, së cilës duhet t'i nënshتروhet secili që beson Allahun dhe Ditën e Fundit. Nuk ka asgjë më meritore në fikjun real dhe në këtë udhëzim se Kur'ani.”<sup>21</sup>

Kontributi gjuhësor formon themelin e parë në ndërtimin e metodologjisë së tefsirit te Muhamed Abduhu dhe konfirmon prerasi se shkalla më e lartë në tefsir plotësohet vetëm përmes këtyre çështjeve: “Kuptimi i thelbit specifik të fjalëve të renditura në Kur'an. Këtë, komentuesi mund ta arrijë vetëm nëse e përdor kontributin e gjuhëtarëve, pa u ndalur vetëm në fjalët e njërit duke i lënë të tjerët. Shumë fjalë në kohën e shpalljes përdoreshin me kuptime të veçanta, por pastaj u transformuan në kuptime tjera për pak kohë apo më vonë. Komentuesi duhet të jetë i përpiktë që ta komentojë Kur'anin sipas kuptimeve që janë përdorur në kohën e shpalljes. Më e drejtë është që fjalë kur'anore të

<sup>19</sup> Muhamed Abduhu, *Mushkilatu el-Kur'ani el-kerimi ve tefsiri sureti El-Fatiha*, Beirut, Daru Mektebeti El-Hajati, f. 7

<sup>20</sup> Po aty, f. 10

<sup>21</sup> Po aty, f. 12-13

kuptohet nga vetë Kur'an, pra të mblidhen të gjitha rastet ku përsëritet ajo fjalë dhe të analizohen.”<sup>22</sup>

Fjalia e fundit duket sikur është përfptuar nga Ibn Tejmija (vdiq 728 h.), i cili ka thënë: “Nëse dikush pyet: cila është metoda më e mirë e komentimit të Kur'anit? Përgjigja është se metoda më e saktë është që Kur'an të komentohej me Kur'an. Ajo që është përbledhur në një vend, interpretohet në një vend tjeter, kurse ajo që është thënë shkurtimisht në një rast, trajtohet gjerësisht në një rast tjeter.”<sup>23</sup>

Shihet dukshëm këtu se Muhamed Abduhu me këtë mendim dëshiron të tregojë domosdoshmérinë e kuptimit të gjuhës kur'anore sipas semantikës rrjedhëse në kohën e shpalljes, dhe në të njëjtën kohë e refuzon procesin e “rënies semantike” nga e tashmja kah e kaluara, duke mos i kushtuar vëmendje semantikës së fjalëve në kohën e zbritjes (së Kur'anit).<sup>24</sup>

Kurse hapi i dytë metodologjik, i cili është i lidhur me kontributin gjuhësor ka të bëjë me stilemat apo figurat stilistike letrare, dhe këtë komentuesi nuk e arrin dot pa treguar interes për diskursin retorik (letrar) apo pa e ushtruar atë. Kjo arrihet duke parë me vigjilencë hollësitë dhe finesat artistike dhe duke u ndalur në qëllimin e folësit. Vetëm njojja e këtyre arteve, kuptimi i këtyre problematikave dhe nxënia e dispozitave nuk e arrin atë që kërkohet.<sup>25</sup> Nuk duhet fshehur faktin se në këto fjalë ka një lloj nënveftësimi implicit, gjegjësisht ngecja dhe stagnimi që i kanë rënë mbi kokë letërsisë arabe, dhe të cilat e kanë cunguar prirjen letrare dhe e kanë dëmtuar aftësinë gjuhësore.<sup>26</sup> Më parë u

<sup>22</sup> Po aty, f. 15

<sup>23</sup> Ahmed Ibn Tejmije, *Mukaddime fi usuli et-tefsiri*, dimne (Mexmuu el-Fetava), hadithet e kësaj vepre i ka konfirmuar Amir El-Xhezzar dhe Enver El-Baz, Bejrut, Daru El-Xhil, botimi I, 1997, vëllimi XIII, f. 195

<sup>24</sup> Nasr Hamid Ebu Zejd, *El-Kiraetu el-edebijjetu li el-Kur'an: ishkaliyyatuha kadimen ve hadithen*, revista “El-Kermelu”, viti 50, 1997 m., f. 142

<sup>25</sup> Muhammed Abduhu, *Mushkilatu el-Kur'an el-kerimi ve tefsiruhu suretu el-fatihu*, vep. e cit., f. 16

<sup>26</sup> Vlen të theksohet këtu qëndrimi i prerë i Mahmud Muhammed Shakirit ndaj Muhammed Abduhusë enkas për këtë problematikë, i cili e akuzon për nënveftësimin që u bën disiplinave shkencore dhe kontributit të të parëve në fushën e

tregua kujdesi i veçantë i Muhamed Abduhusë për dy vep-rat e Xhurxhanit, "Delailu el-i'xhazi" dhe "Esraru el-belagati", të cilat ai i shpjegoi nëpër hallkat e dijes kur angazhohej për ringjalljen e prirjes letrare dhe gjuhësore.

Këtyre dy hapave u bashkëngjitet edhe hapi i tretë metodologjik, i cili është mësimi i rrethanave të njeriut. "Allahu xh.sh. e zbriti këtë libër dhe në të sqaroi shumë rrethana dhe karaktere të njerëzve. I sqaroi ligjet hyjnore në qenien njerëzore dhe na rrëfeu tregimet dhe ngjarjet më të bukura të zbatimit të ligjit të Tij."<sup>27</sup> Gjatë konstatimit të këtij hapi, Muhamed Abduhu diskuton duke thënë: "Nuk di se si dikush mund ta komentojë ajetin "*Njerëzit ishin një umet i vetëm, pastaj Allahu dërgoi pejgamberë përgëzues dhe qortues*" (El-Bekare: 213) pa i njohur rrethanat e njerëzve? Si ishin një? Si u ndanë? Çdo të thotë "ishin një"? Ky unitet ishte i dobishëm apo i dëmshëm? Çfarë ndikim pati dërgimi i pej-gamberëve tek ata?"<sup>28</sup> Muhamed Reshid Rida e komentoi këtë prononcim kështu: "Profesori, Allahu e mëshiroftë, rreth këtij ajeti ka shkruar një tefsir (komentim) që s'e gjen në asnje libër tjetër".<sup>29</sup>

Nasr Hamid Ebu Zejdi ndaloj te hapat metodologjikë që i trasoi Muhamed Abduhu në komentimin e Kur'anit dhe paraqiti një formë të thukët të kësaj metodologjike, e cila lidh fuqishëm dhe shkëlqyeshëm "dy pikat referuese: gjuhën në kontekstin historik të kohës së shpalljes dhe botën bashkë me ligjet, të cilat e vënë në funksion natyrën dhe shoqërinë në procesin e saj historik,"<sup>30</sup> duke pohuar se tek-sti kur'anor në kuptimin Abduhusë është "një strukturë

stilistikës, siç është p.sh. arritura e Sekakiut, Taftazaniut dhe të tjerrëve. Kjo ishte në kontekstin e ballafaqimit me institucionin e El-Azharit dhe të dijetarëve të saj tradicionalistë. Shih: Abdulkadir El-Xhurxhani, *Esraru el-belagati*, e lexuar dhe e komentuar nga Mahmud Muhamed Shakir, Kajro, Xhede, Metbeatu El-Medenijj, Daru El-Medenijj, botimi I, 1991, f. 21

<sup>27</sup> Muhammed Abduhu, *Mushkilatu el-Kur'an el-kerimi ve tefsiruhu suretu el-fatiha*, vep. e cit., f. 16-17

<sup>28</sup> Po aty, f. 17

<sup>29</sup> Po aty, f. 17

<sup>30</sup> Ebu Zejd, *El-Kiraetu el-edebijjetu li el-Kur'an, Ishkalijatuha kadimen ve hadithen*, vep. e cit., f. 142

gjuhësore kumtuese në kontekstin social, historik dhe e pakufizuar në kohë për nga fuqia e prodhimit semantik jashtë kornizës së këtij konteksti. Mirëpo, semantika e prodhuar jashtë kontekstit social-historik nuk do të thotë se duhet domosdoshmërisht (ta anashkalojë) strukturën gjuhësore kumtuese të tekstit.”<sup>31</sup> Muhamed Abduhu iu përvesh projektit të vet reformues, duke u mbështetur në kriterin e arsyes si kriter të parë në rrugën e kuptimit të Kur'anit. Rrënjet e këtij qëndrimi të Abduhusë i gjemë te mendësia e profesorit të tij, tek Afganiu, i cili thërriste “në pastrimin e veprimtarisë komentuese nga mbetjet si legjendat, mitet, devijimet gjuhësore, hadithet e shpikura, dialektikat apologetike dhe konkluzionet e dijetarëve tradicionalistë.”<sup>32</sup> Ky është një synim që domosdoshmërisht të kthen kah ballafiqimi me të tanishmen përparimtare evropiane, duke i parashtruar mendimit islam pyetje të ndryshme dhe të rënda, të cilave patjetër e ka t'u përgjigjet.<sup>33</sup> Ideja e shfaqjes së mundësive pajtuese mes Islamit dhe mendimit modern, është një nga objektivat kryesore të Muhamed Abduhusë në projektin e tij reformues.<sup>34</sup> Sipas Albert Hauranit, “vizioni i Renanit nuk dallon nga polet e mendimit islam modern”.<sup>35</sup>

Në këtë kontekst, patjetër duhet ndaluar te debati i njojur mes Muhamed Abduhusë dhe ministrit të jashtëm francez, Miyo Hantaux, kur ky i fundit shkroi një artikull për “Islamin dhe çështjen politike”, ku e qorton Islamin duke e cilësuar atë si besim që e degradon njeriun deri në skajshmëri, kurse Zotin e lartëson deri në pafundësi, kurse krishterizmi, sipas tij, është angazhuar ta ngritet krenarinë e

<sup>31</sup> Po aty, f. 142

<sup>32</sup> Ahmideh En-Nifer, *El-Insanu ve el-Kur'anu: vexhen li vexhihi*, Bejrut – Damask, Daru El-Fikri El-Muasiri, Daru El-Fikr, vëllimi I, 2000, f. 58

<sup>33</sup> Po aty, f. 58-59

<sup>34</sup> Albert Haurani, *El-Fikru el-arabiju fi asri en-nedhati*, vep. e cit., f. 178; gjithashtu shih: Hasnau Sulejman, *Muhamed Abduhu ve et-tefsiru el-aklijiu*, revista “Kitabatun muaseretun, viti 59, 2006, F. 84

<sup>35</sup> Po aty, f. 200

njeriut dhe ta afrojë atë me madhështinë hyjnore.”<sup>36</sup> Muhammed Abduhu i doli zot kësaj (akuze), u entuziazmua për t’iu kundërvënë kundërshtarit dhe e sulmoi fuqishëm duke i dëshmuar edhe fshehtësitë e fesë, ku nisi të konfirmojë me theks bindës madhështinë e doktrinës islame, e cila është ngritur nga burrat beduinë të një toke të thatë të cilët nuk e kanë nuhatur begatinë e qytetërimit dhe as e kanë shijuar kënaqësinë e shkencës dhe të artit. Megjithatë, ata arritën aty ku arritën dhe u ngritën në frone të larta të pushtetit. Pastaj, ia arritën të formojnë ndërgjegje të lartë dhe arsyë të dëlirë, të cilat u mundësuan të sillen me butësi me të gjithë popujt, duke zbuluar fshehtësitë dhe duke nxjerrë thesaret e dijes së tyre. Kështu, ata treguan epërsi ndaj evropianëve vetëm pas disa shekujve pas shpalljes.<sup>37</sup>

Akkadi e sqaroi rëndësinë dhe thukëtinë e këtij qëndrimi në kontekstin kompleks të luftës ideologjike me perëndimin, ku thotë: “Replikat e Muhammed Abduhusë kundër filozofëve dhe mendimtarë ishin më të rëndësishme për muslimanin e kohës sesa vetë replikat e mbrojtësve të Islamit përballë grupeve misionare dhe grupeve të devijuara. Dyshimet që hidhnin misionarët pothuaj të gjitha silleshin rrëth fjalëve dhe problemeve të njëjta, të cilat më shumë i preknin fetë tjera sesa Islamin... mirëpo, dyshimet e intelektualëve si p.sh. filozofi Ernest Renan dhe ministri Gabriel Nanotaux, kërkonin që besimtari të ketë mendim të kohës për t’u bërë ballë këtyre ideve të kohës, të cilat ndofta nuk përputheshin me Islamin apo me asnjë fe tjetër, por e brejnë mendimin dhe ndërgjegen e muslimanit, sepse janë pyetje komplekse që presin përgjigje nga ata që vërtet janë të bindur në besimin dhe mendimin e vet, dhe nuk kanë lënë asnjë hapësirë për dyshime. Profesori, Muhammed Abduhu,

<sup>36</sup> Ky artikull është publikuar në: Muhammed Abduhu, *El-Islamu bejne el-ilmi ve el-medenijjeti*, Damask, Daru El-Meda, botim i veçantë, 2002, f. 21

<sup>37</sup> Po aty, f. 48

ishte plotësish i përgatitur për atë që kërkohej nga një musliman me mendje të ndritur, në hap me kohën dhe i pajisur me prova bindëse.”<sup>38</sup>

Epoka e Abduhusë ishte kohë kur qarkullonin shumë dilema dhe pyetje logjike, prandaj për ta përballuar këtë presion të vazhdueshëm ndaj Islamit, doli në skenë tendencia logjike e mendimit të Muhamed Abduhusë, e cila i dominoi mjetet e leximit të tij dhe mënyrën e analizimit. Këtu u ndihmua me mjetet mutezilite të interpretimit me theks të veçantë, me të cilat hapi fushat semantike të tekstit, mirëpo prapavija e interpretimit të Abduhusë është më komplekse se prapavija e interpretimit të mutezilitëve. Sipas Nasr Ebu Zejdit, “prapavija e Abduhusë është prapavijë e një muteziliti që jeton në fund të shekullit XIX, e cila kërkon të përfitojë nga fryti i mendimit humanist dhe ta përshtatë me tekstin qendror në kulturën dhe qytetërimin e vet”.<sup>39</sup> Goldziheri, qysh herët e ka spikatur këtë lidhshmëri të shollës së Muhamed Abduhusë me trashëgiminë intelektuale mutezilite, ku ka thënë se “një model të ngjashëm me shkollën e Muhamed Abduhusë e kam gjetur te interpretimi mutezilit. Abduhu i ka thurur dialogët në stil shumë ndikues dhe përmes ironisë thumbuese. Këtu, para së gjithash, kritikohet imitimi i verbër dhe i skajshëm i cili është larg pavarësisë intelektuale dhe e cila kritikohet dukshëm edhe në Kur'an.”<sup>40</sup>

Muhamed Abduhu u inspirua nga teoria e tefsirit, siç kishte shkëlqyer në kontekstin mutezilit, apo më mirë thënë kishte përvetësuar disa qëndrime racionaliste të mutezilëve në komentimin e disa ajeteve, të cilat bien ndesh (në shikim të parë) me arsyen. Gjuha dhe të gjitha disiplinat që lidhen me të zënë një vend thelbësor në teorinë e komentimit

<sup>38</sup> Mahmud Akkad, *Muhamed Abduhu*, vep. e cit., f. 257

<sup>39</sup> Nasr Ebu Zejd, *El-Kiraetu el-edebijjetu li el-Kurani: ishkallijatuhu kadimen ve hadithen*, vep. e cit., f. 144

<sup>40</sup> Goldziher, *Medhahibu et-tefsiri el-Islamiji*, vep. e cit., f. 391

(tefsirit) te mutezilitët. Zemahsheri (vdiq 538 h.) qysh në fillim të veprës së tij të njohur "El-Keshshaf", e ka sqaruar relacionin e ngushtë mes disiplinës së tefsirit dhe disiplina-ve gjuhësore, ku potencon se tefsiri është një nivel (i lartë) ku mund të ngjitet vetëm "ai që shkëlqen në disiplina specifi-ke të Kur'anit: në semantikë dhe në retorikë".<sup>41</sup> Veprimi vetëm me standardet racionaliste në leximin e tekstit kur'a-nor dhe artikulimi i këtyre kuptimeve e bëri Muhamed Abduhunë të rrëshqasë në disa gabime shkencore, të cilat ia mohuan bashkëkohësit e tij. Kështu, ai e ka hapur portën e madhe para leximeve vijuese, të cilat e tepruan në nxjerrjen e vizioneve racionaliste dhe çuan në "shkrirjen e Islamit në mendimin modern".<sup>42</sup> Pastaj, me këtë vrull të mbrojtjes së vetes "ndodh që diskutuesi të afrohet me kundërshtarin më shumë seç e mendon".<sup>43</sup>

Në këtë kontekst, Albert Haurani shtroi pyetjen: "A e hapi Muhamed Abduhu pa dashje derën e ngujimit të akides dhe të sheriatit islam në humnerën e shpikjeve të shkencës moderne? Dëshironte të ngritë një mur kundër shekullarizimit, mirëpo sa po e ngriti atë realisht, ai kishte ngritur një urë që shekullarizimi të kalojë dhe të zë pozita njëra pas tjetrës."<sup>44</sup> Haurani pohon se këto lëshime ndodhën brenda pikëpamjes që mendonte se muslimanët sot duhet "ta riinterpretojnë dhe ta përshtatin sheriatin sipas kërke-save të jetës moderne."<sup>45</sup>

Duket se ky vështrim ndaj realitetit dominoi në pikëpamjen e Muhamed Abduhusë për tekstin kur'anor, prandaj ndërmori hapin në interpretim (te'vil) dhe provokoi teorinë e "interesit dhe të objektivave të sheriatit" në leximin dhe

<sup>41</sup> Ebu El-Kasim Mahmud bin Omer Ez-Zemahsheri, *El-Keshshafu an hakaiki et-tenzili ve ujuni el-ekavili fi vuxhuhi et-te'vili*, Kajro, Daru Er-Rejjan, botimi III, 1987, vëllimi I, f. 5

<sup>42</sup> Albert Haurani, *El-Fikru el-arabiju fi asri en-nehdati*, vep. e cit., f. 200

<sup>43</sup> Po aty, f. 178

<sup>44</sup> Po aty, f. 179

<sup>45</sup> Po aty, f. 187

komentimin e tij. Kjo éshtë një teori me rrënëjtë të thella në fikhun malikij me theks të veçantë, e cila e arriti kulmin e saj në veprën “El-Muvafekat” të Imam Shatibiut.”<sup>46</sup> Këtë Muhamed Abduhu e trajtonte si fondament i interpretimit të teksteve, i cili e detyron fekihuun dhe komentuesin “e Kur'anit dhe të hadithit të kuptojë se synimi i Allahut me sjelljen e shpalljes éshtë ruajtja e interesit të njeriut.”<sup>47</sup> Ndër përshtypjet e tij themelore ishte se në të mirë të Islamit dhe të muslimanëve éshtë ofrimi i një komentimi racional të Kur'anit, i cili do t'u bëjë ballë presioneve të racionalizmit modern dhe triumfeve epistemologjike. Për këtë arsy, kundër mënyrës së leximit të tij të Kur'anit dolën shumë qëndrime kundërshtuese dhe kritikuese nga bashkëkohësit e tij, të cilët ia pranonin diapazonin e gjerë të dijes dhe objektivat e larta që kishte. Këtë çështje Muhamed Husejn Edh-Dhehebij e përmblodhi kështu: “Kur profesori (Muhamed Abduhu) i dha arsyses liri të plotë në komentimin e Kur'anit fisnik, ne shihnim se ai zhytej thellë dhe zgjerohej në këtë liri, madje arriti deri në atë shkallë saqë ishte i skajshëm dhe e tepronte në mendimet e tij.”<sup>48</sup> Muhamed Abduhu i luftonte tendencat sektare apo medhhebore në interpretimin e Kur'anit dhe paralajmëronte shumë që të mos i qaset studimit të Kur'anit pas përvetësimit të një doktrine sektare paraprake apo pas leximit të interpretimeve të ajetave sipas një sekti të caktuar, sepse devijimi i Librit të Zbritur, duke e nxjerrë apo duke e larguar atë nga qëllimi esencial për shkak të faktorëve personalë apo sektarë, éshtë një punë që e tjeteron përshtatshmérinë e Librit të Zbritur

<sup>46</sup> Ky libër éshtë publikuar nën përkujdesjen e dijetarit Abdullah Draz, i cili éshtë nxënës i Muhamed Abduhusë. Abdullah Drazi në hyrjen e librit të Shatibiut thotë se mësuesi i tij vazhdimisht porosiste domosdoshmérinë e leximit të këtij libri dhe përfitimin nga metodologjia kreative në trajtimin e aksidencave brenda teorisë së objektivave të shariatit e cila përbën teorinë fiklore më të denjë për t'i përvetësuar risitë dhe problemet e kohës.

<sup>47</sup> Albert Haurani, *El-Fikru el-arabiju fi asri en-nehdati*, vep. e cit., f. 187

<sup>48</sup> Muhamed Husejn Edh-Dhehebij, *Et-Tefsiru ve el-mufessirune*, Bejrut, Daru Ihjai Et-Turathi el-Arabiji, botimi II, 1976, vëllimi II, f. 569

me mendjen e shëndoshë njerëzore.”<sup>49</sup> Ai adaptoi metodologjinë e vet në interpretimin e teksteve sipas metodës së shëmbëllimit dhe të fikcionit për t’iu përshtatur arsyes moderne humane, ku është rrënuar bindja dhe besohen çështjet metafizike dhe mrekullitë.

Në këtë kontekst duhet zënë në gojë disa gabime ku Muhamed Abduhu ka rrëshqitur nën ndikimin e tendencës të pastër racionaliste në komentim (të Kur'anit), p.sh. prononcimi i tij për pejgamberinë, mrekullitë, melaqet, magjinnë, Iblisin dhe për shumë probleme tjera metafizike, ku është përpjekur t’i afrojë dhe t’i përshtatë me arsyen dhe shkencën, dhe i lidh shkaqet me pasojat, shtuar këtu edhe mendimin e tij të njohur për “tregimet kur’anore”. Disa studiues të Muhamed Abduhusë thonë:

“Kontributi më i rëndësishëm që e ofroi Muhamed Abduhu portretizohet në insistimin e tij se objektiv i Kur'anit nuk është që ai të trajtohet si libër i historisë, prandaj rrëfimi kur'anor duhet të mos shikohet si një dokument historik. Ngjarjet historike që paraqiten në tekstin kur'anor janë thurur në kallëpe dhe shabllone letrare, në mënyrë që të bartin mësimet këshilluese dhe paralajmëruese.”<sup>50</sup> Bazuar në këtë dallim mes rrëfimit kur'anor dhe realitetit historik, Taha Husejni e shkroi veprën “Fi esh-shi’ri el-xahiliji” dhe Muhamed Ahmed Halefullahu veprën “El-Fennu el-kissajju fi el-Kur’ani el-kerimi”. Me këtë problematikë lidhet edhe një çështje tjeter jo me pak vlerë dhe rëndësi, pra ajo është “se Kur’ani në esencë u drejtohet arabëve politeistë të shekullit VII, prandaj çdo aspekt që duket se është joracionall dhe bie ndesh me logjikën dhe shkencën, duhet të kuptohet se ai (aspekt) reflekton pikëpamjen e arabëve për botën.”<sup>51</sup>

<sup>49</sup> Abdullah Shehateh, *El-Imamu Muhammed Abduhu bejne el-menhexhi ed-diniji ve el-menhexhi el-ixhtimaiiji*, Egjipt, El-Hej’etu El-Misrijetu El-Ammetu li El-Kitabi, 2000, f. 134

<sup>50</sup> Abu Zayd, “The Dilemma of the Literary Approach to the Quran,” f. 12

<sup>51</sup> Po aty, f. 13

Muhamed Abduhu përpinqej që muxhizen (mrekullinë) ta nënshtrojë para arsyes, ku u shpreh se "mrekullia nuk është e pamundur logjikisht, sepse kundërshtimi i rendit të natyrshëm dhe të njohur në krijim, nuk është i dokumentuar si i pamundur."<sup>52</sup> Për këtë u kundërshtua, sepse "thelbi i muxhizes (mrekullisë) qëndron në kundërshtimin e ligjeve të natyrës dhe se ajo është mbi përfytyrimin e arsyes njerëzore. Gjithashtu, arsyaja nuk mund të gjykojë nëse muhxizja është e mundshme apo e pamundshme."<sup>53</sup>

Biseda për metodën e Muhamed Abduhusë në komentimin (e Kur'anit) është domosdoshmëri metodologjike dhe përgatitje për të folur për prurjet pasuese në këtë sferë. Po ashtu, të gjithë janë dakord se ai e përgatiti terrenin përlindjen e më shumë leximeve letrare dhe gjuhësore, të cilat pastaj zhvillohen në lexime stilistike. Muhamed Husejn Edh-Dhehebiu, kur i përmendi drejtimet moderne të tefsirit, u ndal te ngjyrimi letrar-social i komentimit në kohën bashkëkohore, ku theksoi se merita e këtij ngjyrimi të tefsirit kreativ i takon shkollës së Muhamed Abduhusë në tefsir<sup>54</sup>, e cila programoi komentimin sipas metodës letrare-sociale, prandaj kështu shpalosi retorikën dhe mrekullinë e Kur'anit dhe i sqaroi kuptimet dhe synimet e tij.

Para Dhehebiut, Goldziheri ofroi një analizë të zgjeruar për metodologjinë e shkollës së Muhamed Abduhusë në tefsir (komentim), ku shtroi pyetjen: "Cili është qëndrimi i këtij drejtimi fetar ndaj vështrimit doktrinar me karakter letrar të Kur'anit?"<sup>55</sup> Pastaj u përgjigj vetë: "Kjo shkollë, edhe pse nuk e ekzagjeron konfirmimin e elementit mrekullor apo mbinatyror të Kur'anit dhe e mbron me shumë

<sup>52</sup> Muhamed Abduhu, *Risaletu et-tevhidi*, Bejrut, Daru El-Kitabi El-Arabiyyi, 1977, f. 119

<sup>53</sup> Afet Sherkavi, *El-Fikru ed-diniyyu fi muvaxheheti el-asri, dirasetun tahlilijetun li ittixhatati et-tefsiri fi el-asri el-hadithi*, Kairo, Mektebeti Esh-Shebabji, 1976, f. 294-295

<sup>54</sup> Edh-Dhehebij, *Et-Tefsir ve el-mufessirune*, vep. e cit., vëllimi II, f. 548

<sup>55</sup> Goldziher, *Medhahibu et-tefsiri el-Islamiji*, vep. e cit., f. 372

kujdes karakterin e teksteve të transmetuara, përsëri rrrotullohet në boshtin e drejimit racionalist. Krahas kësaj, ajo i jep peshë të veçantë faktit për të mos qenë e vardisur pas paraardhësve konservatorë dhe as denigruese ndaj tyre në njohjen dhe pohimin e estetikës së kompozimit stilistik të Kur'anit dhe as në sqarimin e korrelacionit të pjesëve të shpërndara (të Kur'anit) në sure të ndryshme, por pohon se paraardhësit (selefët) dallohen në ofrimin e provave dhe argumenteve për këtë (stilistikën kur'anore).<sup>56</sup> Në këtë kontekst, Muhamed Abduhu i sulmoi metodat e klasikëve në çështjen e shkakut të zbritjes, sepse kjo metodë e ndërpremt vijimësinë (kuptimore) të ajeteve nga njëri-tjetri, prandaj mbështetet në të kundërtën e kësaj, pra e pranon mëvetësinë (unikalitetin) artistike të ajeteve kur'anore dhe e kritikon qëndrimin e klasikëve për këtë çështje: “Është e habitshme puna e transmetuesve të shkaqeve të zbritjes, sepse ata e çajnjë tërësinë unike të fjalës hyjnore dhe e bëjnë atë pjesë-pjesë. Kështu, e shpërbëjnë këtë tërësi unike të ajeteve dhe e ndajnë njërin nga tjetri, bile ndonjëherë i ndajnë edhe fjalitë e lidhura ngushtë në një ajet të vetëm, duke i përshkruar secilës fjali një shkak të veçantë, siç i përshkruajnë çdo ajeti për një çështje të caktuar shkakun e vet specifik.”<sup>57</sup>

Hulumtimi në çështjen e mëvetësisë së brendshme të tekstit letrar në përgjithësi dhe të tekstit kur'anor në veçanti, është një prurje e kritikës moderne, pavarësisht bollëkut të trashëgimisë kritike burimore për këtë çështje.<sup>58</sup>

Sa i përket unititetit të tekstit kur'anor, ndoshta ia vlen të theksohet kontributi madhështor i Burhanuddin El-Bikait (vdiq 885 h.) në veprën e tij “Nedhmu ed-dureri fi tenasubi

<sup>56</sup> Po aty, f. 327

<sup>57</sup> Muhammed Reshid Rida, *Tefsiru el-menar*, i redaktuar nga: Ibrahim Shemsuddin, Beirut, Daru El-Kutubi El-Ilmijjeti, botimi II, 2005

<sup>58</sup> Për qasje më të detaujar rreth çështjes së unikalitetit artistik të Kur'anit, shih: Jusuf Bikar, *Binau el-kasideti fi en-nekdi el-arabiji el-kadimi (fi dau'i en-nekdi el-hadithi)* Beirut: Daru El-Endelus, botimi II, 1983, f. 275-362, ku dr. Bikar shpalos manifestimet klasike dhe moderne të kësaj problematike.

el-ajati ve es-suveri”, për të vërtetuar kështu lidhshmërinë e sureve kur'anore në nivelin e strukturës së përgjithshme të Kur'anit, dhe pastaj lidhshmërinë e ajeteve të njëpasnjëshme të një sureje, pavarësisht vështirësive në disa raste. Megjithatë, mendimi i Muhamed Abduhusë për unitetin e tekstit kur'anor është më ndikues dhe më i perceptueshëm për ta kuptuar unitetin kuptimor me theks të veçantë. Komentimi i tij për ajetin “*Pasha agimin dhe dhjetë netët!*” (El-Fexhr, 1-2) është se ky ajet tregon realizimin e përkryer të domethënieve ku puqen kuptimet e tekstit kur'anor dhe të cilat përshtaten me vështrimin e përgjithshëm të gjërave<sup>59</sup> (pra, fillimin dhe fundin).

Muhamed Abduhu kishte një horizont human të gjërë. I qasej Kur'anit me këtë ndjesi, sepse aspironte ndriçimin e shpirtit njerëzor me reflektime hyjnore. Abbas Akkadi thekson se elita e krishterë “garonin për të marrë pjesë në ligjëratat e tij në xhamitë e Bejrutit”, sepse në mësimet e tij gjenin një fuqi marramendëse për rrënjosjen e kuptimit fetar në zemrën e njeriut. Jakub Sarruf, gjatë varrimit të imamit (Muhamed Abduhusë) u drejtohet nxënësve të tij me këto fjalë: “U dëgjoj të thoni: “Kjo është humbje për Islamin dhe muslimanët”, dhe nuk theksoni se ky është humbje për mendimin dhe shkencën kudo qoftë ajo, bile është humbje për të gjithë ne.”<sup>60</sup>

Charles Adams e cilëson Muhamed Abduhunë si njërin nga themeluesit e Islamit modern.<sup>61</sup> Hamilton Gibb e vuri theksin mbi analizën e thukët dhe madhështore, të cilën Charles Adams e vendosi mbi themelet e mësimeve të Muhamed Abduhusë”. Pastaj shkroi një punim përmble-

<sup>59</sup> Muhamed Abduhu, *Tefsiru el-kur'ani el-kerimi, xhuz'u amme*, Bejrut – Kajro, Daru Ibn Zejdun, Mektebetu El-Kul-lijjat El-Ezheriyyeh, 1989, f. 90

<sup>60</sup> Abbas Mahmud Akkad, *Muhamed Abduhu*, vep. e cit., f. 258-259

<sup>61</sup> Charles Adams, *El-Islamu ve et-tekhidu fi Misre*, e përkthyer nga Abbas Mahmud Akkadi, Kajro, Lexhnetu Daireti El-Mearifi El-Islamijjeti, 1981, f. 4

dhës dhe të thukët për planin që Muhamed Abduhu ua solli reformatoreve në katër pika, ku ndër to është “rivendosja e bazave të doktrinës islame në dritën e mendimit modern.”<sup>62</sup> Në këtë kontekst, Gibb u ndal te kontributi i Muhamed Abduhusë për modernizimin e teorisë së komentimit të Kur'anit, dhe se “ideja e përsosmërisë kur'anore” dhe paprekshmëria e tij janë provë e fuqisë hyjnore. Megjithatë, gjeneratat e tanishme muslimane kanë nevojë për më shumë se kaq. Kanë nevojë ta provojnë se asgjë në të (në Kur'an) nuk është e gabuar dhe e vjetruar, dhe se mendimi shkencor apo historik-modern nuk ka ndikuar asgjë në të, sepse ai (Kur'ani) është një paraqitje e kompletuar dhe përfundimtare e çështjeve të kozmosit. Në të kundërtën, do t'i ekspozohet shkatërrimit nëse mbrojtësi do të mjaftohet vetëm me prononcimin se “këto janë fjalë të Zotit kështu siç janë (me kuptimet e një epoke të caktuar)”. Ajo që kërkohet është rikomentimi i Kur'anit, që ky tefsir në tërësi të flasë edhe për realitetin material të Kur'anit dhe jo vetëm për realitetin shpirtëror.”<sup>63</sup>

Pika më e rëndësishme e spikatur nga Hamilton Gibb është se mjeti klasik i komentimit është lënë anash,<sup>64</sup> megjithatë kjo nuk ndodhi para se të ofrohet një kritikë thumbuese ku ishte i inkuadruar edhe Muhamed Abduhu me interpretimin e disa ajeteve kur'anore sipas pikëpamjes shkençore moderne, p.sh. komentimi i xhinëve tek i prekuri (prej tyre), ku Gibb për këtë çështje shprehet se “ky tefsir (komentim) nuk është më qesharak se përpjekjet e realizuara nga priftërinjtë tanë për ta adaptuar “librin e krijimit” me gjeologjinë; apo përpjekjet e përhapura të cilat komentimin e të vërtetave fetare e bëjnë me shprehje shkençore popullore.

<sup>62</sup> Hamilton Gibb, *El-Ittixhatu el-haditheti fi el-Islami*, e përkthyer nga Hashim El-Husejni, Hashim Beirut, Daru Mektebeti El-Hajati, 1966, f. 60

<sup>63</sup> Po aty, f. 103

<sup>64</sup> Po aty, f. 103

Muslimanët e kulturuar krejt këtë e shohin ngjashëm si ne. Kjo nuk është asgjë tjetër veçse një fazë mbrojtëse që nuk jetoj më shumë se një periudhë kohore".<sup>65</sup> Taha Husejni pajtohet me Hamilton Gibb në këtë pikë. Taha Husejni drejtoi një kritikë thelbësore ndaj metodës së Muhamed Abduhusë për komentimin e Kur'anit fisnik, "Drejtimi i Muhamed Abduhusë, sipas Taha Husejnës, nuk është i qëndrueshëm, sepse mbështetetëj në komentimin e teksteve dhe përshtatjen e vetë shprehjeve të Kur'anit me të vërtetat shkencore që i njohim sot... Nuk ka dyshim sipas meje, se kur zhvillimi i lindjes të jetë paksa më i qëndrueshëm, atëherë njerëzit në vendet tona përsëri do mendojnë rrëth përafrimit të fesë me shkencën. Megjithatë, nuk besoj se kjo do të ndodhë në mënyrë kaq të thjeshtësuar si mënyra e Muhamed Abduhusë, i cili pavarësisht sinqueritetit dhe çiltërsisë shpirtërore, pa e hetuar solli prova që binin mbi koston e teksteve fetare".<sup>66</sup>

Nasr Hamid Ebu Zejdi, këtë kritikë thumbuese e pranoi me jo pak kuptim kritik ndaj veprës së Muhamed Abduhusë, i cili i përdori figurat stilistike si metaforën dhe alegorinë me qëllim të ofrimit të një tefsiri racional për të gjitha vepurat dhe ndodhitë mrekulllore që përmenden në Kur'an. "Të gjitha ajetet kur'anore që flasin për legjendat si magjia, syri i keq, prekja shejtanore etj., duhet të komentojen si shprehje me të cilat arabët janë adaptuar t'i besojnë. Abduhu, ajetet kur'anore që flasin enkas për dërgimin e melekëve nga qielli për t'i luftuar jobesimtarët, i komenton si shprehje që ndërlidhen me stimulimin dhe ngritjen e moralit (ushtarak)".<sup>67</sup>

Albert Haurani, kontributin thelbësor të dhënë nga Muhamed Abduhu në rrugëtimin shkencor e përbledh

<sup>65</sup> Po aty, f. 103

<sup>66</sup> Taha Husejn, *Mine esh-shatii el-ahiri*, Kitabatu Taha Husejn bi el-frensjjeti, i përmblodhi, i përktheu dhe i komentoj Abdurreshid Es-Sadik Mahmudi, Kajro, El-Merkezu El-Kaumiju li et-terxhemeti, vëllimi I, 2008, f. 43

<sup>67</sup> Abu Zayd, "The Dilemma of the Literary Approach to the Quran," f. 20

me këto fjalë: "Qëllimi i Muhamed Abduhusë në të gjitha veprat dhe shkrimet e ditëve të fundit e mbushi zbrazëtirën që ekzistonte në shoqërinë islame, kuptohet me dëshirën për t'i forcuar rrënjet etike të saj. Për ta arritur këtë qëllim vizatoi një rrugë të vetme, e ajo është mosreferimi në të kaluarën dhe ndalimi i rrjedhës së zhvillimit, bile pranimi i nevojës së transformimit të parimeve islame. Kjo duhet bërë duke pohuar se ky transformim jo vetëm që është i lejuar sipas Islamit, por është domosdoshmëri e patjetërsueshme nëse kuptohet realiteti i tij."<sup>68</sup> Sipas Hamilton Gibb-it, Muhamed Abduhu, i cili e gërshtoi identitetin e besimtarit me atë të racionalistik, për t'i ringjallur të vërtetat islame në dritën e mendimit modern dhe për ta përhapur frysmin e re në jetën morale, sociale dhe intelektuale të Egjiptit, nuk duhet mbështetur në përpjekjen e riaktualizimit apo të ringjalljes së të kaluarës, por në marrjen e kësaj të kaluare themel të jetës dhe të mendimit kombëtar. Pastaj, mbi këtë të ndërtohet një strukturë me elementë elastikë dhe funksionalë, të cilat i siguron kultura racionaliste e përparuar e Perëndimit."<sup>69</sup>

Muhamed Abduhu kishte ndikim të drejtpërdrejtë te një pjesë e nxënësve të vet, të cilët pastaj i ndoqën hapat e tij në komentimin e Librit të Allahut. Në krye të këtyre nxënësve ishte: Muhamed Reshid Rida (1282-1354 h.), i cili pas vdekjes së mësuesit veproi i pavarur në tefsirin e vet të quajtur "Tefsiru el-Menar" dhe mbërriti deri në xhuzin XII, gjegjësisht deri në ajetin 52 të sures Jusuf. Gjithashtu, prej nxënësve të tij ishte edhe Muhamed Mustafa El-Meragi, kryesues i Universitetit të Az'harit, i cili la pas vetes disa vepra në fushën e komentimit të Librit të Allahut të Lartësuar.<sup>70</sup> Të dy këta dijetarë i ndoqën hapat e mësuesit dhe u ndikuau shumë prej tij. Nuk gabojmë nëse e theksojmë këtu edhe Abdulaziz

<sup>68</sup> Albert Haurani, *El-Fikru el-arabiju fi asri en-nehdhati*, vep. e cit., f. 172

<sup>69</sup> Gibb Hamilton, *Dirasatun fi el-edebi el-arabiji*, Damask, El-Merkezu El-Arabiyyu li El-Kitabi, f. 37-38

<sup>70</sup> Edh-Dhehebijju, *Et-Tefsiru ve el-mufassirune*, vep. e cit., vëllimi II, f. 591-594

Eth-Thealebiun (1874-1944), i cili e takoi Muhamed Abduhunë dhe u ndikua shumë nga mendimet e tij reformuese, prandaj e shkroi veprën “Ruhu et-teharruri fi el-Kur’ani” (Fryma çliruese në Kur'an)<sup>71</sup>, të cilën e orientoi në kontekstin e kësaj fryme kritike që kërkon transformim dhe u përgjigjet sfidave të kohës. Në vazhdën e zhvillimit të vërtetë të metodës gjuhësore, në komentimin e Kur'anit pritej ardhja e një njeriu i cili do ta gërshtonte thellësisht elementin burimor dhe atë reformues. Ky burrë ishte dijetari Emin Huli, të cilit Nasr Hamid Ebu Zejd ia dha epitetin “Kampion i reformimit”.<sup>72</sup>

## Shembull praktik nga komenti i Muhamed Abduhusë

Më parë u potencua dëshira e flaktë e Muhamed Abduhusë për të ofruar një kuptim racional të Islamit, i cili do të jetë i qëndrueshëm përballë shtypjeve të njëpasnjëshme të arsyes moderne njerëzore. Po ashtu, u theksua mendimi i tij i njojur përrëfimin kur'anor, ku shprehet se rrëfimi është dhënë në Kur'an “për këshillim dhe mësim, jo për sqarim të historisë dhe as për t'i besuar verbërisht imtësitë e ngjarjeve... Tregimi kur'anor nuk e kalon faktin e të qenit mësim dhe udhëzim, prandaj patjetër (tregimi) të paraqitet në Kur'an me kontekstin apo sintaksostilemën që tregon afirmimin e të mirës dhe përcëmimin e të keqes. Ndonjëherë tregimi mund të paraqitet me shprehjet e përdorura nga bashkëbiseduesit apo protagonistët e ngjarjes, edhe nëse nuk janë të sakta në vetvete, si p.sh. “*Siç ngrihet ai që e ka prekur shejtani...*” (El-Bekare: 275). Ky stil është i zakonshëm, sepse shumë shkrimitarë arabë dhe të huaj përmendin zotat

<sup>71</sup> Abdulaziz Eth-Thealebiu, *Ruhu et-teharruri fi el-Kur’ani*, i përkthyer nga Hamadi Es-Sahilij, i kontrolluar dhe me fusnotat të Muhamed Muhtar Es-Selamit, Beirut, Daru El-Garbi El-Islamiji, vëllimi I, 1985

<sup>72</sup> Abu Zayd, “The Dilemma of the Literary Approach to the Quran,” f. 22

e të mirës dhe të keqes nëpër ligjërimet dhe shkrimet e tyre... edhe pse askush nuk i beson këto legjenda politeiste.”<sup>73</sup>

Sipas kësaj pikëpamje kontroverse ndaj tregimit kur'anor, Muhamed Abduhu ofroi komentimin e tij racional për tregimin e Harutit dhe Marutit, bashkë me pohimin dhe mohimin e magjisë, nisur nga tradita gjuhësore dhe ndryshimet semantike. Po ashtu, nuk ka gjë të keqe nëse sillen disa fjälë që kanë objektiv gjuhësor në komentimin e tekstit kur'anor dhe përpilen t'i afrojnë çështjet metafizike me arsyen bashkëkohore. (Abduhu) thotë: “Magjia në Kur'an përmendet në shumë vende, por më shumë në tregimin e Musait me Faraonin dhe kur flitet për hebrenjtë. Nëse kërkojmë ta kuptojmë këtë përmes traditës gjuhësore, do të gjejmë se fjala sihr (magji) tek arabët nënkupton: çdo që gjë që merret me të butë, troket apo fshihet. Disa të tjerë kanë thënë se folja سَحْرَةٌ apo سَحْرَةٌ do të thotë: *e ka mashtruar apo e ka humbur.* Disa kanë thënë apo عَيْنُونْ سَوَاحِرٌ sy *magjepsës* (mashtrues). Në hadithin e saktë thuhet: “Vërtet në Bejan (sqarime) ka sihr”<sup>74</sup> Fjala سَحْرٌ do të thotë *mushkëri*, dhe kjo është etimologjia e kësaj fjale, pra mushkëritë janë benda (kraharorit) të fshehura. Po ashtu këtu lidhet edhe kuptimi i *mashtrimit*, sepse (sihri) paraqet diçka joreale për një çështje të caktuar. Pra, realiteti është i fshehur, kurse sytë ndikojnë te të pasionuarit ndaj të bukurës dhe fjalët elokutive ndikojnë te të pasionuarit ndaj fjalës së retorikës. Kjo mbetet e fshehur dhe enigmatike, sepse për shumicën e njërzve është e vështirë ta perceptojnë motivin e influencës.

Allahu e cilëson magjinë (sihrin) në Kur'an si imagjinatë që mashtron sytë, sepse atë që nuk ekziston e paraqet si krijësë ekzistuese. Allahu xh.sh. ka thënë: “*I duket atij nga magjia e tyre se ai (gjarpri) ec*” (Taha: 66), pra fjala është

<sup>73</sup> R. Rida, *Tefsiri el-menar*, vep. e cit., vëllimi I, f. 325

<sup>74</sup> Buhariu (5767); Ebu Davudi (5007); Ibn Hibban (5795) dhe shumë hadithe të tjera si ky të transmetuara nga Omeri r.a.

për litarët dhe shkopinjtë e tyre. Në ajetin tjetër thuhet “*I magjepsën sytë e njerëzve dhe i frikësuan*” (El-A’raf: 116) Në këtë ajet të cilin e komentojmë: magjia merrej si arsimim, gjë të cilën e dëshmon historia. Egjiptianët llagapin sahir ia jepnin dijetarit, siç kuptohet nga ajeti vijues “*Dhe thanë: o sahir, lute për ne Zotin tënd!*” (Ez-Zuhurf: 49) Tërësia e teksteve të dhëna më parë tregon se sihari (magjia) ose është hile dhe mashtrim, ose është prurje shkencore e fshehët që e dinë vetëm disa njerëz, kurse shumica nuk e dinë, prandaj aplikimin e këtij veprimi e quajnë sihari (magji), sepse motivin e ka të fshehur. Nga sihari është e mundur që një njeri të ndikojë te tjetri për shkak të këtij motivi. Historianët janë shprehur se magjistarët e Faraonit e përdornin zhivën për t’i paraqitur litarët dhe shkopinjtë në formën e gjarpërinxje të lëvizshëm.<sup>75</sup> Ata që janë mësuar t’i pranojnë ndikimet shpirtërore e trajtojnë këtë si një prurje dhe mjet jetese, prandaj ndihmohen duke përdorur fjalë dhe emra të ndryshëm, të cilët te njerëzit njihen si emra të shejtanëve apo të mbretërve të xhinëve. Kinse, kur ata i thërrasin, u përgjigjen dhe janë në shërbim të thirrësit. Fjalë si këto ndikojnë në ngjalljen e kureshtjes dhe dilemës, të cilat njihen si gjëra përvoje, kurse motivi i (realizimit) kësaj është besimi i supozuesit se shejtanët i përgjigjen dhe i nënshtronen thirrësit. Disa besojnë se këtu bëhet fjalë për aftësi specifike të influencës, e në fakt nuk është aftësi specifike, por besimi i kotë bën që magjia t’i tërheq vëmendjen, ta orientojë dhe t’ia imponojë vullnetin e tij (të magjistarit). Kjo është arsyja që turma beson se magjia është veprim që realizohet me shejtanët dhe me shpirrat e yjeve.<sup>76</sup>

<sup>75</sup> Ebu Bekr El-Xhessas, *Ahkamu el-Kur’ani*, Bejrut, Daru El-Kitabi El-Arabiji, 1986, vëllimi I, f. 43, ku theksohen më shumë gjëra seç ka thënë Muhammed Abduhu.

<sup>76</sup> Rida, *Tefsiru el-menari*, vep. e cit., vëllimi I, f. 325. Gjithashtu, shih: Shehateh, *El-Imamu Muhammed Abduhu bejne el-menhexhi ed-dinijji ve el-menhexhi el-ixhtimaijji*, vep. e cit., f. 151-153, ku studiuesi e diskuton mendimin e Muhammed Abduhusë rrëth kësaj problematike, bile i bën disa kundërshtime jo të këqija.

Mutekelimunët, mufesirët (komentuesit) dhe fukahatë nuk ndajnë një mendim në lidhje me realitetin e magjisë dhe me dispozitat e saj. Disa e konsiderojnë si të jashtëzakonshme, por e dallojnë nga muxhizja (mrekullia). Megjithatë, në mesin e dallimeve nuk e kanë theksuar faktin se magjia arrihet me mësim dhe përsëritet me punë. Pra, magjia përfundimisht është gjë e zakonshme kundrejt muxhizes (mrekullisë) e cila është krejtësisht e jashtëzakonshme.”<sup>77</sup>

## Emin Huli dhe udhëheqja e pionierëve

Në mesin e shumë nxënësve të Emin Hilit veçohet Shukri Ajjadi, i cili paraqiti një fotografi kritike të hollësishme të personalitetit shkencor të profesorit të tij dhe vendin e tij në mesin e udhëheqësve të mendimit dhe të kulturës arabe në fillim të shekullit XX.

Pas pohimit të faktit se Huli është furnizuar nga burimet intelektuale të Muhamed Abduhusë,<sup>78</sup> Shukri Ajjadi flet se mësuesi i tij dallohej nga kritikët dhe mendimtarët e mëdhenj të kohës së tij. “Në të njëjtën kohë, Taha Husejni, Abbas El-Akkadi, Muhamed Husnejn Hejkeli filluan të shkruajnë në fushën e letërsisë dhe të studimit letrar. Këshfu, filluan një epokë të re, edhe pse nuk referoheshin shumë te gjenerata pararendëse, ata mbështeteshin në kontributin e tyre sa i përket gërs hetimit të kulturës arabe me një apo me më shumë kultura perëndimore... Emin Huli veçohej

<sup>77</sup> Nga dijetarët (fukahatë) që e mohuan magjinë janë disa hanefi. Xhessasi ishte prej më të zëshmëve në mohimin e kësaj dhe në interpretimin e teksteve të transmetuara për këtë çështje. El-Xhessasu, *Ahkamu El-Kur'ani*, vep. e cit., vëllimi I, f. 41-49. Kurse nga mutekel-liminët që e mohuan magjinë ishin muzetilitët. Të dy grupet i kundërshtoi ashëpër Imam Mazeniu (vdiq 536) në veprën “*Ikmalu el-mual-limi bi fevaidi muslimi*”, i redaktuar nga Muhamed Esh-Shadiliu, Beirut, Daru El-Garbi El-Islamiji, 1993, vëllimi VII, f. 86

<sup>78</sup> Shukri Ajjad, *Er-Ruja el-mukajjedeh, Dırasatın fi et-tefsiri el-hadarijji li el-edebi*, Egjipt, El-Hej’etu El-Misrijjetu El-Ammetu li El-Kitabi, 1978, f. 166. Gjithashtu, shih: Daru El-Hilal, *Et-Tekvinu: hajatu el-mufekkirine ve el-udebab ve el-fennanine bi aklamihim*, Kajro, Kitabu El-Hilali, viti 566, shkurt, 1998, f. 23-24, ku Shukri Ajjadi përsëri e lavdëron personalitetin e mësuesit të vet, Hulin, dhe e dallon atë nga personalitetet tjera të njohura të kohës.

nga bashkëkohësit e tij, sepse ai duhet të ishte burimi. Po ashtu veçohej me mbështetjen në trashëgiminë e gjeneratës pararendëse: i zhvillonte të mirat, i plotësonte mangësitë, i përmirësonte gabimet dhe u qasej materialeve të cilat nuk patën mundësi t'u qasen pararendësit. Në vend se ta vendo-së njërën këmbë në tokën e kulturës egjiptiane dhe tjetrën në tokën e kulturën perëndimore, Huli vendosi t'i ngulitë fort të dy këmbët në atdhe dhe të shohë kah bregu tjetër: nëse diçka do t'i pëlqente, do ta marrte në masën e nevojshme.”<sup>79</sup>

Ky citim relativisht i gjatë është tregues i qartë për thelbin e qëndrimit ideologjik dhe kritik të Emin Hulit, i cili diplomoi në Shkollën e Sheriatit në vitin 1920, ku pas diplomimit u caktua imam (atashe) në legatën egjiptiane në Romë dhe në Berlin.<sup>80</sup> Atje iu dha mundësia t'i mësojë gjuhët perkatëse dhe moderne: gjuhën italiane dhe gjuhën gjermane, të cilat i mundësuan hapjen e dritareve të tij intelektuale në horizontet moderne të dijes njerëzore. Po ashtu, këto dy gjuhë, te personaliteti i tij zhvilluan një dialektikë aktive të gërshetuar nga dy metoda të formimit kulturor: kultura burimore tradicionale, përmes së cilës arriti të ketë një vizion të qartë, të përvetësojë hollësitë e disiplinave tradicionale, të ripërtërijë dëshirën për reformim të tyre dhe të forcojë lojalitetin përmes horizontit të ri epistemologjik. Kurse, nga ana tjetër, kultura moderne, i ofroi mundësinë e pjekurisë intelektuale, të vetëdijes së thellë për unin dhe fuqinë e përzgjedhjes së mendimeve dhe metodologjive të përshtatshme. Te ky formim kulturor u gërshetua personaliteti konservator dhe bashkëkohor në të njëjtën kohë. “Pra, artikulohet me theksin kumtues selefit, por e kënaq edhe arsyen, pra në të njëjtën kohë në këto hulumtime

<sup>79</sup> Ajjad, *Er-Ru'ja el-mukajjedeh, dirasatun fi et-tefsiri el-hadariji li el-edebi*, vep. e cit., f. 166

<sup>80</sup> Bedevij Tabaneh, *Sevanihu ve araun fi el-edebi ve el-udebai*, Longman, Mektebetu Lubnan Nashirun, Esh-Sheriketu El-Misrijetu El-Alemijjetu li En-Neshri, botimi I, 1997, f. 85

ka një influencë të fshehtë të stilit shkencor, siç njihet te evropianët.”<sup>81</sup>

Emin Huli u inkorporua në fushëbetejën e jetës kulturore me dëshirën e flaktë për një reformim të përgjithshëm dhe rrënjosor të kulturës arabe-islame, duke u nisur nga parulla “fillimi i reformimit nis nga vrasja e kuptimit të së kaluarës”. Edhe pse hulumtimi ynë është përqendruar në studimin e kontributit të cilin Huli e dha në reformimin e teorisë së komentimit të Kur'anit, imazhi i tij shkencor nuk plotësohet pa zënë në gojë edhe kontributet tjera në fushën e reformimit. Ky ankth e sundonte arsyen dhe lapsin e tij, pra që këtu e kuptojnë kujdesin dhe përkushtimin e tij ndaj idesë së reformimit. Në këtë frymë e shkruan librin “Menahixhu texhdidin fi el-nehvi ve el-belagati ve et-tefsiri ve el-edebi”. Kjo është vepra kryesore e cila i përfaqë tendencat e tij ideo-logjike. Gjithashtu, e tillë është edhe vepra “El-Muxhe-ddidune fi el-islami”. Të dyja këto vepra përfaqin thellësisht burimin, autoktoninë dhe çiltërsinë e idesë së reformimit te Huli.<sup>82</sup>

Sa i përket reformimit të teorisë së komentimit të Kur'anit te Huliu, idetë e tij themelore shkëlqyen në artikullin e njohur “Lënda e tefsirit”, me të cilin kontribuoi në Enciklopedinë Islame, pastaj e përfshiu atë në librin e vet “Menahixhu texhdidin fi en-nehvi ve el-belagati ve et-tefsiri ve el-edebi”, ku shkroi një pjesë të vlefshme për konceptin e tefsirit: për zhvillimin, drejtimet dhe ngjyrimet e tij. Pas kësaj ofroi pikëpamjen e vet të veçantë me titull “Et-Tefsiru

<sup>81</sup> Ajjad, *Er-Ru'ja el-mukajjedeh, dirasatun fi et-tefsiri el-hadariji li el-edebi*, vep. e cit., f. 167. Gjithashtu, shih hyrjen e Shukri Ajjadit në veprën e Emin Hulit, Menahixhu texhdidi fi en-nehvi ve el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebi, Kajro, Daru El-Ma'rifeti, 1961, f. 9, ku raporti i profesorit të tij me kulturën perëndimore pëershkuhet kështu: “lu mundësua të udhëtojë në Perëndim në moshë të re, i cili nga pjejkura që kishte, krijoj një vetëdije të matur dhe bëri një zgjim të dobishëm.”

<sup>82</sup> Këtë më buruk e sqaron Nasr Hamid Ebu Zejd: “Huli u përkushtua ta aplikojë metodën e “reformimit” në studimin e gjuhës (gramatikës), stilistikës, komentimit të Kur'anit, letërsisë... mbante mendimin se zgjimi (kultur) çdoherë fillon, siç e ka vërtetuar historia, nga reformimi në art dhe në letërsi. Ai beson se ky reformim në art dhe në letërsi përbën kushtin themelor të zhvillimit të vetëdijes intelektuale dhe estetike të populli egjiptian që pastaj të mund ta arrijë resençën e vërtetë islamë dhe gjithëpërfshirëse. Shih: Abu Zayd, “The Dilemma fo the Literary Approach to the Quran,” f. 22

el-jeum" (Tefsiri sot), ku fillon me një kundërshtim thelbësor ndaj mësuesit të vet, Muhamed Abduhusë, i cili mendonte se parësore dhe e rëndësishme në tefsir (komentim) është që komentimi i ofruar të realizojë udhëzimin dhe mëshirën kur'anore, të sqarojë urtësinë e legjitimimit në sferën e besimit, të etikës dhe të dispozitave, duke i bërë të këndshme për shpirtin njerëzor. Sipas pikëpamjes së Hulit, kjo është një objektivë e çmuar pa dyshim, "mirëpo nuk është mendim i qëlluar që për këtë të themi se ky është objektivi i parë i tefsirit, sepse para këtij ka një objektivë tjeter dhe një qëllim të largpamës, nga ku degëzohen objektivat e ndryshme, prandaj duhet siguruar këtë para objektivave të tjera. Ai objektiv është që Kur'anit të shikohet si Libri më i Madh në gjuhën arabe dhe me efekt më të madh letrar. Ai është libër që e përjetësoi gjuhën arabe dhe e ruajti qenësinë e saj. Kjo është një veti e Kur'anit që e di çdo arab, pavarësisht fesë apo orientimit, kuptohet nëse e përjeton arabishten si të tillë në vetvete. Pavarësisht nëse arabi është i krishterë, politeist apo musliman i përkushtuar, ai e di pozitën e këtij Libri në gjuhën arabe pa e besuar atë si libër fetar (të shenjtë)."⁸³

"Arabi autokton apo çdokush që ka ndonjë lidhje me arabishtë, këtë libër madhështor e lexon dhe e studion edhe nga këndi letrar, siç i studiojnë popujt e ndryshëm librat autoktonë dhe burimorë të letërsive të gjuhëve të ndryshme. Ky studim letrar, përfektin e madh që ka Kur'anit, duhet të jetë në rend të parë për studiuesit seriozë. Kjo bëhet për meritën që ka ky libër, edhe nëse nuk synojnë udhëzimin dhe përfitimin nga gjithë ajo madhështi që ka ai. Pra, ata duhet punë të parë ta kenë studimin e Kur'anit, edhe pse nuk i besojnë, madje edhe nëse e kundërshtojnë shenjtërinë e tij, ngase muslimanët atë e konsiderojnë si

<sup>83</sup> Huli, *Menahixhu texhdidin fi en-nehvi ve el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebi*, vep. e cit., f. 303. Shih: Feld Stefan, *Terxhemetu el-Kur'an el-Kerimi*, ishkaliqjatun ve eb'adun, revista "Et-Tesamu" viti 11, 2005, f. 271

librin më të shenjtë. Kur'ani është libri i shenjtë i artit arab, pavarësisht nëse hulumtuesi e quan si të tillë në fe apo jo.”<sup>84</sup>

Nasr Hamid Ebu Zejd e sqaroi këtë çështje në veçanti, ku thotë: “Emin Huli e ka argumentuar këtë metodë si metoda e vetme që mund ta sqarojë mrekullinë (i'xhazin) e Kur'anit, për të cilën është mbështetur në faktin se pranimi i Kur'anit dhe i Islamit nga arabët ishte i mbështetur në perceptimin e tyre ndaj tekstit kur'anor, më saktësisht ndaj epërsisë absolute letrare. Këtë e krahasonin me tekstet tjera njerëzore. Me fjalë të tjera, arabët e pranuan Islamin mbi bazën e vlerësimit të tyre ndaj Kur'anit, duke e cilësuar atë si tekst letrar, i cili i kalon të gjitha krijimet letrare njerëzore. Prandaj, metoda letrare në studimin e tekstit kur'anor duhet të eliminojë dhe të hedh poshtë çdo metodë tjetër që kërkon të zë vendin e saj, pavarësisht nëse ajo është metodë fetare-teologjike, filozofike, etike, sufiste apo shariatike.”<sup>85</sup>

Emin Huli vazhdon ta argumentojë me entuziazëm teorinë e vet të re në sferën e komentimit dhe të leximit letrar të Kur'anit, lexim që fillimisht nis nga gjuha. Huli ka thënë: “Studimi letrar i Kur'anit në këtë nivel artistik, pa e vështruar aspak nga aspekti fetar, është ajo për të cilën esencialisht jemi mësuar dhe janë dakorduar të gjithë popujt arabë. Arabishtja është pika e përbashkët, objektivi i parë dhe synimi largpamës që duhet t'i paraprijë çdo synimi tjetër. Pastaj, pas realizimit të këtij mësimi letrar, secili mund të mbështetet në këtë libër për të marrë atë që do t'i referohet për dispozitën, besimin, moralin, interesin shoqëror apo për gjithçka tjetër që dëshiron. Nuk do të realizohet mirëfilli asnje objektivë tjetër para se të arrihet studimi let-

<sup>84</sup> Huli, *Menahixhu texhdidin fi en-nehvi ve el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebi*, vep. e cit., f. 303-304

<sup>85</sup> Nasr Ebu Zejd në një vend tjetër e sqaron këtë pikë kështu: “Nuk është qëllimi të thuhet se Kur'ani është veprë artistike arabe dhe nuk është veprë e shenjtë fetare e zbritur Muhamedit (a.s.) nga Allahu Fuqiplotë, por theksi vihet mbi faktin se ai është libër që ndikon si te muslimani ashtu edhe te muslimani përmes veçoritë e tij letrare dhe artistike të cilat e dallojnë atë nga tekstet tjera. Ky dallim është ai të cilin dijetarët klasikë e quajnë i'xhaz. Shih: Ebu Zejd, *El-Kiraetu el-edebijetu li el-Kur'an: ishkaliyyatuha kadimen ve hadithen*, vep. e cit., f. 148

rar i këtij libri unifikues. Pra, të studiohet saktë, plotësisht dhe në formë të qartë. Ky studim është ai që ne e quajmë tefsir (komentim), sepse nuk mund të sqarohet qëllimi dhe as të kuptohet pa këtë (studim)."<sup>86</sup>

Iffet Sherkavi, bile edhe Shukri Ajjadi, e kundërshtuan Emin Hulin në fokusimin e tij vetëm te populli arab apo tek ata që lidhen me arabët në mënyrën e kuptimit të Kur'anit dhe në mrekullinë e tij. "Sikur vetëm atyre u është kumtuar kjo shpallje. Kështu largohet nga hulumtimet e i'xhazit (mrekullisë) që përfaqësojnë kuptimet e përgjithshme njerëzore. Fokusimi vetëm te hulumtimet e i'xhazit tek arabët nuk përputhet me karakterin e mrekullisë së përhershme. Do të ishte mirë që bashkë me thirrjen për studim artistik dhe letrar të këtij teksti të shenjtë, hulumtuesit të orientohen edhe kah zbulimi i vlerave njerëzore të përgjithshme... Hulumtimi në kuptimet që insipiron Kur'ani, nuk është nevojë që paraqitet pas komentimit letrar, por është vetë komentimi letrar nëse duam ta studiojmë Kur'anin nga këndi letrar, siç i studiojnë popujt e ndryshëm veprat bazike letrare të gjuhëve tjera."<sup>87</sup> Në këtë kontekst, Shukri Ajjadi thotë: "Nuk është e mjaftueshme për hulumtuesin që kur ta studiojë një vepër bazike letrare vetëm t'i sqarojë kuptimet e fjalëve dhe format retorike të të shprehurit, por t'i përkushtohet sqarimit të vlerave të saj humane, duke paraqitur edhe atë që lidhet me shpirtin njerëzor, pra me vetë vetëdijken e re dhe me perceptimin e thukët të gjithë asaj që lidhet me këtë."<sup>88</sup>

Emin Huli hedh disa hapa në reformimin e teorisë së tefsirit kur propozon komentimin tematik të Kur'anit. Kjo dallon nga metoda e pararendësve, të cilët e komentonin Kur'anin sipas renditjes së sureve dhe të ajeteve. "Kur'ani

<sup>86</sup> Huli, *Menahixhu texhidin fi en-nehvi ve el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebi*, vep. e cit., f. 304

<sup>87</sup> Sherkavi, *El-Fikru ed-dinijju fi muvaxheheti el-asri, dirasetun tahilijjetun li ittixhatati et-tefsiri fi el-asri el-hadithi*, vep. e cit., f. 303

<sup>88</sup> Shukri Ajjadi, *Dirasatun kur'anijjetun: jevme ed-dini ve el-hisabi*, Kajro, Daru Esh-Shuruki, vëllimi I, 1980, f. 10

nuk éshtë renditur sipas tematikave dhe problemeve, e as nuk éshtë përmbledhur në çdo pjesë një çështje e caktuar. Nuk éshtë renditur as sipas librave të akaidit (besimit), të cilat i shtjellojnë çështjet bazike dhe as sipas librave të shariatit. Mirëpo, Kur'an ndoqi një metodë krejt ndryshe, sepse në një vend paraqet më shumë tematika, pa u ndalur vetëm në njérën. E ka shpërndarë materien e trajtuar, saqë i duhet vrojtuesit se komentimi sure për sure dhe pjesë-pjesë nuk mund të kuptohet mirëfilli dhe saktë. Kur komentuesi ndalon te tematika për ta plotësuar, duhet të hulumtojë dhe të endet nga fillimi në fund dhe nga fundi në fillim për t'i lidhur kuptimet e tematikës.<sup>89</sup> Allahu na ka sjell një shembull për këtë në fillim të sures El-Bekare ku flet për besimtarët. Ky kuptim nuk do të kuptohet tërësisht nëse nuk lidhet me vargun e ajeteve që jepen në suren El-Mu'minune në xhuzin XV të Kur'anit. Pastaj, këtë e ka pasur me shumë shembuj të ngjashëm nga Kur'ani, prandaj thuhet: "Ti, Allahu të udhëzoftë, je në gjendje të kuptosh se ai i cili i kupton fjalitë e teksteve që flasin për një tematikë të vetme, mund të arrijë deri te kuptimi i saktë përmes thukëtisë, duke e njojur atë që vjen para apo pas. Pra, atëherë do të shihet se intervali kohor mes këtyre pjesëve të teksteve kur'anore nuk éshtë aq i largët sa janë larg ajetet njëri nga tjetri."<sup>90</sup>

Nuk ka dyshim se struktura kur'anore që kemi para nesh nuk ndjek renditjen kronologjike të ajeteve dhe të sureve. Dijetarët e tefsirimit (komentimit) janë të një mendimi (ixhma), se renditja e Kur'anit në këtë formë, siç e kemi sot, éshtë e vendosur prej Allahut (teukifij) dhe kështu éshtë urdhëruar Pejgamberi a.s.. Kjo strukturë e Kur'anit nuk ka qenë dhe nuk éshtë problem për dijetarët e tefsirit, përkundrazi, efekti i madh i Kur'anit në shpirtin njerëzor u arrit

<sup>89</sup> Huli, *Menahixhu texhdidin fi en-nehvi ve el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebi*, vep. e cit., f. 305

<sup>90</sup> Po aty, f. 305-306

pikërisht përmes kësaj strukture. Nasr Hamid Ebu Zejd e ka spikatur këtë çështje dhe ka ardhur në përfundimin se “ishte e pritshme për profesorin Emin Huli, i cili nisej nga koncepti se Kur’ani është teksti më i madh arab dhe vepra artistike më e shenjtë, që të hedh një metodë për ta studiuar tekstin kur'anor nga këndi artistik dhe letrar sipas strukturës ekzistuese, pa u kthyer kah mënyra e ndërlidhjes së saj historike (kronologjike).”<sup>91</sup>

Ebu Zejdi e ka lidhur këtë metodologji të të menduarit të Emin Hulit me kulturën e tij themelore dhe të bujshme dhe me shkencën e usuli fikhut, i cili ndjek metodologjinë e grumbullimit të ajeteve të një tematike të vetme dhe pastaj i rendit sipas renditjes kronologjike (historike) para se të filloj procesin e komentimit. Kjo është “një metodë që nuk mund të nënvleftësohet kur është në pyetje studimi i tematikave kur'anore, si p.sh. çështjet ideologjike, doktrinare, etike, sociale etj., por nuk është metoda e qëlluar për studimin letrar të Kur'anit.”<sup>92</sup>

Krahas shquarsisë së tefsirit të Nasr Hamid Ebu Zejdit, me këtë rast shtrojmë pyetjen: a ishte i ndikuar Emin Huli nga orientalistët gjermanë në çështjen e rirenditjes së Kur'a-nit? Këta orientalistë mendonin se rirenditja është forma e saktë e cila mund të japë informacion më të hollësishëm për zhvillimin e Islamit dhe për ndërtimin e shoqërisë islame. Ky është një angazhim shumë i lodhshëm, të cilin e ka realizuar Theodor Noldeke, ndërsa Emin Huli e ka studiuar veprimtarinë e tij, siç do të pohojë vetë më vonë. Duket se të dy motivet e kanë nxitur që Huli të mendojë në ndërtimin e një metodologjie të komentimit letrar të Kur'anit.<sup>93</sup>

<sup>91</sup> Ebu Zejd, *El-Kiraetu el-edebijjetu li el-Kur'an ishkaliyyatuha kadimen ve hadithen*, vep. e cit., f. 149

<sup>92</sup> Po aty, f. 149

<sup>93</sup> Theodor Noldeke, *Tarihu el-Kur'an*, e përkthyer nga Xhorx Tamer, Bejrut, botimi I, 2004, f. XVI; Canon Sell, *Tetavvuru el-Kur'an et-tarhiiji*, e përkthyer nga Malik Muslimani, 2005, f. 7 (libër elektronik) [http://www.muhammadanism.org/Arabic/book/sell/hdq\\_arabic.pdf](http://www.muhammadanism.org/Arabic/book/sell/hdq_arabic.pdf)

Në kontekstin e bisedës për ndikimin e kulturës perëndimore në mendimin e Hulit duhet bërë një vështrim kritik për atë që ka pohuar Ahmed Muhammed Salim në studimin e vet për Emin Hulin dhe ndikimin e kulturës perëndimore në formimin e teorisë së tij të re në tefsir (komentim), i cili “në komentimin letrar të Kur'anit ka vënë në funksion prurje shkencore nga kultura perëndimore, veçanërisht trashëgiminë interpretative, hermeneutikën. Këtë e ka bërë për ta nënshtuar tekstin (fatar) para arsyes.”<sup>94</sup> Lexuesi i teksteve sipas Hulit, veçanërisht i teksteve letrare, duhet patjetër ta ngjyrosë këtë tekst me interpretimin dhe mënyrën e të kuptuarit të tij. Pra, lexuesi i shprehjeve është ai i cili e përcakton personalisht nivelin intelektual dhe horizontin logjik të kuptimit të tij (tekstit). Secili e bën këtë sipas nivelit intelektual dhe horizontit logjik që posedon. Në varësi të kësaj, ai e menaxhon tekstin dhe e përcakton sqarin e tij. “Te Hiliu ky interpretim fokusohet në rëndësinë e aspektit gjuhësor dhe psikik ndaj tekstit burimor. Në këtë drejtim, Huli duket se është ndikuar nga Schleiermacher (1768-1834).”<sup>95</sup>

Pastaj, Ahmed Muhammed Salim transmeton një përmbledhje të karakterit të mendimit interpretues të Schleiermacher, “pikëpamja e të cilët ngrihet mbi bazën se teksti është shprehje e një ndërmjetësuesi gjuhësor, e cila e bartë idenë e autorit te lexuesi. Në vazhdim, në aspektin gjuhësor, ai referohet te gjuha në tërsësi, kurse tek aspekti psikik referohet te vetë ideja e autorit. Marrëdhënia mes këtyre dy aspekteve, sipas Shleiermacher, është dialektike. Sa më shumë të avancojë teksti në kohë aq më shumë bëhet paqartë

Këtu patjetër duhet theksuar se ideja e renditjes së Kur'anit sipas kronologjisë së shpalljes është ndjekur edhe nga historianët arabë klasikë, ku El-Jakubiju paraqet një pasqyrim të hollësishtëm të kësaj çështjeje. Për këtë shih: Ahmed bin Ebi Ja'kub El-Abbasî, *Tarihu el-Ja'kubij*, Beirut, Daru Sadir, vëlimi II, f. 33 dhe 43.

<sup>94</sup> Ahmed Muhammed Salim, *El-Islamu el-aklaniju: texhidiu el-fikri ed-diniji iinde Emin Huli*, Kairo: Ru'jetun li En-Neshri ve Et-Tevzî'i, botimi I, 2009, f. 111

<sup>95</sup> Po aty, f. 112

për ne dhe kështu afrohem më shumë me keqkuptimin, jo me kuptimin. Për këtë arsy, duhet një shkencë apo art, i cili do të na mbrojë nga keqkuptimi dhe do të na afrojë me kuptimin (real). Kështu, Shleiermacheri nisi të vendosë rregulla të kuptimit nga pikëpamja e tij për këto dy aspekte të tekstit: për aspektin gjuhësor dhe për aspektin psikik. Për të depërtuar në kuptimin e tekstit, komentuesi ka nevojë për këto dy dhundi: dhuntinë gjuhësore dhe forcën për të depërtuar në natyrën njerëzore.”<sup>96</sup> Pastaj, Ebu Zejdi transmeton nga Shleiermacheri këto fjalë: “Vetëm dhuntia gjuhësore nuk mjafton, sepse njeriu nuk mund ta njohë kornizën e pakufishme të gjuhës. Po ashtu, nuk mjafton edhe vetëm dhuntia për të depërtuar në natyrën njerëzore, sepse realizimi i saj i plotë është i pamundur, prandaj duhet mbësh-tetur në të dy aspektet.”<sup>97</sup>

Pavarësisht sqarimeve të rëndësishme që i ofroi Nasr Hamid Ebu Zejd në kontekstin e bisedës për teorinë e interpretimit te Shleiermacheri, ai nuk ka ofruar ndihmë kritike për të konfirmuar lidhjen e Hilit me Shleiermacherin, madje edhe vetë Ebu Zejdi, i cili është një nga studiuesit më të rëndësishëm të Hilit, nuk e ka pohuar haptazi këtë relacion, aq sa i njoh unë shkrimet e tij. Sa i përket mendimit të Ahmed Salimit se Emin Huli “ka qëndruar në Evropë gjatë periudhës 1923-1927 në Itali dhe në Gjermani, dhe se e ka zotëruar mirë gjuhën italiane dhe gjermane, është e natyrshme që të ketë pasur qasje në veprën e filozofit gjerman, Shleiermacher, i cili vendosi shtyllat e interpretimit letrar të teksteve të shenja dhe të veprave letrare paralelisht.”<sup>98</sup> Prova për pohimin e lidhjes nuk ngrihet mbi bazën e intuitës apo hamendjes, veçanërisht kur dihet fakti se vetë Emin

<sup>96</sup> Nasr Hamid Ebu Zejd, *Ishkalijatu el-kiraeti ve alijatu et-te'vili*, Marok, El-Merkezu Eth-Thekafiju El-Arabiju, 2001, f. 20

<sup>97</sup> Po aty, f. 21

<sup>98</sup> Salim, *El-Islamu el-aklaniju: texhidu el-fikri ed-diniji inde Emin el-Huli*, vep. e cit., f. 113

Huli nuk ka theksuar asnë ndikim të kësaj trashëgimie interpretuese në teorinë e vet të komentimit të Kur'anit, madje edhe krahasimi i teorisë së Hulit në komentim me teorinë e Shleiermacherit në interpretim nuk e sinjalizojnë këtë lidhje të supozuar. Nëse do të ndjehej nevoja e korrelationit të teorisë së Hulit në komentim me trashëgiminë gjermane, atëherë idetë e Hulit ndoshta do të ishin më të afërta me idetë e interpretimit gjerman të Johann Semler (1725-1791), i cili me një fjalë thotë: "Gjëja më e rëndësishme në zanatin e hermeneutikës është njohja personit me mënyrën që Inxhili e ka përdorur gjuhën, pra me një metodë të përshtatshme dhe të thukët, bashkë me domosdoshmérinë e afrimit të rr Ethanave historike që ndërlidhen me diskursin inxhilian. Gjithashtu, njeriu bashkëkohor posedon mundësinë e të folurit për këto çështje përmes mënyrës që u përshtatet ndryshimeve të kohës dhe rr Ethanave."<sup>99</sup> Ky tekost është shumë i ngjashëm me atë që e kushtëzon Huli, pra me domosdoshmérinë e përvojës rr eth kuptimit rr jedhës të fjalëve, siç janë përdorur në Kur'an. Këtu mund ta shtojmë edhe kushtëzimin për njohjen e eksperiencës së mirëfilltë mbi kontekstin e përgjithshëm që paraqitet në Kur'an dhe atë që i quajti dy ambiente: atë material dhe kuptimor, të cilat nuk dalin jashtë tërësisë së quajtur rr Ethanana historike që ndërlidhen me diskursin, sipas Selmer. Sidoqoftë, të dy çështjet nuk përbëjnë argument të qartë të lidhjes së Hulit me trashëgiminë interpretuese, siç ka shkëlqyer saktësisht në kontekstin e kulturës gjermane.

Përbledhja e Emin Hulit për metodën procedurale të propozuar për komentimin është që Kur'ani të komentohet tematikë pas tematike, të mblidhen të gjitha ajetet që flasin për një tematikë, të mësohet renditja kohore (e zbritjes),

<sup>99</sup> Caspar David, *Mukaddimetun fi el-hermeneutika*, e përkthyer nga Vexhij Kansu, Algjeri, Ed-Daru El-Arabijjetu li El-Ulumi, Menshuratul el-Ihtilafi, 2007, f. 107

lidhshmëria dhe rrrethanat shoqëruese. Pastaj të shihet mundësia e komentimit dhe e kuptimit. Ky komentim do të jetë më afër kuptimit (themelor) dhe më i saktë.<sup>100</sup> Ky hap metodologjik në tefsir është i lidhur me dy hapa të tjera metodologjikë, pa të cilët nuk plotësohet studimi letrar i Kur'anit. Hapi i parë është studimi rrreth Kur'anit, kurse i dyti është studimi në Kur'an.<sup>101</sup>

Studimi i parë është dy llojesh: studim specifik dhe i afërt me Kur'anin. Këtu përfshihen njohuritë e domosdoshme rrreth një libri fisnik si Kur'ani, si p.sh. u shpall përafërsisht (më shumë) se njëzet vjet, pastaj mbeti i shpërndarë për vite me radhë derisa u tubua në etapa dhe në rrrethana të ndryshme; mbledhja dhe shkrimi i tij ishte një punë që zgjati një kohë të gjatë. Pastaj këtu përfshihen edhe leximet apo ato që njihen si kiraete të Kur'anit, të cilat ndihmuan në zhvillimin gjuhësor të gjuhës arabe e cila pastaj ndihmoi në renesancën serioze të nxitur nga thirrja islame. Temat nga zbritja, mbledhja e Kur'anit dhe të tjera janë tema që njihen me emrin *shkencat e Kur'anit*... Këto hulumtime janë shumë të nevojshme për studiuesit e veprave letarare dhe të domosdoshme për t'i kuptuar tekstet e studiuar."<sup>102</sup> Kjo është një prurje të cilën e kanë ndjerë të nevojshme klasikët, bile vetë Sujutiu (vdiq 911 h.) e pranon se vepra e tij "El-Itkanu fi ulumi el-Kur'ani" është vetëm një hyrje e tefsirit të tij "Mexhme'u el-bahrejni, matlau el-bedrejni, el-xhamiu li tahriri er-rivajjeti ve takriri ed-dirajjeti"<sup>103</sup>

Pastaj Huli theksoi kontributin e modernistëve në këtë kontekst, ku e veçoi veprën "Tarihu el-Kur'an" (Historia e Kur'anit) të orientalistit gjerman Theodor Noldeke, i cili e

<sup>100</sup> Huli, *Menahixhu texhidin fi en-nehvi ve el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebi*, vep. e cit., f. 306

<sup>101</sup> Po aty, f. 307

<sup>102</sup> Po aty, f. 308

<sup>103</sup> Xhelaluddin Sujutiu, *El-Itkanu fi ulumi el-Kur'ani*, i përgatitur për botim nga Mahmud El-Kajsijeh dhe Muhammed Eshref El-Etasi, Emiratet e Bashkuara Arabe: Muessesetu En-Nida, 2003, vëllimi I, f. 18 dhe vëllimi IV, f. 414

përuroi projektin e studimeve orientaliste-filologjike rreth tekstit kur'anor dhe ofroi një studim të thellë dhe të shkoqitur, i cili zë një vend të rëndësishëm në kontekstin e studimeve serioze rreth Kur'anit. Në përgatitjen për botim të kësaj vepre (*Historia e Kur'anit*) morën pjesë disa studiues gjermanë, si Friedrich Schwally, Zemmin<sup>104</sup> dhe Bergestraser.

Pastaj i thekson pengesat materiale të ulëta, të cilat penguan publikimin e veprës në gjuhën arabe. Ky libër u botua në arabisht vetëm pasi barrën e përkthimin e mori një nga të studiuesit në Fakultetin e Letërsisë, dhe atë me ndihmën e disa profesorëve gjermanë. "Hulumtimet e këtyre modernistëve u shtuan këtyre tematikave ngjyrime të kujdesit shkencor. Këto hulumtime, siç nuk u privuan prej akuzave, ato nuk u privuan as nga kritika dhe shkoqitja, të cilat janë shumë të nevojshme për trajtimin e këtyre hulumtimeve<sup>105</sup> dhe të cilat i cilësojnë këto studime si të domosdoshme për qasjen në tefsir sipas metodologjisë së propozuar. Absolutisht nuk mund hidhet hap për studim të tefsirit pa u pajisur me studimin specifik dhe indirekt rreth Kur'anit, në mënyrë që Kur'ani të kuptohet saktësisht nga këndi letrar dhe të ketë një udhëzues për t'i kuptuar drejt paqartësitetë më të theksuara.<sup>106</sup>

Shukri Ajjadi këtë prononcim të thukët nga mësuesi i tij, Huli, e sqaron si kontribut me karakterin e studimeve orientaliste rreth Kur'anit. Po ashtu, sqaron se "këta orientalistë kanë metodë të veçantë për studimin e Kur'anit, metodë që mbështet në këto dy shtylla: shtylla e parë është se Kur'ani ka zbritur i ndarë dhe pjesë-pjesë për një periu-dhë njëzet e disa vjeçare, prandaj zhvillimi i kohës kërkon

<sup>104</sup> Kështu u shpreh Emin Huli, gjë të cilën e përmend edhe Xhorx Tamer në përkthimin e librit të Noldekes, se tre studies gjermanë kontribuan në publikimin e kësaj vepre (*Tarihu El-Kur'an*), e ata janë: Friedrich Schwally, August Fisher dhe Gotthelf Bergestraser. Shih: Theodor Noldeke, *Tarihu El-Kur'an*, vep. e cit., f. XI

<sup>105</sup> Huli, *Menahixhu texhidian fi en-nehvi ve el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebi*, vep. e cit., f. 309

<sup>106</sup> Po aty, f. 309

që të ndryshohen tematikat dhe stili, sepse rrethanat kanë ndryshuar nga koha e zbritjes. Shtylla e dytë është se Kur'anë është prurje e Muhamedit, dhe se Muhamedi riktheu shumë ide të hebrenjve dhe të krishterëve, të cilat veçse ishin të njohura në disa ambiente të Gadishullit Arabik apo aty afër. Gjithashtu, ka huazuar disa kuptime të poetëve të periudhës së injorancës.<sup>107</sup> Në këtë kontekst, Shukri Ajjadi pohon se këta orientalistë nuk ndalen te çështjet që lidhen me historinë e Kur'anit, si kiraetet (trajtat leximore), regjistrimi dhe të ngjashme, por këto tema i konsiderojnë si pjesë të studimit (të pastër) historik të tyre rreth Kur'anit. Ata u qasen kuptimeve të Kur'anit sipas këtij studimi historik dhe i kthejnë ato, sipas pretendimit të tyre, në bazat e veta.<sup>108</sup>

Pastaj (Huli) sjell si model angazhimin e orientalistit Carrade, i cili e ka përpiluar zërin "xheneti" në Enciklopedinë Islame, ku thekson se ideja e hyrive (grave) dhe e vildanëve (djelmoshave) në xhenet, mund t'i ketë shkuar ndërmend Muhamedit apo ndonjërit prej profesorëve të tij të panjohur nga shikimi i disa piktureve krishtere, të cilat ishin të përhapura atëbotë dhe të cilat pasqyrojnë skena të xhenetit me melekët, e pastaj Muhamedi i ka trilluar si hyri (gra) dhe vildanë (djelmosha) të xhenetit.<sup>109</sup>

Pjesa e dytë e studimit të parë është studimi i gjithçka që ndërlidhet (indirekt) me Kur'anin, d.m.th. gjithçka që lidhet me ambientin lëndor dhe kuptimor, ku u paraqit dhe ku jetoi Kur'an. Fryma e Kur'anit është arabe, brendia është arabe dhe stili është arab "(Zbritëm) një Kur'an arabisht pa shtrembërimë" (Ez-Zumer: 28), prandaj depërtimi në objektivat e tij bëhet vetëm përmes ndjekjes së plotë (të tij) dhe përmes zbulimit të tërësishëm të këtij ambienti lëndor arab.

<sup>107</sup> Shukri Ajjad, *Dirasatun kur'anijjetun: jeumu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 20

<sup>108</sup> Po aty, f. 20

<sup>109</sup> Po aty, f. 20

Gjithçka që ndërlidhet me jetën lëndore arabe, bën pjesë në mjetet e domosdoshme të kuptimit e Kur'anit të qartë në arabishte.”<sup>110</sup> Pastaj e përmend ambientin kuptimor me krejt çfarë përfshin kjo fjalë: “Të kaluarën e largët, historinë e përbotshme, sistemin familjar apo fisnor dhe të tjera. Gjithashtu, sado të ndryshme dhe të llojulloshme të jenë punët, krejt ajo mbi të cilën ndërtohet jeta njerëzore te arabët përfshin mjetet e domosdoshme për ta kuptuar këtë Kur'an të qartë në gjuhën arabe.”<sup>111</sup>

Është e qartë se Emin Huli thërret për studimin tekstit kur'anor në kontekstin gjithëpërfshirës i cili paraqitet në të, kurse dy ambientet, ai lëndor dhe kuptimor, përfshihet domosdoshmërisht në dimensionet fetare, sociale, kulturore dhe historike të këtij konteksti. Duket se Emin Huli e ndjeu rëndësinë e këtyre kërkesave epistemologjike, prandaj tha: “Nuk është e tepërt ta kërkojmë këtë studim të ambientit të Kur'anit kur e dimë se kjo është gjendja e tij (d.m.th. ai është libri qiellor më i ri), sepse librat e tjerë fetarë janë shumë shekuj më të vjetër se Kur'ani, ndërsa ambientet e tyre janë zhdukur dhe gjuhët e tyre kanë vdekur. Megjithatë, ne përsëri në librat fetarë gjejmë gjëra të gjalla, të ngurta, ndodhi dhe dije që studiohet, bile janë shkruar libra dhe fjalorë vëllimor vetëm të mos humb gjithë ajo që duhet ditur. Krejt kjo u takon studimeve serioze historike, letrare, fetare, kanunore, sociale duke i krahasuar me të tjerat.”<sup>112</sup>

Lloji i dytë i studimit është vështrimi në vetë Kur'anin.

Ky është thelbi i metodës aplikative në studimin e tekstit kur'anor. Emin Huli i ka renditur hapat metodologjikë të këtij lloji (të studimit) brenda një sensacioni të thellë për rëndësinë e sistemit brenda strukturës gjuhësore. Hapi i parë fillon me vrojtimin e fjalëve, ku vështrohet me vëmendje

<sup>110</sup> Huli, *Menahixhu texhdidin fi en-nehvi ve el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebi*, vep. e cit., f. 310

<sup>111</sup> Po aty, f. 310

<sup>112</sup> Po aty, f. 112

"çështja e dukurive psikike dhe sociale, faktorët e kulturës së popullit dhe gjithçka tjetër që u ekspozohet fjalëve arabe. Është gabim që letrari, për kuptimin e fjalëve të këtij teksti kur'anor letrar fisnik, të bazohet në një lloj kuptimi që nuk ndërtohet mbi bazën e vlerësimit të plotë të këtij gradualiteti dhe transformimi i cili e ka prekur qenësinë dhe kuptimet e fjalëve."<sup>113</sup>

Emin Huli ishte i vetëdijshëm për vështirësinë e kësaj kërkese dhe për realizimin e saj në një kulturë që nuk posedon fjalorë gjuhësorë, të cilët e ndihmojnë realizimin e këtij synimi, pra nuk posedon fjalorë të cilët kujdesen për zhvillimin semantik të fjalëve gjatë rrjedhës historike. Në këtë kontekst, drejton një kritikë thumbuese ndaj metodës së klasicëve në përpilimin e fjalorëve. "Vepra më madhështore që e posedojmë është fjalori "Lisanu el-arab", i cili është shkruar sipas metodës së prej e ngjit, siç shprehen bashkëkohësit, ku janë puqur tekste që shkojnë larg epokës së tyre. Fjalori "El-Kamusu el-muhit" përmban materie të papërzier me kulturat ndryshe, si p.sh. nga filozofia racionaliste deri te mjekësia praktike, letërsia gjuhësore, doktrina fetare etj."<sup>114</sup>

Nëse puna qëndron kështu, atëherë komentuesi nuk ka pse t'i referohet materies gjuhësore për fjalën që do ta komentojë apo për kuptimin që do ta përgjedhë. E as nuk e ka mundësinë që të shohë gradualitetin e kuptimeve gjuhësore të fjalës që ka në shqyrtim dhe t'i renditë duke i vendosur njërin kuptim pas tjetrit. Kështu do të mund të

<sup>113</sup> Po aty, f. 312. Mustafa Nasif e ka sqaruar karakterin e ndjesisë (prirjes) gjuhësore tek Emin Huli, ku thotë: "Profesori Emin jetën e gjuhës e përfytyronte në kornizën e botëkuptimit të jetës së njeriut. Jeta e njeriut ngritet mbi transformimin e vazhdueshëm në sistemin e marrëdhënieve." Ka transmetuar nga Muhammed El-Alai, dhëndri i Emin Hulit dhe njëri nga anëtarët e shogërisë "El-Umenau" (Besnikët) të formuar nga Emin Huli, i cili ka thënë: "Emin Huli, kur fliste për disa aspekte të gjuhës dhe të figurave letrare, ishte i preokupuar me avancimin apo mbylljen në vetyvetë të tyre, proces që prej arsyen dhe vullnetin e disa shqëritëve. Gjithashtu, ishte i preokupuar me atë i ekspozohet shogërisë, gjegjësisht përziera e standardeve me vizionet e turbullta. Kërkonte të gjiejë aspektet e turbullta të cilat e rrëthojnë gjuhën që e përdorim dhe formën tonë të kuptimit të saj." Shih:

Mustafa Nasif, *El-Lugatu ve el-belagatu ve el-miladu el-xhedishu*, Kuvajt, Daru Sead Es-Sabah, 1992, f. 154

<sup>114</sup> Huli, *Menahixhu tekhididin fi en-neħvi ve el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebi*, vep. e cit., f. 313

arrinte deri te kuptimi i nevojshëm, i kënaqshëm dhe më i preferuar i një fjale të caktuar.”<sup>115</sup>

Pas këtij hapi metodologjik të vështirë, i cili përfaqësohet nga dallimi mes kuptimeve gjuhësore dhe kuptimeve terminologjike të fjalëve, vjen hapi i radhës, gjegjësisht hulumtimi i kuptimit të përdorimit praktik të fjalëve në Kur'an. Kjo nënkupton se “hapi i vrojtit të fjalëve nuk nënkupton se semantika e fjalëve varet vetëm nga përdorimi gjuhësor jashtë tekstit.”<sup>116</sup> Studiuesi (komentuesi) duhet të vështrojë të gjitha paraqitjet e fjalëve nëpër Kur'an, “që pastaj të nxjerrë një mendim nga përdorimi i një fjale të caktuar: a ka pasur ajo fjalë kuptim të unifikuar dhe të sistemuar gjatë gjithë periudhave të ndryshme të Kur'anit (të muslimanëve)? E nëse nuk është kështu, atëherë cilat janë kuptimet e ndryshme të përdorura nga Kur'an? Kështu komentuesi orientohet në kuptimin e fjalës apo në kuptimet gjuhësore të saj dhe arrin te kuptimi apo kuptimet e përdorimit praktik të saj në Kur'an.”<sup>117</sup> Kur komentuesi t'i zotërojë të dy nivelet kuptimore të fjalëve: atë leksikor dhe përdorimin praktik të tyre në Kur'an, atëherë kalon në fazën e vrojtit të kombinimeve gjuhësore, ku patjetër të ndihmohet nga “disiplinat letrare, gramatika, retorika, stilistika etj.”<sup>118</sup>

Emin Huli ka frikë që të mos keqkuptohen fjalët e tij dhe këto disiplina të bëhen qëllim në vetvete në komentim, prandaj ka thënë: “Mjeshteria gramatikore nuk duhet të jetë qëllim në vetvete, por ajo duhet parë si mjet i sqarimit dhe i përkufizimit të kuptimit. Pastaj, vështrimi stilistik i këtyre kombinimeve gjuhësore nuk duhet të jetë vështrim përskrues i cili përpinqet vetëm të aplikojë një terminologji stilistike apo vetëm t'i kategorizojë ajtet sipas grupeve

<sup>115</sup> Po aty, f. 313

<sup>116</sup> Ebu Zejd, *El-Kiraetu el-edebijjetu li el-Kur'an: Ishkalijatuha kadimen ve hadithen*, vep. e cit., f. 150

<sup>117</sup> Huli, *Menahixhu texhidin fi en-nehvi ve el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebi*, vep. e cit., f. 313-314

<sup>118</sup> Po aty, f. 314

stilistike dhe aq. Përkundrazi, vështrimi stilistik duhet të jetë vështrim letrar-artistik, i cili përfaqëson estetikën shprehëse të stilit kur'anor, i sqaron njohuritë e kësaj estetike dhe i shpalos tiparet e saj me prirje të shkëlqyer. Kështu, i zbulon karakteristikat e kombinimeve gjuhësore arabe, shtuar këtu përsiatjet në këto formulime gjuhësore dhe stilistike, me të cilat njihen përparësítë specifike të tyre përballë asaj që mund të vjen në veprat tjera arabe.”<sup>119</sup>

Hulumtimi për veçimin e tekstit letrar i referohet një aspekti i cili i takon një metode të dalluar në përdorimin e gjuhës.<sup>120</sup> Kjo nënkupton se Emin Huli e preferonte mendimin stilistik, apo siç shprehet Mustafa Nasif: “Huli dëshironte të dalë në horizontin stilistik.”<sup>121</sup> Kjo shprehje e thukët tregon vullnetin e fshehur, i cili ka lindur si rezultat i të menduarit të vazhdueshëm për filozofinë e gjuhës dhe për stilistikën. Mustafa Nasif vjen në këtë përfundim: “Ende vazhdoj ta përmend veprën e tij për Ebu El-Alain të titulluar “Re’jun fi Ebi El-Alai”. Në këtë vepër, profesor Emin Huli përpinqet ta ndryshojë kursin letrar dukshëm. Filloj t'i numërojë kundërthëniet në mendimet e Ebu Alait dhe i ndoqi ato me hollësi. Mendonte se kjo kundërthënie është thellë në mendimin e Ebu Alait. Vazhdoi të mbajë këtë mendim derisa iu bë e qartë se kjo kundërthënie nuk mund të hulumtohet vetëm në kornizën e mendimeve, por duhet studiuar edhe në vetë kornizën gjuhësore, gjegjësisht në gjuhën e Ebu Alait.”<sup>122</sup> Pastaj ka theksuar se Emin Huli vazhdoi të hulumtojë në poezinë e Ebu Alait derisa me shumë durim arriti në një fjalë “misterioze”, të cilën e përdorte shumë edhe Mearriu, ku thotë: “Kjo fjalë nuk ka térhequr vëmendjen e studiuesve të Ebu Alait, sepse ata u

<sup>119</sup> Po aty, f. 314-415

<sup>120</sup> Shukri Ajjad, *El-Lugatu ve el-ibda'*, mebadiu ilimi el-uslubi el-arabiji, Kajro, International Press, botimi I, 1988, f. 60

<sup>121</sup> Nasif, *El-Lugatu ve le-belagatu ve el-miladu el-xheditu*, vep. e cit., f. 157

<sup>122</sup> Po aty, f. 157

morën me aspektin ideologjik dhe filozofik, jo me aspektin gjuhësor. Ai mendonte se aspekti ideologjik dhe filozofik nuk është i përqendruar në gjuhë, gjë e cila përbën shkelje të konditave të mësimit letrar.”<sup>123</sup>

Pas kësaj, Emin Huli shtron dilemën: “Cili është “misteri” i Ebu Alasë përderisa ai flet me shumë guxim për çështjet më të rëndësishme filozofike, etike dhe sociale?”<sup>124</sup> Mustafa Nasif këtë dilemë e sqaron kështu: “Ngritja e kësaj pyetjeje është shumë e rëndësishme, sepse Emin Huli ka dashur të flasë për fjalë kyçë.”<sup>125</sup> Pastaj e sqaron qëndrimin përfundimtar të Emin Hulit me këto fjalë: “Realisht, dëshira e profesorit Emin Huli për të kaluar në hulumtimet stilistike ishte shumëdimensionale. Përgjatë rrugës për t'i gjetur fjalët kyçë, insistonte në domosdoshmérinë e ndjekjes së kuptimeve që përdoren në çdo libër që e lexojmë. Mendonte se kuptimet e përdorshme, bashkë me thelbin dhe nuancat kuptimore, janë ato që çojnë në studimin letrar.”<sup>126</sup>

Shukri Ajjadi tregon se hulumtimet e Emin Hulit shkëlqyen në kontekstin e teorisë së “romantizmit” në versionin arab, teori që sundonte atëbotë.<sup>127</sup> Përmes kësaj teorie “Huliu e lidhi studimin e gjuhës, të stilistikës dhe të letërsisë në njëren anë, me komentimin e Kur'anit në anën tjeter. Edhe pse teoria klasike e i’xhazit (mrekullisë së Kur'anit) mbështetej në konceptin klasik për stilistikën, ky koncept duhet të ndryshohet në teorinë moderne të stilistikës e cila krijon lidhshmëri me kritikën letrare. Pastaj kjo lidhshmëri krijon një lidhje tjetër me psikologjinë. Kjo përfshin një tip lidhshmërie e cila pozicionohet mes kritikës letrare dhe estetikës. Pra, studimi i stilistikës duhet të fokusohet në stu-

<sup>123</sup> Po aty, f. 157

<sup>124</sup> Po aty, f. 157

<sup>125</sup> Po aty, f. 157-158

<sup>126</sup> Po aty, f. 158

<sup>127</sup> Ajjad, *El-Lugatu ve el-ibdau, mebadiu ilmi el-uslubi el-arabijiji*, vep.e cit., f. 25

dimin e stilit letrar dhe ndikimin e tij emocional te lexuesi.”<sup>128</sup> Kjo është detyra kritike, barrën e së cilës do ta mbajë kritiku Shukri Ajjad, gjegjësisht nxënësi më i dalluar i Emin Hulit.

## Shembull praktik nga komenti i Emin Hulit

Teoria e metodës letrare në tefsir (komentim) ishte prioriteti kryesor i Emin Hulit. Para nesh nuk kemi ndonjë vepër voluminoze të kontributit të tij në tefsir, përjashtuar këtu disa krahasime metodologjike të çështjeve të caktuara në Kur'anin Fisnik. Vepra e tij, “Min hed’ji el-Kur’ani”<sup>129</sup>, përfshin tre lexime të gjata të disa çështjeve të shtruara në Kur'an, d.t.th. se në këtë libër e ka aplikuar metodologjinë e tij letrare, ku ka përfshirë tre studime: “El-Kadetu er-rusulu” (Udhëheqja e të dërguarve), “Fi remadan” (Në Ramazan) dhe “Ve fi emvalihim” (Në pasuritë e tyre), të cilat në fakt janë fjalime mediatike të transmetuara mes viteve 1941-1942, e pastaj i tuboi në këtë libër. Pasi e publikoi me një hyrje ku i ka përbledhur aspektet themelore të metodës së tij letrare, kishte dëshirë që këto fjalime të jenë “segmente të shkëputura nga rezultatat e studimit letrar-artistik të Kur'anit dhe të muxhizes (mrekullisë) stilistike të arabëve. Burimi më i madh mësimor i thirrjes islame, i cili kërkon të paraqesë udhëzimin kur'anor në komentimin e jetës dhe në planifikimin e saj gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm.”<sup>130</sup>

Pastaj i ripërmblodhi pjesët themelore të kësaj metode letrare dhe i paraqiti më të rëndësishmet, në mënyrë që lexuesi t'i ketë më të qarta karakteristikat logjike dhe veçoritë letrare të saj para se t'i lexojë këto fjalime, si në vijim:<sup>131</sup>

<sup>128</sup> Abu Zayd, “The Dilemma of the Literary Approach to the Quran,” f. 23

<sup>129</sup> Emin Huli, *Min hed’ji el-Kur’ani, El-A’malu el-kamileh*, Kajro, El-Hej’etu El-Misrijjetu El-Ammetu li El-Kitabi, 1978

<sup>130</sup> Emin Huli, *Min hed’ji el-Kur’ani, El-A’malu el-kamileh*, Kajro, El-Hej’etu El-Misrijjetu El-Ammetu li El-Kitabi, 1978, f. 9-11

<sup>131</sup> Po aty, f. 9-11

1. Këto (fjalime) synojnë planifikimin psikik dhe social në Kur'an për jetën e njeriut. Këtu sheh se kjo është sfera e veçantë e Kur'anit dhe rruga e vetme për realizimin e synimeve të shpalljes islame dhe për ndikimin e tyre në jetë.
2. Këto mbështeten në kuptimet e ajeteve kur'anore, të cilat kumtohen përmes fjalëve të qarta arabe, siç i kuptionin vetë arabët, pa i kaluar kufijtë e kësaj. Fjalët e Kur'anit bartin kuptime ezoterike apo indikative, interpretime sektare apo mjeshtëri të cilat u japid jetë disiplinave të gjuhës arabe, si gramatikës dhe stilistikës. Kur fjalët arabe ta kalojnë këtë nivel, atëherë vijnë në shprehje inspirimet letrare dhe artistike që reflektojnë këto fjalë dhe këto formulime (gjuhësore).
3. Këto fjalime janë të orientuara kah komentimi i Kur'anit sipas tematikave dhe jo sipas sureve, xhuzeve apo pjesëve që në një mënyrë kanë një lloj renditjeje. Pra, kjo renditje mëton të mbledh të gjitha ajetet e një tematike kudo qofshin ato nëpër Kur'an, sepse njëra pjesë e Kur'anit e sqaron tjetrën.

Emin Huli, në kontekstin e studimit kur'anor të temës "të dërguarit", më konkretisht te fjala e Allahut: "*Kush është ai që i huazon Allahut një hua të mirë, e Ai t'ia shtojë atij shumë-fish Atë? Allahu shtrëngon (varfëron) dhe çliron (begaton) dhe kthimi juaj është vetëm te Ai.*" (El-Bekare: 245), ofroi një komentim i cili tregon mundësinë e tij për ta ripërtërirë leximin dhe për ta kapërcyer kuptimin e zakonshëm. Krahas disa qëndrimeve emocionale në lexim, aty dalin edhe tipare metodologjike të leximit shkencor sistematik, ku aplikohen hapat metodologjikë të propozuar nga vetë për zhvillimin e korridorit letrar në studimin e Kur'anit Fisnik. Huli në veprën "Min hed'ji el-Kur'ani" thotë: "Ne mendojmë se Kur'ani e konfirmon qartë dhe dukshëm përgjegjësinë individuale, pa lënë asgjë mënjanë. Pastaj, po kaq qartë dhe

dukshëm, e konfirmon përgjegjësinë sociale, njësoj siç e konfirmon edhe unitetin social. Në këtë mënyrë u përkruan udhëheqësve që ndiqen (nga të tjerët) gjurmët e veprave të tyre, në të cilat pastaj i trasojnë edhe njerëzit e tjerë dhe kështu ata ndikohen nga veprimet e tyre. Përderisa askush nuk mban barrën e tjeterit, qoftë edhe i afërt, kjo nënkupton konfirmim të përgjegjësisë dhe se askush nuk mund ta shmang atë. Në të njëjtën kohë (Allahu) konfirmon edhe dënimin pér të humburit, ku thotë: “*Ata pa tjetër do të bartin barrën e vet, e me atë veten edhe barrë tjetra, e në ditën e kijametit do të merren në përgjegjësi pér atë që kanë trilluar.*” (El-Ankebut: 13). Në bazë të kësaj e ka dyfishuar dënimin e udhëheqësve mëkatarë. Këtë e ka paraqitur në më shumë se një vend. P.sh., lutja e ndjekësve kundër tyre do të jetë kështu: “*Zoti ynë, jepu atyre dënim të dyfishtë dhe mallkoj ata si është më së keqi!*” (El-Ahzab: 68). Ndëshkimi bie edhe mbi të afërmit e tyre (udhëheqësve) nëse gabojnë, si p.sh. “*O gra të Pejgamberit, cilado prej jush që bën punë të ligë e të shëmtuar, asaj dënimini i shtohet dyfish e kjo pér Allahun është shumë lehtë.*” (El-Ahzab: 30). Me këtë rast, u bëj thirrje amatorëve të artit kur'anor që ta trajtojnë përdorimin kur'anor (të fjalëve) si njësi të mëvetësishme artistike dhe si ide letrare kur shpreh (ndëshkimin) e dyfishtë. Për këtë ka bazë të fortë, sepse kështu i lidh ajetet e afërtë me ato të largëta, ajetet mekase me ato medinase, pavarësisht distancës kohore. Tani duam të ndalemi te kjo mëvetësi në përdorimin kur'anor kur flitet pér (dënimin) e dyfishtë, sepse këtu bëhet fjalë pér një trajtesë letrare me të cilën mund të ngjitemi në horizontet e artit shprehës të Kur'anit, të Librit më madhështor në gjuhën arabe... Pra, këtu nuk bëhet fjalë pér trajtesë artistike që synon artin, por pér art të ndërlidhur me objektiven sociale, të cilën e synon vazhdimisht Kur'ani. Kjo është gjëja e parë që kërkojmë nga këto fjalime, jo siç thonë disa studiues:

"Objektiv i artit nuk éshtë vlera, por me art synohet vetëm arti. Ne nuk e përkrahim këtë qëndrim, madje as Kur'an nuk mbështetet në këtë parim, sepse ai (Kur'an) artin e tij të pakrahasueshëm e ka bërë mjet të rregullimit të jetës njerëzore: rregullimin etik dhe rregullimin social të përgjithshëm, për të cilin e ka zbritur Kur'anin udhëzim dhe mëshirë për mbarë njerëzimin: "*Është e vërtet se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që éshtë më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh.*" (El-Isra: 9). Ne e studiojmë me vëmendje këtë që kumton Kur'an. Kur e përdor fjalën *da'fun* (dyfish) për shpërblimin dhe ndëshkimin, atëherë prej nesh kërkohet të dimë: a ka mendim të konfirmuar me të cilin realizohet uniteti i përdorimit (të fjalëve kur'anore) ku mund të qetësohem i dhe mund të flasim lirshëm për të?

Pastaj, cila éshtë lidhja e kësaj ideje shprehëse me objektivin social dhe etik te pasojat dhe përgjegjësitë e udhëheqësve që pasohen? Ne synojmë që pas kësaj ta pranojmë dhe të bëjmë thirrje që të merret vështrimi gjithëpërfshirës dhe ideja përbledhëse në komentimin e Kur'anit. Mbeteemi me shpresë se kësaj do t'i përbahen të zotët e fjalës (shkrimtarët) në komentimet e sotme, që pastaj të përdoret edhe në vendet më të largëta dhe në raste të ndryshme, në mënyrë që me këtë të shpalosin teoritë e tij të largëta në kompozim dhe në shkrim. Nuk do të mjaftohen vetëm me vështrimin e pjesshëm: fjalën në ajet dhe ajetin në sure, sepse kjo nuk përshtatet me rëndësinë e këtij libri (Kur'anit) dhe kështu nuk orienton kah objektivat reformuese madhore, të cilat i përmban thurja e mrekullishme (muxhize) dhe formulimi i shkëlqyer i këtij libri. Nuk mund të kuptohet mirëfilli Kur'an veçse me vrojtim të vazhdueshëm dhe të mjaftueshëm... Nëse ky drejtim na jep kuptime të cilat nuk i kanë spikatur komentuesit e mëhershëm, atëherë nuk ka gjë

të keqe të mos ndajmë mendimin e njëjtë me ata në kuptimin e disa ajeteve apo shprehjeve... Sigurisht, s'ka të keqe në këtë kundërshtim, sepse ata nuk e kanë tubuar të ngjashmen me të ngjashmen, të njëtrajtshmen me ekuivalenten e saj në formulimin dhe përdorimin kur'anor. Allahu i shpërbleftë ata (klasikët) për mundin që kanë dhënë, kurse atyre që vijnë pas tyre u dhëntë sukses në atë që ka mbetur dhe që duhet (hulumtuar), kuptohet në varësisht sipas kohës dhe rrjedhës kohore.

O amatorë të artit kur'anor, e shikoni si Allahu e përdor fjalën d'fun (dyfish) kur flet për ndëshkimin, veçanërisht kur flet për pasuesit dhe udhëheqësit, atëherë e përdor më shumë, sepse tregon se si ata e mallkojnë dhe polemizojnë me njëri-tjetrin (në ahiret). "(Allahu) u thotë: "Hyni në Xhehenem me atë popull që ishte para jush nga xhinët dhe nga njerëzit (e që ishin si ju). Sa herë që një grup hyn në të, e mallkon atë të mëparshmin derisa kur të arrijnë në të të gjithë, grupi i fundit i tyre thotë për grüpин e parë: "Zoti ynë, këta (pari) na kanë humbur neve (nga rruga e drejtë), pra shtoju dënimin me zjarr atyre!" (Allahu) Thotë: "Për secilin (grup) është (dënim) i shtuar, por ju nuk po dini. Të parët e tyre (paria) të mbramëve të tyre ju thotë: "Ju nuk keni përparësi ndaj nesh (pse vetë keni bërë kufur), shijoni pra dënimin pér atë që e fituat!" (El-A'raf: 38-39) Njësoj si ky raste tregon edhe për hallin e krerëve zullum-qarë kur do të hyjnë në zjarr, të cilëve do t'u vihen pas një turmë njerëzish që i kanë ndjekur në devijim... Udhëheqësit do t'u thonë pasuesve të devijuar: "Ky është një grumbull që bashkohet me ju (u thonë engjëjt parisë): "Mos paçin rehati as mirëseardhje (thonë paria)!" Ata janë që do të digjen në zjarr." (Sad: 59), ndërsa pasuesit do t'u kthehen krerëve: "Ata (të shtypurit) thonë: "Jo, juve mos u qoftë as mirëseardhja, as reahatia; ju jeni që na e përgatitët këtë!" Sa vendqëndrim i keq është!" (Sad: 60). Pasuesit nuk do të rrinë pa u lutur kundër tyre:

"O Zoti ynë, ata thonë: "Atij që na e bëri këtë, shtoja dyfish dënimin në zjarr!" (Sad: 61). Po ashtu, fjala di'fun (dyfish) përdoret për ndëshkimin, gjegjësish kur kërcënohet i Dërguari i Kur'anit a.s. se çfarë mund ta gjente nëse gjunjëzohej para fjalëve të kundërshtarëve: "Dhe sikur Ne të mos të kishim forcuar ty, ti gati anove diçka pak te ta. E atëherë Ne do ta shijonim mundimin dyfish të kësaj jete dhe dyfish të jetës tjetër, e pastaj ti nuk do të gjeje mbrojtës kundër nesh." (El-Isra: 74-75) Kanë thënë se "ne do të bënim të shijosh mundimin dyfish në dynja dhe dyfish në ahiret" bëhet fjalë për këtë botë dhe për vdekjen. Këto janë vendet ku përmendet fjala di'fun (dyfish) për ndëshkimin, mirëpo askund përveç këtij rasti kjo fjalë nuk është dhënë kështu e vetme, në njëjës dhe e pashquar, apo më saktë është përdorur edhe një herë në njëjës, e vetme, por e shquar vetëm kur flet për shpërblimin: "Nuk është pasuria juaj, e as fëmijët tuaj ajo që ju afron pranë Nesh, është vetëm besimi dhe veprat e mira; të tillët shpërblehen shumëfish për atë që vepruan dhe ata janë në dhoma të larta të shpëtuar." (Sebe': 37). Pra, këto janë vendet kur fjala di'fun (dyfish) përdoret në njëjës dhe e vetme: te dënimi e pashquar, kurse te shpërblimi e shquar.

Vendet ku fjala di'fun (dyfish) përdoret në trajtën e dysisë janë ajetet që flasin për ndëshkim dhe kur përfaqësohen ata që shpenzojnë pasurinë për të kërkuar kënaqësinë e Allahut: "E shembulli i atyre që pasurinë e vet e japid nga bindja e tyre për të kërkuar kënaqësinë e Allahut, i përngjan një kopshti në një rrafshnaltë që i bie shi i madh, e ai jep fruta të dyfishtë. Po edhe nëse nuk bie shi i madh, i bie një rigë (që i mjafton). Allahu sheh atë që veproni." (El-Bekare: 265) Këto janë rastet kur përdoret fjala di'fun në trajtën e njëjësit dhe të dysisë, të cilat komentuesit i kanë analizuar secilin ajet në suren që është. Ka prej tyre që disa i krahasuan me disa të tjera pa pasur bazë, si p.sh. në ajetin "(Allahu) Ju thotë: "Hyni në

Xhehennem me atë popull që ishte para jush nga xhinët dhe nga njerëzit (e që ishin si ju). Sa herë që një grup hyn në të, e mallkon atë të mëparshmin derisa kur të arrijnë në të të gjithë, grupi i fundit i tyre thotë për grupin e parë: "Zoti ynë, këta (pari) na kanë humbur neve (nga rruga e drejtë), pra shtoju dënimin dyfish (ضفت) me zjarr atyre!" (Allahu) Thotë: "Për secilin (grup) është (dënimi) i shtuar, por ju nuk po dini." (El-A'raf: 38) fjalën di'fen, e cila është në trajtën e njëjësit, e kanë komentuar në trajtën e dysisë. Kurse te ajeti "Zoti ynë, jepu atyre dënim të dyfishët (ضفتين) dhe mallkoj ata si është më së keqi!" (El-Ahzab: 68) fjalën në trajtën e dysisë e kanë komentuar njësoj si në ajetin paraprak, pra si njëjësin dhe dysinë. Kjo të jep të kuptosh të kundërtën e teorisë gjithëpërfshirëse që zhvillojmë ne. Po, në këto përdorime ka ajete që janë të zbritura në Mekë dhe të tjerat në Medinë, të cilat duket se ndoshta kanë një distancë përdorimi, megjithatë ne jemi të sigurt se përdorimi fjalëve në Kur'an ndjek një ndjesi artistike të thukët. Ka dallim kur fjala përdoret e shquar nga e pashquara, njëjësi nga dysia apo shumësi. Po ashtu, ndryshon krejtësisht ndjesia kur flitet për dënimin nga ndjesia kur flitet për shpërbimin dhe të mirën. Nuk mund ta komentojmë si dysi fjalën që është dhënë në trajtën e njëjësit në ajetin e ndëshkimit, e as ta komentojmë si të shquar kur ajo është e pashquar.

O amatorë të artit kur'anor, komentuesit e mëparshëm fjalën ضفتين di'fiejni, e cila është dhënë në trajtën e dysisë kur flitet për kërcënimin e grave të Pejgamberit a.s., e komentojnë si dy dëname. Këtë e argumentojnë me faktin se ato që t'i kushtohen Allahut dhe do të punojnë punë të mira, do t'u jepen dy shpërblime. Pra, nëse ndonjëra prej tyre do të bënte një punë të paudhë, atëherë do të ndëshkohej me dyfishin e asaj që meritojnë njerëzit e tjerë. Nuk është drejtësi që për një punë të mirë të shpërbleshesh dy

herë, kurse për një të keqe të kesh tre dënimë. Është transmetuar nga disa se ky është mendimi i shumicës së gramatikanëve dhe i komentuesve. Megjithatë, ky është një mendim që nuk duket kështu nëse e shohim tërësinë e përdoimit të kësaj fjale në Kur'an dhe në fjalën e stilizuar të Kur'anit. Prandaj, u kërkojmë falje dhe i falënderojmë gramatikanët dhe komentuesit e mëparshëm për kontributin në kuptimin e Kur'anit në kohën e tyre, megjithatë ne vlerësojmë se ky është libër i mbarë njerëzimit dhe për çdo kohë.

O amatorë të artit kur'anor: ejani ta analizojmë teorinë e propozuar për ndjekjen (fjalëve) e këtij libri më madhësh-tor, duke e vlerësuar së pari faktin se kuptimet e fjalës di'fun në gjuhë puqen te kuptimi: gjëja e njëjtë që shtohet më shumë, pra nuk është e kufizuar te dy gjëra të njëjtë. Më e pakta e di'fit është kur një gjë është njësoj si një tjeter, kurse më e shumta nuk është e kufizuar, bile shkon në shumë gjëra të njëjta si e para. Në bazë të kësaj, nëse i analizojmë ajetet ku përmendet fjala di'fun: te ajetet ku vjen e pashquar flet vetëm për ndëshkimin, siç theksuam më parë, dhe nën-kupton vetëm shtimin e të njëjtës vetëm një herë, jo shumë herë. Këtë e tregon edhe konteksti. Njësoj është edhe kur flitet për udhëheqësit dhe ndjekësit e tyre, të cilët debatojnë njëri me tjetrin (në ahiret), duke dashur t'i ngarkojnë përgjegjësinë e lajthitjes, derisa udhëheqësit do të thonë ndjekësve "Secili do të ketë di'fin" pra dënimin e vet, dhe jo secili do të ketë shumë dënimë, ngase Allahu mëkatin e ndëshkon një për një, prandaj fjala di'fun është dhënë e pashquar. Për këtë arsy, kur Allahu e paraqet këtë fjalë në kontekst të shumëfishit, atëherë e shquan, siç e ka theksuar shpërbilimin e bamirësve: "*Kush vjen me një (punë) të mirë, ai (në ditën e gjykimit) shpërblehet dhjetëfish, e kush vjen me (vepër) të keqe, ai ndëshkohet vetëm për të. Atyre nuk u bëhet e padrejtë.*" (El-En'am: 160). Kështu dallohet shquarsia nga pashquarsia.

Njerëzit që kanë prirje letrare: e analizojnë përdorimin e fjalës di'fun në trajtën e dysisë dhe shohin se në një rast nënkupton shumëfishin dhe në raste tjera meritën, si p.sh. kur flitet për ndjekësit e udhëheqësve, mbi të cilët bie barra e devijimit të tyre, duke përdorur trajtën e dysisë "O Zot, jepu atyre di'fejni (meritën) në dënim!" (El-Ahzab: 68), nënkupton meritën e dënimit. Po ashtu, kur flet për gratë e Pejgamberit a.s. të cilat i cilëson "nuk jeni si gratë tjera" (El-Ahzab: 32) dhe kur mëkatin e tyre e cilëson si "e paudhë e qartë" (En-Nisa: 19), shohim se këtu e përdor në dysi ndëshkimin "I dyfishohet dënnimi dy herë" (El-Ahzab: 30), pra marrin dënim të dyfishuar dhe jo të shumëfishuar... Ndërsa kur kjo fjalë përdoret në trajtën e dysisë për punë të mira, si për shembull në rastin e kopshtit mbi të cilin bie shi me bollëk, këtu do të thotë shtimi dhe shumëfishi, jo kufizimi vetë në dyfish. Kjo është transmetuar edhe nga gramati-kanët dhe komentuesit (e Kur'anit).

Njerëzit me prirje letrare e dinë se kjo figurë (stilistike) kur'anore, e cila e përdor dysinë me qëllim të shumësit e kundërshton argumentin e atyre që thonë se fjala di'fun kur është në dysi e ka kuptimin e dyfishit. Kjo figurë stilistike, ku fitohet shumësi nga dysia, është në jo pak vende në Kur'an. A nuk e keni dëgjuar ajetin ku Allahu e mohon parregullsinë në krijimtari, ku thotë: "Ai është që krijoj shtatë qiej, palë mbi palë. Në krijuimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, andaj drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje. Mandej, herë pas here (كَوْتَنْ) drejto shikimin, e shikimi do të kthehet te ti i përulur dhe i molisur." (El-Mulk: 3-4) Fjala كَوْتَنْ e cila tekstuallisht do të thotë "dy herë", këtu e ka kuptimin disa herë, pra në shumës. Po ashtu, ajeti "Edhe rrëth jush ka beduinë që janë hipokritë, e edhe nga banorët e Medinës që janë përcaktuar për hipokrizi. Ti nuk i di ata, Ne i dimë, ata do t'i

*dënojmë dy herë, pastaj shtyhen në dënimin e madh.*" (Et-Tevbe: 101), ku me fjalën مَرْتَبَةٍ "dy herë" nënkuptohet "shumë herë". Kjo vërtetohet nga pjesa vazhduese e ajetit, ku thotë "...*pastaj shtyhen në dënimin të madh.*" (Et-Tevbe: 101) Dëshmitë për këtë janë shumë, të cilat na shtynë që frazën "dy herë" te shpërblimi i grave të Muhamedit a.s. ta kuptojmë si "shumë herë", po ashtu edhe frazën "dyfish" në dënimin e atyre grave nëse do të bënин ndonjë mëkat, e kuptojmë si "shumëfish". Kur'ani me dysinë e fjalës di'fun nënkupton "shumëfishin", kurse komentuesit klasikë fjalën di'fun në dysi e kanë trajtuar si dy herë.

Ekspertët e letërsisë e dinë se ky ngjyrim specifik i të folurit e josh vetëm atë që ka kureshtje. Kështu, pasioni e shtyn që ta komentojë Kur'anin Fisnik mbi bazën e vështrimit të stilemave, të cilat e shohin përdorimin e fjalës në vende të ndryshme dhe mbi bazën e prirjes letrare për të sqaruar në formë të saktë, pa u ndalur vetëm në komentimin e kuptimeve të fjalëve vetëm aty ku janë, por të shihen në vende dhe në kontekste të ndryshme. Kjo bëhet për t'u arritur synimet jetësore të Kur'anit dhe objektivat e tij sociale. Pikërisht kjo është dëshira e flaktë që të vendosen themelet e një tefsiri të këtillë, por fatkeqësisht kjo ende nuk është realizuar.

O ju të udhëzuar me Kur'an, ky art qiellor ofron mëshirë dhe bamirësi për njerëzit. Kur paraqet diçka që ka gjëra të mira dhe të dobishme për njerëzit, e thekson fjalën di'fun në njëjës dhe në dysi, bile ndonjëherë e ka paraqitur me vetë shumësin e saj "*Kush është ai që i huazon Allahut një hua tē mirë, e Ai t'ia shtojë atij shumëfish Atë? Allahu shtrëngon (varfëron) dhe çliron (begaton) dhe kthimi juaj është vetëm te Ai.*" (El-Bekare: 245) Kështu është thurur në formë të shkëlqyer dhe shumë të thukët ky Libër i zbritur, i cili synon objektivat më fisnike dhe më largpamëse. Nëse dëshironi të

shikoni përdorimin e këtij arti në të mirë të jetës që jetojmë, duke i njojur pasojat e udhëheqësve, atëherë idenë do ta gjeni të ngulitur te përdorimi i fjalës d'i fun: kur e paraqet të pashquar ku thotë "Secili ka dyfishin", atëherë të gjithë të devijuarit do të marrin dënimin për devijimin dhe shkatërrimin që kanë bërë, kurse ndjekësit e udhëheqësve do të marrin dënimin për ndjekjen e verbër dhe madhërimin e tyre. Kështu, Allahu e refuzon kërkimin e faljes për gabimin fatal që kanë bërë. Sot shohim se shumë njerëz ndjejnë keqardhje për atë që veprojnë udhëheqësit dhe të mëdhenjtë, por kjo nuk mjafton, sepse ata duhet të angazhohen, të kenë vizion dhe të përpiken të përmirësojnë gjendjen e vet. Në këtë mënyrë, secili do ta marrë dënimin e vet, pa shtuar dhe pa tepruar asgjë. Pastaj, kur e sjell në dysi fjalën d'i fun, me të kërkon të shprehë shumësin, gjë e cila tregon se mbi udhëheqësit bien edhe pasojat e shumta të devijimit të të tjerëve. Në njérën anë i tmerron për dëmin e madh, kurse në anën tjetër i nxit për t'u përmirësuar. Në këtë mënyrë, ju në Kur'an nuk përjetoni vetëm kënaqësinë artistike dhe kritike, por edhe perceptimin social të dobishëm për të gjithë.<sup>132</sup>

<sup>132</sup> Huli, *Min hed'ji el-Kur'ani*, vep. e cit., f. 137-146

**KREU I DYTË**



# Dy kritikë nga shkolla “Umena” (besnikët)

## Aishe Abdurrahman dhe tefsiri sqarues (retorik)

Aishe Abdurrahman (vdiq 1999) pohon se profesori dhe bashkëshorti i saj më vonë, Emin Huli, kishte dëshirë që ajo të trasojë hapin e mëparshëm në metodën e studimit të tekstit kur'anor vetëm pasi të pajiset me njohuri shkencore, të cilat do t'i mundësojnë qasjen në librin më të madh në gjuhën arabe.<sup>133</sup>

Pas kësaj u inkuadrua në projektin të cilit ia kushtoi jetën, në specializimin e studimeve kur'anore, kuptohet sipas metodologjisë të cilën e kristalizoi profesori i saj, Emin Huli. Në këtë kontekst ofroi shumë kontributë shkencore, ku ndër më të spikaturat janë: “Et-Tefsiru el-bejaniju li el-Kur'ani el-kerimi” në dy vëllime, “El-I'xhazu el-bejaniju li el-Kur'ani ve mesaili ibni el-Ezrek”, “El-Kur'anu ve et-tefsiru el-asriju” dhe një sërë studimesh dhe hulumtimesh, të cilat shpalosin një ndjesi të thellë të përgjegjësisë letrare kah zhvillimi i leximit gjuhësor (retorik) të tekstit kur'anor.

Pavarësisht thjeshtësisë së trajtimit kritik në disa raste dhe qëndrimit brenda kufijve të stilistikës arabe, siç shihet qartë veçanërisht në veprën “Et-Tefsiru el-bejaniju”,<sup>134</sup> kjo nuk ishte pengesë që ajo të shpalos tipare subjektive të leximit kritik, ku shpesh ka kundërshtuar mendime të komentesve dhe ka ofruar jo pak kontribut në reflektimin subjektiv kritik, i cili bashkëvepron me tekstin kur'anor në cilësinë

<sup>133</sup> Aishe Abdurrahman ka realizuar një studim për veprën “Risaletu el-gufran” të Ebu el-Ala el-Marrit në nivel të magjistraturës. Pastaj, për doktoratë e mori po këtë veprën “Risaletu el-gufran”, por tanë për ta përgatitur dhe për ta përpunuar për botim. Shih: Daru El-Hilal, *Et-Tekvinu: hajatu el-mufekkirine ve el-udebai ve el-fennanini bi akłamahi*, vep. e cit., f. 263

<sup>134</sup> Ebu Zejd, *El-Kiraetu el-edebijjetu li el-kur'an: ishkallijatuhu kadimen ve hadithen*, vep. e cit., f. 148

"e një teksti gjuhësor të kompletuar ku një pjesë e të cilit e komenton pjesën tjeter".<sup>135</sup> Kjo e sfidoi teorinë klasike të komentimit, prandaj drejtoi një kritikë (shkencore) ndaj komentuesve klasikë, "të cilët nuk i kushtuan kujdes marrëdhëniej mes specifikave të leksemave, të sintagmave dhe të klimës së brendshme të tekstit. Në këtë drejtim ajo e ndjek Hulin. Ky orientim mund të emërtohet si historiku i fjalëve kur'anore dhe i përshtatjes së sintagmave me njëra-tjetren. Aspekti më i rëndësishëm në komentimin sqarues (retorik) është veprimi për t'i tekaluar nevojat e fjalorëve gjuhësorë duke e zhvilluar kuptimin në epokat e ndryshme të Kur'anit dhe përshtatjen e formave të ndryshme."<sup>136</sup>

Më herët u theksua se metoda e propozuar nga Huli për komentimin e Kur'anit është që Kur'ani të komentohej tematikë pas tematike (komentim tematik), të mblidhen të gjitha ajetet që i përkasin një tematike të vetme dhe të njihet renditja kohore bashkë me lidhshmëritë dhe paqartësitë që ndërlidhen me to. Pastaj vështrohen për t'u kuptuar dhe për t'u komentuar.<sup>137</sup> Ky është një nga tiparet burimore të metodës së tij letrare. Iffet Sherkavi ka spikatur se Aishe Abdurrahman ka dalë nga metoda e profesorit të saj në këtë problematikë, pra "nuk e ka lidhur me idenë e tematikës për të cilën gjatë kohë punoi profesori. E nëse do ta kishte bërë, atëherë para vetes do të kishte një fushë të gjerë studimore dhe produktive, sepse përcaktimi tematik ndihmon në spikatjen e thukët të kuptimeve të përdorura."<sup>138</sup>

<sup>135</sup> En-Nifer, *El-Insanu ve el-Kur'anu vexhhen li vexhhin*, vep. e cit., f. 125

<sup>136</sup> Po aty, f. 125; Shih: Abdulhebbar Er-Rifaij, *El-Ittixhatu el-hadithetu fi et-tefsiri*, Mexhel-letu kadaja islamijetun muasaretun, nr. IV, 1998, f. 13, ku thotë: "Stilistika klasike vazhdonte ta trajtonte pjesërisht tekstin kur'anor, e cila merrej me veçoritë semantike dhe estetike të fjalës, të fjalisë dhe të paragrafit, pa kaluar në analizimin e veçorive kencptuale dhe artistike të tekstit. Tipi i fundit i analizimit bëhet përmes diagnostifikimit të strukturës organike në sistemin e së cilës sistemohen të gjitha paragrafët, dhe kështu përbëjnë një njësi tematike e cila reflekton kuptime shtesë që nuk i kap dot trajtimi parcial i tekstit.

<sup>137</sup> Huli, *Menahixhu texhiddin fi en-nehvi ve el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebi*, vep. e cit., f. 306

<sup>138</sup> Sherkavi, *El-Fikru ed-diniju fi muvaxheheti el-asri, dirasetun tahllijjetun li ittixhatati et-tefsiri fi el-asri el-hadithi*, vep. e cit., f. 340

Përqendrimi i saj te suret e shkurtra e bëri atë që të duket shumë afër komentimit tematik, sepse secila sure ka pothuaj një njësi tematike. Kjo është një çështje të cilët Aishe Abdurrahman e ka theksuar në fillim të veprës “Et-Tefsiru el-bejaniju li el-Kur’ani el-kerimi”, si edhe sfera tjera që ofrohen nga komentimi i sureve të shkurtra, por që janë ndryshe nga studimi tematik, si p.sh. çështja e përshtatjes së ajeteve, spikatja e kontekstit në një sure të vetme dhe të tjera. Kështu, mund të thuhet: autorja, në komentin e këtyre sureve të shkurtra, e ka gërshetuar përcaktimin tematik me trajtimin letrar të tërë sures.”<sup>139</sup>

Iffet Sherkavi ka spikatur dukurinë e kontrastit në karakterin e trajtimit kritik ndaj tekstit kur'anor, i cili shkëlqeu te Aishe Abdurrahman. Ndonjëherë trajta e leximit të saj ngrihet lart dhe konsiderohet nga kontributet më të arrira në komentimin modern, si p.sh. përsiatjet e saj në suren El-Alek dhe forcën e përqendrimit që në momentin e parë në Kur'anin Fisnik,<sup>140</sup> shtuar këtu edhe durimin e saj për t'i trasuar kuptimet e fjalëve kur'anore në kontekste të ndryshme dhe dallimin e përdorimit leksikor të fjalëve nga përdorimi i tyre në kontekstin kur'anor. Këto momente shkencore shoqërohen me ndjenja krenarie, me përgatitje të theksuar inteligjente dhe me mbyllje të syve përpara kontributit të komentuesve klasikë, të cilët nuk e spikatën atë që e spikati Aishe Abdurrahman, madje sa i shterek forca kritike, i kthehej trashëgimisë komentuese të klasikëve dhe ofronte mendime të zgjedhura nga trajtat e komentit të trashëguar,<sup>141</sup> me vendosmëri se kjo mënyrë e interpretimit është e duhura. Pikërisht kjo është gjëja, të cilën Iffet Sherkavi e ka zgjedhur për ta diskutuar dhe kritikuar. Po ashtu, sqaron se komentuesi klasik

<sup>139</sup> Po aty, f. 340

<sup>140</sup> Aishe Abdurrahman, *Et-Tefsiru el-bejaniju li el-Kur’ani el-kerimi*, Egjipt, Daru El-Mearifi, 1968, f. 15-23

<sup>141</sup> Esh-Sherkavi, *El-Fikru ed-diniju fi muvaxheheti el-asri, dirasetun tahlilijetun li ittixahati et-tefsiri fi el-asri el-asri el-hadithi*, vep. e cit., f. 340-341

nuk kishte guxim të paraqesë një interpretim për të cilin nuk kishte tekst të qartë. Allahu e di më mirë qëllimin, por ai paraqiste trajta krejt të ndryshme në komentimin e tekstit. Ne besojmë, thotë Sherkavi, se sfera letrare dallon nga sferat tjera shkencore në përcaktimin e të saktës dhe të gabuarës. Qëllimi dhe e sakta në sferën shkencore është një, por a është edhe qasja ndaj tekstit letrar njësoj? A mund të jetë diçka e saktë në sferën letrare e në komentim të jetë e gabuar?<sup>142</sup>

Pastaj Iffet Sherkavi e kundërshtoi Aishe Abdurrahmanin ku thotë: "Ne e refuzojmë qëndrimin se "një ajet që përmban disa trajta komentuese, nuk ka asgjë të keqe nëse nuk ka tekst të qartë për të". Megjithatë, ne nuk mund të themi prerë se këto trajta të ndryshme të interpretimit të tekstit të gjitha kanë synim Allahun e Lartësuar, por thjesht përpinqemi të mbërrijmë te kuptimi i duhur përmes gjurmimit të kuptimeve të mundshme dhe duke u përpjekur të arrihet qëllimi i Zotit pa ndonjë shkelje të hapur kuptimore. Kështu, na shpalosen horizonte në varësi të vështrimit tonë shpirtëror dhe të potencialit intelektual, ku pastaj realizohet kuptimi i takvasë (devotshmërisë) në zemrat tona."<sup>143</sup>

Aishe Abdurrahman u inspirua me një ide themelore nga imam el-Hattabiju (vdiq 388 h.), i cili mendonte se shtylla e stilistikës kur'anore është e ngritur mbi parimin e "vendosjes së çdo tipi të fjalëve në vendin më specifik të fjalisë, ashtu që nëse zëvendësohet me një fjalë tjetër, ose ndryshohet kuptimi dhe prishet fjalia, ose prishet estetika stilistike."<sup>144</sup> Pavarësisht kundërshtimit të saj ndaj El-Hattabiut në disa imtësi, ajo konfirmon se "kjo spikatje e thukët është boshti rrëth të cilit Abdulkahiri e ka ngritur drejtimin e vet për i'xhazin

<sup>142</sup> Po aty, f. 341

<sup>143</sup> Po aty, f. 341

<sup>144</sup> Ebu Sulejman El-Hattabiji, *Bejanu i'xhazi el-Kur'ani*, i cili përfshin tre shkrime për i'xhazin (mrekullinë) e Kur'anit, të cilin e përgatit për botim dhe e komentoj: Muhammed Halefullah Ahmed dhe Muhammed Zaglul Selam, Egjipt, Daru El-Mearifi, 1956, f. 29

(mrekullinë) e thurjes gjuhësore (të Kur'anit). Kjo është ajo e cila deri diku përputhet me thelbin e teorisë sonë të mrekullisë sqaruese (retorike). Pastaj ndahemi në realizimin e dome-thënies, në paraqitjen e dimensioneve të saj dhe në mënyrën e argumentimit të saj. El-Hattabiu, kur thotë se humb stili dhe deformohet kuptimi apo humb eleganca, orientohet kah eleganca e fjalës dhe jodeformimi i kuptimit.”<sup>145</sup>

Duket se kjo ide dominon fuqishëm mbi teorinë e i’xhazit (mrekullisë) të Kur'anit. Kjo teori e shtriu ndikimin edhe te karakteri i mendimit të Aishe Abdurrahmanit dhe nën ndikimin e saj filloj të pozicionohet në konceptin e një mendimi të vetëm në interpretimin e tekstit kur'anor. Kjo zgjedhje në esencë bie ndesh me idenë e interpretimit dhe me mirëqenien e tekstit kur'anor. Leximi fikhor i profilizuar për të nxjerrë dispozita juridike, nuk e shikon tekstin kur'anor me këtë pikëpamje të ngushtë, por krijon një hapësirë të gjerë para perceptimeve logjike të fukahave (juristëve islamikë). Kështu u zhvillua kjo mirëqenie krijuese në nxjerrjen e dispozitave të sheriatit ashtu siç e gjejmë, bashkë me divergjencat e katër shkollave juridike në formën e të kuptuarit të tekstit kur'anor.

Nëse kjo qëndron kështu, atëherë leximi letrar (gjuhësor) i tekstit kur'anor fillimisht është themeluar mbi idenë e divergjencës (diversitetit). Mirëpo, përzgjedhja e një mendimi që i anulon të tjerët, nuk do të jetë në të mirë të tekstit të lartësuar kur'anor, i cili “ka disa aspekte letrare të cilat i lejojnë çdokujt që ka prirje, të sjellë një interpretim të ligjshëm, kuptohet nëse ai ka vizionin dhe mekanizmat. Këto aspekte në fund puqen dhe nuk kundërshtohen, madje të gjitha i shërbejnë realitetit fetar dhe letrar.”<sup>146</sup>

<sup>145</sup> Aishe Abdurrahman, *El-l'xhazu el-bejaniju li el-Kur'ani ve mesaili ibni El-Ezrek, dirasetun kur'anijetun lugavijjetun bejanijetun*, Egjipt, Daru El-Mearifi, 1984, f. 101

<sup>146</sup> Sherkavi, *El-Fikru ed-dinijju fi muvaxheheti el-asri, dirasetun tahvilijetun li ittixħahati et-tefsiri fi el-asri el-hadithi*, vep. e cit., f. 343

Aishe Abdurrahman vazhdon të theksojë ndjenjat e frikës dhe të krenarisë, të cilat e kaplojnë kur i afrohet tekstit kur'anor dhe përpinqet ta përgatitë lexuesit për konsekuencia epistemologjike që nuk i di. Lexuesi me eksperiencë në fushat e tefsirit mbetet i entuziazmuar nga leximet që i ofron ajo. Ajo thotë: "Pa dyshim do të habitesh njësoj siç jam habitur edhe unë me fshehtësitë retorike që i ka zbuluar ky mësim metodologjik-eksplorues dhe kjo përsiatje e mprehtë: fjala nuk zëvendësohet me fjalë tjetër, as shkronja me shkronjë tjetër, kurse vokali dhe theksi zënë vendin në këtë thurje mahnitëse".<sup>147</sup> Kur dikush e lexon këtë prononcim, atëherë rezultati i pritur do të jetë në një nivel të lartë. Madje, nëse i shijon fjalët e saj dhe e përvetëson rezultatin e ideve të saj, përashtuar disa tipare subjektive që i theksuan më parë, atëherë humb kjo ndjesi dhe lexuesi e gjen veten para një leximi që s'ka frymë kritike të flaktë dhe e cila u jep thellësi, forcë dhe atraksion. Mjafton nëse e sjell vetëm një pjesë nga fjalët e saj në komentimin e "vavu el-kasemi" (Vavi për betim) te ajeti "*Pasha paraditen dhe natën kur mbulon!*" (Ed-Duha: 1-2) dhe me këtë do të tregohet karakteri i mendimit të saj në komentimin e fjalës së Allahut xh.sh.

Aishe Abdurrahman thotë: "Pas një meditimi dhe përsiatje të gjatë rreth sureve që fillojnë me vavin e betimit, u binda se besimi në këto gjëra, Allahu e di më mirë, mund të dalë nga esenca e përdorimit gjuhësor, e cila besimin e përdor për madhërim, dhe të sjell një kuptim sqarues (retorik). Siç dalin nga konteksti i vet gjuhësor edhe fjalitë urdhërore dhe pyetëse vetëm për një përftesë stilistike. Shkronja V në këtë stilemë tërheq vëmendjen kah shqisat perceptuese që nuk janë të panjohura dhe as dialektike, por janë një hyrje qartësuese për të sqaruar gjërat metafizike të cilat nuk perceptohen me shqisa.

<sup>147</sup> Aishe Abdurrahman, *Et-Tefsiru el-bejaniju li el-Kur'ani el-kerimi*, vep. e cit., vëllimi I, f. 18

Betimi me tingullin V (ش) kryesisht përbën një figurë stilistike e cila i sqaron kuptimet e perceptimeve shqisore, bashkë me madhërimin që paraqet. Me këtë figurë synohet të fitohet forca e tërheqjes së vëmendjes dhe zgjedhja e objektit ku duhet betuar, i cili e përmban cilësinë që i përshtatet pozitës. Nëse i vështrojmë të gjitha pjesët e Kur'anit që janë si ajeti i ved-duhasë, shohim se tërheqin vëmendjen kah imazhi material, shqisor dhe real. Po ashtu, janë hyrje sqauese të një imazhi tjetër kuptimor të ngjashëm, të padëshmuar dhe të paperceptueshëm. "Pasha agimin kur zbulon!", "Pasha agimin kur frymon!", "Pasha ditën kur shpaloset!", "Pasha natën kur errësohet!", "Pasha natën kur mbulohet!" dhe të tjera. Kur'ani me betimet shpalos kuptime tjera të udhëzimit dhe të së vërtetës, apo të devijimit dhe të së kotës, dhe atë përmes elementeve materialë si drita dhe errësira. Ky kuptim abstrakt me shembull konkret (lëndor), është ai që mund ta hasim në betimet në Kur'an që fillojnë me shkronjën V (ش), prandaj kuptimin e tyre e pranojmë pas asnjë ngarkesë interpretuese.

Këtë e ka sqauar hollësish Bashkë me prova dhe me argumente në një punim të veçantë dhe të mëvetësishëm për "Betimin në Kur'an" (El-Kasemu fi el-Kur'ani), kurse këtu, meqë është e kufizuar fusha hulumtuese, atëherë mjafton të paraqiten vetëm disa betime të përzgjedhura të disa sureve, sa për të sqauar idenë dhe për të shpalosur thelbin. Objekti i betimit në dy ajetet e sure Ed-Duha, është një imazh lëndor dhe një realitet konkret të cilin njerëzit e shohin çdo ditë kur del drita ditën dhe kur bie muzgu në mbrëmje. Krejt kjo ndodh pa u çekuilibruar kozmosi përgjatë ndryshimit të të dyja situatave, gjë që s'mund të mohohet, madje as që mund t'i shkojë ndërmend dikujt se qelli ndahet nga toka dhe i dorëzohet errësirës apo izolimit kur drita shfaqet gjatë ditës. Sa e çuditshme është që pas ardhjes së shpalljes dhe daljes së dritës së Mus'tafasë del një periu-

dhë pushimi kur ndërpritet shpallja, njësoj siç e shohim natën e cila vjen pas ditës së ndritur.

Ky është komentimi sqarues (retorik), i cili na qetëson në çështjen e betimit të ditës dhe të natës. Aq sa kam lexuar, nuk njoh ndonjë komentues ta ketë spikatur qartë dhe drejt-përdrejt këtë çështje, edhe pse disa e kanë prekur shumë nga larg dhe në mesin e shumë interpretimeve të ndryshme të cilat nuk shpëtojnë nga ngarkesat dhe dilemat.<sup>148</sup>

Aishe Abdurrahman është ndalur në horizontin e profesorit dhe të bashkëshortit të saj, Emin Huli, dhe nuk ka treguar ambicie personale vizacionare për ta tejkaluar horizontin e tij të të menduarit. Ajo nuk është prononcuar publikisht as për faktin që ka qenë nxënëse e Hulit, gjë e cila shfaqet në interpretimin dhe ndjekjen e hollësive të metodës së tij letare. Krahas kësaj, ajo u tregua e dobët në aplikim dhe kujdesin për t'u inspiruar nga ai në dy librat e saj themelorë, të cilët shkëlqyen në kontekstin e studimeve kur'anore sipas metodës së profesorit të saj, të Hulit, ku shprehet me dedikimin: "për atë që ma mësoi metodën (e hulumtimit), për profesorin tim, Emin Huli, prijësin e zemrave dhe të mendjeve tona." Studiuesi i leximeve të saj vëren se ajo nuk ka aspak zbrazëtirë mes saj dhe profesorit, gjë e cila i mundëson asaj të zhvillojë një lexic kritik për metodën e tij të propozuar.

Në këtë kontekst duhet theksuar sulmi i saj i ashpër kundër mjekut egyptian, Mustafa Mahmud, i cili ofroi disa komentime shkencore për disa ajete kur'anore në librin "El-Kur'anu: muhaveletun li fehmin asrijjin", ku mohoi shumë prurje të tij dhe e rrëzoi poshtë idenë e vështrimit shkencor në Librin e Zotit të Madhërishëm. Ajo në këtë drejtim e ndoqi profesorin e saj, Hulin, i cili e diskutoi këtë çështje me frymë shkencore të zgjuar, pa i munguar paramendimi në kritikën e këtij drejtimi të komentimit, dhe

<sup>148</sup> Po aty, vëllimi I, f. 25-26

duke u frysmezuar nga imam Shatibiu (vdiq 790 h.), autori i veprës "El-Muvafekat", i cili e vë theksin te qëllimet e mira që dalin nga zemrat e përfaqësuesve të këtij drejtimi dhe të cilët "lidhjen e librit të fesë me të vërtetat e ndryshme shkencore duan ta bëjnë një aspekt të vërtetësisë, të mrekullisë dhe të aktualitetit të tij."<sup>149</sup> Pastaj e jep mendimin e vet serioz për këtë problematikë, i shtyrë nga përplasja mes fesë dhe shkencës, ku thotë: "Ndoshta mjafton në këtë sferë që në Librin e fesë të mos ketë tekst i cili drejtperdrejt bie ndesh me një të vërtetë shkencore të zbuluar, e cila mund të jetë një lidhje apo një sistem i kozmosit. Librit të fesë i mjafton kaq, të jetë i vlefshëm për jetën, të qëndrojë pranë shkencës dhe kështu të jetë i privuar nga kritika."<sup>150</sup> Pastaj, krenarinë më të madhe e arrin me aftësinë dhe vlefshmërinë e Kur'anit fisnik për ta drejtuar njerëzimin në rrugë të drejtë, ku thotë: "Kur'ani nuk ka nevojë të krenohet me këtë ngarkesë (shkencore), e cila pothuaj e nxjerr atë nga synimi human-social për rregullimin e jetës dhe kalitjen e të gjithë njerëzve me shkencat e ndryshme natyrore, matematikore etj."<sup>151</sup>

Kjo kritikë racionaliste-iluministe e drejtimit shkencor në komentim nuk ishte ndërmjetësues mes përfaqësuesve të këtij drejtimi dhe Aishe Abdurrahmanit. Ajo e sulmoi me furi këtë tendencë në komentim, kurse përqafuesit e saj edhe më me tërbim. Ndoshta kaq është e mjaftueshme për të treguar sadopak vendosmërinë e fjalëve të saj, me të cilat e ka filluar librin e theksuar më parë "El-Kur'anu ve et-tefsiru el-asriju", veçanërisht kur thotë: "Papritmas, në horizontin tonë filluan të valëviten fjalët për nevojën e njerëzve për një komentim bashkëkohor të Kur'anit, i cili i përgjigjet përparimit shkencor, i ndjek shkencat e kohës, zbulimet e atomit dhe elektrodit, biologjinë dhe të tjera... Dikush mund të pyesë: "Si mund

<sup>149</sup> El-Huli, *Menahixhu texhidin fi en-nehvi ve el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebi*, vep. e cit., f. 294

<sup>150</sup> Po aty, f. 294-295

<sup>151</sup> Po aty, f. 296

të ngurtësohet kuptimi ynë i Kur'anit brenda mënyrës që e kuptuan paraardhësit tanë para katërmëbhjetë shekujve, të cilët jetonin në kohën kur nuk njihej as fjala biologji, gjeologji, kimi organike, embrionologji, anatomi, antropologji?"

Këto fjalë, në pamjen e jashtme duken logjike dhe të arsyeshme, të cilat njerëzit i dëgjojnë me vëmendje dhe krijojnë bindje të thellë në to, pa u kushtuar vëmendje rreziqeve që mund ta deformojnë besimin dhe arsyen paralelisht. Kështu përzihen konceptet, ngatërrohen rrugët dhe çojnë në humbje të thellë. E nëse duam ta shmangim këtë, atëherë duhet të kapemi fort për besimin dhe arsyen që të mund ta dallojmë këtë përzierje të deformuar dhe kështu ta ruajmë shenjtërinë e fesë, logjikën e kohës dhe krenarinë e shkencës.

Gjëja e parë që më preokupon në këtë çështje është thirrja për ta kuptuar Kur'anin përmes komentimit bashkëkohor dhe jo sipas asaj që e ka sqaruar i Dërguari i Islamit. Kjo çon te bindja në idenë e rrezikshme e cila i shmang bashkëkohësit nga mrekullia e Pejgamberit a.s., i cili u dërgua te një popull analfabet dhe në një kohë kur udhëtonin me deve, jo me Mercedes, Rolls Roys, Boing, Apollo dhe të tjera. Ishte një popull që ndriçohej me dru, jo me rrymë. Freskohej me ujë zemzemi, me ujëra të puseve dhe të shirave, jo nga filtruesit dhe nga pijet e ndryshme freskuese... Me këtë logjikë ngatërrohemi në një rrezik të madh, kurse të rinjtë e kësaj kohe mendojnë se Kur'ani, përderisa nuk u ofron shkencat e mjekësisë, të anatomisë, të matematikës, të astronomisë, fshehtësitetë e biologjikë dhe elektronin dhe protonin, atëherë nuk është aktual për kohën tonë, as meritor t'i kushtohet vëmendja shkencore dhe as ta pranojë logjika bashkëkohore.

Kështu, në emër të bashkëkohësisë i nxism ata që ta refuzojnë kuptimin e Kur'anit siç e kanë kuptuar sahabët në kohën e shpalljes dhe në shkollën pejgamberike, e ta kuptoj-

në përmes komentimit bashkëkohor që është shpikur kohën e fundit. I nxisim ta kuptojnë atë në emrin e shkencës, duke i futur në imagjinata të interpretimeve të shpikura të cilat pasohen nga fjalë têrheqëse, si p.sh. për atomin dhe elektro-nin, për teknologjinë e hidrocentraleve, për biologjinë e meri-mangës, për dinamikën e akullit dhe për gjeologjinë e hënës... Në gumëzhinën e këtyre fjalëve tingëlluese dhe joshëse që i ofron komentimi bashkëkohor, shkëlqen arsyaja dhe vizioni i mprehtë i cili e dallon të vërtetën nga e pavërteta, shken-cën nga pseudoshkenca, besimin nga fjalët e zbukuruara me risi. Këtyre njerëzve u mungon aftësia për ta ndarë logji-kën e të menduarit shkencor nga thirrja e fuqishme që proklamon ky ajet: *"Po ka nga njerëzit që blenë tregime boshe e me qëllim që t'i largojnë njerëzit prej rrugës së Allahut, pa pasur kurrfarë fakti dhe për t'i marrë ato (ajetet e) Allahut si tallje. Për ta me siguri është përgatitur dënim i turpshëm. E kur i lexohen atij ajetet Tona, ai kthehet kryelartë dhe bëhet sikur nuk i ka dëgjuar ato, bëhet sikur në veshët e tij ka shurdhim të rëndë, pra t'i përgëzoje atë me një dënim të dhembshëm."* (Lukman: 6-7)

Dituria është obligim, shehadeti (dëshmia) amanet, fjala e vërtetë përgjegjësi dhe detyrim. Në ballafaqim me rrymën shkatërruese, kryej obligimin ndaj dijes dhe amanetin e she-hadetit, në mënyrë që të mos kthehem mallkimin e mëkatit të zemrës.<sup>152</sup>

Këto janë tiparet më të rëndësishme të mendimit kritik, të cilat shfaqen te leximi praktik i tekstit kur'anor nga Aishe Abdurrahman, ku me to përfaqësohen aspektet themelore të metodës letrare, konditat e së cilës i nguliti Emin Huli. Pavarësisht përpjekjeve të saj të sinqerta për avancimin e leximit të tekstit kur'anor, ajo nuk përfaqëson lexuesin më të denjë të xhematit "El-Umenau (Besnikët)". Pra, duket se Shukri Ajjadi është kritiku më me fat në mesin e anëtarëve

<sup>152</sup> Aishe Abdurrahman, *El-Kur'anu ve et-tefsiru el-asrijju*, Egjipt, Daru El-Mearifi, 1970, f. 7-9

të këtij grupei (xhemati), i cili dominon me misteret e kësaj metode, e aplikon dhe e zhvillon atë më denjësisht.

## Shukri Ajjadi dhe aplikimi i leximit letrar

Shkrimi për secilin anëtarë të grupit “Besnikët” është i vështirë, nëse nuk ndalemi te ndikimi shpirtëror dhe ideo-logjik që ka lënë Emin Huli te anëtarët e këtij grupei. Përderisa ekzistonin disa pikëpamje dhe paqartësi të veçanta, të cilat çuan në identifikimin e Hulit nga Aishe Abdurrahmani, atëherë “dija” dhe “metoda” janë faktorët aktivë në formimin e qëndrimit të Shukri Ajjadit (vdiq 1999 h.) nga profesori i tij Huli. Derisa nismat e këtij qëndrimi ishin të gjykuara si nxënie e drejtëpërdrejtë, përfundimet cilësohen si përfaqësim i denjë dhe i thelluar (i kësaj shkolle). Soditësi i karakterit të kësaj marrëdhënieje vëren se ajo vazhdon të jetë e flaktë në mendimin e Shukri Ajjadit, edhe pse ai i kaloi horizontet epistemologjike që i kishte arritur mësuesi i vet Huli.

Shukri Ajjadi ishte i vetëdijshtëm për rolin nismëtar-përparimtar dhe për detyrën madhështore, me të cilën ishte zotuar se mësuesi i tij se do ta mbante. Detyra nënkuptonte “vendosjen e vajit në mendjet tona që ato të vazhdojnë të bëjnë drithë dhe të hiqet errësira.”<sup>153</sup> Siç duket, ndjenja për

<sup>153</sup> Shukri Ajjadi, *Texharibu fi el-edebi ve en-nekdi*, Kajro, Daru El-Katibi El-Arabiji li Et-Tibaati ve En-Neshri, 1967, f. 65  
Si për rastësi, u pata shkruar një artikull me titull “Shukri Ajjadi dhe mirëpriftja e të pasionuarit pas arabishtes”. Në këtë temë u ndala te analiza e thellë që e ofroi Ajjadi për përpjekjet e Mahmud Muhammed Shakirit në leximin e poeziisë së xhahiljetit. Struktura e punimit u zhvillua në atë formë ku ndahej ideja e Ajjadit nga idetë e mësuesit të vet, Hulit, dhe atë si në vijim: “Mahmud Muhammed Shakir jetoi jashtë kulturës së karnavaleve dhe të festivalave... Ai dëshironte që në këtë dynja të jetë prifti që e mban barrën e ndriçimit në errësirë, të cilin e ndihmojnë vetëm pak shokë të mirë, të cilët kur i shikojmë me kujdes në ftyrë, na i kujtojnë këto vargje të Salah Abdussaburit:

*Shokët e mi janë të mjerë,*

*Ndoshta asnjëri s'ka gojë të flasë,*

*E kalojnë dynjanë lehtë si puhia,*

*Kokulur si zogjtë e pëllumbit,*

*Kurse mbi supe kanë barrë të madhe dhe unike,*

*Barrën që në errësirë të lind një kandil i ri.*

Shih: Omer Hasen El-Kijjami, *Fi daireti el-men'hexhi, kiraatun nekdijjetun*, Aman, Menshurat Emanetu Amman El-Kubra, 2005, f. 194

fisnikërinë dhe madhështinë e dritës së dijes vazhdoi të gufonte në mendimin dhe ndërgjegjen e Shukri Ajadit. Dëshmi për këtë është fakti se kur në universitet shkëputi një ngjarje nga formimi i tij intelektual, theksoi se i zhdukej fatkeqësia e verbimit (intelektual), të cilën e ndjente kur i kujtonte kritikët e mëdhenj. Po ashtu, theksoi se si Ibrahim Mustafa dhe Emin Huli ishin dy njerëzit që e dominuan pozitën shkencore në zemrën e tij, ku thotë: "Pas pak m'u bë e qartë se atë që e mësoj prej librave të tyre është më e vlerë dhe më e qëndrueshme sesa atë që e mësoj para tyre. Nuk e përjashtoj këtu as Taha Husejin, i cili kishte "paraqitje" të mrekullueshme, personalitet magjeps, prezantim tërheqës dhe muzikalitet në zë gjatë ligjërimin... Megjithatë, borxhi i madh që e ndjej ndaj këtyre dy profesorëve veçmas, ndaj Emin Hulit dhe ndaj Ibrahim Mustafasë, i kthehet asaj se unë nuk kam gjetur në librat personazhet që mund t'i zëvendësojnë personalitetet e tyre. Sa i përket Ibrahim Mustafasë, vepra e tij "Ihjau en-nehvi", së cilës nuk i gjendet shoqja, përfaqëson vetëm një pjesë të vogël nga dija dhe prirja e tij për gramatikën, duke lënë mënjanë faktin se ai ishte lexues dhe ekspert i leximit të poezisë klasike bashkë me hollësitë e fshehta... Kurse Emin Huli "debatonte" dhe "përpinqej" vazhdimisht. Me dialogët e tij sokratikë, e ndante lëvoren nga fryti (pra, ishte tepër i saktë në sqarimin e gjërave). Kështu i mësonte studentët që ta ndjekin atë hap pas hapi. Në të gjitha projektet e tij shkencore përpinqej të arrijë një synim, por që ai vetë i pari ishte që e dinte se arritura e tij është larg. Pastaj kështu dera e ixтиhadit (përpjekjes) mbetej e hapur për ata që vinin pas tij. Në këtë mënyrë e gjeta veten afër këtyre dy profesorëve, pa e kritikuar dijen e tyre me injorancën time. Lidhja ime me Emin Hulin vazhdoi derisa ai vdiq, e kur u ktheva në universitet për t'i mësuar studentët, atëherë ndoqa dhe trasova rrugën e tij."<sup>154</sup>

<sup>154</sup> Daru El-Hilal, *Et-Tekvinu: hajatu el-mufekkirine ve el-udebai ve el-fennanine bi aklamihim*, vep. e cit., f. 23-24

Ky tekst flet qartë për kënaqësinë shpirtërore dhe bindjen logjike të Shukri Ajjadit sa i përket metodës së profesorit dhe personalitetit të mësuesit të tij, Emin Huli. Format e shprehjes së kësaj bindjeje ishin të shumta dhe u manifestuan në mënyra të ndryshme në shkrimet e Shukri Ajjadit. Ndoshta hyrja e thukët të cilën e përgatiti për botimin e librit të mësuesit të vet "Menahixhu texhdidin fi en-nehvi ve el-belagati ve et-tefsiri ve el-edebi", është e mjafqueshme për të treguar përfaqësimin e thellë të mendimeve të tij dhe dëshirën për të vazhduar ndërtimin sipas tij. Këtu mund të shtohet mbrojtja nga ana e tij e këtyre ideve, dënim i keqkuptimeve populliste që i adresoheshin atij dhe mohimi i atyre që i quanin "armiq të mendjes". Ai sqaronte se thirrja e mësuesit (Hulit) që komentimi i Kur'anit fisnik të bëhet sipas metodës së tefsirit letrar, nuk ishte asgjë tjetër veçse thirrje për derdhje të mundit në rrugën e të kuptuarit të Librit të Qartë pa u ndalur te komentimet klasike, ku shumica, për të mos thënë të gjithë, ishin të lidhur me legjenda dhe me doktrina të popujve të zhdukur. Kështu, ai e tejkalon këtë dhe i përdor metodat moderne në kërkimin gjuhësor dhe letrar, kuptohet duke u ndihmuar edhe nga njohuritë e kohës, gjegjësisht nga psikologjia dhe sociologjia.<sup>155</sup>

Shukri Ajjadi në një mënyrë ishte përqendruar tek idetë e "njeriut ekzistencial". Vullnetin e ekzistencës e interpretoi me këto fjalë: "Vullneti i ekzistencës nënkupton ndjesinë e njeriut për vetveten dhe përpjekjen e vazhdueshme për formësimin e fatit të vet. Ky vullnet e prodhon arsimin, leximin dhe metodën e të menduarit."<sup>156</sup> Vështrimi shkençor ndaj realitetit është korniza e gjerë e të menduarit, kurse brenda kësaj kornize është edhe problemi i "metodës së hulumtimit letrar". Kjo është problematika që e dominoi të

<sup>155</sup> Shukri Ajjadi, *Texharibu fi el-edebi ve en-nekdi*, vep. e cit., f. 63

<sup>156</sup> Daru El-Hilal, *Et-Tekvinu: hajatu el-mufekkirine ve el-udebai ve el-fennanine bi aklamihim*, vep. e cit., f. 11

menduarit e tij kritik. Çështja e "identitetit kulturor" dhe e "unit qytetërimor" aktiv është pikërisht ajo që e orienton të menduarit, i vizaton shenjat dhe rrugët, dhe e shtyn këtë kritikë drejt ngjiqes së horizonteve epistemologjike të shumëlojshme. Pavarësisht arritjeve kritike serioze, të cilat shkëlqyen në rrugëtimin shkencor të Shukri Ajjadit, përsëri ekzistonin ndjenjat e fshehta të dështimit, gjë të cilën e shprehu vetëm duke thënë shenjë dhe të cilën e hetuan të afërmit e tij. Ndoshta artikulli "El-Ashiku el-misrijju",<sup>157</sup> i cili llogaritet ndër shkrimet e fundit të tij, tregon qartë hutinë dhe konfuzionin e tij për vërtetësinë e këtij drejtimi. Shukri Ajjadi thotë: "Megjithatë unë jam egjiptian apo arab. "S'ka dallim" nëse e gjej veten në pozitën e spektatorit apo të atij që lëviz në fund të karvanit. Kur e meditoj çfarë lëviz rrëth meje dhe shoh gjendjen time, atëherë më kaplojnë dyshimet dhe më ngjallen dy brenga: të eci për të mos më ikur karvani, ta njoh vetveten dhe të shoh se ku jam unë përball kësaj fuqie e cila e ka mbështjellë mbarë universin? Personalisht e pranoj se jam i preokupuar me brengën e dytë më shumë sesa me të parë, madje vazhdoj të vrapij në këtë drejtim: ndoshta do të ishte më e udhës ta lë popullin në vrarin e vet, kurse unë, pasi të merrja pak frymë, të vazhdoja vrarin në një drejtim tjetër."<sup>158</sup> Pastaj kulmin e vrerit e mbërrin kur shtron dilemën: "I them vetes: karvani është udhëzuesi im! Pikërisht ky është vetë devijimi"<sup>159</sup>

Kur Shukri Ajjadi e përqafoi fundin e vet dhe hyri në horizontin e përjetësisë (pra kur vdiq), Hasen Tilbi thuri për të një kaside me titull "Jekinu el-eman".<sup>160</sup> Kjo është kaside me strukturë dialogu të vagëlluar, ku hollësítë e saj shpre-

<sup>157</sup> Ky artikull u publikua kështu: Shukri Ajjadi, "El-Ashiku el-misrijju", në librin: *Nehbetun min el-kitabi, merfeu edh-dhakireh*, Kuvajt, Kitabu el-arabiji, nr. 54, tetor, 2003. Studimi ishte publikuar edhe në revistën "El-Arabijja" nr. 491, tetor, 1999, afërsisht një muaj pas vdekjes së Shukri Ajjadit, sepse ai vdiq më 23.07.1999.

<sup>158</sup> Shukri Ajjad, "El-Ashiku el-misrijju", vep. e cit., f. 105

<sup>159</sup> Po aty, f. 106

<sup>160</sup> E publikuar në revistën "Ibda", nr. VII, shtator, 1999, f. 4-10

hin hutinë e Shukri Ajjadt për jetën dhe dëshirën e tij të flaktë për ta shmangur plejadën e atyre që shkojnë në "festival". Poeti shprehet kështu:

*Mos e kërko, biri im, shpëtimin kötu... kujdes!*

*Mos të të mashtrojë tufa e shpezëve që fluturojnë në perëndim*

*Këtë tufë e lëviz frika dhe uria,*

*Prandaj mendo gjatë... dhe realizo mëdyshjet e shkrimit...*

Deri te:

*E tani: ndjej se u çlirova... lundrova*

*E pashë fundin e rrugës... dhe eca me turmën.*

*Shok i rrugëtimit tim ishte Ibn Ruzhdi*

*dhe pak njerëz të besueshëm dhe të mirë:*

*shejhu El-Mearri, Tagore dhe Dhun-nuni.*

*Këta nuk kanë frikë Ditën e Llogarisë*

*dhe nuk pikëllohen.*

Esktrapolimi i qëndrimit kritik të Shukri Ajjadt, bashkë me dimensionet shpirtërore dhe kulturore, është një çështje shumë e rëndësishme para se të hyhet në botën e tij kritike. Kjo botë, sipas Abdulmun'im Tel-limeh, shkëlqeu brenda tre boshteve madhore: "Reformimi i mësimit letrar dhe ngritura e tij mbi të njëjtat tekste derisa të përfaqen bukuritë e gjuhës arabe dhe karakteristikat e stileave të saj. Kjo rrugë nisi në dy tezat e Ajjadt, në atë të magjistraturës dhe të doktoratës. Në të parën (në magjistraturë) e studioi përshkrimin e Ditës së Llogarisë në Kur'an, ku punën shkencore e mbështeti në ajetet kur'anore që e përshkruajnë llogarinë. Bëhet fjalë për veçoritë retorike, stilistike dhe estetike të përgjithshme. Ndërsa në të dytën (në doktoratë) e studioi përkthimin klasik arab të veprës "Poetika" të Aristotelit dhe ndikimin e saj në stilistikën arabe."<sup>161</sup>

<sup>161</sup> Abdulmun'im Tel-limeh, "El-Kuvvetu en-nakideh ve el-kuvvetu el-halikah: Shukri Muhammed Ajjad", revista "Ibda", viti IX, shtator 1999, f. 19, shih:

Boshti i dytë është themelimi i modernes duke e ndërtuar mbi mutevatirin. Në këtë kontekst Tel-limeh ka theksuar një sërë studimesh fundamentaliste të Ajjadit, si p.sh. "El-Betalu fi el-edebi ve el-esatiri – 1959", ku i ka vendosur fondamentet e metodës moderne për zbulimin e trashëgimive të grupeve dhe të bashkësive njerëzore. Këtu ka paraqitur manifestimet e këtyre trashëgimive në krijimin e grupeve përgjatë historisë. Po ashtu, vepra "Med'halun ila ilmi el-uslubi, 1983", ku e ka lidhur stilistikën bashkëkohore me retorikën dhe kritikën e trashëguar, bashkë me praktikat e thella në poezinë arabe. Trinomia kritike e Ajjadit është gjuha dhe krijimi, letërsia dhe kultura, dhe qarku i krijimit. Ajjadi në këtë trinomi ka vendosur një imazh gjithëpërfshirës të teorisë së tij të letërsisë, metodat studimore dhe mënyrat e kritikës së tij.<sup>162</sup>

Boshti i tretë përfshin metodën kritike aplikative. Ajjadi qysh në fillim të aktivitetit të tij kritik kërkonte të trillojë një metodë objektive për kritikën aplikative, e cila do të ngrihej mbi studimin e tekstit, gjegjësisht mbi studimin e karakteristikave gjuhësore, stilistike dhe estetike të tij. Të gjitha përpjekjet e tij janë grumbulluar në tri vepra: "Texharibu fi el-edebi ve en-nekdi, 1968 (Eksperiencia në letërsi dhe në kritikë, 1968)", "El-Edebu fi alemin mutegajjirin, 1971 (Letërsia në botën dinamike, 1971)" dhe "Er-Ru'ja el-mukajjedeh, 1978 (Botëkuptimi i ngujuar, 1978)".<sup>163</sup>

Abdulmun'im Tel-limeh e lehtësoi dallimin kritik dhe të thukët me një përbledhje e cila tregon thelbin e të menduarit kritik të Ajjadit. Tel-limeh mendon se ai është koka e një drejtimi ideologjik dhe kryesuesi i një shkolle shkencore, "rrënjet e para të së cilës i ka vendosur mësuesi i tij reformues, Emin Huli. Pastaj për ato u kujdes Ajjadi dhe i pasu-

Ahmed El-Hevar, *Shukri Ajjad ve hitabu en-nehdati*, brenda "El-Kitabu et-tekrimiji",

Ahmed El-Hevar, *Shukri Ajjad: xhusurun ve mukarebatun thekafijjetun*, Egjipt, botimi I, 1995, f. 46

<sup>162</sup> Po aty, f. 19

<sup>163</sup> Po aty, f. 20

roi me shtesa kreative për t'i përvetësuar rezultatet shkencore të fituara nga gjuhëtarët, letrarët dhe kritikët nëpër qarqe shkencore përparimtare. Rrugë e kësaj shkolle është ringjallja e trashëgimisë stilistike dhe gjuhësore dhe shmangja e hulumtimit (të thatë). Mjet i kësaj shkolle është konsolidimi i metodës së hulumtimit dhe bashkëveprimi me shkencat moderne. Ndërsa synim i saj është mbërritja te një shkencë arabe bashkëkohore për studimin e letërsisë, e cila ngrihet mbi klasiken burimore dhe i shfrytëzon metodat dhe mënyrat hulumtuese bashkëkohore.<sup>164</sup> Kjo është shumë e përafërt me thënien e studiuesit Mahmud Emin El-Alim për Shukri Ajjadit: "E trajtoja atë si një nga nxënësit më të njojur dhe më të mençur të shkollës së Emin Hilit, shkollë që shpejtonte me ngulm dhe me shumë guxim drejt reformimit letrar, si nga ana intelektuale ashtu edhe nga ajo kreative."<sup>165</sup>

Drejtimi i komentimit letrar u paraqit në të njëjtën kohë kur u paraqiten edhe dy drejtime të tjera në tefsir (komentim): drejtimi social dhe drejtimi shkencor. Drejtimi social u mbështet në interpretimin e teksteve kur'anore "në kornizën e problematikave të mëdha sociale, të cilat janë të ndërlidhura me zhvillimin social në ballafaqim me kohën. Këto janë probleme që lidhen edhe me ballafaqimin e kolonializmit, me thirrjen për unitet, me reformimin social, me problemin e (përfaqësimit të) gruas dhe të tjera."<sup>166</sup> Muhamed Abduhu gëzon meritën e nismës së themelimit të këtij drejtimi aktiv në lëvizjen e zgjimit arab-islam. Pyetja esenciale që shtrohet në kontekstin e këtij drejtimi është: çfarë marrëdhënie ka Islami me kulturën moderne? A kanë mundësi muslimanët t'i përgjigjen logjikës së kohës dhe nevojave të

<sup>164</sup> Abdulkun'îm Tel-limeh, *El-Kuvvetu en-nakideh ve el-kuvvetu el-halikah: Shukri Muhammed Ajjad*, vep. e cit., f. 18-19

<sup>165</sup> Mahmud Emin El-Alem, *Shukri Ajjad ve nedharijetihu en-nekdijeh*, në hyrje të librit të Shukri Ajjadit, *El-Kafz ala el-eshvaki*, Kajro, Daru el-Hilal, 1999, f. 5

<sup>166</sup> Affet Sherkavi, "Shukri Ajjad ve menhexhuhi fi et-tefsiri el-edebiji li el-Kur'ani el-kerimi bejne menahixhi el-mufessirine fi el-asri el-hadith", brenda librit: *Shukri Ajjad: xhusurun ve mukarebatun thekafijetun*, Kajro, botimi I, 1995, f. 256

modernizmit?<sup>167</sup> Nëse po, atëherë përpjekjet e pionierëve të këtij drejtimi të tefsirit do të konsiderohen si një metodë e re për mbrojtjen e mrekullisë së Kur'anit Fisnik dhe për ta sqaruar aspektin social të realitetit kur'anor.<sup>168</sup>

Sa i përket drejtimit shkencor në komentim, më herët e theksuam qëndrimin e ekuilibruar të Emin Hulit për këtë drejtim. Këtu mund të shtohet se ky qëndrim përshtatet deri diku me mësimet e shkollës së profesorit të tij, Muhammed Abduhusë. Gjëja më e vogël që ka kjo shkollë është premisa e komentimit të Kur'anit në formë të drejtë. Kjo premisë nënkupton faktin se Kur'ani nuk mund të përmbayë asnje mësim që bie ndesh me të vërtetat shkencore.<sup>169</sup> Iffet Sherkavi e quan këtë drejtim si "shkenca e re e kelamit"<sup>170</sup>, duke e konsideruar atë si një disiplinë shkencore që i mbron të vërtetat fetare brenda të dhënavë logjike. Po ashtu, kjo disiplinë kërkon të barazojë apo pajtojë shkençën me fenë. Krahas rreziqeve që e rrethojnë këtë drejtim, muslimani bashkëkohor duhet ta shohë atë pozitivisht, sepse ka të bëjë "me aspiratat të cilat i ndërlidhin arritjet e të kaluarës shpirtërore dhe historike me arritjet më të dalluara të shpikura nga shkenca moderne. Ky drejtim përfaqëson çelësin e vërtetë të kulturës njerëzore sot."<sup>171</sup>

Sa i përket Hasen Hanefiut, ai ka hedhur dritë zbuluese mbi këtë drejtim, duke i spikatur disa aspekte pozitive, si p.sh. dëshirën për modernizim, respektin relativ ndaj ditur

<sup>167</sup> Po aty, f. 256. Goldziheri i ka ndjekur rrënjet e hershme të këtij drejtimi te muslimanët e Indisë. Me theks të veçantë është ndalur te përpjekjet e Sejjid Emir Alij, te njëri nga udhëheqësít më të shqar dhe më me ndikim të renesancës kulturore-islamë. Gjithashtu, ai flet se si kjo lëvizje kishte mundësi t'i pasqyrojë parimet themelore të Islamit si burimin specifik të pëparimit intelektual dhe social. Shih:

- Goldziher, *Medhahibu et-tefsiri el-islamiji*, vep. e cit., f. 338. Analiza e thukët e cila u ofrua nga Hasen Hanefi në këtë drejtim, dhe atë në veprën: Hasen Hanefi, "Et-Tefsiri ve mesalihu el-ummeti: et-tefsiri el-ixtimaiju", *Kadaja islamijetun muaseretun*, viti 4, 1998, f. 174

<sup>168</sup> Sherkavi, *Shukri Ajjad ve menhexhuhi fi et-tefsiri el-edebijji*, f. 256

<sup>169</sup> Goldziher, *Medhahibu et-tefsiri el-islamiji*, vep. e cit., f. 376

<sup>170</sup> Sherkavi, *El-Fikru ed-diniju fi muvaxheheti el-asri, dirasetun tahlilijetun li ittixhatati et-tefsiri fi el-asri el-hadithi*, vep. e cit., f. 391

<sup>171</sup> Sherkavi, *Shukri Ajjad ve menhexhuhi fi et-tefsiri el-edebijji li el-Kur'an el-kerimi*, vep. e cit., f. 259

risë, orientimin kah komentimi kohor-historik. Në të njëjtën kohë jep alarmin për kujdesin nga gjërat negative dhe nga pasojat e këtij drejtimi, sepse kjo çon në vazhdimësinë e nakalit (dijes tradicionale) në një periudhë të gjatë, pa i marrë në konsideratë teoritë shkencore: i merr në konsideratë arrijet shkencore pa pasur botëkuptim shkencor për botën; i jep shkencës timonin e inicuesit, kurse fenë e bën ndjekëse të tij. Te këto numërohet edhe shpërfillja e çështjeve politike dhe sociale që e preokupojnë mendjen e turmës dhe tjetërsimi i vetëdijes për çështjet që e preokupojnë realitetin social dhe politik, pra, sipas këtij botëkuptimi të gabuar, duket sikur Allahu përfaqet vetëm në natyrë dhe jo në shoqëri.<sup>172</sup>

Kontekstini e mbushur plot me dije, me vizione dhe me metodologji të propozuara për zhvillimin e leximit bashkë-kohor të Kur'anit, Goldziheri e quan "komentim në dritën e qytetërimit islam".<sup>173</sup> Leximi (letrar) i Kur'anit fisnik nga Shukri Ajjadi shkëlqeu nën udhëheqjen e profesorit të tij, Emin Huli, i cili për temë doktorate ofroi temën e dalluar "Nga pëershkrimi kur'anor për Ditën e Gjykimit dhe të Llogarisë"<sup>174</sup> në vitin 1948 dhe ishte themel i lindjes së një kritiku, i cili mund të trajtonte problemet më delikate shkencore, por fatkeqësisht u ndal te ky hap i parë i jetës së tij shkencore. Shkolla e Emin Hulit u ballafaqua me një stuhi të furishme të kundërshtimeve, madje kundërshtohej fuqishëm pasi Muhammed Ahmed Halefullah e shkroi doktoratën që nxiste debat "El-Fennu el-kisasiju fi el-Kur'ani el-kerimi" në vitin 1947, me të cilën solli rezultate shokuese për mendimin islam të kohës, prandaj administrata e Universitetit Egjiptian vendosi që Hulit të mos i lejohet mësimdhënia në studimet kur'anore apo

<sup>172</sup> Hasen Hanefi, *Et-Tefsiru ve mesalihu el-ummeti: et-tefsiru el-ixhtimaiju*, vep. e cit., f. 170-171; Edh-Dhehebij, *Et-Tefsiru ve el-mutesirune*, vep. e cit., vëllimi II, f. 491

<sup>173</sup> Goldziher, *Medhahibu et-tefsir el-islamiji*, vep. e cit., f. 337

<sup>174</sup> U publikua me titullin "Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi

- Shukri Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, Kairo, Daru Esh-Shuruki, 1980

udhëheqja e kandidatëve. Shukri Ajjadi, sipas Nasr Hamid Ebu Zejdit, duhej "ta kundërshtonte për shkak të vendimit që kishte sjellë Universiteti pas debatit të nxeh të që kishte nxitur doktorata e Halefullahut dhe të cilat i ishte kërkuar të zgjedhë të vazhdojë studimet kur'anore nën udhëheqjen e një profesori tjeter apo me Emin Hulin, mirëpo në një sferë tjeter të studimeve kur'anore. Njësoj si me këtë ndodhi me shumicën e studentëve të Hilit. Ajjadi ishte shumë i lidhur me profesorin e tij, prandaj zgjodhi zgjidhjen e dytë."<sup>175</sup>

Kjo ngjarje la një pakënaqësi që vazhdonte të fshihej në vetëdijen e Shukri Ajjadt. Kur vendosi ta publikojë pas tridhjetë e ca viteve, e publikoi me një hyrje të shkurtër ku gufoi millefi dhe keqardhja, sepse doktorata e tij ishte lënë në harresë. I patrembur në fjalë, shprehte ndjenjën e humbes, sepse tani nuk kishte mundësi ta vazhdonte rrugëtimin në këtë drejtim, ku thotë: "Këtë hulumtim e kam shkruar para tridhjetë e disa viteve. Atëkohë shkolla e tefsirit letrar përpinqej të çajë rrugën përpara në jetën tonë universitare dhe kulturore, në një mjedis me shumë ciklone të keqkuptimit dhe të shkurtpamësisë. Nuk isha edhe aq i kënaqur me këtë prurje, megjithatë isha i bindur se pak lexues mund t'ia arrijnë kësaj pune. Ky punim përpinqet ta komentojë Librin më madhështor në gjuhën arabe sipas një "metode" të përfthuar nga librat e tefsirit tradicional dhe racional. Ky hulumtim e ndihmon studimin letrar me një kulturë të çmuar dhe sociale. Jep mundin maksimal për ekzaminimin e ngjarjeve dhe krahasimin e teksteve para se të shpalosë mendimin. Atë që mund të them tani është se unë pretendoj se ia kam arritur qëllimit apo jam afruar aty afër... Megjithatë, isha shumë i lënduar sepse ndjehesha i privuar."<sup>176</sup>

<sup>175</sup> Abu Zayd, "The Dilemma of the Literary Approach to the Quran," f. 19

<sup>176</sup> Shukri Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 5

- Ibn El-Ethir Ebu Es-Seadat, *En-Nihajtu fi garibi el-hadithi ve el-etheri*, hadithet i ka përgatitur për botim dhe i ka komentuar Salah Uvejdhah, Beirut, Daru El-Kutubi El-Ilmijjeti, botimi I, 1997, vëllimi I, f. 93

Pastaj tregon shkaqet e publikimit të këtij disertacioni, se pas një hamendje të gjatë “se jeta kulturore sot në botën arabe u kërkon ekspertëve të tefsirit letrar që të ofrojnë krejt çfarë kanë rrith kësaj problematike.”<sup>177</sup> Kjo hyrje e shkurtër do të jetë një rrugë për të kaluar te punimet tjera të ngjashme si kjo. Aty ai i ka sqaruar gjerësisht finesat e metodës së tij, për të cilën disa kritikë mendojnë se ajo është një llo degëzimi teorik i mendimit të profesorit të tij, të Hilit. Po ashtu, këtë e trajtojnë si një model praktik të metodës së tij në tefsir dhe aty shpaloset vështrimi i tij për idenë e i'xhazit (mrekullisë) në Kur'an<sup>178</sup>, pa prekur asgjë në originalitetin shkencor të Shukri Ajjadit. Pavarësisht qartësisë së fjalëve të metodës së Ajjadit dhe të prononcimit të përfitimit nga prurjet teorike të profesorit të tij, Abdusselam Shadhiliu anoi në një burim tjetër të influencës, sepse mendon se Ajjadi e ka aplikuar “metodën e Lansonit në studimin e thelluar të teksteve, dhe atë duke filluar nga sqarimi i fjalëve dhe i figurave, ku kuptimet leksikore lidhen me objektivin human. Me këtë ai e lëkund metodën historike të disa orientalistëve, të cilët shpeshherë mbështeten në sensin gjuhësor, veçanërisht për kuptimet e teksteve vjetra fetare dhe letrare.”<sup>179</sup>

Nuk ka dyshim se ndikimi i Gustave Lanson (1857-1934) kishte mbërritur në qarqet kulturore egjiptiane, duke u trajtuar sipas Rene Wellek<sup>180</sup> “si simbol i historisë letrare akademike franceze”. Muhamed Menduri e ka përkthyer veprën e tij të rëndësishme “Menhexhu el-bahthi fi tarihi el-adabi” para viti 1946.<sup>181</sup> Dritaret logjike të grupit “Besnikët” ishin

<sup>177</sup> Shukri Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 5

<sup>178</sup> Abdulhakim Radi, “Shukri Ajjad (nga përkrimi i Kur'anit për Ditën e Gjykimit dhe të Llogarisë) diskutimi i lëndës, objekti, teoria, metoda”, revista “Ibda”, viti IX, 1999, f. 21

<sup>179</sup> Abdusselam Shadhiliu, “Shukri Ajjad bejne et-tarihi ve en-nekdi ve edh-dhakireh el-hadarijeh”, revista “Ibd”, viti IX, 1999, f. 41

<sup>180</sup> Rene Wellek, *Tarihi en-nekdi el-ebediji el-hadithi (1750-1950)*, i përkthyer nga Abdulmun'im Muxahid, Kajro, El-Mexhisi El-A'la li Eth-Thekafeti, 2000, vëllimi IV, f. 145

<sup>181</sup> Muhamed Mendur, *En-Nekdu el-menhexhijju inde el-arabi*, Kajro, Daru Nehdati Misri li Et-Tab'i ve En-Neshri, 2008, f. 3

kah kultura perëndimore, edhe pse ato trajtonin probleme që kishin të bënин me kulturën arabe. Muhamed Ahmed Halefullah, në hyrjen e librit “El-Fennu el-kisasiju fi el-Kur’ani el-kerimi” pohon ndikimin e drejtpërdrejtë nga hulumtimi i Lansonit, siç potencuam më parë, ku thotë: “Lexova një hulumtim të vlefshëm për metodën letrare të shkruar nga Lansonit dhe të arabizuar nga Menduri.”<sup>182</sup> Pastaj bëri një sqarim të dallimeve thelbësore në studimit tonë të letërsisë dhe në studimin e perëndimorëve. Gjithashtu, ka sqaruar se perëndimorët kur e studiojnë atë (tekstin) nga aspekti letrar i kushtojnë kujdes të plotë dallimit të vlerave logjike nga ato emocionale, artistike dhe stilistike, sepse perëndimorët i sjeillin gjykimet letrare për poetët, shkollat letrare apo drejtimet artistike vetëm pasi t'i posedojnë të gjitha mekanizmat që u mundësojnë sjelljen e këtij apo atij gjykimi.”<sup>183</sup>

Huazimi i Halefullahut nga Lansoni është shumë i qartë. Lansoni e ka renditur grupin e hapave që duhet ndjekur gjatë studimit të teksteve letrare. Në mesin e këtyre hapave ishte “konstituimi i kuptimit të fjalëpërfjalshëm të tekstit, i kuptimit të fjalëve dhe formulimeve duke e shfrytëzuar historinë e gjuhës, gramatikën dhe strukturën historike... Pastaj, pas kësaj e ndërtojmë kuptimin letrar të tekstit, d.m.th. i përcaktojmë vlerat logjike, emocionale dhe artistike. E dallojtmë përdorimin e gjuhës nga shkrimtari individual nga përdorimi rrjedhës i bashkëkohësve të tij. Gjithashtu, i përbledhim idetë, imazhet dhe mendimet etike, sociale, filozofike dhe fetare të cilat renditen nën diskursin e përgjithshëm logik.”<sup>184</sup> Ky tekst na kujton hapat metodologjikë të cilat i ka propozuar Emin Huli për t'i sunduar kup-

<sup>182</sup> Muhamed Ahmed Halefullah, *El-Fennu el-kisasiju fi el-Kur’ani el-kerimi*, Kajro, Mektebetu En-Nehdati El-Misrijjeti, botimi i, 1950-1951, f. 12

<sup>183</sup> Po ashtu, f. 12

<sup>184</sup> Gustav Lanson dhe Meillet Antonie, “Menhexhu el-bahthi fi tariki el-adabi”, i përkthyer nga Muhamed Menduri, i cili u publikua brenda librit të Muhamed Mendurit, *En-Nekdu el-menhexhiju inde el-arabi*”, Kajro: Daru Nehdati Misre li Et-Tibaati ve En-Neshri, 2008, f. 410-411

timet e tekstit në kontekstin historik. Prononcimi i Halfullahut për ndikimin nga Lanson i pret rrënjet e dyshimeve që mund të lindin nga lidhja e shkollës së Hulit me kritikën e saj bashkëkohore. Mirëpo, Shukri Ajjadi nuk e pranon assesi ndikimin e drejtëpërdrejtë në nivel të metodës, pavarësisht interesimit të tij për t'i theksuar referencat që janë përfshuar prej tyre, apo i diskuton dhe i kundërshton mendimet e tyre. Në këtë mjegullim vështirësitet konstatimi se Shukri Ajjadi në studimin e vet "Jevmu ed-dini ve el-hisabi" e ka aplikuar metodën e Lansonit. Abdulkexhid Hanun i ka ndjekur gjurmët e Gustave Lanson në kritikën moderne arabe. Fillon me Ahmed Dajfin (1880-1945), për të vazhduar me Muhamed Mendurin (1907-1965) dhe përfundon me Taha Husejn (1889-1973), për të shtuar këtu edhe një turmë të madhe të kritikëve të cilët erdhën pas tyre. Shukri Ajjadi nuk theksohet në mesin e kritikëve që u ndikuani nga metoda e Lanson.<sup>185</sup> Ndoshta atë që thotë Abdusselami Shadhiliu është vetëm një krahasi me hapësirën kritike që sundonte në atë periudhë historike.

Ndikimi kritik i drejtëpërdrejtë, të cilin mund ta spikatim në studimin e Shukri Ajjadit është ndikim i kritikut të njohur anglez Ivor Armstrong Richards. Ajjadi e ka theksuar veprën e tij "Felsefetu el-belagati"<sup>186</sup> në paraqitjen kundërshtuese ndaj Sejjid Kutubit, autorit të veprës "Et-Tesviru elfenniju fi el-Kur'ani".<sup>187</sup> Xhabir Asfuri është ndalur në artikullin e tij të vetëm "Durusu el-ustadhi", të cilin e ka shkruar pas vdekjes së profesorit të tij, Shukri Ajjadi. Më konkretisht është ndalë tek etapat e zhvillimit kritik të profesorit. Po ashtu konstatoi se "i ka përfaqësuar shkrimet e kritikut anglez Richards dhe i riprodhoi idetë e tij për gjuhën në lib-

<sup>185</sup> Abdulkexhid Hanun, *El-Lansunijetu ve etheruha fi ruvvadi en-nekdi el-arabiji el-hadithi*, Kajro, El-Hej'etu El-Misrijjet El-Ammetu li El-Kitabi, botimi I, 2006, F. 252

<sup>186</sup> U përktheje në arabisht nga Seid El-Ganemi dhe nga Nasir Halavi. U publikua nga Daru Efrikja Esh-Sherki, 2002

<sup>187</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 80

rat si "Mebadiu en-nekdi el-edebijji", "Felsefetu el-belagati" dhe "Ma'na el-ma'na". Këto vepra i shfrytëzoi në disertacionin e magjistraturës, ku paraqiti një studim të ri stilistik të kohës dhe ku zbulohet ndikimi nga përpjekja rrënjosore e Richardit në fushën e reformimit të stilistikës klasike."<sup>188</sup>

Metoda e zgjedhur nga Shukri Ajjadi me vetëdije dhe me vizion ishte metoda, fondamentet e së cilës i kishte ngulitur profesori i tij, Emin Huli. Duket se pas këtij entuziazmi të xhematit "Besnikët" shfaqet ideja e inkuadrimit në një leadership (të ri) letrar, i cili bie ndesh me dy lidershipet letrare në Egjipt: me atë francezo-latin, të përfaqësuar nga Taha Husejni dhe me atë anglo-sakson, të përfaqësuar nga Abbas Akkadi. Më herët u theksuan tiparet unike të cilat Shukri Ajjadi i ka përbledhur për mësuesin e vet. Nuk është diçka e re nëse themi se ai zgjodhi tërësinë e ideve thelbësore, mbi të cilat u ngrit metoda e Hilit në periudhën e hershme, gjegjësisht qysh nga nisma e tij akademike. Dëshironte që ta përzgjedhë dhe ta bëjë atë si hyrje të doktoratës së vet, pastaj tha: "Ato janë fondamentet e metodës letrare në tefsir. Unë nuk kam pse e zgjas më shumë dhe pse sjell argumente. Ai që do të dijë më shumë për ato, le t'i referohet hulumtimit të profesorit tonë. Unë vetëm i konstatoj këto parime dhe mbështetem në ato para se t'i aplikoj në atë që përpinqem të bëj, gjegjësisht në përshkrimin kur'anor për Ditën e Gjykimit dhe të Llogarisë."<sup>189</sup>

Ndjenja subjektive për origjinalitetin shkencor e shtyri Shukri Ajadin në këtë moshë të re të shtojë edhe një parim tjetër në tefsirin letrare, se pas hulumtimit të fjalëve dhe të figurave letrare duhet hulumtar qëllimet humane dhe sociale në Kur'an. Ky hulumtim është thelbi i tefsirit letrar, kuptohet nëse duam ta studiojmë Kur'anin në aspektin

<sup>188</sup> Xhabir Usfuri, "Durusu el-ustadhi", revista "El-Hilali", viti 108, 1999, f. 20

<sup>189</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 9

letrar, siç i studiojnë popujt e ndryshëm veprat bazike-letrare të gjuhëve të tyre.”<sup>190</sup> Këtë çështje e ka theksuar tërthorazi edhe mësuesi i tij, megjithatë e konfirmoi dhe e aplikoi Shukri Ajjadi. Pra, “gjatë studimit të një vepre të dalluar letrare, nuk mjafton që studiuesi vetëm t’i sqarojë kuptimet e fjalëve dhe figurat stilistike të të shprehurit nëse nuk e ka kanalizuar mundin e vet edhe në sqarimin e vlerës humane, duke shtuar një vetëdije të re dhe një perceptim të thukët një frysmin (shpirtin) njerëzor.”<sup>191</sup> Kjo shtesë metodologjike e shtyri atë të hulumtojë marrëdhënien e fesë me artin, duke i kaluar reflektimet e mësuesit të vet dhe duke i zvogëluar pengesat që mund t’i dildnin në rrugë studiuesit letrar të tekstit kur'anor. Feja dhe arti puqen në atë se të dyja shprehin aspektin ndërgjegjësor (sentimental) të shpirtit njerëzor. Pastaj feja dallohet me një tufë veçorish... ku do të veçoja besimin në një fuqi më të lartë dhe jetën tjetër shembullore. Megjithatë, feja vazhdon të ketë lidhje të ngushtë me artin, sepse feja, pavarësisht vështirësisë së përcaktimit të zhvillimit, objekti i saj domosdoshmërisht ngërthen problemet e identitetit, të ekzistencës, ndryshimet rrënjosore në jetë dhe në mendim.”<sup>192</sup>

Ajjadi e zhvillon këtë ide për të mbërritur te e vërteta se letërsia fetare është ngjyrimi më fisnik i letërsisë. “Përvojat e çmuara janë objekt i letërsisë, kurse përvojat më të thella gjenden në fe. Nëse kjo është kështu, pra nëse letërsia fetare ndërtohet mbi përvoja të përbashkëta të gjinisë njerëzore, atëherë letërsia fetare vërtet qenka më madhështorja dhe më e vlefshmja.”<sup>193</sup>

Raporti i fesë me artin ka shumë dimensione filozofike dhe shpirtërore. Sipas Xhak Maritanit, poezia është “fryti i

<sup>190</sup> Po aty, f. 9

<sup>191</sup> Po aty, f. 9-10

<sup>192</sup> Po aty, f. 69. Ajjadi vetë e ka deklaruar shfrytëzimin e ideve të tij (të profesorit) këtu, gjegjësisht në vepren “Enciklopedia e fesë dhe e etikës”.

<sup>193</sup> Po aty, f. 69

lidhjes së shpirtit dhe realitetit me burimin e tyre: me Allahun.”<sup>194</sup> Alija Izetbegoviq pohon se ekziston një unitet parimor në rrënjet e thella të fesë dhe të artit. “Drama, po ashtu, ka burim fetar, qoftë në aspektin tematik apo atë historik... Drama greke lindi nga këngët e Koralit për ndër të zotit “Dionis”, prandaj skenat ndërtoheshin pran faltore së tij... arti i ndërtimit, më shumë se çdo gjë tjeter përparoi në ndërtimin e faltoreve.”<sup>195</sup> Pastaj Izetbegoviqi transmeton një thënie shumë domethënëse për filozofin francez Herni Bergson, ku ndër të tjerash thotë se “arti është pjellë e fesë, prandaj nëse arti dëshiron të mbetet gjallë, duhet çdoherë të ushqehet nga burimi i vet.”<sup>196</sup>

Para se Shukri Ajjadi të nisë leximin praktik, u ndal te dy çështje që ndërlidhen me metodën. Çështja e parë është lidhja e tefsirit letrar me drejtimet tradicionale të tefsirit, gjegjësisht me dy degët e tij: me tefsirin tradicional dhe me tefsirin racional. Çështja e dytë është biseda rreth metodës historike të orientalistëve në studimin e Kur'anit Fisnik.

Shukri Ajjadi e shfrytëzoi metodën e Goldziherit kur e zgjodhi tefsirin e Taberiu (310 h.) “Xhamiu el-bejani an te’vili aji el-Kur'an” si model të tefsirit tradicional<sup>197</sup> dhe

<sup>194</sup> Alija Izetbegoviq, *El-Islamu bejne esh-sherkî ve el-garbi*, i përkthyer në arabisht nga Muhammed Jusuf Adis, Beirut, Muessesetu El-Ilmi El-Hadithi, botimi I, 1994, f. 144

<sup>195</sup> Po aty, f. 146, 148

<sup>196</sup> Po aty, f. 148

<sup>197</sup> Goldziheri nuk fshel simpatinë e madhe ndaj tefsirit të Taberit. Për të ky tefsir “është një libër madhështor i cili në një anë e pasqyrat kulmin e tefsirit tradicional, kurse nga ana tjeter konsiderohet pikë fillostarte apo gurë themeltar i letërsinë e tefsrit të Kur'anit.” Shih:

- Goldziher, *Medhahibu et-tefsiri et-islamiji*, vep.e cit., f. 106-107. Kurse Noldeke, pavarësisht pohimit se tefsiri i Taberit përfaqëson një pikë kthene në historinë e tefsirit dhe se është vepra më madhështore që ka prodhuar bota islamë, ai përsëri ka drejtuar një kritikë thumbuse për këtë vepër duke e konsideruar atë tubim të një materie e cilë sipas tij “tërësisht është nën ndikimin e paragjykimeve doktrinore (akaidore), ashtu që nuk është i gatshëm të krijojë një pikëpamje historike objektive. Shih:

- Noldeke, *Tarihu el-kur'anî*, vep. e cit., vëllimi II, f. 391-392. Ai (tefsiri i Taberit) është fjalë jo e thukët, sepse Taberiu pas shoshtjes së thukët të formave të komentimit, ku i thekson edhe trajtat e kundërshtarëve, shpeshherë përzgjedh formën që kënaq atë. Shprehja e tij e njohur është kjo: “Sipas meje ky interpretimi është më me përparsësi dhe më i saktë” dhe reflekton fugjishëm frymën kritike të tij me të cilën e komenton librin e Allahut. Regis Blachere e lavdëron metodën e Taberit dhe ofron një përmblehdje të thukët përmënyrën e tij të komentimit, ku ndër të tjerash e cilëson si “themelues i tefsirit me fjalët më shembulllore”. Gjithashtu, sqaron edhe mënyrën Taberit (në komentim), e që është

tefsirin "El-Keshshaf an hakaiki gavamidi et-tenzili ve ujuni el-ekavili fi vuxhuhi et-te'vili" të Zemahsherut (528 h.) si model të tefsirit racional.<sup>198</sup> Taberiu e mbushi librin e vet me transmetime, ku dominojnë hadithet mer'fu' dhe mevkuf. Në këtë sferë nuk i del përpara asnje koleksion i tefsirit. Kjo punë hulumtuese e çoi atë të mbledhë transmetimet e vërteta dhe të dobëta, prandaj ajo mbeti si një materie madhështore për studiuesit e librit të tij. Hafidh Ibn Kethiri (vdiq 774 h.), nëse nuk do t'i kishte shoshitur, kritikuar dhe përzgjedhur transmetimet e Taberiuut në veprën e tij të çmuar "Tefsiru el-Kur'ani el-Adhimi", atëherë vepra e Taberiuut do të mbetej si një vepër nga e cila mund të përfitonin vetëm dijetarët e zgjedhur. Për këtë arsy, Shukri Ajjadi ishte shumë i kujdeshëm dhe i matur kur mbështetetë në prurjet e dijetarëve klasikë për çështjen e pranimit apo refuzimit të transmetimeve. Këtë e sqaron me këto fjalë: "Nëse e shqyrtojmë qëndrimin tonë ndaj tefsirit tradicional, nuk duhet lënë të lirë fjalën për këtë tip tefsiri, sepse kjo kërkon studim të sendeve (zinxhirëve të transmetimeve), siç kerkohet studim përvetësues dhe kritik i faktorëve që ndikojnë në to. Ne nuk i hedhim krejt këto transmetime, por vetëm atë që komentuesit klasikë e kanë shpallur të dobët dhe kanë hedhur dyshime mbi të."<sup>199</sup> Kjo ka të bëjë vetëm me zinxhirët transmetues. Sa u përket fjalëve të transmetuara të Kur'anit, kemi konstatuar (fjalë të Shukri Ajjadit) që disa nga fondamentet e metodës sonë letrare t'i përcaktojnë kuptimet e fjalëve kur'anore. Prandaj jemi mbështetur në poezitë e vërteta islame apo paraislame dhe në hadithet

mënyrë "akumuluese dhe metodologjike në të njëjtën kohë. Kjo ngjall ndjenjat se çdo gjë që është në Kur'an mund të sqarohet pa iu referuar debatit personal të çështjeve." Shih:

- Blachere, *El-Kur'an: nuzuluhu, tedvinuhi, terxhumetuhi ve te'thiruhu*, e përkthyer nga Rida Suade, Bejrut, Daru El-Kitab El-Lubnaniju, botimi I, 1994, f. 117, 119

<sup>198</sup> Goldziher, *Mehdahibu et-tefsiri el-islamiji*, vep. e cit., f. 141

<sup>199</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 11

e transmetuara, të cilat na afrojnë me domethëniet e fjalëve kur'anore, siç i kanë kuptuar gjeneratat e para.”<sup>200</sup>

Studimi gjuhësor i mirëfilltë i cili i ndihmon prirjes letrare për ta kuptuar Librin Fisnik, sipas vështrimit të Shukri Ajjadit, “fillimisht duhet të realizojë apo të fitojë kuptimin gjuhësor të fjalës, pastaj të hulumtojmë urtësinë e përzgjedhjes së kësaj fjale në këtë vend, përshtatjen e saj me kuptimin e përgjithshëm të ajetit dhe vlerën e saj në paraqitjen e këtij kuptimi në trajtën e kërkuar.”<sup>201</sup>

Në këtë kontekst, Shukri Ajjadi e kritikon atë që ne e hasim në komentimet tradicionale, sepse, sipas tij, nuk japid kuptim të qartë dhe të përcaktuar për fjalën. Këto komentime, edhe nëse përshtaten për t'i pranuar apo refuzuar kuptimet e tyre, nuk na japid kuptim të qartë dhe të kufizuar të fjalës.” Pastaj e sqaron shkakun e kësaj dhe i referohet faktit “se angazhimi i të parëve që u ballafaquan me komentimin e Kur'anit ndryshon nga angazhimi i gjuhëtarëve të cilët bëjnë komentimin e fjalëve, njérën pas tjetrës. Gjuhëtari i përbahet përdorimit të fjalës dhe kuptimeve të saj. Po ashtu, e sqaron kuptimin apo kuptimet e përgjithshme të saj. Ndërsa, sahabiu apo tabiini shpeshherë ndalojnë te kuptimi i përgjithshëm (sipërfaqësor) i fjalës apo te kuptimi që ajo fjalë ka në atë ajet, duke u mbështetur në mënyrën e të kuptuarit të esencës së kuptimit gjuhësor nga ai që i dedikohet (ajeti) apo duke e sqaruar qëllimin e ajetit në mënyrën më të afërt.”<sup>202</sup> Pastaj solli shumë shembuj që tregojnë se sahabët dhe tabiinët nuk shihnin gjë të keqe

<sup>200</sup> Po aty, f. 11

<sup>201</sup> Po aty, f. 12

<sup>202</sup> Po aty, f. 11. Shih:

- Huxhxetullah Dehlevij, *El-Fevzu el-kebiru fi usuli et-tefsiri*, Damask, Daru Kutejbeh, botimi I, 1989, f. 47, ku thotë: “Ajo që duhet ditur është se sahabët dhe tabiinët (ndoshta) e komentonin fjalën vetëm me kuptimin e domosdoshëm (parësor). Komentesit e mëvonshëm e ndiqnin komentimin klasik në këndin gjuhësor dhe në resurset e përdorimit të fjalëve.” Për më shumë shih:

- Ibn Tejmije, *Mukaddimetun fi usuli et-tefsiri*, vep. e cit., f. 51, ku e trajtoi shumë mirë orientimin e divergjencës në komentimin e fjalëve.

në përdorimin e fjalëve metonimike, prandaj e komentonin fjalën el-gashijeh me fjalën الْقِيَامَةِ apo السَّاعَةِ es-saatu (të gjitha fjalë për kijametin) etj. Kështu sjell shumë shembuj të cilët paraqesin përafrime kuptimore në komentimin e fjalëve kur'anore në qarqet e mëhershme të komentimit tradicional.

Tefsiri "El-Keshshaf" i Zemahsherit eshtë vepër që "krahas aspektit të domosdoshmërive të kuptimit gjuhësor, ka vendosur në rend të parë edhe hedhjen dritë mbi estetikën dhe përsosmërinë stilistike (në Kur'an)." <sup>203</sup> Më parë u theksua ndihma kritike që mendimi mutezilit i ofroi Muhammed Abduhusë në rrugën e realizimit të një interpretimi racional të Islamit, pa e përzier në parimet e tij doktrinare. <sup>204</sup> Me këtë frymë të kujdesshme dhe të zgjuar, Shukri Ajjadi iu qas tefsirit "El-Keshshaf", duke e cilësuar si vepren më të shquar të mu'tezilëve, të cilët, sipas Ajjadit, u përpoqën ta pastrojnë tefsirin nga botëkuptimet populiste. Kjo përpjekje mu'tezilate solli shumë vepra të mira dhe të mëdha në të kuptuarit letrar (të Kur'anit), veçanërisht te Zemahsherit, i cili cilësohet si studiues me prirje të mprehtë letrare. Në tefsirin e tij janë shumë evidente spikatjet shpirtërore. Po ashtu, i ka kushtuar vëmendje stilit representativ dhe përdorimit të shpeshtë të tij në Kur'an." <sup>205</sup> Pavarësisht se tefsiri i tij u mbush me shumë antagonizma doktrinare, kjo nuk ishte pengesë që të pranohet dhe të dallohet nga komentuesit e tjerë. Ky dallim eshtë konfirmuar edhe nga dijetarët klasikë dhe nga të mëvonshmit, edhe pse disa pajtohen dhe disa të tjerë e kundërshtojnë. <sup>206</sup> Kjo

<sup>203</sup> Goldziher, *Medhahibu et-tefsiri el-islamiji*, vep. e cit., f. 142, shih:

- Noldeke, *Tarihu el-Kur'ani*, vep. e cit., vëllimi II, f. 393

<sup>204</sup> Blacher, *El-Kur'anu: nuzuluhi, tedvinuhi, terxhumetuhi ve te'thiruhi*, vep. e cit., f. 126

<sup>205</sup> Ajjad, *Dırasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 15

<sup>206</sup> Ibn Halduni, pasi e theksoi llojin e dytë të tefsirit, gjegjësisht tefsirin që i referohet njohjes së gjuhës, sintaksës dhe stilistikës, tha: "Purja më e buruk që është sjellë në këtë art (në komentim) është vepra "El-Keshshaf" e Zemahsherit, kurse autori i takon drejtimit mu'tezilit dhe polemizon me drejtimet e gabuara, ku në ajitet kur'anore i paraqet

madhështi shkencore nuk e ndaloj Shukri Ajadin t'i dallojë dy metoda në komentimin e Kur'anit: metodën racionale dhe metodën letrare, duke pohuar se "ka shumë dallim mes komentuesit letrar dhe atij racional. Komentuesi racional e sheh Kur'anin fillimi si burimi i parë i doktrinave besimore dhe i interpretionit ajetet sipas drejtimit dhe botëkuptimit të tij për Zotin, ku ka ndikuar mendimi filozofik, kurse komentuesi letrar e sheh Kur'anin, si librin më madhështor në gjuhën arabe, i cili e ka magjepsur umetin me retorikën e vet dhe u ka ofruar atyre një botëkuptim të ri për jetën. Ky (komentuesi letrar) e trillon një metodë sipas objektivave të veta dhe përpinqet ta kuptojë retorikën (stilistikën) kur'anore përmes studimit të gjuhës dhe të kontekstit kur'anor. Gjithashtu, metoda e shëndoshë letrare kërkon që përmes kësaj të arrihet te perceptimi i objektivave humane dhe te stilemat shpjeguese (retorike) të Kur'anit."<sup>207</sup>

Më parë u theksua se Emin Huli i ka spikatur kontributet e disa orientalistëve gjermanë, me theks të veçantë në studimin e Kur'anit në nivel historik dhe strukturor. E ka veçuar veprën e orientalistit Noldeke, "Tarihu el-Kur'an (Historiku i Kur'anit)". Gjithashtu ka theksuar se "hulumtimet e këtyre modernistëve përbajnjë trajtesa të gjera rrëth këtyre tematikave, gjegjësisht rrëth tematikave kur'anore, megjithatë ato nuk u shpëtojnë akuzave, frymës kritike

mënyrat dhe figurat stilistike. Kjo bëri që shumë studiues të ehlë sunetit ta shpallin si të devijuar dhe ta paralajmërojnë masën e njerëzve për devijimet e fshehta, kurse nga ana tjeter e pranonin qëndresën dhe afinitetin e tij në sferën e gjuhës dhe të stilistikës: Shih:

- Ibn Haldun, *El-Mukaddimeh*, i irregulluar nga Nasr Hurini, Bejrut, Daru el-Xhelil, f. 488

Thashë: "Nga dijetarët që e ndalan leximin e "El-Keshshafit" janë dy imamët e nderuar: Tekijuddin Es-Subkij (vdiq 756 h.) dhe djali i tij Et-Taxh Abdulvehhab (vdiq 771 h.). Të dy këta konsiderohen dijetarë të shquar në shkollën juridike shafiite. Taxhi në veprin "Muidu en-niami ve mubidi en-nikami" ka thënë: "Dije se "El-Keshshafi" është libër madhështor në sferën e vet dhe autorë i saj është imam në artin e vet, mirëpo ai është njeri që e proklamon bidatin (risinë), le pas dore shumë gjëra nga pejgamberia (hadithe) dhe është i pasjellshëm ndaj ehlë sunetit dhe xhematit. Është obligim që "El-Keshshafi" të pastrohet prej gjithë kësaj. Babai i tij, Tekijuddin Es-Subkiu, ia lexonte atë (të birit), kur mbërriti te fjala e Allahut në suren Tekvii "Ajo është fjalë e një të Dërguari fisnik" (El-Hakkatu: 40), i mbylli faqet dhe shkroi një letër të cilën e quajti "Shkaku i ndërprerjes së leximit të "El-Keshshafit"".

<sup>207</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 19

dhe verifikimit, bile është e nevojshme të veprohet kështu kur merren në trajtim këto hulumtime.”<sup>208</sup> Po ashtu, u theksua më parë sqarimi serioz që u ofrua nga Shukri Ajjadi në këtë pikë, gjë e cila nuk ka nevojë të përsëritet këtu, mirëpo mjafton të theksohet dallimi i thukët që Ajjadi e bën mes këtyre dy metodave: metodës historike të orientalistëve dhe metodës letrare. Ka një dallim thelbësor mes këtyre dyjave. Shukri Ajjadi thotë: “Ky dallim nuk ka të bëjë me atë se ne besojmë në shenjtërinë e Kur'anit dhe ata nuk besojnë, por në atë se ne Kur'anin e studiojmë si libër të përhershëm letrar. Arabët në të kanë gjetur dëshminë e qartë, është mrekulli dhe, në këtë aspekt, meriton të studiohet, së paku si çdo vepër e dalluar letrare, për të sqaruar (zbulimet e reja) në botëkuptimet njerëzore apo në shprehjet retorike.”<sup>209</sup> Pastaj ka potencuar se orientalistët nuk ndalojnë te “përjetimi i kuptimeve dhe i stilit të Kur'anit, kurse në anën tjetër pohojnë se suret mekase dallohen me një imagjinatë të ndezur dhe silleshin rrëth tematikës së premtimit dhe ndëshkimit... Pastaj stili i Kur'anit u zbut paksa, sipas prononcimit të tyre, ku shumica e tematikave të tij u shndërruan në meditim të krijimtarisë së Allahut dhe në kundërshtim të antagonistëve të Pejgamberit. Pastaj stili (artistik) filloi të shpërfilltet dhe sundoi stili këshillues i lodhshëm, bashkë me disa legjitimime përbledhëse në kohën qytetëruese.”<sup>210</sup>

Në këtë kontekst, Shukri Ajjadi transmeton disa ide orientaliste nga libri “Tarihu el-Kur'anî” i Noldekes. Nuk ka gjë të keqe nëse shtojmë edhe atë që shkroi orientalisti hungarez, Ignac Goldziher (vdiq 1921), i cili ishte inspirues i Noldekes në veprën “Tarihu el-Kur'an” dhe drejtues i këtij orientalisti të rrezikshëm, i cili ofroi studime shumë influ-

<sup>208</sup> Huli, *Menahixhu texhidian fi en-nehvi ve el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebi*, vep.e cit., f. 309

<sup>209</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 21

<sup>210</sup> Po aty, f. 21

encuese në qarqet e mendimit orientalist. Goldziheri, duke e sqaruar dallimin mes stilit kur'anor në periudhën mekase dhe atë medinase, thotë: "Hulumtimi kritik dhe stilistik i Kur'anit e justifikon këtë dallim historik në përgjithësi. Në periudhën mekase erdhën këshilla, përmes të cilave Muhamedi i paraqiti imazhet që i diktonte entuziazmi i tij i ndezur, dhe atë në formë fantastike, fiktive, të prerë dhe impulsive dhe subjektive. Ai në këtë kohë nuk e dëgjon kërcëllimën e shpatës së tij dhe as nuk u flet luftëtarëve të vet apo barinjve paqësorë, por shfaqet para një mase kundërshtarësh dhe antagonistësh të besimit rrjedhës, të cilët flasin për fuqinë e Allahut, Krijuesin e Botës, për fuqinë e Tij të pakufishme dhe për afrimin e Ditës së Llogarisë, e cila i shfaqet në ëndrrat e shpallura që ia prishin rehatinë. Ai proklamon dënimin e zullumqarëve të shkuar dhe popujt që i kundërshtuan urdhrat e Allahut, të cilat u shpallen përmes gjuhëve të pejgamberëve të tyre. Mirëpo, entuziazmi dhe mprehtësia e pejgamberllékut në këshillat e Medinës filloj dalëngadalë të qetësohet, prandaj edhe stilistika e shpalljes filloj të dobësohet. Po ashtu, edhe materia e shpallur filloj të zbresë në një nivel më të ulët, d.m.th. me gjykimet dhe trajtesat e tematikave dhe çështjeve (konkrete), madje ndonjëherë degradoi edhe në nivelin e prozës së rëndomtë."<sup>211</sup>

Shukri Ajjadi e kritikoi këtë vështrim orientalist ndaj stilit të Kur'anit dhe i cilësoi këto vërejtje si përbledhje të cekëta. Po ashtu, sqaron se "ne e shfrytëzojmë hulumtimin historik të Kur'anit për të kuptuar kontekstin intelektual, material dhe gjuhësor në një aspekt më të gjerë kuptimor. E vështrojmë zhvillimin e stilit paralel me zhvillimin e ambientit dhe me vargëzimin e idesë. Kur të mbërrijmë një nivel të kënaqshëm nga ky kuptim, atëherë na mundësohet

<sup>211</sup> Ignac Goldziher, *El-Akidet ve esh-sheriatu fi el-Islami*, i përkthyer dhe i komentuar nga Muhamed Jusuf Musa dhe dy kolegët e tij, Liban, Daru Er-Raidi El-Arabiyyi, botimi i kopjuar nga shtëpia botuese Daru El-Kitabi el-Misriji, 1946, f. 14-15

më mirë t'i perceptojmë objektivat humane dhe shoqërore të Kur'anit, bashkë me metodat dhe mënyrat shprehëse.”<sup>212</sup>

Kjo hyrje metodologjike ka një domethënie të rëndësishme në sqarimin e vizionit të Shukri Ajjadit. Abdulhakim Radi thekson se synimi i këtij krahasimi është “sqarimi i devijimeve dhe i lëshimeve, ku mund të kenë rënë këto drejtime të tefsirit. Gjithashtu e sqaron dallimin mes metodës letrare dhe metodave të tjera në komentim.”<sup>213</sup>

Shukri Ajjadi i aplikon tri etapat metodologjike për të cilat bëmë fjalë gjérësisht: studimin e fjalëve, gjegjësisht studimin e fjalëve kur'anore në cilësimin e Ditës së Gjykimit dhe të Llogarisë. Ky është një studim ku lexuesi mund të mësojë imtësitë e kuptimeve. Pastaj kalon në fazën e tretë, në hulumtimin e stilit të Kur'anit, në përpilimin e këtyre imtësive. Faza e fundit është hulumtimi i objektivave humane dhe sociale në Kur'an, duke e pohuar se kjo fazë e fundit është “thelbi dhe qëllimi final i komentimit.”<sup>214</sup>

Kujdesi për fazën e fundit nuk do të thotë se nënvlërësohen dy fazat paraprake. Studimi i fjalëve nuk është më pak i rëndësishëm se studimi i stileve dhe i objektivave. Ajjadi këtë e arsyeton me atë se “fjalorët që i kemi para vetes dhe librat e tefsirit që na kanë mbërritur. nuk e shpjegojnë plotësisht përdorimin e fjalëve nëpër Kur'an, madje as përafërsisht.”<sup>215</sup> Kjo është një çështje e hetuar prej dijetarëve të mëhershëm, prandaj disa u përpoqën ta plotësojnë këtë zbrazëtirë, si p.sh. puna e Ragib Isfahanit në veprën “Mufredatu el-Kur'ani”. Megjithatë, kjo mbetet përpjekje individuale dhe nuk u zhvillua më tej. Po ashtu, nga gjuha e fjalorëve lindën shumë vështirësi që binin ndesh me ligjin

<sup>212</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jemu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 21

<sup>213</sup> Radi, “Shukri Ajjad (min vesfi el-Kur'an) jemu ed-dini ve el-hisabi) diskutim i lëndës, tematika, teoria dhe metoda”, vep. e cit., f. 26

<sup>214</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jemu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 25

<sup>215</sup> Po aty, f. 25

e zhvillimit gjuhësor. Kjo është ajo që e shprehu Shukri Ajjadi, duke e degëzuar pikën paraprake me këto fjalë: "Fjalët kanë jetën dhe historinë e vet si çdo gjallesë tjetër. Fillojnë me një kuptim të thjeshtë, pastaj ky kuptim zhvillohet me zhvillimin e jetës njerëzore. Kështu degëzohen kuptimet njësoj si format gramatikore. Krejt këto kthehet te burimi i parë."<sup>216</sup> Këtu Ajjadi ndan mendimin e njëjtë me Jaroslav Stetkevych, i cili mendon se "zhvillimet semantike janë një proces i vlefshëm në gjuhën arabe, bile ka filluar qysh në epokën e injorancës dhe vazhdon deri më sot. Transformimi i kuptimit të fjalëve është i pranishëm në nivel të lartë, prandaj kërkohen njoħuri gjuhësore të veçanta që hulumtuesi të ketë mundësi t'i lexojë dhe t'i kuptojë drejt poetët, si Imrul Kajsi, Nabiga, Shenferiu etj."<sup>217</sup>

Njohuritë leksikore nuk janë të mjaftueshme për komentuesit letrar, sepse puna e tij te fjalët e tejkalon punën e gjuhëtarit. Komentuesi letrar nuk kënaqet vetëm me kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, por kalon edhe te kuptimet e brendshme të fjalëve. Pra, kalon te kuptimet e fjalëve që nuk hyjnë në përkufizim, megjithatë ato rrrotullohen dhe lidhen me to... Këto kuptime të brendshme të fjalëve, apo hijet e kuptimeve, janë një faktor i rëndësishëm i të shprehurit letrar, sepse kanë vlerë të lartë në ngjyrimin emotiv të kuptimeve dhe përmes këtyre dallohen fjalët që duken si sinonime.<sup>218</sup> Kjo ide e thukët dhe têrheqëse është idea e "hijes së kuptimeve", të cilën më vonë e përvetësoi Muhammed Arkuni dhe e paraqiti si propozim të vetin për ta zhvilluar leximin kur'anor. Në studimin e tij me titull "El-Axhibu el-hal-labu fi el-Kur'ani" ndalon te "lidhshmëria mes ndjesisë dhe botëkuptimit të cilën e ka themeluar Kur'ani", ku thotë:

<sup>216</sup> Po aty, f. 25

<sup>217</sup> Jaroslav Stetkevych, *El-Arabijetu el-fus'ha el-haditheh, buhuthun fi tetavvuri el-elfadhi ve el-esalibi*, e përkthyer dhe e komentuar nga Muhammed Hasen Abdulazizi, Egjipt, El-Hej'etu El-Ammetu li Shuuni El-Metabii, 2002, f. 155

<sup>218</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 26-27

"Do të propozojmë një dije shtesë në të gjithë literaturën e akumuluar të tefsirit përgjatë trembëdhjetë shekujve, pra bëhet një përafrim i fjalëve dhe një përafrim letrar për të riformuluar sistemin e kuptimeve gjithëpërfshirëse, apo të hijeve të kuptimeve, të cilat menaxhohen me lidhjen e "emocionit, perceptimit dhe vetëdijes" në Kur'an."<sup>219</sup>

Studimi i Shukri Ajjadit u përgjigjej dy karakteristikave themelore të tefsirit letrar: karakteristika e parë është orientimi kah tefsiri tematik, kurse e dyta është përkujdesja e veçantë për studimin e ri analistik të leksikut kur'anor sipas metodave gjuhësore moderne.<sup>220</sup>

Shukri Ajjadi këto fondamente metodologjike i sqaron me këto fjalë: "Përderisa nga parimet e metodës sonë është t'i studiojmë ajetet sipas tematikave, atëherë këtë do ta pasojmë edhe te studimi i fjalëve. Kështu do t'i ndajmë ajetet në grupe sipas kuptimeve sipërfaqësore dhe të përafërtë, që pastaj kjo ndarje të na ndihmojë në përcaktimin e kuptimeve të fjalëve. Përderisa ajetet që kanë një tematikë i komentojmë me njëritjetrin, atëherë përmes kësaj mund t'i përcaktojmë kuptimet e përgjithshme të fjalëve. Pastaj përpinqemi, sipas mundësive, çdo fjalë të përafërt në kuptim ta sqarojmë me një dallim shprehës, i cili e bën fjalën më të përshtatshme për vendin ku është përdorur."<sup>221</sup> Më herët e theksuan se kjo është përfthuar nga El-Hattabiu, nga vepra e tij "Bejanu i'xhazi el-Kur'ani", gjegjësisht kur flet për metodën e Aishe Abdurrahmanit në leximin e tekstit kur'anor. Gjithashtu, këtu mund të thuhet se Mustafa Sadik Er-Rafii ishte prej pararendësve që e vuri re këtë mendim dhe e aplikoi te libri "I'xhazu el-Kur'an", por

<sup>219</sup> Muhammed Arkun, *El-Fikru el-islamiju, kiraetun ilmijjetun*, e përkthyer nga Hashim Salih, Merkezu el-Inmai el-Kavmiji, Bejrut, El-Merkezu eth-Thekafiju el-Arabiju, Ed-Daru el-Bejdau, botimi II, 1996, f. 191

Hashim Salihu e ka komentuar konceptin "hijet e kuptimeve" me këto fjalë: fjalën *konotacion* e përkthejmë si hije e kuptimeve apo hijet për kuptimet e përgjithshme. Dihet botërisht se çdo fjalë ka dy kuptime: i pari është burimor dhe i dukshëm, kurse i dyti është alegoriq dhe i mbushur me nuanca kuptimor dhe me përdorime historike.

<sup>220</sup> Sherkavi, *Shukri Ajjad ve menhexhuhu fi et-tefsiri el-edebiji li el-Kur'an el-kerimi*, vep. e cit., f. 267

<sup>221</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 27

vetëm brenda një vështrimi të pjesshëm ndaj tekstit kur'anor, dhe atë pavarësisht vezullimeve inteligjente dhe shkrepjeve logjike të cilat shfaqen kohë pas kohe përgjatë studimeve të tij për mrekullinë (i'xhazin) e Kur'anit.”<sup>222</sup>

Shukri Ajjadi e fillon hulumtimin me studimin e emrave të Ditës së Fundit, siç kanë ardhur në Kur'anin Fisnik. Konstaton se emri “Dita e Kjametit” është më i përdorshëm, i cili është përdorur shtatëdhjetë herë në Kur'an. E hulumtoi kuptimin burimor të fjalës Kijameh (Kjamet) dhe erdhi në përfundimin se ajo është fjalë arabe dhe se nuk është i vërtetë prononcimi i gjuhëtarit që thotë se kjo fjalë është e arabizuar nga fjala siriane e vjetër (قيمتنا), e që mban të njëtin kuptim. Ajjadi e gjurmoi këtë fjalë në mesin e fjalëve aramite të arabizuara, dhe atë në librin “El-Elfadhu el-arabijjetu fi el-lugati el-arabijjetu” të Sigmund Fraenkel.<sup>223</sup>

Kuptimi themelor i rrënjos “قَمَ” është ngritje dhe qëndrimi. Nga ky kuptim themelor dalin më shumë kuptime alegorike. Pas studimit të thukët të reflektiveve alegorike të kësaj fjale, Shukri Ajjadi vjen në përfundimin se fjala (القيامة), ose përftohet nga ngritja e njerëzve nga varrezat kur do të ringjallen, ose nga ngritja dhe qëndrimi i krijesave para Allahut kur do të vijë kjameti. Kuptimi i parë përjashtohet, sepse folja (قَمَ) asnëherë nuk është përdorur në Kur'an me kuptimin e ngritjes së njerëzve nga varrezat dhe shumë pak është përdorur në kuptimet sensitive. Gjithashtu, përjashtohet edhe i dyti, sepse lidhja e *kjametit* me fjalët *es-saatu* është vetëm lidhje alegorike. Kur paraqitet paskajorja, vësh-tirë se mund të përdoret me kuptim alegorik pa pasur ndonjë fjalë tjeter shoqëruese që e sqaron atë. Pra, mbetet kuptimi i tretë, pra quhet *Ditë e Kjametit* sepse e tillë është

<sup>222</sup> Mustafa Sadik Er-Rafii, *I'xhazu el-Kur'ani ve el-belagati el-kur'anijjeti*, Bejrut, Daru el-Kitabi el-Arabiyyi, botimi II, 1974, vëllimi II, f. 234

<sup>223</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijjetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 27-28

përdorur në ajetin 51 të sures Gafir: “*Ne patjetër do të ndihmojmë të dërguarit tanë në jetën e kësaj bote, edhe ata që besuan, e edhe në ditën e prezantimit të dëshmive.*” (Gafir: 51) dhe në suren Mutaffifine “*Ditën kur do të ngrihen njerëzit para Zotit të botëve.*” (El-Mutaffifine: 6) Këtë kuptim e përkrah edhe fakti se fjala *kijam* në Kur'an është përdorur shumë edhe me kuptimin e *drejtim kah Allahu* dhe se ky kuptim, me sa dimë, është përdorur në formë specifike në Kur'an.”<sup>224</sup>

Shukri Ajjadi përzgjedhjen e këtij kuptimi e ka argumentuar me njëzet prova dhe fakte shoqëruese që e përkrahin këtë mendim. Duke u mbështetur te vepra “*El-Bahru el-muhitu fi et-tefsiri*” e Ebu Hajjan El-Endelusi, vjen në përfundim se togfjalëshi jevmu el-kijameh (Dita e Kjametit) është përdorur me kuptimin “e kohës kur do të bëhet ndarja e robërve: banorët e xhenetit në xhenet dhe banorët e zjarrit në zjarr.”<sup>225</sup>

Gjithashtu, Shukri Ajjadi e arsyeton këtë përzgjedhje me faktin se ardhja e togfjalëshit jevmu el-kijameh (Dita e Kjametit) si rrethanor përshtatet me kuptimet sensitive, kuptimore dhe shpirtërore për ringjalljen, për llogarinë, për gjykimin mes krijesave dhe për shpërblimin apo dënimin e asaj që kanë punuar, pra ngritjen apo poshtërimin e tyre.”<sup>226</sup>

Fjala kijameh (kjamat) nuk e tregon karakterin e argumentimit kritik të Shukri Ajjadit, sepse ajo ka një rrëth të ngushtë kuptimor. Ndoshta fjala jevmu ed-dini (Dita e Gjykimit) e tregon më mirë frymën kritike të Ajjadit. Pas shqyrtimit të vendeve ku është përdorur togfjalëshi “*jevmu ed-din*”, e që janë dymbëdhjetë, Ajjadi filloj ta orientojë divergjencën e ashpër mes gjuhëtarëve arabë dhe orientalistëve dhe t'i japë një drejtim të kuptimit të kësaj fjale. “Kuptimet

<sup>224</sup> Po aty, f. 30

<sup>225</sup> Po aty, f. 32

<sup>226</sup> Po aty, f. 32

që i paraqesin linguistët arabë për fjalën (دين) *din* janë shumë dhe të llojlojshme, aq sa hulumtuesi nuk mund t'ua kup-tojë origjinën. Fjala din me kesre (دين) do të thotë shpërblim, sundim, mundje, mbikëqyrje, traditë, gjendje, gjykim, vde-kje dhe shumë kuftime të tjera të përafërtë.<sup>227</sup> E nëse vijmë te qarku i orientalistëve, atëherë na paraqiten shumë kuftime. Sir Macdonald veçon tri kuftime të kësaj fjale:

1. Fjalë e huazuar nga arabishtja dhe hebraishtja me kuftimin e gjykimit;
2. Fjalë e gurrës arabe me kuftimin e traditës dhe të mënyrës (apo rrugës). Mund të lidhet edhe me fjalën e parë (me mendimin e parë).
3. Fjalë perse që dallohet krejtësisht nga këto dy kuftime (paraprake), dhe mban kuftimin e fesë (të religionit).<sup>228</sup>

Këtë që e ka thënë Macdonald e ka aprovuar edhe orientalisti gjerman Bergstrasser, autori i veprën “Et-Tetavvuru en-nehviju li el-lugati el-arabijjeti”. Pra, fjala *ed-dinu* me kuftimin e *llogarisë* është fjalë e arabizuar nga gjuha aramite, kurse me kuftimin *religion* është e arabizuar nga persishtja, ku ndër të tjerash (Bergstrasser) thotë: “Më afër është të jetë fjalë me burim nga akadishtja, e lidhur me legjisacionet e Hamurabit, të cilat kanë ndikuar te popujt semitë.”<sup>229</sup>

Shukri Ajjadi i shqyrtoi krejt këto kuftime të ndryshme për fjalën *ed-dinu* dhe e kundërshtoi këtë metodë të lehtë, me të cilën fjala *ed-dinu* kthehet në tri burime: në burimin arab, pers, hebraik dhe akadik. Mendon se kuftimi burimor i fjalës *ed-dinu* është “huazimi” në kuftimin më të lehtë të saj, apo diçka që duhet realizuar dhe përbushur. Nga ky kuftim është fituar kuftimi i *dominimit* dhe i *nënshtimit*. Nga kuftimi i *nënshtimit* lehtë mund të fitojmë nga fjala

<sup>227</sup> Po aty, f. 34

<sup>228</sup> Po aty, f. 35

<sup>229</sup> Po aty, f. 36, shih:

- Gotthelf Bergstrasser, *Et-Tetavvuru en-nehviju li el-lugati el-arabijjeti*, Kajro, Mektebetu el-Hanxhi, botimi IV, 2003, f. 144

*din* kuptimin e *adhurimit*, pastaj kuptimin e *besimit* dhe në fund kuptimin e *fesë*.<sup>230</sup> Pastaj Shukri Ajjadi ka përzgjedhur që fjala *din* të jetë huazuar në një nga periudhat e arabishtes nga fjala akade (denu) dhe atë përmes gjuhës aramite. Më pastaj i mori kuptimet që lidhen me gjykimin dhe realizimin, të cilat favorizojnë mendimin se kjo fjalë është përfthuar nga kultura e lashtë në gjykim dhe legjislacion. Po ashtu, me këtë kuptim të përzier është përdorur edhe në Kur'an.<sup>231</sup>

Përcaktimi i kuptimit të parë nga ku doli fjala ed-din është vështirë i realizueshëm. Mahmud Muhammed Shakir e pranon se realizimi i kësaj kërkese është i vështirë, prandaj ka thënë: "Shumë vështirë është të përmblidhen kuptimet që i ka akumuluar fjala ed-dinu periudhë pas periudhe dhe deri në fund kur kthehet në originën e parë (si fjalë e thjeshtë)."<sup>232</sup> Pavarësisht kontributit që ka dhënë Shukri Ajjadi në vështrimin e kuptimeve gjuhësore të kuptimit të fjalës ed-din dhe të fjalëve tjera që janë përdorur për të shprehur "Ditën e Llogarisë", dhe dallimin e tyre në përdorimin kur'anor, megjithatë kjo nuk na privon që ta kritikojmë punën e tij. Iffet Sherkavi mendon se Ajjadi "pavarësisht se ofroi shumë kontribut në përgatitjen gjuhësore dhe e vështri për gjatë kohë zhvillimin semantik (të fjalëve), në shumicën e rasteve nuk ia arriti të zbërthejë misterin e mrekullisë letrare, ku një fjalë ka një semantikë të caktuar në vetë vendin ku është përdorur."<sup>233</sup> Pastaj ka sjellë një shembull nga rezultati që ka arritur Ajjadi nga vështrimi gjuhësor i fjalës *el-kijameh* dhe *es-saatu*, ku konfirmon faktin se ai nuk shton asgjë më shumë se regjistrimi i "natyrës së përdorimit kur'anor të këtyre dy fjalëve, dhe nuk është

<sup>230</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jemu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 36

<sup>231</sup> Po aty, f. 37

<sup>232</sup> Mahmud Muhammed Shakir, *Ebatilu ve esmaru, Kajro, Met'beatu el-Medeniji*, botimi II, 1972

<sup>233</sup> Sherkavi, *El-Fikru ed-diniju fi muvaxheheti el-asri, dirasetun tahllilijetun li ittixhati et-tefsiri fi el-asri el-hadithi*, vep. e cit., f. 337-338

vetëm sqarim artistik që shpalos urtësinë e përzgjedhjes së se cilës fjalë në sferën e caktuar. Pastaj shtron pyetjen: "Cila është dobia e gjithë atij kontributi të gjatë në sferën e vështrimit gjuhësor të burimit konkret të fjalës dhe të zhvillimit semantik të saj, kur dihet se në fund puna përfundon te realiteti letrar i tekstit dhe jo te komentimi i tij?"<sup>234</sup>

Hulumtimi i fjalëve nuk ndaloj në këto kufij, por Shukri Ajjadi u inkuadrua edhe në diskutimin e disa çështjeve të besimit, të cilat lidhen me kuptimet e fjalëve që përdoren në cilësimin e Ditës së Gjykit dhe të Llogarisë. Shembulli më domethënës i cili pasqyrон paraqiten e tij kritike është çështja e shikimit në "fytyrën e Allahut" të Lartësuar, problematikë që fitohet nga ky ajet kur'anor: "*Disa fytyra atë ditë do të shkëlqejnë, Zotin e tyre do ta shohin*" (El-Kijame: 22-23), ku e ka trajtuar divergjencën e ndezur mes drejtimit të ehli sunetit, të cilët pohojnë pamjen e Allahut të Lartësuar në një mënyrë që i përshtatet përsosmërisë së Tij, dhe drejtimit të mutezilëve të cilët e mohojnë pamjen e Allahut brenda perceptimeve të pastra logjike. Pastaj u dekurajua nga këto përpjekje racionaliste dhe u fokusua te metoda e tij letrare në "studimin e nuancave kuptimore të fjalës. Pastaj vinte aplikimi i këtij kuptimi në përdorimin kur'anor dhe përjetimi shpirtëror dhe artistik i këtij kuptimi."<sup>235</sup> Megjithatë, ai favorizonte mendimin e mu'tezilëve, sepse nga grumbullimi i provave treguese kuptohet se shikimi i përmendur në ajet nuk është shikim (real). Pra, "duket se provat e përdorimit të "shikimit" në poezi dhe në Kur'an tregonjë se fjalë طلاق (shikues) është emër prejfoljor që përdoret për individin që shikon, apo siç vërehet, këtu bëhet fjalë për veprimin e personit që shikon. Për këtë arsy, në shumicën e rasteve kur vjen një fjalë që tregon për shikimin, kryesisht tregon gjendjen e atij

<sup>234</sup> Po aty, f. 338

<sup>235</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 73

që shikon.”<sup>236</sup> Sa i përket ajetit të cituar më parë, aty flitet për gëzimin e madh që i shoqëron besimtarët nga ndriçimi i fytyrave. “Këtu përzgjodhi mendimin se qëllimi me fjalën e Zotit “Zotin e tyre do ta shohin” (El-Kijameh: 23) është se besimtarët atë ditë janë të preokupuar vetëm me Allahun, i Cili ka qenë meritor të jenë të preokupuar me Të edhe në dynja. Po ashtu, do të thotë se shpirrat e tyre janë të orientuar kah dashuria për Të, prandaj janë në kulmin e lumturisë.”<sup>237</sup>

Nuk ka dyshim se ky stil i studimit të fjalëve kur'anore imponohet nga drejtimi tematik në komentimin e Kur'anit, i cili në synimet përfundimtare të vetat është i përfshuar nga teoria letrare dhe nga metodat e hulumtimit historik. Pavarësisht kureshtjes dhe reformimit në stilin e trajtimit, rezultatet që jep hulumtimi nuk ngrihen në horizontin e lexuesit me eksperiençë. Prej kësaj mund ta kuptojmë kritikën që Iffet Sherkavi ia adreson së Ajjadit në studimin e fjalëve. “Hyrjet gjuhësore të gjata pothuaj nuk mbarojnë rezultate të duhura.”<sup>238</sup>

Kur problemi i fjalëve u drejtua në këtë mënyrë, atëherë Shukri Ajjadi kaloi në studimin e stilit kur'anor për përshtumin e Ditës së Gjykimit dhe të Llogarisë. Stilin e përkufizon si “mënyrë të harmonizimit të kuptimeve të pjesshme për ta realizuar objektivin e letërsisë. Stili është shprehje e përvjoes emocionale.”<sup>239</sup> Gjithashtu, ai konfirmon lidhjen e ngushtë reciproke mes stilit dhe ideve, sepse shpërfillja e kësaj lidhjeje të ngushtë do t'i shtyjë hulumtuesit e çështjeve të retorikës dhe të kritikës letrare drejt njërit prej këtyre dy rezultateve: “ose në vështrimin e kuptimeve letrare si një gjë të ngulitur në mendje dhe të ndarë nga fjalët, te e cila

<sup>236</sup> Po aty, f. 75

<sup>237</sup> Po aty, f. 75

<sup>238</sup> Sherkavi, *El-Fikru ed-dinijju fi muvaxheheti el-asri, dirasetun tahvilijetun li ittixhatati et-tefsiri fi el-asri el-hadithi*, vep. e cit., f. 339

<sup>239</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 79

mbërrihet me soditje racionale të thjeshtë, dhe kështu (studiuësit) e shpërfillin vlerën e fjalëve shprehëse... ose në vështrimin e imazheve (figurave) shprehëse: metaforën, alegorinë, tropin etj., si lloje të zbulurimit (në të shprehur), duke nxitur kureshtjen dhe duke e lodhur mendjen për t'i hulumtuar ato, ndërsa në anën tjetër e neglizhojnë sferën kuptimore.”<sup>240</sup>

Bazuar në këtë dallim të thukët, Shukri Ajjadi shtron konceptin e “kuptimeve letrare” si një gjykatës arbitrar në këtë divergjencë. Saron se kuptimet letrare nuk janë si “kuptimet e aforizmave, si kuptimet filozofike dhe as si kuptimet shkencore... Pra, kuptimi letrar është rezultat i reaksionit të shpirtit njerëzor me të gjitha potencialet percep-tuese, shtytësit instinktivë, ndjenjat dhe ambiciet, prirjet dhe tendencat dhe bashkë me dy sferat e karakterit që poseden njeriut.”<sup>241</sup> Pastaj e pëershruan nga këndi (karakteri) i këtyre kuptimeve letrare, duke pasur parasysh se ato janë komplekse dhe të ndërthurura me njëra-tjetrën nga vetë natyra. Gjithashtu, potencon se kjo kthehet te dallimet psi-kike individuale të shumta mes njërsës dhe gjeneratës tjetër, apo mes një populli dhe popullit tjetër. Nëse kjo është kështu, mjeti për shprehjen e kuptimeve letrare nuk duhet të jetë i ngulitur, dhe kuptimi i saj nuk duhet të jetë i kufizuar te të gjithë njerëzit vetëm pas pak apo shumë angazhimi intelektual, por duhet të jetë një mjet elastik dhe fleksibil i cili lë të hapur mundësinë që artisti t'i japë ngjyrime të ndryshme emocionale.<sup>242</sup> Sipas Shukri Ajjadit, gjuha letrare është mjeti më i fuqishëm dhe më ndikues i shprehësisë emocionale. Në këtë kontekst të studimit, Ajjadi ndalon në dy çështje që ndërlidhen me karakterin e gjuhës letrare. Ato janë: semantika e fjalëve konkrete dhe dallimi i ilustrimit të skenave të natyrës në letërsi nga ilustrimi i tyre në artet dekorative.

<sup>240</sup> Po aty, f. 79

<sup>241</sup> Po aty, f. 79

<sup>242</sup> Po aty, f. 80

Pra, në çështjen e parë e kundërshtoi mendimin e Sejjid Kutubit, i cili mendon se themel i shprehësisë letrare, madje mister i mrekullisë kur'anore, është në forcën që fjala për të provokuar imazhe konkrete dhe të mundshme në intelektin e dëgjuesit, e cila ndonjëherë quhet ilustrim, ndonjëherë antropomorfizëm dhe ndonjëherë fantazi.<sup>243</sup> Ky është një drejtim i padëshirueshëm për Shukri Ajjadin, sepse sipas tij, edhe pse gjuhës njerëzore nuk i mungon imitimi i realitetit të jashtëm, ajo përsëri nuk është një imazh i barasvlershëm i këtij realiteti... Nëse kërkojmë një lidhshmëri sistematike mes tingullit dhe kuptimit të fjalës, atëherë humbasim në greminat e psikikës njerëzore dhe nuk mund të arrijmë te fondamenti ku vendoset kjo lidhje.”<sup>244</sup>

Pastaj (Shukri Ajjadi) konstaton se letrari kur i përdor fjalët për të shprehur një kuptim të caktuar, mbështetet në korrelacionet emocionale të fjalëve në intelektin e dëgjuesit dhe nuk mbështet domosdoshmërisht në imazhet konkrete që ngjallin ato fjalë. Pastaj sjell shembull fjalën *vdekje*, ku thotë: “a provokon (fjala *vdekje*), me tingull apo pa tingull, ndonjë kuptim për imazhin e të vdekurit? Pas përgjigjes “Jo”, ai konfirmon se fjala *vdekje* në mendjen e njeriut i provokon korrelacionet kuptimore-emocionale, të cilat nuk numërohen si emocionet (që fitohen) nga gjërat e ngurta si guri, nga asgjëja apo vakumi dhe nga hapësira boshe ku humb shikimi. Atëherë, fjala *vdekje* është një fjalë shumë inspiruese dhe shumë ndikuese, kurse forca e saj nuk kthehet te imazhi apo imazhet konkrete që jep perceptimi ynë, por te korrelacionet emocionale që ngjall (ajo fjalë) në intelektin tonë.”<sup>245</sup>

Ndërsa pika e dytë është sqarimi i dallimeve të ilustrimit të skenave të natyrës nga ilustrimi i skenave në artet dekorative.

<sup>243</sup> Po aty, f. 80

- Sejjid Kutub, *Et-Tesviru el-fenniju fi el-Kur'ani*, Kairo: Daru esh-Shuruki, f. 32

<sup>244</sup> Po aty, f. 81

<sup>245</sup> Po aty, f. 81

rative. Shukri Ajjadi shkoqiti tri karakteristika thelbësore me të cilat dallohet letërsia. Ato janë: stili letrar pothuaj asnjëherë nuk është i pavarur në realizim (interpretim), madje kryesisht vjen i kombinuar me stilin e tregimit dhe të dialogut. Karakteristika e dytë është se përshkrimi letrar mund ta ilustrojë më mirë një gjë të lëvizshme sesa artet dekorative (formale). Karakteristika e tretë është se skenat në përshkrimin letrar ndjekin njëra-tjetrën, prandaj nuk mund ta gjesh veten para një skene të gjerë që ka nevojë për vështrim të thelluar që ta kuptosh fillimin dhe fundin e idesë... siç është në artet dekorative.”<sup>246</sup> Pastaj theksoi një parim tjetër me të cilin dallohet përshkrimi letrar. Ai është parimi i “orientimit”, d.m.th. parcializimi (ndarja e) i përshkrimit, ashtu që prej tij ofron dhe paraqet aq sa tregon qëllimin e folësit, dhe kështu bëhet si peri i cili i sistemon të gjitha pjesët e përshkrimit.”<sup>247</sup>

Shukri Ajjadi i aplikon këto karakteristika thelbësore të stilit letrar në tekstet që flasin për Ditën e Gjykimit dhe të Llogarisë dhe mendon se ekzistojnë tri ide themelore që veprojnë në orientimin e përshkrimit për Ditën e Gjykimit dhe të Llogarisë. E para është ideja e përbrysja e kobshme që do t'i ndodhë tokës dhe atyre që jetojnë mbi të. Pastaj i potencon hollësishët dhe përgjithësisht manifestimet e kësaj ideje në ajetet kur'anore. Pastaj vazhdon me theksimin e idesë së dytë orientuese, d.m.th. me shkatërrimin e befasishëm të popujve gjenjeshtarë. Në fund e trajton idenë e tretë, idenë e vdekjes, sepse vdekja në sytë e të gjallit është e trishtueshme, njësoj si përbrysja e kjametit apo më e keqe. Pastaj i gërshton këto tri ide dhe jep një imazh të hollësishëm të ngjarjeve të Ditës së Gjykimit dhe të Llogarisë në kornizën e idesë së përbrysjes së kobshme e cila do ta godasë tokën dhe ata që janë mbi të,

<sup>246</sup> Po aty, f. 85

<sup>247</sup> Po aty, f. 85

pavarësisht nëse përbysja është në jetën e individit, të kolektivit (popullit) apo të mbarë dynjasë.”<sup>248</sup>

Përbyllja e studimit ishte rreth objektivave humane të Kur'anit fisnik në këtë tematikë. U theksua më parë se këtë ide Shukri Ajjadi e lidhi me metodën e mësuesit të vet, të Hulit. Fjalimin e filloi me hulumtimin e marrëdhënies së fesë me artin, duke i trajtuar të dyja si shprehje (e vetme) e aspektit emocional të shpirtit njerëzor dhe duke sqaruar se ky fondament shpirtëror i fesë dhe i letërsisë bashkërisht shkaktojnë lidhjen e studimit fetar me atë letrar. Kështu studimi psikik u bë pjesë e rëndësishme e studimit të fesë, duke spikatur në të njëjtën kohë thirrjen e profesorit të tij, të Hulit, për realizimin e një përpjekje të re në stilistikë dhe në tefsir, duke i përdorur ligjet psikologjike të sjella nga psikologjia moderne për kuptimin letrar.<sup>249</sup> Pastaj Shukri Ajjadi e përcakton qëllimin e kësaj kërkese, dhe se ai ka pasur për qëllim vetëm format e ndryshme të kuptimit të eksperiencave të mëdha shpirtërore, të cilat i përmban feja: në atmosferën humane gjithëpërfshirëse dhe në atmosferën sociale të veçantë. Pastaj në atmosferën individuale psikike.”<sup>250</sup>

Pastaj Shukri Ajjadi, me një sens kritik të mprehtë, u ndal te disa çështje që ndërlidhen me Ditën e Llogarisë. Mjafton të sjell diskutimin e tij serioz rreth idesë së afrimit të kjametit, si ai i dha kësaj orientim letrar kreativ. Pas hulumtimit të ajeteve që flasin për afrimin e kjametit, Shukri Ajjadi shtroi këtë pyetje: “A konsiderohen këto ajete informim për afrimin e kijametit?” Përgjigjja ishte e befasishme: “Duket se jo. Ajeti 15 i sures Taha “*S'ka dyshim se momenti (kijameti) do të vijë patjetër, Unë gati e kam fshehë atë; (do të vijë) për t'u shpërblyer secili njeri për atë që ka bërë.*” (Taha: 15) është kumtim që i drej-

<sup>248</sup> Sherkavi, *Shukri Ajjadi ve menhexhu fi et-tefsiri el-edebijji li el-Kur'ani el-Kerimi*, vep. e cit., f. 270

<sup>249</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 100; shih:

- Huli, *Menahixhu texhidin fi en-nehv vi el-lugati ve et-tefsiri ve el-edebii*, vep.e cit., f. 177

<sup>250</sup> Po aty, f. 101

tohet Musës a.s. Ka kaluar shumë kohë mes dërgimit të tij dhe dërgimit të Muhamedit a.s., prandaj nuk thuhet se kërcënimi për afrimin e kjametit është një paralajmërim që nuk u realizua. Pra, nëse ishte për qëllim kuptimi i afërsisë që na bie ndërmend secilit prej nesh, atëherë nuk lejohet të paraqitet si e tillë për Musën a.s. “*S'ka dyshim se momenti (kijameti) do të vijë patjetër, Unë gati e kam fshehë atë;*” (Taha: 15).<sup>251</sup> Pastaj, në Kur'an ekzistojnë ajete të drejtپerdrejta që flasin se dija për kjametin i takon vetëm Allahut, kurse përcaktimi i kohës së ndodhjes, afër apo larg, është një çështje e pamundur të dihet.”<sup>252</sup> Nëse këto ajete që flasin për afërsinë e kjametit do të ishin të prera në kuptim, atëherë si ta komentojmë paraqitjen e dendur të tyre në fazën mekase në veçanti?

Para se t'i përgjigjet kësaj pyetjeje, Shukri Ajjadi diskuton disa dyshime që kanë ngritur disa orientalistë për këtë çështje. E veçon këtu orientalistin gjerman Josef Horovitz, i cili mendon se “(dija për kjametin) nuk ishte prej ideve që Muhamedi i huazoi nga njohësit e feve të huaja. Ideja e llogarisë së fundit dominoi fuqishëm para vdekjes së tij... Sa herë që i soditeshin tmerret e kjametit para syve, i shtohej bindja se ardhja e tij është afër dhe do të ndodhë në befasi.” Pastaj, sipas Horovitzit, e zhvilloi idenë e bindjes se Allahu e ka zgjedhur atë për ta paralajmëruar popullin e vet se dënimini është afër. Shukri Ajjadi këtë mendim e komentoi me këto fjalë: “Kështu Horovitzi e kthen problemin te përjetimi shpirtëror i Muhamedit, kurse besimin në idenë se kjameti është afër e konsideron si fillim i ndjenjave për pejga-

<sup>251</sup> Këtu shihet qartë se Shukri Ajjadi e ka zgjedhur njërin (nga dy mendimet) përfjalëن (أَخْفِيَ) që është fshehja apo mosshafaqja. Këtë mendim e përzgjodhi edhe Ibn Utejeh në tefsirin e vet, i cili theksoi mendime të ndryshme në komentimin e kësaj fjalë, ku më të njohurat janë këto: (أَخْفِيَ) me kuptimin “e shfaq atë”, i cili është antonim. Ibn Utejje tha: Ky është mendim i pavend. Pastaj zgjodhi se (أَكُدْ أَخْفِيَ) është në vendin e vet, me kuptimin e afërsisë që nuk ka ngjarë, mirépo ky togfjalësh është i përshtatshëm përfshirë dhe alegori. Pra, ajeti është mënyrë e të shprehurit përfshirësina ekstreme që ka çështja dhe momenti i kjametit, prandaj tha (أَكُدْ أَخْفِيَ) “pra përfshirë mos u shfaqur asnjëherë”, por kjo nuk ndodh sepse një ditë kjameti do të bëhet. Shih:

- Ibn Utejje El-Endelusi, *El-Muharrir el-vexhizu fi tefsiri el-Kitabi el-Azizi*, Bejrut, Daru Ibn Hazm, botimi I, 2002, f. 1248

<sup>252</sup> Ajjad, *Dirasatun kur'anijetun: jevmu ed-dini ve el-hisabi*, vep. e cit., f. 102

mberi. Me këtë arsyetim ai shkon paralel me mendimin e orientalistëve për shpalljen dhe pejgamberinë, të cilët gjendjen shpirtërore të Muhamedit e konsiderojnë themel të kuptimit të Kur'anit.”<sup>253</sup> Pastaj konstaton drejtimin letrar psikik të kësaj problematike kështu: “Ideja e shkatërrimit përfundimtar të dynjasë është ide shumë e afërt (e pranueshme) për mendjen e njeriut, madje të gjithë popujt primitivë në një formë kanë besuar në të.”<sup>254</sup> Sa u përket dy besimeve qiellore: hebraizmit dhe krishterizmit, Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re, nuk janë boshe nga përmendja e shkatërrimit përfundimtar të botës. Siç duket kjo ide depërtoi në mendjet e politeistëve në Mekë “dhe kështu Kur'ani gjeti një ambient kuptimor ku dëgjohej afërsia e shkatërrimit të dynjasë, prandaj dhe shtrohet pyetja, për habi apo tallje, për kohën e atij momenti që përfillet shumë.”<sup>255</sup>

Kur'ani ka rrëfyer një anë bukur të mirë të mohimit dhe të talljes së tyre. Vazhdimesht dhe pareshtur gjuhët e tyre përsëritnin fjalët “*Kur është ky premtim, nëse jeni të singertë?*” (Junus: 48) Këtu shfaqet stili kur'anor që i kundërshton ata dhe është një ajet i mrekullisë psikike në përhapjen e thirrjes. “(Muhamedi) e ka përdorur frikën nga e panjohura si themel mbi të cilin pastaj jetësohet ideja në shpirrat e njerëzve. Pastaj filloj ta ngulitë këtë ide me inspirim sporadik, për të arritur përmes saj te bindja se ajo do të ndodhë. Kur njeriu e arrin këtë nivel të besimit, atëherë nuk ka nevojë ta dijë kohën e kjamitetit, por ky (kjamet) është dominues dhe pothuaj e merr gjithë kohën e tij. Kjameti tregon dhembshuri për shpirtin njerëzor, duke e mësuar të përgatitet për t'u pyetur atje. Me këtë stil të logjikës emocionale, Kur'ani u bën ballë pyetësve që tallen.”<sup>256</sup>

<sup>253</sup> Po aty, f. 102

<sup>254</sup> Po aty, f. 103

<sup>255</sup> Po aty, f. 103

<sup>256</sup> Po aty, f. 104

Sa u përket objektivave sociale të Kur'anit, ka shumë ajete që e përshkruajnë Ditën e Gjykimit dhe të Llogarisë, por që nuk mund të kuptohen pa u kuptuar gjendjet sociale që sundonin në Gadishullin Arabik, veçanërisht në Mekë. Në këtë kontekst, Shukri Ajjadi e thekson shtresën e të pasurve, të cilët në fillim e kundërshtuan thirrjen islame. Qëndrimin e tyre antagonist e lidhën me interesat tregtare dhe me dëshirën për të qëndruar në sistemin fetar që kishin, sepse ai u siguronte dominimin mbi shtresat e varfra. "Kjo shtresë i kundërshtonte fuqishëm normat e reja etike dhe rregullimet e reja sociale që i solli Islami."<sup>257</sup>

Kur'ani na ka rrëfyer jo pak për historinë e tyre, bile i ka kërcënuar me dënim të hidhët për sjelljet e tyre të mbrapshta. Allahu xh.sh. thotë: "*Jo, assesi! Vërtet njeriu i kaloi kufijtë, për shkak se e ndjeu veten të pavarur. Vërtet, te Zoti yt është kthimi. A nuk e pe atë që e pengonte robin kur falej?!*" (El-Alek: 6-10) Pastaj Kur'ani foli me diskurs më të ashpër kundra 'vlerave' sociale të atëhershme dhe sqaroi se ai që i ushtron ato (vepra të liga) nuk e shpëton asgjë nga dënim i Allahut. Krerët dhe ndjekësit e tyre do të mbajnë përgjegjësi për tiraninë e tyre dhe do të dëshironin që t'i shpëtojnë trishtimit të asaj dite madhështore, qoftë edhe për një tokë të tërë të mbushur me flori (por ajo nuk do të ndodhë). Kjo shtresë e shëmtuar, e cila e do pa masë dynjanë është e zhytur në kënaqësi, saqë edhe këtë do ta godasë sëmundja e dyshimin njësoj siç i ka prekur ambientet dëfryese (paraprake). Të këtillët nuk besojnë asgjë përpos epsheve të tyre."<sup>258</sup>

Kështu përfundon studimi tematik i Shukri Ajjadit. Iffet Sherkavi mendon se kjo është një përpjekje lider në llojin e vet dhe ndërtohet mbi përpjekjen për perceptimin e kuptimeve të fjalëve kur'anore në mendjen e arabëve të kohës

<sup>257</sup> Po aty, f. 114

<sup>258</sup> Po aty, f. 114

kur zbriti Kur'ani. Po ashtu, bën përpjekje që ato fjalë të jenë elastike (dhe në realitet janë), në mënyrë që të mos kufizohet vetëm te kuptimi leksikor i tyre, por ta inspirojë edhe kontekstin e semantikës letrare të vetë kuptimit.”<sup>259</sup>

Rrethanat kulturore të kohës kishin ndikimin më të madh te qëndrimi i Shukri Ajjadit për vazhdimin e studimeve kur'anore, për kthimin e tij kah kritika, krijimi letrar dhe inkudrimin e tij në vendosjen e konturave teorike arabe në disiplinën e stilistikës. Pavarësisht kësaj, ndërprerje që bëmë me doktoratën e tij të parë, ideja e i'xhazit (mreku-llisë) dhe ngritjes letrare të tekstit kur'anor vazhdoi ta inspirojë dhe të ndikojë dukshëm në të menduarit e tij stilistik. Kur e hulumtoi çështjen e normave të stilistikës në gjuhën arabe, pas një analize kritike të thelluar, pohoi se Kur'ani Fisnik është modeli më i lartë (i përkryer) në stilistikën arabe, prandaj është edhe më meritor që të jetë teksti më gjithëpërfshirës i vutive stilistike dhe më influencuesi.”<sup>260</sup> Ky është edhe konstatimi i orientalistit të njohur Johann Fick, i cili ka thënë: “Gjuha e Kur'anit ndryshon jo pak nga gjuha e poetëve. Gjuha e Kur'anit si një vepër (e rrallë) gjuhësore paraqet një imazh të çmuar dhe të pakrahasueshëm kundrejt veprave tjera në gjuhën arabe. Në Kur'an, për herë të parë në historinë e arabishtes, shpaloset perdja e botës ideologjike (intelektuale) nën parullën e tevhidit (një-shmërisë së Zotit), kurse gjuha e rimuar e fallxhorëve dhe e magjistarëve nuk është gjë tjetër, veçse një model i zbehur i tij për nga dukja e mjeteve (figurave) stilistike dhe e mënyrave alegorike në formën dhe në kuptimin e fjalës.”<sup>261</sup>

<sup>259</sup> Sherkavi, *El-Fikru ed-dinijju fi muvaxheheti el-asri, dirasetun tahlilijetun li ittixhahati et-tefsiri fi el-asri el-hadithi*, vep. e cit., f. 339

<sup>260</sup> Ajjad, *El-Lugatu ve el-ibdau, mebadiu ilmi el-uslubi el-arabijji*, vep.e cit., f. 102

<sup>261</sup> Johann Fick, *El-Arabijjetu: dirasatun fi el-lugatu ve el-lehkhatti ve el-esalibi*, i përkthyer, i përgatitur dhe i komentuar në gjuhën arabe nga Ramadan Abduttevvab, Egjipt, Mektebetu el-Hanxhi, botimi II, 2003, f. 16-17

**KREU I TRETË**



# Muhamed Arkuni: lëkundja e konceptit të shenjtërisë

Në një kahasim brilant mes qëndrimit të Niçes dhe të Dostoevskit për Inxhilin, Andre Gide zbulon reagimin e parë dhe të thelluar të këtyre dy gjenive humanistë. “Te Niçja dominoi një lloj smire ndaj Mesihut (Isait a.s.) saqë e çoi deri në çmenduri... Në veprën e tij të fundit “Mesihu i kurorëzuar me ferra”, e vendosi veten në pozitën e armikut të përbetuar të Mesihut (Isait a.s.), ku para vetes vendosi mësimet e tij (për studim) rrënjoshtësht.”<sup>262</sup>

Kurse reagimi i Dostoevskit ishte krejt ndryshe. Dostoevski, që në kontaktin e parë me Inxhilin ndjeu se në të ka gjëra të çmuara, bile jo vetëm për të, por për mbarë njerëzimin. Aty e nuhati aromën e hyjnores dhe u përkul me respekt para madhështisë së Mesihut.”<sup>263</sup>

Kjo ishte vetëm një hyrje e përshtatshme për të mësuar qëndrimin shpirtëror të Muhamed Arkunit ndaj Kur'anit. Ndoshta është e vështirë të thuhet “se Arkuni e rishfaqi qëndrimin shpirtëror të Niçes ndaj Inxhilit”, megjithatë lexuesi i Arkunit nuk gabon nëse thotë “se Arkuni nuk e nuhati madhështinë hyjnore të Kur'anit. Ai është një lexues i privuar nga “begatia qiellore”, së paku sipas Muhamed Ikbalist.<sup>264</sup>

Arkuni është nismëtari në mesin e studiuesve që morën mbi supe “heqjen e pengesës së shenjtërisë”<sup>265</sup> nga teksti

<sup>262</sup> Andre Gide, *Dostojevski, mekalatun ve muhaderatun*, i përkthyer nga Iljas Hana Iljas, Bejrut – Paris, Menshurat Uvejdat, botimi I, 1988, f. 108

<sup>263</sup> Po aty, f. 109

<sup>264</sup> Muhamed Ikbal, *Xhenahu Xhibril*, i përkthyer dhe i komentuar nga Xhelal Es-Seid El-Hafnavi, i kontrolluar nga Muhamed Alauddin Mensur, Kajro, El-Mexhlisu el-A'la li eth-Thekafeti, botimi I, 2003, f. 138

<sup>265</sup> Muntesir Hamadeh, “El-Ajatu el-kur'anijetu ve el-kiraatu el-hadatheti inde duktur Taha Abdurrahman”, revista “Mexhel-letu el-muntaliku el-xhedidu”, Liban, nr. IX, 2006, f. 13

kur'anor dhe pozicionimin e Kur'anit nga pozita hyjnore në pozitën njerëzore, dhe atë brenda një mekanizmi me përmasa të kufizuara. Për këtë mbështetet në metodat funksionale të disiplinave të feve, por në trajtën e kulturës perëndimore, ku metodat e disiplinave fetare që u përdorën në analizimin dhe kritikën ndaj Tevratit dhe Inxhilit, u transferuan në sferën e studimeve kur'anore, si p.sh. krahasimi i feve, historia e feve, historia e komentimit dhe e teologjisë. Këtu mund të shtojmë edhe "mbështetjen në metodat e përdorura në shkencat humane dhe sociale, dhe përshtatjen e tyre në studimin e tekstit kur'anor, sidomos linguistika, semiologjia, historia, sociologjia dhe antropologjia."<sup>266</sup>

Nuk ka dyshim se Muhamed Arkun është një lexues i pajisur mirë me dituri, mirepo "mendimi i gabuar mund t'i zë fryshtë mendimit kreativ ndonjëherë"<sup>267</sup> dhe të trashëgojë tepri apo fryrje kulturore. Ndoshta ka ndonjë interpretim për këtë "përbysje poshtëruese"<sup>268</sup>, të cilën Arkuni e lidhi me kontributet e pararendësve në studimet kur'anore. Kjo është një veti dalluese në shkrimet e tij. Fillimisht Arkuni dallon tri drejtime (forma leximi) në studimet kur'anore, dhe atë si në vijim:

## A- Leximi besimor (teologjik)

Arkuni me këtë synon gjithë trashëgiminë komentuese (të tefsirit) që lanë pas vetes muslimanët dhe e cila u shënua në fryshtë e Kur'anit fisnik. Me fjalë të tjera, "çdo sjellje në rapport me Kur'anin Fisnik e cila e ngulit dhe e forcon atë në

<sup>266</sup> Po aty, f. 15

<sup>267</sup> Alija Izetbegović, *Hurubi ila el-hurrijjeti*, i përkthyer në gjuhën arabe nga Ismail Ebu el-Bendure, Bejrut, Damask: Daru el-Fikri el-Muasiri, Daru el-Fikri, botimi I, 2003, f. 66

<sup>268</sup> Sabri Hafidhi, Ufuku el-hitat en-nekdiji, Kajro: Sherkijjatur li en-neshri ve et-tevzi'i, botimi I, 1996, f. 238, ku Sabri Hafidhi ka përdorur togfjalëshin "përbysje poshtëruese" në cilësimin e shkrimeve të doktor Kemal Ebu Dinit pë Poezinjë e injorancës dhe për përkushtimin e tij për t'i minimizuar studimet pararendëse për të.

zemrat e besimtarëve. Komentimi besimor (teologjik) i Kur'anit është i mbyllur brenda gardhit absolut dogmatik. Brenda këtij gardhi janë përbledhur doktrinat fetare, botëkuptimet, supozimet dhe tematikat që i mundësojnë çdo sistemi dogmatik apo adogmatik të mbajë pozicion larg ndërhyrjeve kritike, pavarësisht nëse ndërhyrja është nga jashtë apo nga brenda.<sup>269</sup> Bazuar në këtë, komentimi besimor (teologjik) ndjek strategjinë e refuzimit për ta mbrojtur besimin apo edhe mobilizimin (e ushtrimit) nëse e kërkon nevoja. Mbështetet në një formulim që nuk u përbahet rregullave të leximit sinkronik dhe as rregullave të leximit diakronik të zhvillimit të gjuhës. Pra, leximi besimor (teologjik) sipas pikëpamjes së Arkunit, nuk i shërbën Kur'anit dhe as mendimit islam, kurse studiuesit e pavarur orientalistë dhe afetarët janë të vetmit që mund ta ripërtërinë leximin dhe t'i shërbejnë mendimit islam.

Kjo kritikë e ashpër ndaj leximit besimor (teologjik) nuk do të thotë se Arkuni e nënçmon këtë lexim në nivelin epistemologjik, pavarësisht dyshimeve të mia të thella për realitetin e këtij qëndrimi, i cili ndoshta ishte një aspekt kontradicitor në mendimin e Arkunit. Ai pohon se "marrja në konsideratë e leximeve besimore (teologjike) apo inkuadrimi i tyre brenda vështrimit të gjerë të historianit, do ta pasuronte epistemologjinë historike dhe, në të njëjtën kohë, do të conte drejt një kritike më pak abstraktive dhe medituese tamam për mendësinë fetare."<sup>270</sup> Arkuni mendon se komentuesit klasikë, përmes ciltërsisë së përvojës fetare, i mbulonin (me shkathtësi) mangësitë apo mospërputhjet e tefsireve të tyre me kuptimin e tekstit.<sup>271</sup>

<sup>269</sup> Muhamed Arkun, *El-Fikru el-islamiju ve istihalatu et-te'sili*, i përkthyer dhe i komentuar në arabishtë nga Hashim Salih, Bejrut, Daru es-Saki, botimi III, 2007, f. 66

<sup>270</sup> Po aty, f. 70. Hashim Salih përktheje jep këtë sqarim: "Këtu shfaqet horizonti i gjerë i cili u mor në konsideratë nga Arkuni. Ai refuzon të nënqohen leximet besimore (teologjike) të Kur'anit me argumentin se ato janë të lashta dhe kanë mbijetuar gjatë gjithë kohës. Mendon se detyrë e hulumtuesit është t'i inkudrojë ato në studimin (e vet), sepse ato janë paraqitur të parat në histori dhe përbajnjë një eksperiencë shpirtërore reale të kolosëve që dallohen me imagjinatë kreative."

<sup>271</sup> Muhamed Arkun, *El-Fikru el-islamiju nakdun ve ixhihadun*, i përkthyer në gjuhën arabe nga Hashim Salih, Bejrut: Daru es-Saki, botimi II, 1992, f. 95

## B- Leximi historik-filologjik

Këto janë lexime që shkëlqyen në hulumtimin orientalist në kontekstin e historisë, strukturës dhe metodave të komentimit të Kur'anit. Arkuni tregohet shumë i kënaqur me kontributet e orientalistëve të parë (në këtë sferë) si Noldeke dhe Blachere, për faktin se ata i thyen tabutë e imponuara nga ortodoksizmi islamik në studimet kur'anore, të cilat pengonin afrimin më shumë seç duhej.<sup>272</sup> Megjithatë, Arkuni e sulmonte pozitivizmin orientalist, për shkak se ai ishte mbyllur brenda rrëthit historik-filologjik që ishte promovuar në shekullin XIX dhe nuk ishte inkuadruar në modernizimin e leximit, për të përfituar nga arritjet epistemologjike në sferën e filologjisë dhe të semiotikës me theks të veçantë. Gjithashtu, e kritikon frymën e kujdesit dhe të vëmendjes në shkrimet e orientalistëve bashkëkohorë, të cilët i cilëson si "ekspertë në sferën e caktuar profesionale, por mendimtarë nuk mund të jenë asnjëherë."<sup>273</sup>

Në këtë kontekst, Muhamed Arkuni ofron një kritikë thumbuese për shokun dhe frymëzuesin e tij, për orientalistin gjerman Josef Van Ess, autorin e veprës "El-Lahutu ve el-muxhemeu fi el-kuruni eth-thelatheti el-ula li el-hixhreti (Teologja dhe shoqëria në tri shekujt e parë pas migrimit)". Kjo veprë është caktuar për studimin e periudhës së parë të formimit të mendimit islam dhe hedh për të shumë dritë.<sup>274</sup> Van Essi e trajtoi me shumë kujdes problemin e mutezilëve, iu përmbajt qëndrimit sunit në analizimin e natyrës së të menduarit dhe e la vlerësimin e tyre (të sunitëve) si vlerësim përfundimtar për muslimanët.<sup>275</sup> Ky qëndrim nuk i pël-

<sup>272</sup> Arkun, *El-Fikru et-islamiju ve istihaletu et-te'sili*, vep. e cit., f. 44

<sup>273</sup> Po aty, f. 46

<sup>274</sup> Muhamed Arkun, *El-Kur'anu min et-tefsiri el-mevruthi ila tahlili el-hitabi ed-diniji*, i përkthyer në gjuhën arabe nga Hashim Salih, Bejrut: Daru et-Taliah, botimi I, 2001, f. 8

<sup>275</sup> Josef Van Ess thotë: "Kisha mundësi të sjell edhe shembuj nga mutezilit, mirëpo pasi ata u konsideruan si heretikë nga shumica e muslimanëve më vonë, atëherë mua më duhet ta marr në konsideratë këtë kundërshtim dhe të mos i

qeū Muhamed Arkunit, prandaj e kritikoi kështu: "Shoku im, Josef Van Ess, i cili ka dhënë kontribut të veçantë në studimet islame, pavarësisht kësaj, ai është një nga orientalistët që ushtruan vetëkontroll mbi ata, d.m.th. ai ushtron vetëkontroll mbi veten në çdo çështje që ka të bëjë me sferën konservatore apo me besimin. Puna arriti deri aty sa të ketë frikë nga ndonjë manifestim i këtij besimi (d.m.th. i besimit sunit)... Po, kjo është ajo që veproi studiuesi i madh Van Ess"<sup>276</sup> pa pasur frikë nga mallkimi dhe qortimi që mund t'i sjellë ky intonacion këtij orientalisti. Nuk u inkuadrua në "deshifrimin e çdo forme të ortodoksizmit, të cilit rrejshëm i ishin hedhur perdet e shenjtërisë nga aktivistët historikë."<sup>277</sup>

Në anën tjetër, Muhamed Arkuni i thuri çdo lavd veprës së hulumtueses franceze Jacqueline Chabbi, të titulluar "Rabbu el-kabaili: islamu Muhammed", e botuar në vitin 1997. Këtë vepër (Arkuni) e shihte si një studim profesional të nivelit të lartë dhe të thellë.<sup>278</sup> Bëri një analizë të zgjerruar, të cilën e filloi me këto fjalë: "Vërtet ndjehem i lumtur, sepse flas për një libër të vlefshëm si ky. Libër që trason drejtimin që e do çdo hulumtues-mendimtar dhe kërkon ta mbërrijë. Libri i saj ofron modelin shembullor shkencor, i konkretizuar me mundësinë e realizimit të një ngritjeje tipologjike dhe epistemologjike në shkrimin historik për Kur'anin. Autorja vizaton kufijtë që nuk mund të shkelen: kufijtë e ligjit struktural të historianit në njérën anë dhe të sferës së mendimit besimor (teologjik) dhe të njoftjes teologjike në anën tjetër."<sup>279</sup>

paraqes ata si përfaqësues legjitim të Islamit... Unë nuk mund apo nuk dua ta përmbysh pikëpamjen islame për historinë. Këtë duhet ta bëjnë vetë muslimanët, jo unë." Shih:

- Arkun, *El-Fikru el-Islamiju ve istihaletu et-te'sili*, vep. e cit., f. 34

- Nasr Hamid Ebu Zejd, *El-Hitabu ve et-te'sili*, Ed-Daru el-Bejdau: El-Merkezu eth-Thekafiju el-Arabiju, botimi II, 2005, f. 107-108

<sup>276</sup> Arkun, *El-Fikru el-Islamiju ve istihaletu et-te'sili*, vep. e cit., f. 33-34

<sup>277</sup> Po aty, f. 34

<sup>278</sup> Po aty, f. 44

<sup>279</sup> Po aty, f. 49-50

Hashim Salihu, përkthyesi i librit në gjuhën arabe, këtë çështje e komenton kështu: "Duket se studiuesja ka shkuar shumë larg për ta deshenjtëuar gjithë atë që ishte zhveshur nga historia përgjatë shekujve. Për herë të parë merr guxim një studiues për ta deshenjtëuar tekstin kur'anor deri në këtë nivel. Kështu (Kur'ani) u zhvesh nga historia e vet, d.m.th. nga korrelacioni me shekullin VII dhe nga ambienti i Gadishullit arabik. Për këtë arsy, ai përplaset rëndë me ndjeshmërinë e besimtarit tradicional."<sup>280</sup>

Shpërfillja e leximit orientalist e arriti kulmin me thënien e Muhamed Arkunit, "të gjithë orientalistët (përashtuar ata pak orientalistë që s'kanë lënë asnje gjurmë) i shpërfillin dialogët metodologjikë dhe brengët epistemologjike. I kush-tojnë vëmendje vetëm studimit të ngjarjeve dhe ndodhive lëndore-konkrete. Këtë e bëjnë me kuptimin që synojnë dhe brenda kornizës epistemologjike që përzgjedhin vetë ata."<sup>281</sup> Megjithatë, sipas Hashim Salihut, këta orientalistë e kundërshtojnë Arkunin, duke thënë se ai vazhdimisht merret me çështje teorike pa sjell asnje studim shkencor konkret për të përkrahur programet e tij teorike. Gjithashtu, disa intelektualë arabë filluan t'i drejojnë akuzën e njëjtë për ta zvogëluar rëndësinë e mendimit të Arkunit."<sup>282</sup>

## C- Leximet linguistike, semiotike dhe letrare

Në vështrimin e Arkunit këto lexime përbëjnë alternativën aktive të dy leximeve paraprake: të leximit besimor (teologjik) dhe të leximit historik-filologjik (orientalist), të cilat lëngojnë nga lëshime të mëdha metodologjike. Lëngata

<sup>280</sup> Po aty, f. 50

<sup>281</sup> Po aty, f. 20

<sup>282</sup> Po aty, f. 20. Shih:

- Ron Halper, El-Aklu el-islamijuu emame turathi asri el-envari fi el-arabi, (El-Xhuhudu el-felsefijjetu inde Muhammed Arkun), i përkthyer në gjuhën arabe nga Xhemal Shehid, Damask, El-Ehali li et-Tibaati, botimi I, 2001, f. 176

më e madhe e tyre është se standartet e aplikuara në dy leximet paraprake, nuk përshtaten me metodat gjuhësore, kritike dhe letrare-moderne. Këtu Arkuni i drejtohet epistemologjisë gjuhësore-moderne dhe përfiton nga semiotika që u formua nga Algirdas Greimas me theks të veçantë, sepse semiotika aspiron rivendosjen kritike e cila mban një distancë mes saj dhe lëndëve të lexuara të nivelit parësor. Pastaj, të gjitha lëndët dytësore që dalin nga trashëgimia (i vendos) në të njëjtën kohë bashkërisht. Sa i përket semiotikës së ligjërimit kur'anor, Arkuni pohon se "ligjërimi kur'anor përgjithësisht është i komplikuar përmes një plani të caktuar të përcimit-kumtimit (apo përmes një rrjeti përques të caktuar). Në këtë plan hasim se funksionet dominuese ushtrohen nga ana e vetë Aktivizuesit, pra nga Allahu. Allahu u kumton dy llojeve të njerëzve: besimtarit dhe jobesimtarit. Procesi i kumtimit arrihet përmes një ndërmjetësuesi që gjëzon pozitë të dalluar dhe negative (pasive) në të njëjtën kohë, pra përmes Muhamedit i cili është vetëm përques i shpalljes."<sup>283</sup>

Ai nuk frikësohet se devijimi i idesë për ta tjetërsuar shpalljen nga konotacioni pozitiv në atë negativ është një aspekt i gabuar i Arkunit. Orientalisti japonez Toshihiko Izutsu e sqaron këtë çështje në një mënyrë krejt ndryshe: "Shpalljes në Kur'an i është dhënë një vend shumë i veçantë, pra është trajtuar si një çështje jo e zakonshme dhe si një çështje enigmatike, e cila nuk mund të deshifrohet nga arsy-aja e zakonshme njerëzore, prandaj ishte i domosdoshëm ekzistimi i një ndërmjetësuesi, i cili quhet "i dërguar"<sup>284</sup> A është domosdoshmëri e pengamerisë që i dërguari të inkorporohet në mësimet që i shpallen atij? Ambicjet e politeis-

<sup>283</sup> Muhammed Arkun, *El-Fikru el-Islamiji, kiraetun ilmijjetun*, e përkthyer në gjuhën arabe nga Hashim Salih, Beirut, Ed-Daru el-Bejdau, Merkezu el-Inmai el-Kavmiji, El-Merkezu eth-Thekafiji el-Arabiji, botimi II, 1996, f. 72

<sup>284</sup> Toshihiko Izutsu, *All-Llahu ve el-insanu fi el-Kur'ani*, e përkthyer dhe i përgatitur për botim nga dr. Hilal Muhammed El-Xihad, Beirut, El-Munedh-dhemetu el-Arabijjetu li et-Terxhemeti, botimi I, 2007, f. 240

tëve kërkonin ta tjetërsonin Kur'anin dhe të sjellin diçka tjetër, mirépo Allahu i Lartësuar i mposhti ambiciet e tyre me atë që i shpalli të Dërguarit a.s.: “*Dhe kur atyre u lexohen ajetet Tona të qarta, ata që nuk besojnë takimin Tonë (ringjalljen), thonë: ‘Sillna një Kur'an tjetër, ose ndryshoje këtë!*” Thua: ‘*Mua nuk më takon që ta ndryshoj vetë, unë e përcjell vetëm atë që më shpallet, unë nëse i kundërshtoj Zotit tim, i frikësohem dë-nimit të një Ditës së madhe*’’. (Junus: 15) Këtu shihet se pozita e predikimit është treguesi i sinqeritetit të Muhamedit a.s. Pra, predikimi dhe besnikëria janë treguesi i “veçorisë pej-gamberike” ndaj tekstit. Kjo është sipas Roland Barthes, i cili i studioi disa pjesë të Inxhilit dhe ndaloi te problemi i predikimit të tekstit te ne lexuesit, veçanërisht te rrëfimet e mrekullive. Në fund erdhi në përfundimin se “Lëvizësi i këtij teksti (i Inxhilit), bile këtu shihet edhe veçoria pejgamberike, nuk është hulumtimi, por predikimi dhe kumtimi.”<sup>285</sup>

Poeti dhe kritiku Thomas Stearns Eliot thekson se leximi i Inxhilit si tekst letrar është i pamundur, sepse ai është tekst i shenjtë. Këtë mendim, me kujdes të veçantë e ka hedhur si në vijim: “Inxhili ka influencë letrare në letërsinë angleze, jo në cilësinë e letërsisë, por në cilësinë e raportit të fjalës së Zotit. Megjithatë, është realitet se letrarët sot e diskutojnë atë si një letërsi që flet ndoshta për fundin e ndikimit të saj letrar.”<sup>286</sup> Më parë u fol për rezistencën e ashpër me të cilën ballafaqohet shkolla e tefsirit (komentimit) letrar, mirépo Muhamed Arkuni ishte shumë entuziast për ta ringjallur leximin linguistik-letrar të Kur'anit. Arkuni me fjalën *lexim letrar* këtu nënkupton studimin e alegorisë kur'anore larg presionit të teorisë së i'xhazit (mrekullisë), teori që u bë pjesë e doktrinës zyrtare (teologjike) të musli-

<sup>285</sup> Roland Bathes, *Et-Tahilu en-nessiju, tettbikatun ala nususin min et-tevrat ve el-inxhili ve el-kissatu el-kasiretu*, e përkthyer nga Abdulkebir Eh-Sherkavi, Ed-Daru el-Bejdau: Met'beatu en-Nexhahi, 2001, f. 51

<sup>286</sup> David Jasper, *Mukaddimetun fi el-hermenutika*, vep. e cit., f. 166

manëve, bile kjo e fundit (i'xhazi) u bë shkak i ngadhënijimit të leximeve të fjalëpërfjalshme të Kur'anit dhe mjet i shtypjes ndaj çdo avitje linguistike, semantosemiotike apo letrare në tekstin e shenjtë.<sup>287</sup>

Muhamed Arkuni, para se t'i ofrojë botëkuptimet e veta teorike për realizimin e leximit linguistik-letrar në Kur'an, pranon se ekziston një vështirësi e madhe që s'mund të neglizhohet. Kjo vështirësi mund të përmblidhet në atë se "kur flasim për gjërat e çuditshme (mrekullitë) në Kur'an, kjo do të thotë se ne domosdoshmërisht do t'i zbatojmë metodat e analizës linguistike dhe letrare, sepse këto mrekulli janë realizuar duke u mbështetur në tekste të shkruara. Kjo në të njëjtën kohë tregon se Kur'ani, si Tevrati dhe Inxhili, fillimi ishtë është gjuhë fetare."<sup>288</sup> Pastaj (Arkuni) e përkufizon gjuhën fetare si "përbledhje e manifestimeve dhe formave të shprehura të shpirtit (frymës) fetare: qofshin ato lëvizje, fjalë dhe rite. Pastaj më vonë këtu përfshihet edhe shkrimi, i cili e përkthen këtë frymë përmes marrëdhënies së saj absolute me absoluten jetike (të kësaj jete)."<sup>289</sup> Arkuni e pranon se vazhdon të na mungon linguistika dhe semiotika adekuate për ta analizuar hollësishët këtë gjuhë. Pastaj problemi të gjuhës fetare i jep një formë tjeter: si mund të flasim për gjërat e çuditshme (apo magjepse) në Kur'an pa marrë një qëndrim stenografik kundrejt gjuhës fetare."<sup>290</sup>

Muhamed Arkuni leximin e tekstit kur'anor e nis nga pozita simbolizmit dhe e alegorisë së gjuhës fetare, "sepse gjuha fetare, sipas tij, dallohet nga gjuhët tjera me faktin se ajo paraqet imazhe simbolike të jetës, bile më shumë seç ofron shprehje të drejtpërdrejta për jetën dhe për ekzistençen. Gjuha fetare, në formë të veçantë dhe shembullore e ka

<sup>287</sup> Arkun, *El-Fikru el-Islamiju ve istihaletu et-te'sili*, vep. e cit., f. 62

<sup>288</sup> Arkun, *El-Fikru el-Islamiju, kiraetun ilmijjetun*, vep. e cit., f.190

<sup>289</sup> Po aty, f. 190

<sup>290</sup> Arkun, *El-Fikru el-Islamiju, kiraetun ilmijjetun*, vep. e cit., f.190

zbuluar simbolizmin fetar.”<sup>291</sup> Nasr Hamid Ebu Zejd i sqaron faktorët e kësaj përzgjedhjeje dhe konfirmon “se Kur'anë eshtë më i përshtatshëm për t'u ripërtërirë kuptimisht dhe semiotikisht përmes përdorimit të alegorisë, kurse përmes alegorisë gjuha fetare fiton simbolizmin e vet, i cili mund të deshifrohet përmes qarkut të interpretimit.”<sup>292</sup>

Teoria metaforike dhe simbolike e gjuhës eshtë njëra nga gjashtë teoritë e propozuara nga filozofët e gjuhës dhe nga teologët për interpretimin e gjuhës fetare. Përfaqësuesit e kësaj teorie mendojnë se gjuha e fesë eshtë gjuhë e shëmbëllimit (alegorisë) dhe jo gjuhë e realitetit (e drejtpërdrejtë). Po ashtu, gjuha fetare eshtë gjuhë e koncepteve të ngërthyera në fjalët fetare (fetarizmat), sidomos në librat e shenjtë, kuptimet e përdorimeve të zakonshme nuk janë në fokusin e tyre.”<sup>293</sup> Prej më të njohurve që e thonë këtë eshtë Ebu Hamid Gazaliu (505 h.) në kontekstin e mistikës islame, shenjtori Thomas Aquini (vdiq 1274 m.) në kontekstin e teologjisë krishtere dhe teologu protestant Paul Tillich, i cili mendon se “besimi fetar i cili eshtë ‘synimi më i lartë’ i ekzistencës, nuk mund shprehët ndryshe veçse me gjuhën e simbolit, sepse çdo gjë që lidhet me synimin më të lartë, pavarësisht fakteve, ka kuptimin simbolik. Tillich nga krejt kjo përjashton vetëm një çështje reale të vetme që nuk ka kuptim simbolik, ajo eshtë “ekzistenca e Allahut”, e cila eshtë ekzistencë e pastër.”<sup>294</sup>

Brenda kulturës arabe u zhvillua një debat i ashpër për ekzistencën e alegorisë në Kur'an. Rryma e ashpër e përfaqësuar nga Ibn Hazm Dhahiri (vdiq 456 h.) dhe nga Ibn Tejmije Hanbeliu (vdiq 728 h.) e mohon ekzistencën e

<sup>291</sup> Muhammed Arkun dhe Gardi Louis, *El-Islamu, el-emsı ve el-gadi*, e përkthyer në gjuhën arabe nga Ali El-Mukal-lid, Beirut: Daru Et-tenviri, 1983, f. 202

<sup>292</sup> Ebu Zejd, *El-Hitabu ve et-tevilı*, vep. e cit., f. 118

<sup>293</sup> Muhammed Mustafevij, “Nedharrijatu lugati ed-dini ve ishkallijjeta el-ma'rifeti ve et-tebjini”, Mexhel-letu El-Muhabbxheh, Liban, Ma'hadu el-Mearifi el-Hikemijjeti, nr. X, 2004, f. 119

<sup>294</sup> Mustafevij, “Nedharrijatu lugati ed-dini ve ishkallijjeta el-ma'rifeti ve et-tebjini”, vep. e cit., f. 119

alegorisë në Kur'an. Ibn Tejmija, librin e tij madhështor, "Der'u tearudi el-akli ve en-neqli", e ka shkruar mbi bazën e këtij parimi, prandaj i ka sulmuar fuqishëm të gjitha qarqet që pohonin ekzistencën e alegorisë në Kur'an. Gjithashtu, ka aprovuar domosdoshmërinë e interpretimit kur provat tradicionale përplasen me provat racionale. Megjithatë, shumica e linguistëve, fukahave (juristëve islamë) dhe dijetarëve të kelamit ndajnë të njëtin mendim se alegoria është e pranishme në Kur'an. Për këtë problematikë ka disa çështje, por nuk është vendi për ta hulumtuar këtu.<sup>295</sup> Sa i përket mendimit se gjuha e Kur'anit është gjuhë simbolike-alegorike, kjo i ngjan mendimit të disa filozofëve, të cilët Ibn Tejmije i quan si "fantazues dhe iluzionistë", sepse ata thonë: "Pejgamberët tregojnë për Zotin, për Botën Tjetër, për xhenetin dhe xhehenemin dhe për melaqet përmes gjërave që nuk përkojnë me vetë çështjen, megjithatë ata u kumtojnë njerëzve gjëra me të cilat imagjinojnë dhe përfytyrojnë se Allahu është ("trup") i madh dhe se ata kanë begati konkrete. Edhe pse puna mund të mos jetë ashtu në realitet, sepse interes i shumicës është t'u flitet në formën e cila do t'u mundësojë të përfytyrojnë dhe të imagjinojnë se çështja është kështu."<sup>296</sup> Ibn Sina ka një vepër "Risaletun fi ithbati en-nubuvvati" për interpretimin e simboleve dhe të ngjashmeve, ku mendon se "është kusht që pejgamberi të ketë fjalë simbolike dhe sinjalizuese."<sup>297</sup> Ka përkthyer edhe nga Platonii në veprën e tij "En-Nevamisu", ku thotë: "Kush nuk ndalet te kuptimet e simboleve të pejgamberëve, nuk e ka arritur (ta njobë) mbretërinë hyjnore."<sup>298</sup>

<sup>295</sup> Këtë problematikë gjérësish mund ta gjeni te:

- Xhelaluddin Sujutiu, *El-Muz'hir fi ulumi el-lugati ve en'veiha*, e përgatitur për botim nga Muhammed Ahmed Xhad el-Mevla dhe të tjerë, Bejrut, Daru el-Fikri, vëllimi I, f. 355

<sup>296</sup> Ibn Tejmije, *Der'u tearudi el-akli ve en-neqli*, i përgatitur për botim nga Muhammed Reshad Salim, Bejrut, Daru El-Kunuzi, el-Edebijeti, botimi I, 1971, vëllimi I, f. 8

<sup>297</sup> Ibn Sina, *Risaletun fi ithbati en-nubuvvati*, e përgatitur për botim nga Mishael Mermureh, Bejrut, Daru en-Nehari li en-Neshri, botimi I, 1991, f. 48

<sup>298</sup> Po aty, f. 48

Ky drejtim u izolua në kulturën arabe-islame dhe u akuzua me gnosticizëm të fshehur. Ky drejtim u shmang nga qarqet e ndikimit të drejtpërdrejtë, mirépo pati një shpërthim të fuqishëm të simbolizmit të gjuhës në kornizat e hulumtimit të filozofisë së gjuhës në përgjithësi dhe të gjuhës fetare në veçanti. Tekstet e vjetra nuk "janë të pranueshme me formën e tyre primitive asnjëherë, prandaj pastaj erdhi në shprehje nevoja e interpretimit për t'i përshtatur me nevojat moderne. Në bazë të kësaj, Philo Alexandrian (vdiq 50 e.s.) nisi t'i interpretojë tregimet historike-letrale të Tevratit hebre si mostra shpirtërore. Tregimi i daljes nga Egjipti (i Musait), humbja në shkretëtirë përafërsisht dyzet vite dhe arritja në tokën e premtuar, siç thotë Philo, janë alegori e lirisë së shpirtit individual, e kalimit të sprovave dhe në fund e shpëtimit."<sup>299</sup>

Ideja esenciale në të menduarit linguistik tek Arkuni është "veçori e kësaj gjuhe". Studimi i kësaj veçorie nis nga një maksimë esenciale, burimi i së cilës është fuqia e kësaj gjuhe për ta shndërruar të tanishmen, historiken dhe relati-vën në "absolute", "transcendente" dhe në "eternale". Kjo fuqi ka nevojë që hulumtuesi t'i analizojë mjetet e asaj gjuhe, të cilat do t'i mundësojnë realizimin e këtij transformimi.<sup>300</sup> Në këtë kontekst, Arkuni pohon se ligjërimi kur'anor është nga çdo ligjërim tjetër në gjuhën arabe. Ky dallim nuk buron nga ideja e epërsisë letrare ku është fokusuar teoria e i'xhazit (mrekullisë), por nga të dhënat formale, gramatikore, kuptimore, retorike, stilistike dhe ritmike, të cilat janë specifikë e Kur'anit dhe të cilat mund të kufizohen apo të shpalosen praktikisht. Alegoria luan një rol vendimtar në formimin e tërësisë së ligjërimit kur'anor.<sup>301</sup>

<sup>299</sup> Susan Sontag, *Didde et-te'vili ve mekalatun uhra*, e përkthyer në gjuhën arabe nga Nehle Bejdun, Beirut: El-Munedhdhemet el-Arabijjetu li et-Terxhemeti, botimi I, 2008, f. 19

<sup>300</sup> Ebu Zejd, *El-Hitabu ve et-te'vili*, vep. e cit., f. 72

<sup>301</sup> Arkun, *El-Fikru el-Islamijju: kiraetun ilmijjetun*, vep. e cit., f. 72

Arkuni ka përzgjedhur konceptin e “krahasimit letrar” për të shprehur karakterin e leximit të tij të Kur'anit. Ky krahasim në formë lineare përmblidhet si në vijim: “Krahasimi formal-leksikor paraqet vetëm momentin e parë të analizës gjuhësore dhe linguistike, i cili me rolin e vet duhet të shpjerë tek analiza letrare.”<sup>302</sup> Gjithashtu, pohon “se çdo krahasim letrar i Kur'anit duhet të fillojë me një rikthim kritik ndaj gjithë literaturës që sillet rreth i’xhazit.”<sup>303</sup> Pastaj ndaloj te kontributi kritik që ofroi Bakilaniu (vdiq 403 h.), me theks të veçantë në librin “I’xhazu el-Kur’ani”. Para kësaj tregon se teoria e i’xhazit (mrekullisë) të Kur'anit është teorizuar sistematikisht dhe në formë të rregullt nga shumë autorë arabë te të cilët sundonte logjika dhe retorika e Aristotelit.

Ihsan Abbasi i ka studiuar me kujdes të veçantë rrënjet e ndikimit të kulturës greke, dhe atë duke filluar nga Er-Rummani (vdiq 386 h.) dhe deri te Hazim El-Kartaxhani (vdiq 684 h.), ku personaliteti kritik i tij e formësoi “vendtakimin e arritjeve arabe dhe greke bashkërisht.”<sup>304</sup> Sa i përket Bakilanit, orientalistja gjermane Angelika Neuwirth bëri për të një studim kritik-analistik, ku mendon se “ideja specifike e analizës te Bakilaniu përputhet me njëren nga metodat e vështrimit të prozës artistike-klasike në Perëndim. Pra, edhe ajo kthehet te vetë Aristoteli. Kjo metodë nënkopoton ndarjen e tekstit në pjesë sintetike të vogla, të cilat në gjuhën e vjetër greke quhen “kolon””.<sup>305</sup>

Arkuni, kur e analizon veprën e Bakilaniut, mendimi i “kompozimit mahnitës unik” i Kur'anit i tërroqi vëmendjen për ta analizuar. Pavarësisht se vetëdija gjuhësore arabe i nënshtrohej nevojës fetare për “të demonstruar vetinë mre-

<sup>302</sup> Po aty, f. 198

<sup>303</sup> Po aty, f. 198

<sup>304</sup> Abbas, *Tarihu en-nekdi el-edebijji inde el-arabi*, vep. e cit., f. 539

<sup>305</sup> Angelika Neuwirth, *Tarikatu el-Bakilani fi idh'hari i’xhazi el-Kur’ani*, pjesë e përfshirë në librin “Dirasatun arabijjetun ve islamijjetun” e Ihsan Abbasis, e realizuar nga Veddad el-Kadi, Beirut: El-Xhamiatu el-Emrikijjetu, botimi I, 1981, f. 284

kullore të Librit të Shenjtë, ai kishte vërejtur mirë, qoftë përmes intuitës apo analizave retorike, një thyerje të formu-limit të zakonshëm gjuhësor në ligjërimin kur'anor.”<sup>306</sup>

Në këtë kontekst, Muhamed Arkuni shkoqit dhjetë karakteristika letrare, të cilat i japin Kur'anit mëvetësinë letrare dhe lartësinë retorike. Në ballinë të këtyre karakteristikave paraqitet “struktura e fjalisë kur'anore, e cila ndryshon nga çdo formulim (sistem fjalish) i njojur në ligjërim arab.”<sup>307</sup> Hamid Ebu Zejdi për këtë shprehët kështu: “Kur'ani Fisnik shtron një gjini letrare unike. Këtë koncept e përvetësoi Taha Husejni kur sqaroi se Kur'ani Fisnik nuk është as poezi dhe as prozë, por është Kur'an.”<sup>308</sup>

Këtë çështje e pohon edhe orientalisti francez, Jacques Berque, i cili thotë: “Sipas mendimit tonë (Kur'ani) më shumë anon kah poetika. Edhe pse bashkëkohorët nuk ia arritën të gjejnë një interpretim për këtë çështje, ai (Kur'ani) është një kompozim kur'anor i cili aty-këtu paraqitet i rimuar. Këtë metodë, e cila nuk është as prozë dhe as poezi, bashkëkohësit e Kur'anit e njihnin dhe e ushtronin në disa raste. Kjo do të thotë se ata nuk u habitën me vetë formulimi (kompozimin e thjeshtë të fjalëve). Kiss bin Saideh dhe të tjerët dinin të nxjerrin prej tij një tingëllimë (intonacion) të bukur, mirëpo lidhja e re (kompozimi shumëdimensional) që e realizoi Kur'ani mes shumë formacioneve (gjuhësore) është ajo që i habiti.”<sup>309</sup>

Nuk ka dyshim se ndalja vetëm te vepra e Bakilianiut është e pamjaftueshme për të sqaruar teorinë e i'xhazit (mrekullisë) dhe marrëdhënien e saj me hyrjen letrare. Kjo hyrje shpërtheu në kontekstin e një dialogu të ashpër mes

<sup>306</sup> Arkun, *El-Fikru el-Islamiji, kiraetun ilmijjetun*, vep. e cit., f. 199

<sup>307</sup> Po aty, f. 199

<sup>308</sup> Abu Zayd, “The Dilemma of the Literary Approach to the Quran,” f. 14

<sup>309</sup> Jacques Berque, *El-Kur'anu ve ilmu el-kiraeti*, i përkthyer dhe i komentuar në gjuhën arabe nga Mundhir Ajashi, Bejrut, Haleb: Daru et-Tenviri, Merkezu el-Inmai el-Hadariji, botimi I, 1996, f. 113

mutezilëve dhe esharive në veçanti. Nasr Hamid Ebu Zejdi i vështroi hollësitë e divergjencës mes këtyre dy drejtimeve akaidore dhe e dalloj ndërhyrjen thelbësore të kolosëve të të dy drejtimeve. Filloi me Ibrahim Nedhdhamin (vdiq 232 h.) dhe përfundoi me Abdulkahir Xhurxhanin (vdiq 471 h.). Gjithashtu, i trajtoi edhe dy kaditë: El-Kadi Ebu Bekr Bakiliuni (vdiq 403 h.) nga esharitet dhe El-Kadi Abdulxhebbar Hemdhani (vdiq 415 h.) nga mutezilët, shtuar këtu edhe kontributin e Xhahidhit dhe të Hashim Xhubbajut,<sup>310</sup> kur e studioi teorinë e i'xhazit në kontekstin tradicional. Kështu na solli një përbledhje e cila përbante thëniat dhe trajtesat më të rëndësishme që u realizuan në fushën e zhvillimit të hyrjeje letrare për komentimin (e Kur'anit). Kjo është diçka në të cilën dështoi vepra e Muhamed Arkunit.

Muhamed Arkuni i riktheu analizat klasike të teorisë së i'xhazit (mrekullisë) brenda parimeve sistematizuese në vazhdim:

1. Formulimi alegorik: me këtë synohen “tërësia e ligjeve të brendshme, të cilat e dominojnë stilin që e bën funksional këtë sistem (Kur'anin) dhe veprojnë për t'i transformuar gjërat reale në simbolike përmes operacionit alegorik.”<sup>311</sup> Në këtë kontekst, Arkuni e përmend orientalistin anglez Montgomery Watt, i cili mendon se thelbi i problemit në gjuhën kur'anore “mbetet i fshehur në natyrën e alegorisë... ndërsa njeriu i sotëm i cili është adaptuar në vështrimin shkencor, ka prirje për të cilësuar gjërat alegorike si jo reale dhe të parealizueshme.”<sup>312</sup>

2. Rrëfimi mitologjik: Muhamed Arkuni i kritikon kompromiset që i ofroi Muhamed Ahmed Halefullahu në librin e tij “El-Fennu el-kisasiju fi el-Kur'ani”, për të ruajtur doktrinën e i'xhazit dhe thërrret në realizimin e një detyre

<sup>310</sup> Abu Zayd, “The Dilemma of the Literary Approach to the Quran,” f. 18

<sup>311</sup> Arkun, *El-Fikru el-Islamijju, kiraetu ilmijjetun*, vep. e cit., f. 201

<sup>312</sup> Po aty, f. 201

shumë të rëndë, për kristalizimin “e një teorie të interpretimit të rrëfimit mitologjik, duke i shfrytëzuar të dhënat metodologjike të Greimasit në interpretimin e rrëfimeve popullore të mrekullueshme. Sa i përket Kur'anit, Arkuni e pranon mungesën e një semantike specifike të gjuhës fetare.”<sup>313</sup>

Arkuni konstaton se të menduarit në ngjarjet e ndryshme të pejgamberëve dhe të popujve paraprakë që janë dhënë në Kur'an, kërkon një kritikë historike për përcaktimin e llojeve të përzierjeve (tekstuale), të heqjes, të shtimit dhe të paralogizmave historike, të cilat i kanë shkaktuar transmetimet kur'anore, duke u krahasuar me të dhënat historike konkrete. Gjithashtu, duhet bërë një analizë strukturale për të sqaruar mënyrën se si Kur'ani (me të njëjtën mënyrë të mendimit mitologjik i cili u qaset miteve të lashta), e realizon dhe e kristalizon një formë dhe një kuptim të ri, madje edhe një punë të kompletuar e të përgatitur përmes një përdorimi dhe stilistike specifike në gjuhën arabe.”<sup>314</sup> Po ashtu, tregimet e pejgamberëve, për t'u paraqitur në formë të kompletuar në vetëdijen e besimtarit, kanë nevojë një ndërlidhje të ngjashme si ajo e tregimeve mitologjike, në mënyrë që të besohen.”<sup>315</sup>

Mendimi për mitizimin e tregimeve kur'anore është një qëndrim i përvetësuar nga politeistët kurejshit të Mekës. Kur'ani e mohon fuqishëm këtë mendim. Librat e biografisë pejgamberike dhe të tefsirit (të komentimit) theksojnë se “Nadr bin Harith kishte shkuar në Persi, i kishte mësuar historinë e mbretërve të tyre, të Rustemit dhe të Isfindijarit. Kur u kthyе, e pa që Muhamedi a.s. ishte zgjedhur pejgamber nga Allahu dhe u lexonte njerëzve Kur'an. Kur Muhamedi a.s. ngrihej nga një mexhlis, ulej Nadri dhe u fliste për historinë e mbretërve. Pastaj i pyeste: Pashë Zotin! Cili tregim është më i mirë? I imi apo i Muhamedit? Prandaj, kur Nadri

<sup>313</sup> Po aty, f. 201

<sup>314</sup> Po aty, f. 203

<sup>315</sup> Po aty, f. 203

u zu rob në Luftën e Bedrit, Muhamedi a.s. nuk lejoi që ai ta shpaguajë lirinë. Mikdad bin Esvedi r.a. foli me të Dërguarin për këtë, sepse Nadri ishte rob i tij, ku i tha: "O i Dërguari i Allahut, çfarë të bëjmë me robin tim?" Pejgamberi a.s. iu përgjigj: "Ai për Kur'anin fliste atë që fliste" Pastaj urdhëroi dhe u vra para të Dërguarit të Allahut a.s."<sup>316</sup> Ky dhe tregimet e ngjashme tregojnë shëmtinë dhe ligësinë e këtij mendimi. Po ashtu, këtu shihen kryelartët për të cilët Allahut i Lartësuar zbriti këtë ajet: "*E kur atyre u lexohen ajetet Toma (Kur'ani), thoshin: 'Kemi dëgjuar (këso fjalësh) dhe sikur të donim edhe ne do të thoshim diçka të ngjashme me këtë dhe se ky nuk është gjë tjetër pos mit i lashtë'*". (El-Enfal: 31) Po të kishte më shumë hapësirë, do ta kisha përmendur analizën e thellë teologjike të Sejjid Kutubit, përfaqësuesit të Leximit Ndriçues, për këtë ajet dhe se si ky (veprim-kryelartësia) është renditur në vargun e përpjekjeve të vazhdueshme për të parandaluar përfitimin e njerëzve nga drita e Kur'anit. Ky parandalim bëhej përmes kaosit, i cili kishte paksa efekt në mjedisin injorant (të atëhershëm), kuptohet para se të shpalosen dallimet e miteve, legjendave dhe tregimeve nga Kur'ani fisnik."<sup>317</sup>

Mendimi filozofik modern në sferën e ekzistencializmit bën dallime të thella të mësimeve të pejgamberëve nga vetëdija mitologjike. Mendimi spekulativ te njeriu, siç mendon Karl Jaspers, ka lindur në një periudhë historike kur u shfaq një delegim (hyjnor) i çuditshëm dhe me shtrirje të gjerë në shpirtin njerëzor. Kjo periudhë përkon "me epokën e të dërguarve hebraikë, me epokën e lulëzimit madhështor të qytetërimit grek dhe me fundin e epokës mitologjike."<sup>318</sup> Martin Popper sqaron se mësimet e të dërguarve përmbanin

<sup>316</sup> Ebu Xhafer Ibn Xherir Et-Taberij, *Xhamiu el-bejani fi tefsiri el-Kur'ani*, Bejrut, Daru el-Fikri, 1983, vëllimi III, f. 504, Po ashtu, shih: Ismail bin Omer ibn Kethir, *Tefsiri el-Kur'ani el-adhimi*, i përgatitur për botim nga Muhammed Selame, Xhide, Daru Tajjibeh, 2003, vëllimi IV, f. 46

<sup>317</sup> Sejjid Kutub, *Fi dhilali el-Kur'ani*, Kajro, Daru esh-Shuruki, botimi XXV, 1996, vëllimi III, f. 1503

<sup>318</sup> John Maccurrly, *El-Vuxhudijet*, e përkthyer në gjuhën arabe nga Imam Abdulfettah Imam, i kontrolluar nga Fuad Zekeria, Kuvajt, Alemu el-Ma'rifeti, nr. 58, 1982, f. 49-50

një revolucion në ekzistencën njerëzore, gjegjësish ato përfshinin hulumtimin për një ekzistencë burimore njerëzore dhe se këshillat e të dërguarve bënин thirrje me theks të veçantë për "transformimin" nga idhujtaria që bëhej me ibadetet mekanike dhe kryesish ia ulnin vlerën njeriut (besimtarit) në raport me përgjegjësinë ndaj Zotit dhe ndaj shoqërisë... Misioni i të dërguarve i thërriste njerëzit të heqin dorë nga këto shprehje boshe, në mënyrë që të mos interpretohen kështu (gabimisht). Realisht, shpallja u bën thirrje njerëzve ta shmangin mendësinë mitologjike, sepse kjo mendësi e pengon ndjenjën (arsyen) e kohës... me fjalë të tjera, të dërguarit u bënin thirrje njerëzve të ballafaqohen me ekzistencën njerëzore apo me atë që cilësohet me karakter të përkohshëm dhe me karakter historik-rrënjosor. Gjithashtu, u bën thirrje të dalin nga djepi jashtëkohor i mendimit mitologjik.<sup>319</sup>

3. Shprehja e vetëdijes eskatologjike: Muhamed Arkuni binomin kohë-vend e shikon siç është dhënë në Kur'an, pra mbi bazën se ky binom përfaqëson vijën e parë ndarëse nga historia e krijimit hyjnor. "Brenda kësaj hapësirë-kohë homogjene, e cila erdhi si rezultat i foljes urdhërore të Krijuesit "bëhu! E u bë" dhe kështu zhvillohet drama e shpëtimit deri "në një afat të caktuar". Brenda këtij vështrimi vërejmë se universi është shprehje e një vendi ku deponohen simbolet dhe shenjat që e ushqejnë mendimin dhe meditim me madhështinë e pafundësisë, me të bukurën e përzgjedhur, me krijimtarinë e harmonishme dhe të sistemuar dhe me shënjuesin."<sup>320</sup> Arkuni mendon se vetëdija që formohet nga ligjërimi kur'anor, themelohet mbi bazën e dallimit të "tri kohëve: e para është koha e shkurtër, e përkohshme dhe kalimtare e kësaj bote. E dyta është koha e pakufishme e vdekjes dhe e

<sup>319</sup> Po aty, f. 51-52. Për më shumë hollesi rreth natyrës së marrëdhënies mes mitit dhe fesë, shih:

- Ernest Cassirer, *Med'halun ila felsefeti el-hadareti el-insanijet ev mekalun fi el-insani*, e përkthyer nga Ihsan Abbas, e kontrolluar nga Muhammed Jusuf Nekhm, Beirut: Daru el-Endelus, f. 140

<sup>320</sup> Arkun, *El-Fikru el-Islamiju*, kiraetun ilmijetun, vep. e cit., f. 204-205

qëndrimit në varr, dhe e treta është koha e ahiretit apo e kthimit të përhershëm. Kjo e fundit është koha e cila i drejton të dy kohët e mëparshme dhe ngrihet mbi to.”<sup>321</sup>

Problemi që e shtron Arkuni këtu është se ne nuk mund ta analizojmë këtë vetëdije eskatologjike. Çështja do të ndryshojë “rrënjosht nëse ligjërimi kur'anor lexohet nga ajo që ne e quajmë vetëdije historike.”<sup>322</sup> Ka një dallim thelbësor mes dy leximeve. Në situatën e parë do të vërejmë se ka një vazhdueshmëri mes fjalës dhe veprës, d.m.th. njeriu e jeton (së paku me një) gjithë kuptimin që e dikton shpallja, pa përjashtuar asnjë të vërtetë mahnitëse që ndërlidhet me Botën Tjetër. Ndërsa në situatën e dytë ka një liri mes fjalës dhe veprës. Gjërat që më shumë mund t'i ekspozohen mendimit janë mundësitet e ëndrrës dhe të imaginatës.”<sup>323</sup>

Nuk ka dyshim se këtu ka një shkëputje rrënjosore mes karakterit letrar të tekstit kur'anor, siç është shfaqur në kontekstin e teorisë tradicionale të i'xhazit (mrekullisë) dhe karakterit të tij letrar brenda këtij vështrimi të Arkunit, i cili buron nga prapavija epistemologjike e komplikuar dhe e llojullojshme. Pyetja që shtrohet këtu është kjo: si do ta vë në funksion Arkuni këtë aparat epistemologjik, i cili ngjall frikë te yetë lexuesi bashkëkohor?

Këtu mund të vështrohen dy koncepte: "problematizimi i tekstit kur'anor"<sup>324</sup> dhe "zhvendosja",<sup>325</sup> të cilat mund të cilësohen si dy koncepte ekzekutive, të cilat në njërën anë kontribuojnë shumë në zbulimin e metodës dhe vizionit të Muhamed Arkunit në leximin e tekstit kur'anor, dhe në zbulimin e përbajtjeve dhe mendimeve të drejtimeve të këtij leximi në anën tjetër.

<sup>321</sup> Po aty, f. 205

322 Poaty, f. 205

323 Po aty, f. 205

<sup>324</sup> Problematizim do të thotë që dikça të bëhet problematike, pasi dukej fillimi sh e arsyeshme dhe lehtë e arritshme.

<sup>325</sup> Zhvendosje do të thotë zhvendosje e konceptit nga pozita e ngulitur tradicionale, pastaj shpërbehet për ta kaluar kuptimin e ngulitur tradicional. Shih: Arkun, *El-Kur'anu min et-tefsiri el-mevruthi ila tahlili el-hitatib ed-diniji*, vep. e cit., f. 28

Konsiderimi i tekstit kur'anor si problematik nuk do të thotë se Arkuni ofron një vizion të ri në interpretimin e tekstit, por kërkon t'i zërthejë të gjitha mendimet që i ka vendosur drejtimi selefi (klasik) në komentimin dhe kuptimin e Kur'anit, sepse çështja e problematizimit të tekstit kur'anor në sytë e hulumtuesit dhe të lexuesit, nuk duket si çështje e re apo si drejtim i ri në studimin Kur'anit, të tematikave dhe të problemeve kur'anore. Teksti kur'anor, siç dihet, është tekst problematik, i cili ka nxitur një debat të ashpër mes drejtimeve dhe fraksioneve islame. Ndoshta ndër çështjet më problematike ishte problematika e "krijimit të Kur'anit". Këtu mund të shtohet edhe çështja e "shpalljes", e zbritjes së Kur'anit, e tubimit dhe renditjes së sure. Gjithashtu, ideja e problematizimit të Kur'anit nga brenda është një problematikë që e gjejmë te mutezilët, esharitë dhe te fraksionet e shiave, por në nivel të strukturës së gjuhës, veçanërisht në dy çështje: në alegorinë dhe në i'xhazit (e Kur'anit).

Arkuni, kur e trajton tekstin kur'anor si tekst problematik, me të synon të realizojë dy objektiva:

- Ta paraqesë vetveten si lexues kontrovers, d.m.th. si lexues problematik, i cili mund të krijojë probleme të reja në nivel të tekstit dhe të strukturës së tij. Gjithashtu, e paraqet veten si lexues transformues, i cili kërkon të ndryshojë drejtimet e leximit të tekstit kur'anor, duke e trajtuar atë si një tekst gjuhësor të ndarë nga autorii i vet në njëren anë dhe nga realiteti historik në anën tjeter.
- Çlirimini e tekstit kur'anor nga koncepti i shenjtërisë apo, siç thotë vetë ai, nga rendi teologjik që u sqarua më parë. E vërteta është se realizimi i këtyre dy objektivave dhe ngritja e tyre në nivel të metodës, nuk bëhet pa fenomenologjinë e Husserlit, të cilën Arkuni e përfaqëson me këto fjalë: "Duhet t'i shpjegoj lexuesit atë që do ta bëj tani më saktësisht. Unë tani dal apo shpëtoj nga një rend ideo-

logjik klasik, pa u kushtuar vëmendje reflektive të kësaj (daljeje) në fenë time dhe solidaritetit tim historik dhe kulturor me komunitetin tim islamik. Unë e di se të gjitha grupet tjera fetare, si hebreizmi dhe krishterizmi, janë të interesuara vetëm për çështjet teorike, të cilat i ngrënë tani rreth konceptit të shpalljes. Këto çështje përbëjnë një sfidë apo ndoshta edhe një provokim për të gjithë.<sup>326</sup>

Arkuni, kur e vë në funksion fenomenologjinë, ai zhvishet komplet nga ajo që quhet "presion historik", i cili nuk ndalolet pa çlirimin e ligjërimit fetar. Sipas tij, "fetë dogmatike e kanë përdorur dhe vazhdojnë ta përdorin (presionin historik) deri sot si strehë politike dhe si mjet apo bazament i sundimit të pushtetit. Përderisa ky presion historik është i pranishëm te fetë, qofshin ato sisteme teologjike më të hapura apo shkencat më të përparuara, nuk do të kenë sukses në balancimin e ndikimit të botëkuptimeve fetare-sektare, sepse ato kështu janë forcë ideologjike që vënë në lëvizje masën.<sup>327</sup>

Këtu shfaqet tek Arkuni çështja e çlirimt tligjërimit fetar sipas dilemës vijuese: "A është e mundur që ndonjë ditë ta arrijmë çlirimin e ligjërimit fetar në formë të përgjithshme, duke e ditur se ai është shpallje specifike? A mund t'u ndryshohet funksioni duke e kaluar udhëheqjen (e kuptimeve) nga Allahu, te mbreti, perandori, halifja, sulltani apo kryetari?"<sup>328</sup>

Çlirimi i ligjërimit fetar nga ajo që Arkuni e quan "shtypje historike" nuk realizohet veçse përmes rrëzimit të idesë së shpalljes, ashtu siç njihet në fetë e qiellore. "Ideja që thotë se shpallja është e tëra nga Allahu dhe njerëzimit i është përcjellë përmes pejgamberëve dhe melekëve, për hebrejtë, të krishterët dhe muslimanët ka zënë vendin e botëkuptimit organik qendror të "fesë së vërtetë""<sup>329</sup>

<sup>326</sup> Arkun, *El-Kur'anu min et-tefsiri el-mevruthi ila tahlili el-hitabi ed-diniji*, vep. e cit., f. 27

<sup>327</sup> Po aty, f. 27

<sup>328</sup> Po aty, f. 27

<sup>329</sup> Po aty, f. 22

Arkuni mendon se ideja e shpalljes, e cila përfaqëson idenë “e botëkuptimit organik qendror të fesë së vërtetë”, ka marrë një dimension më të thellë te muslimanët. Ata (muslimanët) këtyre dy botëkuptimeve: atij hebre dhe të krishterë, u shtojnë atë se “ajtet e shprehura në gjuhën arabe përfaqësojnë fjalësin original dhe formulimin sintaksor dhe morfollogjik të vetë Allahut.”<sup>330</sup> Shtuar këtu edhe faktin se ai (Kur’ani) është “fjalë që flet për të gjitha llojet e krijesave, qenieve njerëzore, botëve, gjërave të ndërlikuara ontologjikisht në krijimin e parë nga Allahu.”<sup>331</sup>

Pavarësisht lidhjes organike dhe objektive mes “tekstit kur'anor” dhe idesë së “shpalljes”, hulumtuesi këtu përsëri ka mendim ndryshe nga Arkuni në çështjen e “botëkuptimit qendror organik”, jo duke e cilësuar atë si çështje problematike, por duke e cilësuar atë si teori që e rrënon tekstin kur'anor, i cili është “boshti struktural” i fesë islame. Besimi në tekstin kur'anor, duke e cilësuar atë si “boshtin struktural” të Islamit, është një çështje e padiskutueshme derisa u bë pjesë e jona, prandaj nuk kemi nevojë për prova shtesë për ta vërtetuar këtë. Faza e shumimit tematik të dijes mbi realitetin e tekstit kur'anor, është fazë e shumimit spontan e cila u ngrit nga dije e lartë e mundshme në bindje kategorike.”<sup>332</sup>

Pikëpamja e qëndrueshme ndaj tekstit kur'anor te muslimanët, të cilët e cilësojnë si një të vërtetë absolute dhe si bindje të paluhatshme, e cila sipas Arkunit nuk mund të luhatet vetëm pas problematizimit të tekstit kur'anor, dhe atë jo vetëm në nivelin e formës apo domethënies, por edhe në nivelin e “historizmit tematik”, i cili e ka ngulitur “realitetin e lartësuar të tekstit kur'anor”. Hulumtimi në fushën e problematizimit të “tekstit kur'anor” veçanërisht

<sup>330</sup> Po aty, f. 22

<sup>331</sup> Po aty, f. 22

<sup>332</sup> Salah El-Xhabirij, “En-Nessu ve el-vakiu”, Mexhel-letu el-muntaliki el-xhedidi, Beirut, nr. IX, 2006, f. 65

dhe të “mendimit islam” në përgjithësi, sipas Arkunit nënkupton “refuzimin e nënshtrimit ndaj petkut kulturor rrjedhës”<sup>333</sup> dhe ngritjen e një “përpjekjeje për t’iu përgjigjur pritjes së miliona myslimanëve, të cilët me pasion duan ta kuptojnë gjendjen e tyre në botën bashkëkohore dhe të cilët janë të mprehtë përballë kontradiktave të ndryshme që duan t’i kalojnë.”<sup>334</sup>

Tani shtrohet pyetja e radhës: deri në çfarë niveli mund të pajtohem i me Arkunin në atë se metodologjia e “problematizimit të tekstit” mund të bartë kontradikta ideologjike dhe sektare në mendimin islam, veçanërisht nëse e analizojmë faktin se kontradiktat që muslimanët duan t’i kalojnë janë kontradikta ideologjike dhe sektare? Apo janë kontradikta historike të prodhuara nga faktorë politikë në korinzen e lëvizjes së luftës kundër pushtetit?

Nëse çështja e “problematizimit të tekstit” ndërlidhet me kontradiktat ideologjike dhe sektare, atëherë çështja është e lejueshme në nivel të teorisë dhe të metodës. Megjithatë, çështja e problematizimit të tekstit (kur'anor) e kalon situatën historike-objektive sipas Arkuni, sepse ai futet në thellësitë e strukturës së vetë tekstit kur'anor, dhe atë jo vetëm për ta komentuar, për ta rilexuar dhe për t’i mbushur zbrazëtitë te gjërat kontradiktore në nivel të strukturës apo kuptimit, por me qëllim të sqarimit se “të gjitha ligjërimet e përftuara nga fjala e shpallur e Allahut dhe të cilat synojnë komentimin e urdhreve dhe këshillave, kanë kontribuuar në formimin e strukturës antropologjike të imaginatës fetare, politike dhe sociale.”<sup>335</sup>

Rreziku i mendimit të Arkunit fokusohet në atë që duket sheshazi se është përdorim jo i drejtë i konceptit “të imaginatës fetare”. Përdorimi i këtij koncepti nga ana e tij nuk

<sup>333</sup> Arkun, *El-Fikru el-Islamiju, kiraetun ilmijetun*, vep. e cit., f. 114

<sup>334</sup> Po aty, f. 114

<sup>335</sup> Arkun, *El-Kur'an min et-tefsiri el-mevruthi ila tahlili el-habibi ed-diniji*, vep. e cit., f. 28

e mohon vetëm cilësinë e shenjtërisë së “fesë-tekstit”, por e mënjanon edhe veticë e racionalizmit dhe të realizmit nga tërësia e ligjërimit fetar, edhe pse ai prononcohej se “përdomimi i termit imagjinatë nuk synon flakjen e vetisë së racionalizmit nga çfarëdo lloj trashëgimie fetare.”<sup>336</sup>

Koncepti i “imagjinatës” dhe i “historizmit”, në cilësinë e mishërimit të mendësisë grupore dhe të idesë së “Islamit historik” ato të Islamit që e prodhoi mendësia grupore arabe dhe pastaj mendësia islame sektare, reflektuan qartë te Muhamed Arkuni në leximin e sures El-Alek. Këtu mund të citojmë fjalët e tij: “Në bazë të asaj që thuhet në komentimin islam të trashëguar, kjo sure e cila zë vendin 96 në mus'haf, realisht është surja e parë që iu shpall Muhamedit në kodrën Hira përmes melekut Xhibril, të cilin e njohin edhe si Shpirti i Shenjtë. Meleku i kërkoi tri herë: *“Lexo me emrin e Zotit tënd!”*”, kurse Muhamedi i përgjigjej: “Nuk di të lexoj”. Në këtë tregim posedojmë një transmetim letrar të procesit që është ndjekur për kalimin e shpalljes nga Allahu te mbarë njerëzimi përmes Muhamedit. Xhibrili endet vazhdimisht mes Allahut dhe Muhamedit për të marrë shpalljen, siç vepronte me Jesusin dhe me pejgamberët tjerë të Tevratit. Kështu melaqja Xhibril, me ekzistencën e vet garanton vërtetësinë e shpalljes së transmetuar përgjatë gjithë kohës, duke filluar nga Ademi a.s., për të përfunduar me Muhamedin a.s.

## Arkuni dhe leximi (komentimi) i sures El-El-Fatiha

Muhamed Arkuni ofron një lexim (komentim) linguistik të sures El-El-Fatiha. Fillimisht e pranon madhështinë e kësaj sureje në nënvetëdijen e muslimanit. Këtë lexim (komentim) e fillon me thënien e Hasan Basriut, i cili suren

<sup>336</sup> Po aty, f. 29

El-Fatiha e vlerëson me këto fjalë: "Allahu i ka grumbulluar dijet e librave të mëparshëm në Kur'an, kurse dijet e Kur'anit i ka përbledhur në suren El-Fatiha. Kush e di komentimin e saj, është sikur ta ketë ditur komentimin e të gjitha librave të zbritur."<sup>337</sup> Pas këtij teksti, Arkuni thotë: "Kjo thënie vazhdon të përsëritet gjeneratë pas gjenerate, bile edhe sot e kësaj dite na përkujton rrezikun e ushtrimit të çdo leximi të shkurtër. Në të njëjtën kohë pohon se nuk do të inkjadrohet në linjën vlerësuese, nuk do të përsëritë formulime gjuhësore të ndryshme nga mendimet e kaluara dhe se objektivi i tij është shumëdimensional dhe shumë i thellë, pra ai synon të kontribuojë në formësimin e një mendimi fetar të hapur (dhe ndryshe) nga rruga që sot njihet si shembullore në islam."<sup>338</sup>

Duke dashur të heqë mbulesën e madhështisë, të cilën e imponon teksti kur'anor në përgjithësi dhe surja El-Fatiha në veçanti, Muhamed Arkuni përdor një sérë termash gjuhësorë në leximin (komentimi) e El-Fatihasë. Kësaj i vë emrin "El-Mudevvenetu en-nessijjetu (regjistri tekstual)" i Kur'anit dhe "el-mentukatu (e artikuluara)" apo "el-ibaretu el-lugavijjetu (shprehja gjuhësore)" e ajetit kur'anor.<sup>339</sup> Hashim Salihu këtë prurje e arsyeton kështu: "Këtë ai e bën për shkak të neutralizimit të ngarkesave teologjike, të cilat shpejt përvetësohen nga vetëdija jonë kur flasim për Kur'anin. Shenjtëria teologjike apo madhështia teologjike e cila ka rrethuar Kur'anin qysh para disa shekujve, na privon ta shohim siç është në të vërtetë, pra si një tekst gjuhësor i formuar nga fjalët, nga shkronjat dhe nga formulimet gjuhësore, sintaksore dhe stilistike. Me fjalë të tjera, qenia e Kur'anit lëndë gjuhësor është fshehur krejtësisht apo na ka munguar shkaku i vështrimeve tona me syrin e madhështisë së

<sup>337</sup> Po aty, f. 111

<sup>338</sup> Po aty, f. 111

<sup>339</sup> Po aty, f. 119

paprekur që e rrethon atë. Veçori e leximit gjuhësor është se ai e neutralizon madhështinë e tij qoftë për një moment, dhe atë për ta kuptuar formulimin tekstual dhe gjuhësor të Kur'anit.”<sup>340</sup>

Nisja nga simbolizmi i gjuhës fetare, ndoshta kjo ishte edhe një hile e mençur, sipas Arkunit nuk do të thotë mohim i krejt tefsirit (komentimit) tradicional të trashëguar, veçanërisht i tefsirit sunit, sidomos ky komentim “i cili kontribuoi në hulumtimin e përkufizimeve reale që synohen nga gjuha arabe. Gjithashtu (ky tefsir) dha kontribut në gjetjen e provave të thukëta që vërtetojnë krejt atë që është dhënë në Kur'an.”<sup>341</sup> I përkushtuar në mospranimin e barrës së simboliqës së gjuhës fetare, ndoshta nga frika se mundësitë analitike janë pak, Arkuni e lehtëson barrën e përgjegjësisë së të gjitha formulimeve alegorike dhe simboliqe, të ëndrrave të tepruara dhe të parashikimeve të fryra të komentuesve mistikë dhe batinitë. Ai e përbledh këtë punë të vetën vetëm në faktin se e pranon “një funksion themelor të gjuhës, funksionin i cili është hequr nga përdorimi përgjatë shumë shekujve me radhë nga ushtrimi racional-qendror i mbyllur në vetvete.”<sup>342</sup> Në të njëjtën kohë spikat vlerën e pakrashueshme të leximit linguistik për nga maturia, thukëtia dhe ngurtësia. Ajo “na detyron të vazhdojmë të qëndrojmë të ngjujar brenda kufijve të ngurtë të mundësive shprehëse të gjuhës, duke përashtuar çdo mundësi të drejtë dhe dome-thënëse që ofron çdo lexim (komentim) i tekstit.”<sup>343</sup>

Sipas Arkunit, faktori themelor për aplikimin e leximit (komentimit) linguistik/antropologjik në tekstin kur'anor, është inkorporomi i modelit islamik të “Kur'anit” brenda trashëgimive fetare (hebraike-krishtere), te të cilat është

<sup>340</sup> Po aty, f. 119

<sup>341</sup> Po aty, f. 141

<sup>342</sup> Po aty, f. 141

<sup>343</sup> Po aty, f. 112

ushtruar ky lexim me theks të veçantë. Pra, këto lexime ia arritën të paraqesin epërsinë dhe veçorinë e këtyre dy besimeve, kurse Islami mbeti i privuar dhe i përjashtuar nga ky projekt shkencor dhe ideologjik madhështor.”<sup>344</sup> I nxitur nga presioni i kësaj ndjesie, ai (Arkuni) drejtoi një kritikë të drejtpërdrejtë për orientimin ideologjik, gjegjësisht për atë që ushtrohej në perëndim nën emrin e shkencave fetare.

Arkuni leximin (interpretimin) e tekstit kur'anor e nis mbi bazën e pyetjes vijuese: cila është gjëja që do ta lexojmë? Më parë u theksua përkufizimi linguistik për Kur'anin në përgjithësi, të cilin e ofroi Arkuni dhe të cilin e quan “regjistër tekstual”,<sup>345</sup> pra është një “regjistër homogjen, i përfunduar dhe i hapur”. Me fjalën “i përfunduar” nënkopon se është i kufizuar dhe i mbyllur për nga numri i caktuar i shprehjeve dhe i ajeteve. Gjithashtu, është i arirrë dhe i plotë për nga forma e shprehjes dhe e domethënies. Kjo përkryerje e largon atë (Kur'anin) nga degradimi i leximit vlerësues, i cili ndikon në formë themelore mbi karakterin mrekullor të Kur'anit. Po ashtu, e shmang kënaqjen vetëm me leximin filologjik i cili hulumton burimet e mëparshme dhe ndikuese në tekst, hulumton paqartësitë, kundërthëniet dhe mangësitë stilistike.”<sup>346</sup> Qenia e këtij leximi “regjistër i hapur” nënkopon se është i hapur para konteksteve të shumëllojshme, të cilat i përban apo i imponon çdo lexim, me kuptimin se teksti kur'anor thotë diçka... dhe e ngulit në mendje. Pavarësisht “regjistrat kur'anor”, ky lexim përfundimisht është i mbyllur, dhe atë në formën të pakthyeshme në aspektin teologjik, megjithatë ne mund ta pranojmë historikisht si të hapur përballë përmirësimëve tekstuale, të cilat i ofron kritika filologjike apo gjuhësore historike.”<sup>347</sup>

<sup>344</sup> Po aty, f. 140

<sup>345</sup> Po aty, f. 113

<sup>346</sup> Po aty, f. 115

<sup>347</sup> Po aty, f. 115-116

Përkryerja e tekstit kur'anor nuk nënkupton zbehje apo shterje të potencialit reformues të tij. Prej kësaj kuptojmë thirrjen e vazhdueshme për të përsëritur leximin dhe komentimin e tij "pa qenë kuptimet e fshehura apo të mundshme për t'u shfaqur në formë të vërtetë, edhe pse ndonjëherë disa prej tyre mund të jenë të pakapshme apo të parealizueshme. Në vijim, çështja ndërlidhet me krijimtarinë letrare, e cila është e pajisur me potencial kreativ. Mund të themi se kjo nuk ka fund brenda rrëthanave aktuale përmundësitetona të leximit (komentimit)."<sup>348</sup>

Arkuni dallon tre tipa protokolesh, të cilat imponohen në kontekstin e leximit (komentimit) të kësaj sureje:

a) *Protokoli ceremonial*: ky është protokoll të cilin besimtari i denjë e zbaton në adhurim. Ky protokol është i vetmi që mund të sigurojë vazhdimësinë shpirtërore me grupin e besimtarëve, të adoptojë të gjitha dijet e shpallura dhe të fshihet në kontekstin e tij distanca historike reale mes besimtarëve, ashtu që fshihen kuptimet e kohës dhe vendit dhe kërkohet aktualja për të zënë vendin e tyre kuptimet e uniteti shpirtëror të cilat i bart surja El-Fatiha."<sup>349</sup>

b) *Protokoli komentues*: me këtë nënkuptohet literatura e bujshme e tefsirit (komentimit) e cila u zhvillua për tekstin kur'anor. Vepër më e mirë në këtë sferë, sipas Arkunit, është tefsiri i Fahru Razit (606 h.). Ai e quan këtë literaturë si "tekste dytësore" në krahasim me tekstin parësor të Kur'anit. Në këtë literaturë sheh një tekst këshillues të përzier me tekstin e parë. Kështu, parimet e komentimit u shenjtëruan dhe nuk mund të luhaten.<sup>350</sup>

c) *Protokolli linguistik-kritik*: ky është protokolli ku mbështetet Arkuni për leximin e sures El-Fatiha. Përmes këtij leximi

<sup>348</sup> Po aty, f. 116

<sup>349</sup> Remzij Tefifeha, "Ma'kulijjetu el-asli ve el-lugat er-remzijjeti, El-Fatiha rehanatu el-ma'na, (Kiraetu Muhamed Arkun nemudhexhen)" Revista "Kitabatun muasaretun", nr. 47, 2002, f. 117

<sup>350</sup> Arkunit, *El-Kur'anu min et-tefsiri el-mevruthi ila tahlili el-hitabi ed-diniji*, vep. e cit., f. 120

do të bëhet zbulimi i "vlerave të pastra gjuhësore të tekstit".<sup>351</sup> Megjithatë, ky lexim do të trajtohet edhe nga leximi kritik, d.m.th. se çdo gjë që do të themi, do të ketë vlerë zbuluese apo hipotetike në vështrimin tonë... sepse Kur'an i është shprehje e teksteve që duhet të lexohen nga fryma e hulumtimit dhe e dilemës."<sup>352</sup>

Arkuni, para se të fillojë të ballafaqohet me tekstin kur'anor (me El-Fatihanë), thekson një sërë parimesh që e dirigojnë leximin komentues dhe të tjerat që e dirigojnë leximin linguistik-kritik. Nga parimet e leximit të parë (kommentues) janë: Allahu ekziston dhe vetëm Ai është Ai, kurse unë nuk mund të flas për Të në formë të përshtatshme dhe të saktë, përveçse përmes fjalëve që i ka zgjedhur Vetë Ai t'i përdorë në Librin e Tij.

Nga parimet e këtilla është se Allahu i ka folur mbarë njerëzimit në gjuhën arabe, dhe atë herën e fundit përmes Muhamedit a.s. Fjalët e tij flasin gjithçka për qenien dhe ekzistencën. Atë që thotë ai, është e vërteta e vetme dhe krejt e vërteta. Gramatika, gjuhësia historike (filologjia), retorika, logjika dhe të gjitha disiplinat tjera na mësojnë teknikat që çojnë te kuptimi dhe teknikat e prodhimit të kuptimit. Si rezultat i kësaj, këto parime japid mundësinë e përbledhjes së tekstit që e përfaqëson fjalën e Allahut, të vërtetën që e ndriçon mendjen, vullnetin dhe veprat e njeriut."<sup>353</sup> Do të thotë se arsyja në këtë qark edhe mund të përqendrohet vetëm në kuptimin e thjeshtë të tekstit apo kuptimin për shkak të besimit. Kjo është ajo që quhet qarku interpretues te Paul Ricoeur.

Ka një shkëputje rrënjesore mes këtyre parimeve që shkëlqyen në kontekstin e teorisë klasike të komentimit. Pesë parimet që dirigojnë leximin linguistik-kritik të Arkunit janë këto:<sup>354</sup>

<sup>351</sup> Po aty, f. 121

<sup>352</sup> Po aty, f. 120

<sup>353</sup> Po aty, f. 121-122

<sup>354</sup> Po aty, f. 123

a) njeriu përfaqëson një problem konkret për vetë njeriun. Pikërisht siç ka thënë Ebu Hajan Tevhdiu një herë: "Kam parë se njeriut i bën problem njeriu".

b) njohja e realitetit në formë të saktë dhe të përshtatshme është përgjegjësia ime dhe vetëm e imja.

c) kjo njohje në kohën aktuale përbën një përpjekje të vazhdueshme për të tejkaluar urejtjet që qëndrojnë përpara ekzistencës sime si një qenie e gjatë që flet, si qenie politike, historike dhe ekonomike.

ç) kjo njohje është shprehje e daljes së përsëritur nga gardhi i mbyllur ku anon çdo trashëgimi kulturore.

d) kjo dalje përputhet me dy drejtime në të njëjtën kohë: me drejtimin sufit i cili mbështetet në lëvizjen shpirtërore, e cila nuk është e qëndrueshme në asnjë etapë të sjelljes ndaj Allahut; dhe me drejtimin e hulumtuesit, i cili e trajton hulumtimin shkencor si ushtrim luftarak, d.m.th. ai e refuzon epistemologjinë e ndaljes në një zgjidhje të caktuar, sado qofshin rezultatet.

Arkuni punën praktike të tij e ndan në tre momente: momenti linguistik-gjuhësor, momenti historik dhe i fundit momenti antropologjik.

Në momentin linguistik Arkuni shpalos manifestimin gjuhësor të sures El-Fatiha. I analizon emrat e trajtës së shquar me nyjën shquese të përparme el (ال) si: el-hamdu (الْحَمْدُ), es-siratu (الصِّرَاطُ), er-rahmanu (رَبِّ الْعَالَمِينَ), paskajoret, emrat prejfoljor, mbiemrat. Kjo tek Arkuni do të thotë se krejt për çfarë flet folësi është e plotësisht e njohur apo e mundshme për t'u njohur.<sup>355</sup> Për shkak të centralizmit të kësaj sureje (të El-Fatihasë) në Kur'an, Arkuni rrëshqet në një gabim fatal kur supozon se fjala

<sup>355</sup> Po aty, f. 126

Allah (الله), me nyjën shquese “el-“ ka ardhur pas zbritjes së 45 sureve para El-Fatihasë, dhe kështu u bë emërtimi i vetëm i ekzistencës (së domosdoshme), i cili zë vendin e një përdorimi sinonimik me domethënë dinamike sinonimike.”<sup>356</sup> Ky mendim është i pasaktë, sepse fjala Allah është përdorur me semantikën e saj të plotë qysh në pjesën e shpallur të Kur'anit në Mekë, para shpalljes së El-Fatihasë. Pra, problemi i besimit ishte boshti themelor rrith të cilit sillej shpallja kur'anore. Arkuni përfiton nga mendjemprehtësia e komentuesve klasikë, të cilët spikatën kuptimin e gjithëpërfshirjes (istigrak) që ka nyja shquese e përparme te fjala el-hamdu (الحمدُ). Po ashtu, nga Raziu i bart aspektet e mrekullisë në sintagmën *el-hamdu li'l-lahi* (الحمدُ لِلّٰهِ) “Falënderimi i takon Allahut”, në vend të sintagmës *ahmedu All-llahe* (أَخْمَدُ اللَّهَ) “Falënderoj Allahun”.

Pastaj Arkuni kalon në shqyrtimin e përemrave në suren El-Fatiha dhe mendon se analizimi i tyre përfaqëson një moment vendimtar në leximin e saj, sepse “kjo analizë e detyron atë ta trajtojë çështjen shumë të ndjeshme, veçanërisht atë që lidhet me autorin e tekstit (me pragmatikën)”,<sup>357</sup> ku vazhdon me tufën e përemrave që flasin për identitetin e Autorit, edhe pse nuk ekziston shenjë fondamentale të identitetit të tij.

Ndërsa foljet në suren El-Fatiha janë shumë pak. Arkuni ndalet te dy foljet na’budu (تَبَدَّلُ) “adhurojmë” dhe nes’tteinu (تَسْتَعِنُ) “ndihmë kërkojmë”. Në këto sheh mundin që duhet dhënë vepruesi (njjeriu) për të arritur tek Allahu. Folja e kohës së tashmë shpreh vazhdimësinë e veprës për të përbushur zbrazëtirën qenësore mes folësit i cili e pranon veten si shërbëtor i dobët dhe Atij që i drejtohet lutja me

<sup>356</sup> Po aty, f. 126

<sup>357</sup> Po aty, f. 128

gjithë qenien, duke e konsideruar Atë si Qenien më të Lartë dhe meritor për adhurim, të Gjithëfuqishëm i Cili mund ta kthejë mëshirën dhe dhembshurinë.”<sup>358</sup>

Në këtë formë Arkuni vazhdon t'i shkoqitë emrat dhe formulimet sintaksore. Në fund edhe rimën dhe metrikën në suren El-Fatiha, për t'u ndalur, para momentit të dytë, te koncepti i “marrëdhënies kritike”, të cilin e huazoi nga kritiku zviceran Jean Starobinski. E përgjithshmjë është se “kritiku letrar ndjen lumturi dhe kënaqësi ndonjëherë gjatë leximit të disa teksteve, mirëpo nuk u dorëzohet këtyre ndjenjave, por i kthehet tekstit për ta gjurmuar motivin që i solli këto ndjenja. Ky kthim bëhet brenda një ndjesie objektive që nuk u nënshtrohet ndjenjave të para. Kështu e paraqet tekstin si lëndë gjuhësore.”<sup>359</sup> Pyetja që mund të shtrohet në këtë kontekst është: një lexues i thellë dhe një kritik i spikatur si Arkuni, a mund ta përfjetojë momentin e gjëzinim dhe mirëqenien shpirtërore duke iu afruar Kur'anin? Informacionet që i kemi para vetes nuk tregojnë as shenjën më të vogël të këtij momenti të veçantë, madje ka një frymë hak-marrëse që nuk i ik syrit të mprehtë në leximin e Arkunit ndaj tekstit kur'anor.

Ndërsa momenti historik i El-Fatihasë i përfshin të gjitha leximet interpretuese, të cilat u realizuan në kontekstin e kulturës arabe. Nga pamundësia për ta përfshirë gjithë këtë matri, Arkuni e ka përzgjedhur vetëm tefsirin e Raziut “Mefatihu el-gajbi” si shembull, i cili na ofron “strategji të qarta nëse e trajtojmë si pikënisje. Raziut ka një vizion të rrallë dhe të shkëlqyer. Ai në tefsirin e tij e ka përbledhur kontributin e tefsirit përgjatë gjashtë shekujve të parë të migrimit.”<sup>360</sup>

Arkuni ka zbuluar pesë ligje që e menaxhojnë leximin interpretues të Fahrudin Raziut:

<sup>358</sup> Po aty, f. 130

<sup>359</sup> Po aty, f. 135

<sup>360</sup> Po aty, f. 137

a) *sistemi gjuhësor*: këtu janë për qëllim pjesët hyrëse gjuhësore me të cilat komentuesit dhe dijetarët e bazave të fikhut (usulistët) i fillojnë veprat. Këtë e bën se përsëri sepse ndjehej nevoja e madhe për formimin e një vetëdije gjuhësore para fillimit të ndërtimit të një sistemi të tefsirit apo të usulifikhut. Ky sistem ka dy gjëra të rëndësishme: teorinë dhe praktikën. Teoria përfaqet në njohjen e formimit të pastër arab të mendimit islam, kurse rëndësia praktike mishërohet në fuqinë e këtij ligji (sistemi) për të veçuar informacionin gjuhësor kundrejt informacioneve tjera.”<sup>361</sup>

b) *Sistemi fetar*: kjo përfshin tërësinë e parimeve teologjike, të doktrinave besimore dhe të riteve që e dirigojnë mendimin, e pastaj edhe diskursin dhe orientimin në një drejtim të caktuar.

c) *Sistemi simbolik*: kjo përfshin mundësinë e Kur'anit për të provokuar imagjinatën, njësoj si mundësinë për të provokuar mendimin. Muhamed Arkuni ankohet se “puna e imajginatës (fiksionit) është lënë në harresë në Islam, si te grekët klasikë ashtu edhe të racionalizimit te Perëndimi.”<sup>362</sup>

c) *Sistemi kulturor*: ky është një sistem shumë i pasur dhe aktiv në tefsirin e Raziut. Ai mes dy kapakëve të librit të vet ka përmbledhur dijen arabe, me qëllim të arritjes deri te kuptimi me të gjitha mjetet e mundshme apo të pasura në dispozicion në kohën e vet. Megjithatë, ai këtë sistem e vuri në shërbim të sistemit ideologjik, d.m.th. të drejimit esh'arit, përballë mutezilitëve, ku gjejmë një dialektikë kritike të bujshme kundër mutezilëve dhe thënieve të tyre.

d) *Sistemi interpretues*: ky është sistemi më i rëndësishëm, sepse të gjitha sistemet e mëparshme çojnë në drejtim të tij dhe puqen me të, në mënyrë që kështu të kalohet te kuptimi i fundit i tekstit kur'anor, për shkak se, sipas Raziut dhe sipas mbarë

<sup>361</sup> Tefifeha, *Ma'kulijjetu el-asli ve el-lugati er-remzijjeti, el-fatiha rehanatu el-ma'na*, (kiraetu Muhamed Arkun nemudhexhun), vep. e cit., f. 119

<sup>362</sup> Arkun, *El-Kur'anu min et-tefsiri el-mevruthi ila tahlili el-hitabi ed-dinijji*, vep. e cit., f. 138

vetëdijes islame, “ekzistenca e kuptimit të fundit në Kur'an është një gjë e konfirmuar dhe nuk preket nga dyshimi.”<sup>363</sup>

Ka mbetur vetëm momenti antropologjik në leximin e El-Fatihasë. Këtu Arkuni pohon mungesën e antropologjisë fetare specifike të Islamit, sepse Perëndimi e mbajti monopol këtë sistem epistemologjik. Për të realizuar një përafrim antropologjik me suren El-Fatiha, Arkuni propozon bashkëveprimin me tekstin kur'anor përgjatë hedhjes së tezës së “burimit fillestar”, me të cilin synon “pikën kulmore të ekzistencës së njeriut, si p.sh. jetën, vdekjen, kohën, dashurinë, të shenjtën dhe dhunën. Krejt këto janë synime të ndërmjetme, të cilat na çojnë te çështja e qenësisë dhe e ekzistencës. Këtu lind kuptimi dhe merr formë.”<sup>364</sup> Arkuni e pranon se nuk mund të “mbërrijë deri te burimi fillestar përvçe përmes inspirimit, inspirimit të gjuhës arabe. Kjo nuk mund të shprehet përnjëherë dhe asnëjëherë përmes gjuhës së fjalëpërfjalshme dhe logijke.”<sup>365</sup>

Në kontekst të kësaj pikëpamjeje për simbolizmin e gjuhës fetare në suren El-Fatiha, Arkuni nuk mund të shpëtojë nga “simbolika e të mirës dhe të keqes”, e cila shprehet me fjalët vijuese “Vetëm Ty të adhurojmë”, “rruga e drejtë”, “me të cilët u hidhërove” dhe “të humburit”. Po ashtu, nuk mund ta shmangë as problemin e qenësisë njerëzore të dedikuar në fjalët: “Allah” dhe “Zot i botëve”. Nuk shpëton dot as nga skajet e kohës dhe të vdekjes të përfshira në domethënien, të cilat konsiderohen vetëm si vendkalim dhe oborr. Kulmin e kënaqësisë antropologjike (Arkuni) e arrin kur thotë: “Nuk mund ta hedh në harresë gjithë këtë, veçse nëse e mbyll vetveten brenda leximit filologjik të El-Fatihasë. Filologjia ka qasje dhe trajtesa të ndryshme ndaj fjalës, pra si një simbol i shkruar. Filologjia konfirmon mundësinë

<sup>363</sup> Po aty, f. 139

<sup>364</sup> Po aty, f. 141

<sup>365</sup> Po aty, f. 141

e vërtetimit të kuptimit përmes etimologjisë dhe përmes informacioneve historike, sociale dhe kulturore.”<sup>366</sup>

Së fundi, Arkuni ndalet para këtij antagonizmi qenësor mes “atyre të cilët i begatove” dhe “ndaj të cilëve tërhoqë hidhërimin”. Kërkon të paraqesë tefsirin tradicional, i cili e ka ndarë shoqërinë njerëzore në dy taborë të kundërt: njeriu i përsosur si pejgamberi apo njeriu i urtë. Ky tabor gjëzon begatinë dhe kujdesin e Allahut. Kurse tabori i dytë specifikon njeriun, i cili i është dhënë të keqes dhe ka devijuar. Ky është objekt i hidhërimit dhe i mallkimit hyjnor.<sup>367</sup> Arkuni e kritikon efikasitetin e tefsirit i cili ngulit këtë gjendje dhe këtë rregullim përfundimtar. Në të njëjtën kohë, Kur’ani, përmes këtyre gjërave, synon ngjalljen e ndjesisë së gabimit dhe të mëkatit, por nuk e përcakton dhe as e ngulit këtë ndjenjë.<sup>368</sup> Këtu dhe vetëm këtu shkëlqen një shkëndijë e ndritur në fjalën e Arkunit, ku thotë: “Namazi apo lutja e ngritur te Zoti nuk ka asnjë kuptim nëse nuk ngjall shpresë te lutësi që të ndjehet i barabartë me njerëzit e zgjedhur apo nëse nuk ngjall frikë që të mos hidhet me të këqijtë e mallkuar. Brenda këtij konfuzioni qenësor mes shpresës dhe frikës lind ndjenja e mëkatit.”<sup>369</sup>

Kështu përfundon leximi (komentimi) i Arkunit për suren El-Fatiha brenda këtyre tre momenteve. Nuk e proklamon të përfunduar studimin derisa nuk i hap lexuesit dy vija të gjata të hulumtimit:

Gjuha kur'anore, e cila me shpejtësi arrin një nivel të lartë të shprehësisë simbolike, i cili na krijon mundësinë e kontributit në kristalizimin e teorisë së gjuhës simbolike në raport me kontekstin e mendimit shembullor apo alegorik që paraqitet në të dhe me kontekstin e mendimit shkencor aktual i cili e rizbulon gjuhën simbolike.

<sup>366</sup> Po aty, f. 142

<sup>367</sup> Po aty, f. 144

<sup>368</sup> Po aty, f. 144

<sup>369</sup> Po aty, f. 144

Përse dhe si komentuesit klasikë e tjetërsuan me përgjithësimet e tyre këtë gjuhë simbolike? Ia ulën vlerën, e zbritën në nivelin e diskursit të sistemit të kodifikuar dhe të funksioneve të tij, apo e kthyen atë në diskurs gnostik dhe batinist.”<sup>370</sup>

Gjyki për diçka eshtë dëshmi e ekzistencës së saj. Biseda rrëth simbolikës së gjuhës fetare në përgjithësi dhe rrëth gjuhës kur'anore në veçanti, nuk eshtë një kauzë pa provë. Teoria e tefsirit në Islam përpunhet skajshmërisht me botëkuptimin thelbësor të gjuhës, të karakterit dhe të funksionit gjuhësor. Prej problematikave të qarta në arsyen njërezoresh eshtë se “burimi real historik dhe garantuesi përfundimtar i çiltërsisë së eksperiencës fetare të besimtarëve mishërohet në një realitet themelor. Ky realitet eshtë se Allahu e ka prezantuar Vetveten para njërezoimit. Shpallja në Islam nënkuption se Allahu “flet” apo e prezanton Vetveten përmes gjuhës dhe se kjo nuk eshtë realizuar me një gjuhë të paqartë jonjerëzore, por përmes një gjuhe të qartë dhe të kuptueshme. Ky eshtë realiteti i parë dhe vendimtar. Pa këtë veprim themelor nga ana e Allahut, nuk do të kishte fe të vërtetë në tokë sipas kuptimit islam të fjalës fe.”<sup>371</sup>

Të vërtetën më të madhe ka thënë Allahu në Librin e Vet: “*Ky eshtë sqarim për njërexit dhe udhëzim dhe këshillë për të devotshmit.*” (Alu Imran: 138) Kushejriu ka thënë një fjalë të spikatur në komentimin e këtij ajeti: “*sqarim për disa njëreza nënkupton provat logjike, për disa të tjerë eshtë zbulues i përjetimeve shpirtërore dhe për disa të tjerë eshtë përqasja e të vërtetës në fshehtësitë.*”<sup>372</sup>

Çdokush që e lexon eksperiencën e Arkunit në tefsir (komentim), do të buzëqesh me ironi dhe me kënaqësi para kësaj konkluze të zbehët që e solli. Arkuni i ofroi të gjitha

<sup>370</sup> Po aty, f. 144

<sup>371</sup> Izutsu, *Allahu ve el-insanu fi el-Kur'ani*, vep. e cit., f. 240

<sup>372</sup> Ibn Hevazin Abdulkerim El-Kusherij, *Letaifi el-isharat*, i përgatitur për botim nga Ibrahim Bejdun, Kajro, El-Hejetu el-misrijjetu el-ammetu li el-kitabi, botimi I, 1971, vëllimi I, f. 280

sistemet paraprake të komentimit, kurse në anën tjetër e hamendësonte lexuesin se do të sjellë një gjë të çuditshme dhe atraktive në komentim. Kështu, ai tërroqi me vete gjithë ata që ua merrte mendja t'i afrohen tekstit kur'anor. I paraqiti njohuritë dhe metodologjitet e tij me një stil që kishte nevojë për një seriozitet shkencor. E ngriti horizontin e pritshmërisë te lexuesi që nuk ka lidhje me këtë metodë të vështirë dhe unike të komentuesve, derisa ra në grackën e tefsirit (të gabuar). E vërtetoi se ky teprim në teorizim ka sjellë deri në këtë derexhe që ai të ketë nevojë për tefsirët e klasikëve. E kuptoi se hollimi i prirjes së tij historike është përgjegjës për këtë lexim (komentim) të zbehtë në shumicën e sureve të Kur'anit.

Vënia e dijes përparimtare në funksion të kulturës perëndimore përgjatë studimit të çështjeve të kulturës islame, është një tregues i thellë për zbehjen e prirjes historike tek ata që merren me këtë punë. Gjithashtu, është e çuditshme që Hashim Salihu të jetë përkthyes dhe sqarues i Arkunit, i cili është njëri ndër kritikët më të shquar të cilët e trajtuan këtë problematikë me vizion dhe maturi. E ka analizuar me shumë përpikëri krizën e vetëdijes arabe-islame. Pastaj erdhi në përfundimin se ka një motiv themelor të vetëm për krejt këtë, është hollimi i prirjes historike te ne... “Ne, realisht përqendrohem i një kthesën historike ndarëse mes shekullit XVIII dhe shekujve të mesjetës”.<sup>373</sup>

Deri te ky përfundim i dhimbshëm dhe i kthjellët arriti vetëm pasi e pranoi se i ka humbur dhjetë vjet në Francë, duke u marrë me diskutim për Michel Fuco, Jacques Derrida dhe Dellueze Gilles, dhe atë rreth problemeve të modernizmit dhe të postmodernizmit... “Më duheshin më shumë se dhjetë vjet për të kuptuar se unë jam bashkëkohës i njerëzve të shekullit XVII, duke filluar me Dekartin dhe

<sup>373</sup> Hashim Salih, “Havle mefhumi el-hissi et-tarhiiji”, Mexhel-letu el-vahdeti, nr. 81, 1991, f. 17

Spinozën, dhe i iluministëve si Russo dhe Diderod, më shumë seç jam bashkëkohës i mendimtarëve aktualë francezë dhe perëndimorë. Shkurt thënë, më duhej të kthehem prapa, madje nuk ndjej ndonjë kompleks apo vështirësi për ta thënë haptas këtë, përkundrazi ndjej kënaqësi të madhe pasi zbulova pozicionin tim.”<sup>374</sup>

Metodologja e Muhamed Arkunit në lexim dhe interpretim, sipas disa studiuesve të tij, mbështetet në fjalët: “Absolutisht nuk ka vetëm një të vërtetë në çdo sferë për atë që të gjurmojë realitetet e punëve me objektivizëm dhe i paanshëm. Arkuni e paraqet që në fillim vendosmërinë e tij, por e ndjen se ka humbur dhe se duhet të përpinqet të futet në rrëmujën e mendimit. Arkuni e hedh poshtë mendimin e mbërritjes tek e vërteta dhe e quan atë si pretendim të mendësisë klasike që sundonte para se të kritikohet logjika e Aristotelit nga dija moderne. Ne tani, sipas Arkunit, kemi arritur në një stad të ri, në “stadin e fundit të bindjeve”. Njeriu është i krijuar në relativitet, i ngujuar në pavërtetësi, në dynjanë ku jeton, në gjuhën dhe në institucionet e tij. Ato janë burg i përjetshëm dhe nuk i lënë atij hapësirë ta shikojë botën me objektivizëm dhe as i mundësojnë të përvetësojnë ndonjë bindje.”<sup>375</sup>

<sup>374</sup> Po aty, f. 16

<sup>375</sup> Muhamed Zahid Gol, “En-Nessu ve et-te’vilu istratixhijjatu el-kiraeti el-mudetheti”, Mexhel-letu et-tesamuhi, nr. 24, 2008, f. 217

**KREU I KATËRT**



# Nasr Hamid Ebu Zejd: Koncepti i tekstit dhe karakteri i gjuhës fetare

## Koncepti i tekstit

Nasr Hamid Ebu Zejd ishte nga kritikët që u kushtonin vëmendje më të madhe çështjeve të tekstit kur'anor. Rrugëtimi i tij shkencor dëshmon inkuadrimin e tij të plotë në këto çështje të cilat ndollën jo pak vështirësi në dy nivele: në atë shkencor dhe personal. Disertacioni i parë, të cilin e mori institucionin Alemu el-Ma'rife el-Akademijje, ishte me titull "El-Ittixhahu el-aklijju fi et-tefsiri, dirasetun fi kadijjeti el-mexhazi inde el-mu'tezileh (Drejtimi racional në komentimin e Kur'anit: studim mbi problemin e alegorisë te mu'tezilët)" dhe u botua në vitin 1982. Pastaj rrodhën një pas një studimet dhe hulumtimet e tij në këtë sferë me bollëk dhe në formë të thelluar. Prej studimeve më të rëndësishme që u publikua në këtë kontekst është vepra "Felsefetu et-te'vili: dirasetun fi te'vili el-Kur'ani inde Muhjiddin bin Arabiji (Filozofia e interpretimit: studim në interpretimin e Kur'anit nga Muhjudin Arabiu)", "Mef'humu enessi: dirasetun fi ulumi el-Kur'ani (Koncepti i tekstit: studim në shkencat e Kur'anit)", "El-Hitabu ve et-te'vili (Ligjërimi dhe interpretimi)", "En-Nessu, es-sultatu, el-hakikatu (Teksti, pushteti, realiteti)", "Ishkalijjatu el-kiraeti ve alijjatu et-te'vili (Problemët e leximit dhe mjetet e interpretimit)", "El-Imamu esh-Shafiiju ve te'sisu el-idjuluxhijjetu el-vesetijetu (Imam Shafiu dhe themelimi i ideologjisë mesatarisë).

te)". Këtu mund të shtojmë më shumë se një hulumtim të vlefshëm që trajton problemet e tefsirit, ku ndër më të zëshmit është "El-Kiraetu el-edebijjetu li el-Kur'an: ishkalijsatuha kadimen ve hadithen (Leximi letrar i Kur'anit: problemet e tij në të kaluarën dhe në modernitet)" dhe në gjuhën angleze "Me'ziku el-mukarebeti el-edebijjeti li el-Kur'an (Ngërçi i afisë letrare të Kur'anit)".

Kjo trashëgimi e bujshme dhe e llojlojshme, e cila fillimisht themelohet mbi bazën e vetëdijes komplekse për problemet e tekstit kur'anor. Studimi i tij përbën një detyrë të vështirë. Ai është një kritik i cili merr pjesë në debatin e ashpër dhe të nxeh të brenda strukturës së kulturës bashkë-kohore arabe rreth kornizave të njohjes, mjeteve të të menduarit në problemet e nivelit epistemologjik dhe sociologjik. Arma e tij epistemologjike dhe metodologjike, me të cilën ballafaqohet me problemet ideologjike është "interpretimi"/"hermeneutika"<sup>376</sup>

Ndoshta, Nasr Hamid Ebu Zejdi ishte ndër kritikët e parë arabë të cilët kontribuan që në kulturën arabe të futet mendimi interpretues, ku e publikoi studimin e tij të gjerë "Hermeneutika dhe problemi i interpretimit të tekstit".<sup>377</sup> Ky studim, kornizën historike dhe konceptet kritike i huazon nga kultura perëndimore, me disa reflektive të tirthorta në manifestimet e mendimit interpretues të kulturës arabe-islame. Aty ka realizuar një prekje të përgjithshme të manifestimeve të kësaj metode në kulturën perëndimore dhe atë duke filluar nga F. Schleiermacher (vdiq 1834) dhe

<sup>376</sup> Kritiku algjerian Abdulmelik Murtad e kundërshton përdorimin e termit "hermeneutikë" në kulturën arabe dhe e shikon si një term të ashpër për fonologjinë arabe, i cili si i tillë ndikon edhe në nivelin ideologjik. Pohon se "ne nuk e pranojmë këtë përkthim bastard dhe të rëndë përderisa arbët e njohin këtë koncept dhe e trajtojnë këtë brenda termit te'vil (interpretim). Atëherë, nuk na mbetet gjë tjeter veç se përdorim termin "te'vilijetun" përball termit perëndimor klasik. Shih: Abdulmelik Murtad, "Et-Tevilijjetu bejne el-mukaddesi ve el-mudennesi", Mexhel-letu Alemi el-Fikri, nr. I, 2000, f. 263

<sup>377</sup> Është publikuar në revistën "Fusul", vëllimi i parë, numri 3, 1981, f. 141-159. Pastaj e ribotoi në librin: Ebu Zejd, *Ishkalijsatu el-kiraeti ve alijjatu et-te'vili*, vep. e cit., f. 13-49

duke përfunduar me Paul Ricoeur (vdiq 2006). Kështu përshkoi personalitetet më me zë në këtë sferë, duke paraqitur një sërë mendimesh me të cilat këta kolosë të interpretimit kontribuan në mendimin perëndimor modern, por u mjaftuan vetëm me paraqitje dhe me sqarim, pa i kritikuar dhe zhvilluar ato.”<sup>378</sup>

Ky studim ishte si një përgatiqje e parë teorike me të cilën u pajis Nasr Hamid Ebu Zejdi për zhvillimin dhe afrimin e çështjeve të trashëgimisë në rrjedhën e interpretimit me theks të veçantë.<sup>379</sup> Pavarësisht se tendenca interpretuese është e qartë në studimet e tij, ai përsëri e prezanton vetveten në nivelin kritik, duke u frymëzuar nga shkolla e mësuesit Emin Huli, për të cilën u bisedua më parë.<sup>380</sup> Gjithashtu ai u frymëzua nga racionalizmi modern arab, flamurin e së cilisë e mbante Ahmed Lutfi Sejjid, Taha Husejn, Ferih Antoni, Zekij Nexhib Mahfudhi, si dhe një varg burrash të mendimit dhe kulturës, të cilët njihen dhe cilësohen si udhëheqës të vërtetë të iluminizmit modern arab.<sup>381</sup>

Hasen Hanefiu i thekson transformimet rrënjosore në qëndrimin ideologjik të Nasr Hamid Ebu Zejdit, i cili në fillim i takonte të majtës islame, në anën e Hasen Hanefiut, por pastaj kaloi në të majtën shekullare, të cilën Hanefiu e konsideronte si armik të mendimit fetar dhe jo si rrymë të tij (të Islamit).<sup>382</sup> Ndoshta në këtë ka një komentim për llaga-

<sup>378</sup> Hasen Hafij, “Ulumu et-te’vili bejne el-hassati ve el-ammeti”, revista “El-Kajro”, numrat 173-175, 1997, f. 11

<sup>379</sup> Disa studiues bënин thirrje për shëmangje të aplikimit të fondamenteve të interpretimit në Kur'anin Fisnik, me pretekstin se “ai ndryshon nga librat e tjerë fetarë dhe jo fetarë në dy bazamente: e para është se të gjitha fjälët dhe shprehjet e Kur'anit, së paku sipas besimit të muslimanëve, janë nga Allahu dhe janë fjallë të Tij. Kjo nuk pretendohet për asnjë librë tjetër. E dyta është se renditja aktuale e përmblajtjeve të Kur'anit nuk e përfaqëson renditjen dhe kronologjinë e shpalljes.” Shih: Mustafa Melkijan, *El-Aklanijetu ve el-ma’nevijjetu mukarebatun fi felsefeti ed-dini*, i përkthyer në gjuhën arabe nga Abdulkhebbar Rifai dhe nga Hajder Nexhef, Bejrut, Daru el-Hadi, botimi I, 2005, f. 578-579

<sup>380</sup> Abu Zayd, “The Dilemma of the Literary Approach to the Quran”, f. 33

<sup>381</sup> Në fjälët e Nasr Hamidi Ebu Zejdit dallohet qartë pikëllimi dhe keqardhja për bëmat e iluminizmit arab dhe se si ai u struk në qarqet e ngushta të jetës kulturore. Shih: Nasr Hamid Ebu Zejd, *En-Nususu ed-dinijjetu bejne et-tarihi ve el-vaki’i*, *kadaja ve shehadat, el-hadathetu*, (1), nr. 2, 1990, f. 386. Po ashtu, studimi i tij: Zekij Nexhib Mahfudh, *Remzu et-tenviri*, në veprën: Ebu Zejd, *El-Hitabu ve et-te’vili*, vep. e cit. f. 67

<sup>382</sup> Hasen Hanefi, *Ulumu et-te’vili bejne el-hassati ve el-ammeti*, vep. e cit., f. 25

pin “kuadër i premtuar marksist”, të cilin Muhamed Amareh ia dha Nasr Hamid Ebu Zejdit në prononcimin për metodologjinë e tij analitike e cila është përf tuar nga mendimi marksist në leximin (komentimin) e tekstit kur'anor.<sup>383</sup>

Mendimet e Nasr Hamid Ebu Zejdit për “tekstin kur'anor” dhe mjetet e leximit të tij, të cilat përkonin me frymën e kohës dhe fitoheshin nga të dhënat e dijes moderne, u përhapën gjithandjej nëpër librat dhe artikujt e tij, për të cilat u bë fjalë më herët. Libri më i rëndësishëm në kontekstin e zhvillimit të tij ideologjik është “Mef'humu en-nessi, dirasetun fi ulumi el-Kur'ani (Koncepti i tekstit: studim në shkencat e Kur'anit)”.<sup>384</sup> Në këtë vepër ka bërë një përmbledhje për karakterin e të menduarit kritik rrëth natyrës tekstuale të Kur'anit Fisnik. Ky është libër që ka ngjallur hidhërimin e shumë studiuesve, dhe atë për shkakun e mendimeve të tij të guximshme që lidhen me natyrën e tekstit kur'anor, megjithatë ai ka siguruar edhe analiza kritike të shkruara nga kritikë, të cilët qëndrojnë në sfondin ideologjik ku qëndron edhe Nasr Hamid Ebu Zejd, ku në krye të tyre qëndron: Hasen Hanefiu, Xhabir Usfuri dhe Alij Harbi.

Kur Hasen Hanefiu në vitin 1971 e përktheu veprën “Siraletu fi el-lahut ve es-sijaseti” të filozofit hebre Baruch Spinoza (vdiq më 1677), përkthimin e nisi me përkushtimin vijues: “Për të gjithë ata që i shikojnë librat e shenjtë me sy shkencor”. Këtë e botoi me një hyrje të gjatë afersisht 100 faqe. Në këtë hyrje e trajton thirrjen për kritikën ndaj librave të shenjtë në dritën e kritikës historike, të cilën Hasen Hanefiu e trajton si përfitimin më të rëndësishëm të kulturës evropiane.”<sup>385</sup> Hasen Hanefiu nuk ka nguruar ta renditë Kur'anin në mesin e librave të shenjtë që duhen t'u nënshtrohen

<sup>383</sup> Muhammed Amareh, *Et-Tefsiru el-marksiju li el-islami*, Kajro, Daru esh-Shuruki, botimi I, 1996, f. 7-8

<sup>384</sup> Botimi i parë u publikua në vitin 1990 nga Qendra Kulturore Arabe në Bejrut.

<sup>385</sup> Baruch Spinoza, *Risaletun fi el-lahuti ve s-sijaseti*, i përkthyer dhe i përgatitur për botim në gjuhën arabe nga Hasen Hanefiu, Bejrut, Daru et-Talati, botimi III, 1994, f. 18

metodave të kritikës historike. Për këtë bën thirrje haptazi: "Disa e teprojnë, shumica prej tyre teologë konservatorë, të cilët pretendojnë se Allahu e ka mbrojtur Librin e Tij nga ndryshimi dhe tjetërsimi, dhe se kujdesi hyjnor është mbrojtësi i teksteve. Prandaj, nuk ka hapësirë për aplikim të rregullave të metodës historike ndaj teksteve fetare dhe bërjen e kritikës historike ndaj librave të shenjtë: "Ne e zbritën Dhikrin (Kur'anin) dhe Ne jemi mbrojtësit e tij" (El-Hixhr: 9)... Ajeti mund të kuptohet si mbrojtje e kuptimit dhe si mbrojtje e aplikimit të kuptimit në realitet, jo si mbrojtje e tekstit të shënuar fjalë për fjalë. Kështu, nuk e prek tjetërsimi dhe ndryshimi atë, gjë për të cilën e akuzojnë ithtarët e librit Kur'anin dhe e përkrahin kritikën historike të librave të shenjtë."<sup>386</sup>

Nasr Hamid Ebu Zejdi, kur e publikoi librin e tij "Mef'humu en-nessi (Koncepti i tekstit)" në vitin 1990, në të njëjtën kohë edhe Hasen Hanefiu solli një studim shumë të gjatë, të cilin e nisi me fjalët: "Kur hulumtuesi e lexon një tematikë nga jashtë, i pavarur dhe neutral, atëherë mund të shohë, të krahasojë, të përshkruajë dhe të analizojë. Ndërsa kur e lexon një temë nga brenda dhe si pjesë e saj, atëherë e analizon vetveten, i përshkruan përvojat e veta dhe i shpreh qëndrimet e veta. Leximi im i veprës "Koncepti i tekstit" është i llojit të dytë. Tematika dhe autori, libri dhe shkrimtari janë të të njëjtit formim shpirtëror dhe pjesë të historisë së tij."<sup>387</sup> Nëse realizohet themelimi i kësaj marrëdhënie të fuqishme mes këtyre dy studiuesve të specializuar në teorinë e interpretimit dhe në studimet kur'anore, atëherë mund të prekim ndikimin e fuqishëm të Hasen Hanefiut në formimin e vizionit shkencor te Nasr Hamid Ebu Zejd, i cili me

<sup>386</sup> Po aty, f. 22. Unë them: "Mendimi i ndryshimit dhe i tjetërsimit në Kur'an është i pabazë. Ky mendim është një shpifje e vjetër që nuk është vërtetuar nga kritika dhe as nga hulumtimi serioz. Kësaj i doli përballë Imam Bakiliani me veprën "El-Intisaru li el-Kur'an", ku i asgjësoi të gjitha dyshimet që u ngritën reth kësaj teme. Ky është një libër për të cilin kam punuar për përgatitjen e tij për botim. U botua në dy vëllime të mëdha nga instituti "Er-Risaleh" në Bejrut, në vitin 2003.

<sup>387</sup> Hasen Hanefiu, "Kiraetu mëf'humu en-nessi li Nasr Hamid Ebu Zejd", revista "Fusul", numri 3-4, 1991, f. 277

studimet e tij të vazhdueshme i ka kaluar horizontet interpretuese të profesor të tij së paku në nivel sasie.<sup>388</sup>

Ndoshta kjo hyrje ishte e domosdoshme për ta kuptuar prapavijen kulturore të hyrjes që e publikoi Nasr Hamid Ebu Zejdi për librin "Mefhumu en-nessi" me titull "El-Hatabu ed-dinijju ve el-menhexhu el-ilmijju", ku i riktheu jehonat e thella që burojnë nga vepra e Hasen Hanefiut rreth veprës së Spinozës, pavarësisht zhvillimeve thelbësore në qëndrimin e Nasr Hamid Ebu Zejdit në këtë fazë të jetës dhe pavarësisht kritikës së tij ndaj Hasen Hanefiut, të cilin e akuzon si "tevkifist (që e pranon çdo gjë si të dhënë nga Zoti), mesatarist, selefist, pragmatist dhe ilustrues."<sup>389</sup>

"Asnjëherë nuk ekziston një studim (i vetëm) për një tekst, një mendim dhe një temë".<sup>390</sup> Ndoshta kjo thënie me peshë e kritikut rus, Mikhail Bakhtin, është një hyrje e përshtatshme për ta kuptuar lidhjen e thellë të cilën e promovoi Nasr Hamid Ebu Zejd mes "tekstit kur'anor" dhe "kulturës islame". Kur'ani "është tekst gjuhësor, të cilin mund ta cilësojmë si përfaqësues boshtor në historinë e kulturës arabe. Nuk është aq e thjeshtë ta cilësojmë kulturën arabe-islame si kulturë të "tekstit"... Nëse mund ta përmbledhim kulturën në një dimension të vetëm, atëherë ia vlen të themi "se kultura e lashtë egiptiane është kulturë "e pas vdekjes", kultura greke është kulturë e "arsyes", kurse kultura arabe-islame është kulturë e "tekstit".<sup>391</sup>

Shprehja "kulturë e tekstit", e cila ngjall entuziazëm dhe vlerësim, në vështrimin e disa studiuesve mund të mos

<sup>388</sup> Xhabir Usfuri, *Hevaxhisu ala defteri et-tenviri*, Kuvajt, Daru Suad es-Sabah, botimi I, 1994, f. 57, ku flet për marrëdhënien e fuqishme mes Hasen Hanefiut dhe Nasr Hamid Ebu Zejdit në nivel ideologjik. Po ashtu, e potencon epërsinë e këtij të fundit për nga disiplina metodologjike në konceptin e tekstit, pavarësisht borxhit që ky i ka profesorit të vet.

<sup>389</sup> Hasen Hanefi, *Ulumu et-te'vili bejne el-hassati ve el-ammeti*, vep. e cit., f. 10

<sup>390</sup> Mikhail Bakhtin, "Mes'eletu en-nessi", e përkthyer në gjuhën arabe nga Muhammed Ali Mukal-led, revista "El-Fikru el-arabiju el-muasiru", nr. 36, 1985, f. 39

<sup>391</sup> Nasr Hamid Ebu Zejd, *Mefhumu en-nessi, dirasatun fi ulumi el-Kur'ani*, Beirut: El-Merkezu eth-Thekafiju el-Arabiju, botimi I, 1990, f. 9

reflektøjë një qëndrim pozitiv ndaj tekstit kur'anor. Këtu e kuptojmë kundërshtimin që e paraqet Ali Harbi ndaj titullit të librit "mef'humu en-nessi (Koncepti i tekstit)", sepse ky titull nuk përkon me përbajtjen. Më e udhës do të ishte që këtë libër ta quajmë "nekdu en-nessi (Kritika e tekstit)". Pra, ai shkencat kur'anore i trajton me vështrim analistik-kritik.<sup>392</sup> Pastaj flet për guximin kritik me të cilin cilësohet vepra "Mefhumu en-nessi (Koncepti i tekstit)" kur hedh një koncept të ri për tekstin kur'anor, duke e cilësuar atë "si produkt kulturor i realitetit njerëzor-historik".<sup>393</sup> Përmes kësaj e përgatit vendin për vështrim kritik që Kur'ani të lexohet në kornizën e historicizmit dhe kontekstit të tij social, pavarësisht se e pranon edhe dimensionin e i'xhazit (të mrekullisë) të këtij teksti unik.

Nasr Hamid Ebu Zejd nuk ofron një përkufizim kritik të tekstit, siç është kristalizuar në kontekstin e tekstologjisë (si për shembull te Julia Kristeva dhe te Paul Recouer), por e ka parë të mjaftueshme të flasë vetëm për kritikun rus Yuri Lotman, i cili pranoi një pikëpamje më gjithëpërfshirëse, ku konceptin e tekstit e renditi në botëkuptimet e tij të përgjithshme për artin.<sup>394</sup> Kjo është pikëpamja e përshtatshme për metodën që do ta aplikojë Nasr Hamid Ebu Zejdi në studimin e tekstit kur'anor, duke e quajtur atë si tekst letrar dhe ku struktura e tij kristalizon në kontekst kulturor dhe social. "Ndërrimi i metodave dhe ndryshimi i orientimeve në studimin e teksteve letrare, në thelb është vetëm ndryshim në përkufizimin e esencës së "tekstit", të karakteristikave dhe të funksioneve të tij. Koncepti i tekstit nuk është koncept themelor vetëm në studimet letrare, por është bërë koncept themelor edhe në shkencat humane dhe në kulturë në përgjithësi."<sup>395</sup>

<sup>392</sup> Ali Harb, *Nekdu en-nessi*, Ed-daru el-Bejdau: El-Merkezu eth-Thekafiju el-Arabiju, botimi IV, 2005, f. 200

<sup>393</sup> Po aty, f. 200

<sup>394</sup> Salah Fadl, "Belagatu el-hitabi ve ilmi en-nessi", "Alemu el-Marifeti", Kuvajt, nr. 164, 1992, f. 233

<sup>395</sup> Ebu Zejd, *Mefhumu en-nessi, dirasatun fi ulumi el-Kur'ani*, vep. e cit., f. 19

Xhabir Asfuri është ndalë në këtë pikë dhe ka ofruar një komentim ndryshe për këtë: "Libri ofron koncept për tekstin vetëm përmes konotacionit apo nevojës, përmes mungesës dhe jo përmes prezencës. Nëse e përdorim zhargonin struktural rrëth të cilit sillet hyrja gjuhësore e librit. Me këtë dua të them, thotë Xhabir Asfuri, se ajo që përban libri, është korniza referuese që përcakton një kuptim apo një koncept të tekstit i cili fitohet duke i rikthyer marrëdhëniet momentale të tekstit te ekivalenet që nuk janë të pranishme. Pra, ne nuk kemi diçka konkrete drejtpërdrejt për të thënë se ky është koncept i tekstit për librin në përgjithësi, dhe atë as nga pikëpamja e mendimit ndryshe për librin me të gjitha format dhe as nga pikëpamja e librit me të gjithë kërret e tij."<sup>396</sup> Më herët u fol për kujdesin e Nasr Hamid Ebu Zejidit për ta paraqitur veten si shtrirje kritike e shkollës së mësuesit të vet Emin Hulit. Në veprën "Mefhumu en-nessi" kthehet për ta konfirmuar se i përket kësaj shkolle plotësisht. Hulumtimi në veprën "mefhumu en-nessi" në realitet nuk është hulumtimi për thelbin e Kur'anit dhe për cilësimin e tij si tekst gjuhësore, por është studim që e trajton Kur'anin për nga fakti se ai është "Libri më madhështor në gjuhën arabe dhe posedon efekt letrar të përhershëm".<sup>397</sup>

Qartë duket këtu se kthehet zëri i Emin Hulit, i atij luftëtarë të paepur i cili ka kontribut të çiltër dhe të madh në rrugën e zhvillimi të afërsisë letrare të Kur'anit. Kjo afërsi është garantuese e realizimi të një vetëdijeje shkencore për tekstin kur'anor. Përmes "rilidhjes së studimeve kur'anore me sferën e studimeve letrare dhe kritike, pasi u ndanë prej tyre në vetëdijen moderne dhe bashkëkohore. Si rezultat i shumë faktorëve ndodhi ndarja e përbajtjes së trashëgimisë

<sup>396</sup> Asfuri, *Hevamishu ala defteri et-tenviri*, vep. e cit., f. 72-73

<sup>397</sup> Ebu Zejd, *Mefhumu en-nessi, dirasatun fi ulumi el-Kur'ani*, vep. e cit., f. 18

misë nga metodat e mësimit shkencor.”<sup>398</sup> Duke i konfirmuar këto botëkuptime metodologjike, Nasr Hamid Ebu Zejdi konfirmon se “studimi i tekstit nga aspekti gjuhësor apo struktura, formulimet, semantika dhe marrëdhënia e tij me tekstet tjera në një kulturë të caktuar është studim që i takon vetëm sferës së “studimeve letrare” në vetëdijen bashkëkohore shkencore.”<sup>399</sup>

Nasr Hamid Ebu Zejd e mbronte tendencën letrare në studimin e vet “Me’zuku el-mukarebeti el-edebijjeti fi el-Kur’ani”. E ka zbuluar shkakun thelbësor i cili çoi në ngushtimin e grykës së kësaj tendencë dhe mossigurimin e asnjë përkrahje fetare për të. Shkaku i këtyre rezultateve të sjella nga kjo tendencë kritike, është dominimi i mendimit se “Kur’ani përfaqëson fjalën e përhershme të Zotit dhe se dallimi mes statikes dhe aktuales te fjala e Allahut nuk ka ekzistuar në mendimin modern islam. Si rezultat kësaj, metoda letrare është bërë e brishtë dhe lehtë mund të kritikohet, madje është bërë i lehtë edhe provokimi i njerëzve në përgjithësi kundër studiuesve. Lehtë mund të binden njerëzit se metoda letrare nuk përbën thjesht vetëm një kërcënim, por sjell dëme të mëdha në shenjtërinë e Kur'anit.”<sup>400</sup>

Në kontekstin e mbrojtjes së efikasitetit të metodës letrare, Nasr Hamid Ebu Zejdi pohon se “nuk ka dyshim se metoda letrare në asnjë mënyrë nuk i sjell dëme hyjnësë së Kur'anit apo të ngjallë dyshime në karakterin e tij të shenjtë. Tekstet fetare, edhe pse janë hyjnore dhe burojnë nga Allahu, ato përcaktohen historikisht dhe maten kulturalisht, pra ato përbëjnë një mision të cilin Allahu ia shpalli njerëzimit përmes të dërguarit Muhamed, i cili është i dër-

<sup>398</sup> Ebu Zejd, *Mefhumu en-nessi, dirasatun fi ulumi el-Kur’ani*, vep. e cit., f. 18. Po ashtu, shih: Asfurin, *Hevamishu ala defteri et-tenviri*, vep. e cit., f. 60, ku Xhabir Asfur pohon se studimet e Emin Hilit me theks të veçantë janë një ndër hyrjet logjike themelore të metodës së “konceptit të tekstit” i cili patjetër duhet lidhur me fondamentet që i thekson.

<sup>399</sup> Ebu Zejd, *Mefhumu en-nessi, dirasatun fi ulumi el-Kur’ani*, vep. e cit., f. 18

<sup>400</sup> Abu Zayd, “The Dilemma of the Literary Approach to the Quran,” f. 34

guar dhe njeri në të njëjtën kohë. Kur'ani përmban: Dërguesin, Pranuesin dhe kodin e sistemit gjuhësor. Përderisa Dërguesi i Kur'anit është i pamundur të jetë objekt i studimit shkencor, atëherë është e natyrshme që analiza shkencore të lëshohet në tekstin kur'anor përmes realitetit dhe kulturës kontekstuale të tij.”<sup>401</sup>

Ky botëkuptim çon te mendimi se teksti kur'anor është produkt kulturor. Këtu lind pyetja vijuese: si është e mundur që konceptimi i Kur'anit si produkt kulturor të përshtatet me legjimitetin e tij gjithëpërfshirës? Kjo pyetje që shtrohet nga Nasr Hamid Ebu Zejdi, do të na çojë në një anë tjetër të tendencës letrare, të cilën e shpërfillin qëllimi shët dhe vazhdimisht kundërshtarët. Ky aspekt është aspekti mrekullor (i’xhazi), të cilin e pohon fuqishëm Taha Husejni, Huli, Halefullahu dhe përkrahësit e tyre. Të qenët e tekstit produkt kulturor përfaqëson vetëm një aspekt të tij, gjegjësisht aspektin që ndërlidhet me dukjen e tij si një tekst... biseda për Kur'anin si një mesazh hedh një realitet tjetër, pavarësisht se teksti kur'anor paraqitet përmes një sistemi gjuhësor arab, megjithatë, ai vazhdon të bartë karakteristike unike. Këto karakteristika unike fituan miratim të përgjithshëm nga arabët, madje i habitën edhe disa antagonistë që e luftonin shpalljen. Përmes këtyre karakteristikave unike dhe sfidës që u bëri arabëve, del në shesh koncepti i mrekullisë (i’xhazit) absolute i Kur'anit.”<sup>402</sup>

Pyetja kyçë me të cilën Nasr Hamid Ebu Zejdi e përfundoi studimin e vet të mëparshëm është kjo: çfarë e pengon zhvillimin e një mendimi islam-fetar modern i cili i ndihmon funksionalizimit të tendencës letrare në raport me Kur'anin? Përgjigjja e tij duket qartë në thirrjen që ai bën për adoptimin e mendimit të mutezilëve në krijimin e

<sup>401</sup> Po aty, f. 35

<sup>402</sup> Po aty, f. 38

Kur'anit. Nasr Hamid Ebu Zejdi i kritikon transformimet që ndodhën në qëndrimin e Muhamed Abduhusë në lidhje me karakterin e Kur'anit, kur ai në botimin e parë të librit "Risaletu et-tevhidi" e përvetëson konceptin e mutezilëve se Kur'ani është i krijuar, "mirëpo prej këtij mendimi u tër-hoq në botimin e dytë dhe e pranoi mendimin e esh'a-riive."<sup>403</sup> Nasr Hamid Ebu Zejd e vlerësoi qëndrimin e mutezilëve, të cilët tregohen shumë entuziastë për vënien e një marrëdhënieje të fuqishme fetare mes fjalës së Allahut, Kur'anit, dhe gjuhës njerëzore, prandaj ata i përbaheshin konceptit të urfit (traditës) humane për t'u ballafaquar me konceptin e inspirimit hyjnor."<sup>404</sup>

Nasr Hamid Ebu Zejdi ishte kundërthënës me vetveten pikërisht në këtë pikë. Kur Muhamed Arkuni e adaptoi këtë ide, gjegjësisht ripërtëritjen e idesë për krijimin e Kur'anit", siç shkëlqeu te mutezilët, ku thotë: "Kur ideologët mutezilitë e mbronin konceptin e krijimit të Kur'anit, ndjenin nevojën e integrimit të fjalës së Allahut në rrjetin e historisë. Pra, nëse mendimi islam sot do ta rimerre këtë ide, atëherë do të posedonte mjete të nevojshme për t'u ballafaquar me problemet që i bien mbi kokë mendimit bashkëkohor, bile do të ishte më i besueshëm, më kreativ dhe më madhësh-tor."<sup>405</sup> Nasr Hamid Ebu Zejdi e komenton këtë mendim kështu: "Duket se ideja e "krijimit të Kur'anit", pa mendimet tjera të mutezilëve, është ide që tërheq vëmendjen e Muhamed Arkunit, sepse ajo lidhet me projektin e tij për riobjektivizimin e shpalljes në histori, prandaj e sheh atë si pikënisje të mirë e cila duhet ripërtërirë për ta vënë në lëvizje mendimin islam. Pastaj e transmeton mendimin e mëparshëm të Arkunit, të cilin e komenton kështu: "Këtu Arkuni bie në kurthin e leximit selektiv dhe oportunist, gjë

<sup>403</sup> Po aty, f. 40

<sup>404</sup> Po aty, f. 12

<sup>405</sup> Arkuni, *El-Fikru el-Islamijju, kiraetun il-mijjetun*, vep. e cit., f. 82

për të cilën shpesh akuzohet edhe diskursi fetare se bie në të. Ai e nxjerr idenë nga konteksti i poemës mutezilite-teologjike, pastaj u shton kuptimin e vet.”<sup>406</sup>

Ky qëndrim kritik u themelua si shkak i zbehjes së pranisë mutezilite në shkrimet e Arkunit. Ky është një qëndrim jokritik në thelb. Ideja e “krijimit të Kur'anit” është ideja e vetme e cila mund të përgjidhet nga mendimet e mutezilëve në projektimin e karakterit kohor të tekstit kur'anor dhe flakjen e idesë së shenjtërisë nga gjuha e tij, kuptohet sipas qëndrimit kritikues ndaj tekstit kur'anor. Kjo është një vlerë e përbashkët mes Arkunit dhe Ebu Zejdit. Çështjet tjera ideologjike që mund të përfitohen nga mendimi mutezilit, si për shembull drejtësia sociale, nuk hyjnë në hapësirën e studimit letrar të Kur'anit. Më duket se të dy hulumtuesit: Arkuni dhe Nasr Hamid Ebu Zejdi, e ushtrojnë një operacion selektiv ndaj trashëgimisë. Ata e ripërtërinë qëndrimin e intelektualit ideologjik, të cilit nuk i intereson realiteti historik i trashëgimisë, por mundësia e funksionalizimit të saj në luftën ideologjike, e cila domosdoshmërish pranon ndarjen.”<sup>407</sup> Ashtu siç ka qenë trashëgimia fushë e përplasjes, ashtu duhet edhe të merret.

Nuk ka dyshim se mendimi mutezilit është shumë i pranishëm në projektin ideologjik të Nasr Hamid Ebu Zejdit. Ndoshta në fillimet e tij kishte një influencë vendimtare në këtë anë. Shumë studiues e pohojnë këtë realitet. Studimi i Xhabir Asfurit “Mefhumu en-nessi ve el-i'tizali el-muasiri”, ndoshta është hulumtimi më i thellë që ka trajtuar metodologjinë e Nasr Ebu Zejdit në leximin e trashëgimisë dhe në funksionalizimin e sistemit mutezilit në zhvillimin e vetëdijes bashkëkohore ndaj trashëgimisë, dhe atë përmes

<sup>406</sup> Ebu Zejd, *El-Hitabu ve et-te'vilu*, vep. e cit., f. 112-113

<sup>407</sup> Xhorx Tarabishi, *Medhbehatu et-turathi fi eth-thekafeti el-arabijjeti el-muasareti*, Beirut: Daru es-Saki, botimi I, 1993, f. 12

idesë së “ndërmjetësimit racional” mes besimit dhe metodës, e cila ndikoi në “Konceptin e tekstit” dhe ndikoi në “ngritjen e një lidhjeje të ekuilibruar epistemologjikisht mes bazave kontradiktore të metodave, të cilat në tërësi mund të ndihmojnë në leximin e tekstit, dhe atë në drejtim të ekuilibruar mes klasikes mutezilite dhe të resë moderniste dhe bashkëkohore, brenda një rrjeti të marrëdhënieve të përafisë, i cili vepron në shërbim të tekstit dhe të kuptimeve të tij specifike dhe të përgjithshme.”<sup>408</sup>

Xhabir Asfuri i ndoqi me hollësi metodologjike të theksuar manifestimet e mendimit mutezilit në veprën “Koncepti i tekstit” dhe ofroi një interpretim kritik ndaj saj, ku erdhi në përfundimin se mutezilitët klasikë nuk kanë hasur “kundërthënie mes tendencës së tyre racionaliste dhe pikë-pamjeve të tyre fetare. Folësi mutezilit ishte ai që e zotëronte besimin e fjalës së fesë, ashtu siç i zotëronte me meditim fjalët e filozofeve... Studiuesi bashkëkohor i “Konceptit të tekstit” i ngjan muteziliut, sepse e gërshton besimin në fjalët e fesë me meditimin në shkencat e kohës, madje ky është studiues real mutezilit, jo në formë alegorike.”<sup>409</sup> Pavarësisht se flet për njëanshmërinë e qartë kah mutezilitët të “Konceptit të tekstit” dhe vendin e tyre në “strukturën e hierarkisë e cila zbulon “prapambetjen” e rendit sunit,<sup>410</sup> me gjithatë ky prononcim nuk përmban asnjë dimension kritik në nivel të metodës, madje Xhabir Asfuri mendon se kjo njëanshmëri është ngritje e akli (arsyes) mbi naklin (shpalljen) dhe të kreativitetit mbi pasimin.”<sup>411</sup>

Kur të përcaktohet pozita ideologjike e Nasr Hamid Ebu Zejidit, e cila konsiderohet si zhvillim i qëndrimtit racionalist të mutezilëve ndaj tekstit dhe vazhdimësi e shkollës së

<sup>408</sup> Asfur, *Hevamishu ala defteri et-tenviri*, vep. e cit., f. 56

<sup>409</sup> Po aty, f. 53-54

<sup>410</sup> Po aty, f. 76

<sup>411</sup> Po aty, f. 52

Emin Hulit në zhvillimin e tendencës letrare vetëm në nivel procedural, atëherë para se të flitet për komponentët e metodës, kalohet në kornizën e përgjithshme brenda së cilës do të lëvizë Nasr Hamid Ebu Zejdi. Këtë ai e quajti "vetëdije shkencore për trashëgiminë". Këtu hyjnë bazat që u formuan nga faktorët të cilët kontribuan në lëvizjen dhe në zhvillimin e tij derisa mbërriti te ne."<sup>412</sup> Këtu ai niset nga pikëpamja vitale për trashëgiminë. Krejt kjo përmblidhet në atë se trashëgimia përmban "tërësinë e tefsireve që i jep çdo gjeneratë bazuar në kërkesat e kohës",<sup>413</sup> në mënyrë që "registri i trashëgimisë" në vetëdijen bashkëkohore të jetë përkrahës i ekzistencës sonë dhe të ndikojë në formë aktive në komponentët e vetëdijes sonë aktuale... Trashëgimia, në fund, është mbret yni të cilin na e kanë lënë të parët tanë, jo për ta ngujuar lirinë dhe lëvizjen tonë, por për ta manifestuar, për ta rikuptuar, për ta rikomentuar dhe për t'i riformuar pikëpamjet tona aktuale."<sup>414</sup>

Metodën që e përzgjodhi Nasr Hamid Ebu Zejdi në studimin e veprës "Koncepti i tekstit" dhe në zbulimin e mjeteve të formimit kulturor është metodë e analizës gjuhësore. Marrëdhënia mes tekstit dhe kulturës është marrëdhënie dialektike komplekse. Për t'i zbuluar disa aspekte të kësaj marrëdhënieje mbështetet në studimin e tij, me theks themelor te "hyrja gjuhësore",<sup>415</sup> mirëpo hyrja gjuhësore nuk lëviz në bosh, por Xhabir Asfuri mendon se ekziston korniza e një modeli metodologjik tredimensional, "ku këndi i parë lidhet me linguistikën bashkëkohore dhe me arritjet e saj, gjegjësisht me strukturalizmin, stilistikën dhe semiotikën. Këndi i dytë lidhet me këndin e leximit bashkëkohor, gjegjësisht me marrëdhëniat e saj, në sferën e hermeneu-

<sup>412</sup> Ebu Zejdi, *Mefhumu en-nessi, dirasatun fi ulumi el-Kur'anî*, vep. e cit., f. 17

<sup>413</sup> Po aty, f. 16

<sup>414</sup> Ebu Zejd, *Ishkalijatu el-kiraeti ve alijatu et-te'vili*, vep. e cit., f. 51

<sup>415</sup> Ebu Zejd, *Mefhumu en-nessi, dirasatun fi ulumi el-kur'anî*, vep. e cit., f. 25

tikës, me interpretimin e tekstit letrar, tekstit fetar dhe tekstit kulturor në përgjithësi, dhe atë në një rrjet marrëdhënie shët të koncepteve që e lidhin lexuesin me të lexuarën në aktin e leximit. Kurse këndi i tretë dhe i fundit e lidh tërësinë e koncepteve sociale dhe i cili i jep një dimension funksional aspekteve procedurale të dy këndeve paraprake të metodës, d.m.th. teksti merr kuptimin e aktualitetit dhe e konfirmon dialektikën mes atyre dyjave.”<sup>416</sup>

Pikëpamja gjuhësore në këtë studim mbështetet mbi sistemin e shenjave. Ky është një sistem që i riofron botës një formë simbolike (semiotike), të cilën Emile Benveniste e quan si asimilim, me kuptimin “se gjuha zë vendin e një gjësë tjetër e cila kërkon të jetë alternativë e saj.”<sup>417</sup> Pavarësisht kujdesit të theksuar që e tregoi Fernand de Sosuri për semiologjinë, ai ishte optimist se do të shfaqet një shkencë “e cila do të studiojë jetën e treguesve (shenjave) në jetën sociale, sepse gjuha është një sistem simbolesh që shpreh idetë e njeriut.”<sup>418</sup> Sipas Benveniste, kjo do të thotë se sistemet dytësore brenda shoqërisë interpretohen përmes gjuhës, ashtu siç interpretohet vetë shoqëria përmes gjuhës.”<sup>419</sup> Pastaj e sqaron zhvillimin e marrëdhënieς së tefsirit përmes sistemit të marrëdhënieve si në vijim: “veçoria kryesore e gjuhës fshihet në faktin se ajo përfshin kuptimin unik të shenjës dhe kuptimin e fjalës në të njëjtën kohë. Këtu fitohet fuqia dalluese e krijimit të nivelit dytësor të (kuptimit të) fjalës dhe kështu mund të trajtësohet një fjali që rrotullohet rreth kuptimit të vet. Në këtë aftësi metagjuhësore e shohim fondamentin e marrëdhënieς së komentimit, i cili i mundëson gjuhës përvetësimin e sistemeve tjera.”<sup>420</sup>

<sup>416</sup> Asfuri, *Hevamishu ala defteri et-tenviri*, vep. e cit., f. 64-65

<sup>417</sup> Emile Benveniste, “*Semijulxija el-lugati*”, i përkthyer në arabisht nga Siza Kasim, revista “Fusul”, nr. 3, 1981, f. 58

<sup>418</sup> Fernand de Sosur, *Durusun fi el-elsunijieti el-ammeti*, e arabizuar nga Salih el-Fermadi dhe kolegu i tij, Libi, Ed-Daru el-Arabijjetu li el-Kitabi, botimi I, 1985, f. 37

<sup>419</sup> Benveniste, *Simjuluxhija el-lugati*, vep. e cit., f. 59

<sup>420</sup> Po aty, f. 63

Krahas këtij funksioni interpretues të gjuhës, duke e cilësuar atë si sistem shenjash, ka edhe funksionin komunikues mes Dërguesit dhe Pritësit. Ebu Zejdi në veprën "Koncepti i tekstit" u mbështet në modelin gjuhësor strukturalist, siç u themelua me theks të veçantë nga Roman Jakobson. Jakobson ofroi një imazh të shkurtër për faktorët që formojnë çdo progres linguistik dhe çdo veprim komunikues mes fjalëve, si p.sh.: "Dërguesi i drejton një porosi të dërguarit, mirëpo për të qenë porosia efikase, para së gjithash ka nevojë për një kontekst i cili duhet përçuar, pra, një kontekst i cili mund të perceptohet nga personi të cilit i dërgohet... gjithashtu, porosia ka nevojë edhe për një kontakt apo kanal fizik dhe për një lidhje shpirtërore mes Dërguesit dhe palës pranuese. Pra, ka nevojë për një kontakt që u lejon të dy palëve komunikimin dhe mbajtjen e komunikimit."<sup>421</sup>

Duke e sqaruar këtë marrëdhënie mes funksionit të përgjithshëm "të shenjave" dhe funksionit të saj komunikues, i cili realizohet përmes sistemit gjuhësor strukturalist, pastaj marrëdhënien e saj me kontekstin dhe kulturën. Nasr Hamid Ebu Zejd thotë: "Megjithatë, krahas funksionit të përgjithshëm, gjuha ka edhe një funksion tjeter: ai është funksioni komunikues, i cili imponon një marrëdhënie mes folësit dhe atij që i drejtohet kumti apo mes dërguesit dhe atij që i dërgohet mesazhi. Përderisa funksioni informues-komunikues i gjuhës nuk ndahet nga natyra e saj simbolike, ashtu edhe funksioni i tekstit në kulturë, e që është funksion informues sepse teksti është mesazh, nuk ndahet nga sistemi gjuhësor që i takon. Po ashtu, nuk ndahet nga sfera e kulturës dhe e realitetit."<sup>422</sup>

<sup>421</sup> Roman Jakobson, *Kadaja esh-shi'rjeti*, i përkthyer në gjuhën arabe nga Muhamed el-Velij dhe Mubarek Hanun, Ed-Daru el-Bejdau, Daru Tubkal, botimi I, 1988, f. 27, shih:

- Jose Maria Ivanoks, *Nedharjetjet el-lugati el-ebedbijjeti*, i përkthyer në gjuhën arabe nga Hamid Ebu Ahmed, Kajro, Mektebetu Garib, 1992, f. 51

<sup>422</sup> Ebu Zejd, *Mefhumu en-nessi, dirasatun fi ulumi el-Kur'ani*, vep. e cit., f. 25

Arritja në kuptimin shkencor të tekstit kur'anor duhet të themelohet mbi të vërtetat vijuese: "Kur'ani e cilëson veten si mesazh, pra mesazhi përfaqëson një marrëdhënie lidhshmërie mes dërguesit dhe pranuesit, përmes një shifre apo një sistemi gjuhësor. Përderisa Dërguesi në situatën e Kur'anit nuk mund të jetë objekt i studimit shkencor, atëherë është e natyrshme që dera shkencore hyrëse për studimin e tekstit kur'anor të jetë dera e realitetit dhe e kulturës. Realiteti e sistemon lëvizjen e njerëzve që u kumtohet teksti, kurse perspektivën e rendit të parë të tekstit e sistemon i Dërguari dhe kultura që mishërohet në gjuhë... Përmes analizimit të këtyre realiteteve, mbërrimë në kuptimin shkencor të dukurisë së tekstit."<sup>423</sup>

Në këtë moment të hulumtimit Ebu Zejdi arrin te ideja që ngriti shumë kritika, protesta dhe reagime. Ai mendonte se "teksti është produkt kulturor, dhe si i tillë është problem i pakontestueshëm që nuk ka nevojë për vërtetim."<sup>424</sup> Këtë ide e sqaronte me këto fjalë: "Teksti në realitet dhe në thelb është produkt kulturor. Qëllimi i kësaj është se ai arriți të formësohet në realitet dhe në kulturë përgjatë një periudhe më shumë se njëzet vite."<sup>425</sup> Pastaj e hedh poshtë akuzën e cila mund të thuhet në këtë kontekst, e cila është se ky botë-kuptim kulturor ndaj tekstit do të çojë në shkëputjen e tekstit nga burimi hyjnor. Këtë e shpjegon kështu: "Besimi në burimin hyjnor të tekstit është çështje që nuk bie ndesh me analizën e tekstit përgjatë kuptimit të kulturës që i takon."<sup>426</sup>

Duke këmbëngulur t'i sqarojë këto mendime dhe të hedhë poshtë keqkuptimet që i bashkëngjiten atyre, Nasr Hamid Ebu Zejdi thotë: "Allahu i Lartësuar kur ia shpalli të Dërguarit a.s. Kur'anin, zgjodhi sistemin gjuhësor specifik

<sup>423</sup> Po aty, f. 24

<sup>424</sup> Po aty, f. 24

<sup>425</sup> Po aty, f. 22

<sup>426</sup> Po aty, f. 24

që lidhej me perceptuesin e parë (të Dërguarin). Nuk zgjodhi gjuhën e cila do të ishte e zbrazët, sepse gjuha është mjeti më i rëndësishëm kolektiv për perceptimin dhe sistemimin e botës. Bazuar në këtë, nuk mund të flasim për një gjuhë paradoksale ndaj kulturës dhe realitetit. As nuk bëhet fjalë për një tekst paradoksal ndaj kulturës dhe realitetit, sepse ai është tekst që vepron brenda kornizës së sistemit gjuhësor të kulturës. Hyjnia e burimit të tekstit nuk e mohon faktin e realitetit të përmbajtjes dhe as vënien e tij në shërbim të njeriut.”<sup>427</sup>

Në këtë kontekst, Nasr Hamid Ebu Zejdi i dallon këto dy fazë historike të progresit të tekstit kur'anor. Mendimi “se teksti është produkt në raport me Kur'anin, përfaqëson një fazë të formimit dhe të përsosmërisë. Kjo është fazë pas së cilës teksti bëhet produkt i kulturës, d.m.th. ai është teksti dominues me të cilin krahasohen tekstet tjera dhe përcaktohet legjitimiteti i tyre.”<sup>428</sup>

Biseda për lidhshmërinë e tekstit me realitetin dhe kulturën, bashkë me rolin e tyre në formësimin e tij, përbën shenjën ndarëse mes metodës së veprës “Koncepti i tekstit” dhe metodave të tjera që i studiojnë këto problematika. Në këtë pikë Nasr Hamid Ebu Zejdi huazon disa terma marksistë në dallimin e leximit të tij nga leximet tjera. Në të njëjtën kohë, përparësia në këto lexime (komentime) i takon Atij që e thotë tekstin (Allahut xh.sh.), pastaj pranuesit të parë (Muhamedit a.s.), pastaj vjen në shprehje biseda për realitetin me titullin “esbabu nuzul (shkaqet e zbritjes)” dhe “Nasihu ve mensuh (abrogimi)”, të cilën Nasr Hamid Ebu Zejdi e quan dialektikë rënëse. Leximi i veprës “Koncepti i tekstit” e praktikon konceptin e “didaktikës ngritëse”. Fillon

<sup>427</sup> Po aty, f. 24. Gjithashtu, shih: Nasr Hamid Ebu Zejd, *En-Nessu, es-sultatu, el-hakikatu*, Ed-Daru el-Bejdau: El-Merkezu eth-Thekafiju el-Arabiju, botimi II, 1997, f. 92, ku kthehet për ta konfirmuar këtë të vërtetë nga e cila nis studimi i tekstit kur'anor.

<sup>428</sup> Ebu Zejd, *Mefhumu en-nessi*, Dirasatun fi ulumi el-Kur'anit, vep. e cit., f. 24

me realitetin që "nis nga sensacionalja dhe okularja, duke shkuar në ngjitje. Fillon nga realitetet dhe aksiomat për të arritur te e panjohura dhe te ajo që është e fshehur,"<sup>429</sup> pastaj pohon se metoda e parë mbështetet në meditim dhe është i ekspozuar për t'u zhytur në thashethemet ligjërimore. Me këtë, ligjërimi shkencor përmes kësaj metode e devijon detyrën e tij reale dhe kryen një detyrë tjeter, pra ajo detyrë është këshillim dhe udhëzim."<sup>430</sup>

Ebu Zejdi nuk mërzitet aspak kur pohon idenë se teksti është mjet komunikues, i cili kryen një funksion informues dhe se nuk mund të kuptohet natyra e mesazhit që bart teksti pa i analizuar të dhënat e tij gjuhësore në dritën e realitetit ku është formësuar ai tekst. Mendimi se çdo tekst është një mesazh pohon se Kur'ani dhe hadithi pejgamberik janë tekste mbi të cilat mund të aplikohen metodat e analizimit të teksteve.<sup>431</sup>

Një pikë tjeter e provokuar nga Nasr Hamid Ebu Zejdi, kur flet për metodën gjuhësore në analizimin e tekstit kur'anor, është: prej ku buron kredibiliteti (besueshmëria) e tekstit kur'anor në kontekstin e analizës gjuhësore-kulturore? A buron nga jashtë apo nga brenda? Kjo pyetje u kristalizua në kontekstin tradicional të kulturës arabe, ku diskutimi përfundoi se mrekullia më e madhe është vetë "teksti" dhe krejt ajo që përfshiu teoria e i'xhazit në thelb. Kurse në kontekstin modern është "konteksti i realitetit dhe i kulturës." Besueshmëria e tekstit në metodën e analizimit të teksteve nuk buron nga jashtë, por nga pranimi i tij. Atë që e refuzon dhe e mohon kultura nuk bie në rrëthin e teksteve, kurse atë që e pranon kultura si tekst kumtues, ai është i tillë."<sup>432</sup>

<sup>429</sup> Po aty, f. 26

<sup>430</sup> Po aty, f. 26

<sup>431</sup> Po aty, f. 26

<sup>432</sup> Po aty, f. 27

Sa i përket tekstit kur'anor, ky tekst unik vazhdoi "të plotësohet derisa u bë pjesë themelore aktive në kulturën që i takon. Me kalimin e pak viteve u bë teksti sundues në kulturë. Pastaj e kaloi kornizën e kulturës së tij për të ndikuar në kulturat tjera."<sup>433</sup> Për herë të parë shtrohet kredibiliteti i tekstit kur'anor përgjatë kësaj pikëpamjeje. Kjo është pikëpamje formaliste e cila përmban çështje kyçë kulturore dhe fetare. Dominimi kulturor nuk është kriter shkencor i njëzëshëm, por është rezultat i cili buron nga përbërësit që bart teksti në strukturën e tij themelore. Dominimi kulturor i tekstit ndodh vetëm pasi ta ketë zbuluar zemrën e njeriut dhe pasi të rritet numri i atyre që e besojnë atë. Besimi në të mbështetet në fuqinë mrekulluese të tij, e cila është kriter i vetëm për besimin e tij, bile me këtë u realizua sfida. Prej kësaj kuptojmë rëndësinë e mendimit të Nasr Hamid Ebu Zejdit, ku thotë: "Kredibiliteti i këtij teksti, i Kur'anit, nuk buron nga fakti se atë e besojnë shumë njerëz, sepse edhe numri i vogël nuk e pakëson besueshmërinë e tij. Ekzistenca e tekstit në kulturë është më kyç se ekzistenca e tij në ndjenjat e besimtarëve."<sup>434</sup>

Mendimi thelbësor i fundit në metodën e propozuar shkencore për leximin e tekstit kur'anor, është mendimi që ndërlidhet me kundërshtimin vijues i cili nuk privohet ngaakuza: "Si mund të aplikohet metoda e analizimit të teksteve mbi tekstin hyjnor?"<sup>435</sup> Në kontekstin e përgjigjes së kësaj pyetjeje, Nasr Hamid Ebu Zejdi, e përcakton burimin e kësaj kundërshtie dhe se ajo buron nga soditësit platonikë, dhe përgjigjja është si në vijim: "Nëse përfaqësuesit e kësaj metode pajtohen me ne se Allahu i Lartësuar nuk është objekt i analizës dhe i studimit dhe se Ai deshi që kumti i tij te

<sup>433</sup> Po aty, f. 27

<sup>434</sup> Po aty, f. 28

<sup>435</sup> Po aty, f. 27

njerëzit të shkojë përmes gjuhës së tyre, d.m.th. përmes sistemit të tyre kulturor-qendror, atëherë do të kuptojnë se gjëja e vetme që i nënshtronet studimit shkencorë është "fjala" hyjnore përmes analizimit të të dhënave në kornizën e sistemit kulturor i cili manifestohet përmes tij. Prandaj, metoda e analizës gjuhësore është metoda e vetme humane që mund ta kuptoje shpalljen dhe pastaj edhe Islamin."<sup>436</sup>

Kjo ngurtësi metodologjike e thatë, e cila u trasua nga Nasr Hamid Ebu Zejdi kur flet për karakterin letrar të tekstit kur'anor dhe qenien e tij në thelb tekst gjuhësor, për këtë është shprehur edhe Adonisi me një stil poetik térheqës, i cili gufon me romantizmin letrar që tregon pasurimin e prirjes së tij me gjuhën kur'anore të mishëruar në këtë tekst hyjnor unik.<sup>437</sup> Teksti kur'anor, sipas Adonisit, "u përgjigjet pyetjeve të ekzistencës, të etikës dhe të fatit. Ai i përgjigjet kësaj me një formë estetike-artistike, prandaj mund ta cilësojmë si tekst gjuhësor, d.m.th. patjetër të kuptohet përmes kuptimit të gjuhës së tij pikë së pari. Kjo gjuhë nuk është thjesht fjalë dhe me formulime gramatikore, por bart vizionë të caktuara për njeriun, për jetën dhe për kozmosin."<sup>438</sup>

Përgjigjen e individit arab Adonisi e quajti "habi" dhe e shënoi se ajo është habi gjuhësore. "Kështu u magjepsën me estetikën dhe artin e gjuhës së tyre. Kjo gjuhë ishte çelësi i drejtpërdrejtë, i cili i hapi dyert për të hyrë në botën e tekstit kur'anor dhe për të besuar në fenë islame. Për këtë arsy, në asnjë mënyrë nuk mund të ndahet Islami nga gjuha. Mund të themi se muslimanët e parë janë ata që e formësuan bërrthamën e parë të thirrjes islame. Fillimisht e besuan atë, jo sepse ua zbuloi misteret e kozmosit dhe të njeriut apo sepse u ofroi një sistem të ri për jetë, por sepse e panë se ai është një shkrim i pakrahasueshëm me të tjerët. Me

<sup>436</sup> Po aty, f. 27

<sup>437</sup> Adonis, *En-Nessa el-kur'aniju ve afaku el-kitabeti*, Bejrut, Daru el-Adabi, botimi I, 1993, f. 20

<sup>438</sup> Po aty, f. 20

gjuhën ndryshoi qenia e tyre nga brenda dhe me të ndryshoi edhe jeta e tyre. Me atë u identifikan, si në gjuhë ashtu edhe në të shprehur, prandaj ai (Kur'ani) u bë vetë ekzistanca e tyre, sikur gjuha të ishte një njeri që frymon dhe jo thjesht një mjet që lidh njeriun me botën. Pra, gjuha është vetë thelbi i tij.”<sup>439</sup>

## Natyra e gjuhës fetare

Një dallim thelbësor dhe i thellë ekziston mes natyrës së gjuhës fetare në përgjithësi dhe natyrës së gjuhës kur'anore në veçanti. Studiuesi iranian, Sejjid Husjen Nasr, ka një studim të çmuar në këtë sferë, ku shprehet se gjuha arabe është gjuhë e shenjtë, kurse gjuhët tjera fetare nuk përputhen me konceptin “e shenjtërisë” dhe se kuptimi i kësaj natyre të shenjtë të gjuhës kur'anore kërkon një vështrim mbi traditat e feve të tjera të mëdha në botë. “Ekzistojnë dy tipa traditash: tipi i parë bazohet mbi shpikësin e traditës, ku pranuesi i shpalljes është ai në të cilin është mishëruar ajo... dhe vetë ai është Fjala e Allahu dhe Mesazhi i Qiellit. Në këto tradita nuk ekziston gjuhë e shenjtë, sepse trupi apo forma e jashtme e mishëruesit (të traditës) është forma e dukshme e fjalës së Allahut, prandaj në krishterizëm Mesihu vetë është Fjala e Allahut.”<sup>440</sup> Kjo e krishterizmit përputhet edhe me budizmin, sepse Buda është vetë mishërimi (i fesë).

Krahas këtyre traditave, ekzistojnë tradita të ndryshme në fetë tjera “ku vetë themeluesi nuk konsiderohet si mesazh i qiellit apo fjalë e Allahut, por në realitet është i dërguari i asaj fjale. Kjo është ideja si Islami e pasqyron shpalljen, ku themeluesi i shpalljes thirret i Dërguar. Në këtë lloj feje, ku

<sup>439</sup> Po aty, f. 21-22

<sup>440</sup> Sejjid Husejn Nasr, *El-Kur'anu kelimetull-llahi, masdaru el-ma'rifeti ve el-fi'ilî*, i arabizuar nga Musa Safvan, revista “El-Mehaxxheh”, Beirut, Daru el-Hadi, nr. 10, 2004, f. 18

themeluesi nuk është vetë fjala, duhet pasur një gjuhë të mbrojtur, të shenjtë dhe të homogjene që nuk pranon të shpërbëhet përbajtja e mesazhit. Po ashtu, kjo gjuhë është përgjedhur për t'u kujdesur në skajshmëri të plotë për shprehjet e saj. Shprehjet dhe fjalët e kësaj gjuhe të shenjtë konsiderohen pjesë të shpalljes dhe luajnë të njëtin rol në këtë fe. Njësoj siç është trupi i Mesihut në krishterizëm.”<sup>441</sup>

Kur të pranohet ky rezultat, atëherë Kur'an, si çdo tekst tjetër i shenjtë, nuk mund të krahasohet me asnjë formë tjetër të shkrimit njerëzor, sepse ai saktësish është mesazhi i shenjtë i shprehur me gjuhën njerëzore.”<sup>442</sup> Këtë që e tha Sejid Husejn Nasri, e pat thënë edhe Hisham Xhaiti, i cili e hulumtoi këtë çështje dhe erdhi në përfundimin se Kur'an “është libër i shenjtë i dalluar.”<sup>443</sup>

Kështu doli në skenë dallimi mes gjuhës kur'anore dhe sistemeve të tjera gjuhësore në trashëgiminë kulturore përgjatë shtjellimit të idesë së i'xhazit dhe të hulumtimit për konceptin e ngritjes letrare dhe të epërsisë së jashtëzakonshme të gjuhës kur'anore, pavarësisht mjeteve shprehëse tjera dhe inkuadrimit të tyre në ligjet e stilistikës arabe.<sup>444</sup> Një vështrim vrojtues në veprat që shkëlqyen në kornizën e idesë së i'xhazit, mund të sigurojë paraqitjen e kontributit të jashtëzakonshëm që është dhënë në sferën e paraqitjes së epërsisë letrare të gjuhës së Kur'anit përballë gjuhëve tjera, gjegjësisht manifestimeve gjuhësore në të, madje edhe nëse këto manifestime janë minimizuar, siç e pamë te Kadi Bakilani, i cili metodën e tij e ngriti mbi paraqitjen e i'xhazit të Kur'anit përmes përqendrimit në dobësinë teksteve letrare të dalluara në kontekstin e kulturës

<sup>441</sup> Po aty, f. 18-19

<sup>442</sup> Po aty, f. 20

<sup>443</sup> Hisham Xhaiti, El-Vahju ve el-Kur'anu ve en-nubuvveti, Bejrut, Daru et-Taliati, botimi I, 1999, f. 22

<sup>444</sup> Shih: El-Munxhi el-Ka'bji, “Tetbiku nedharrijjeti el-i'xhazi ala esh-shi'r'i”, pjesë e librit të Ibrahim Seafinit, *Fi mihrabi el-ma'rifeti, dirasatun muhdathun ila ihsani Abbas*, Bejrut, Daru el-Garbi el-Islamiji, Daru Sadir, botimi I, 1997, f. 433

arabe, si p.sh. poezia e Imrulkajxit, e Buhteriu dhe të tjerëve që arritën kulmin në krijimtarinë letrare. Nuk është rendi të sjellim kritikat që kritikët regjistruan për metodën e Bakilanit në shfaqjen e dallimit të gjuhës kur'anore dhe dallimin e semantikës kur'anore nga semantika njerëzore, ku, sa për shembull, është kritika e Mahmud Muhammed Shakir,<sup>445</sup> i cili foli gjerësisht për shkaqet dhe motivet që e shtynë Bakilanin ta përdorë gabimisht projektin e vet në paraqitjen e mangësive të poezisë së periudhës së injorancës me theks të veçantë, ku më mirë për të do të ishte që të hulumtojë karakteristikat retorike të kësaj poezie unike dhe konfirmimin se ajo dallon nga retorika kur'anore.”<sup>446</sup>

Krahas kësaj hyrje kritike për studimin e karakterit të gjuhës kur'anore dhe dallimin e saj letrar, i cili mbërriti kulmin te Abdulkahir Xhurxhanin me teorinë e kompozimit gjuhësor, ka edhe një hyrje tjetër e cila bazohet mbi të dhënat kelamiste në sqarimin e mënyrës së njohjes së fjalës së Allahut të Lartësuar. Abdulkhebbar Hemedani mutezilit ka një shkrim të rëndësishëm dhe të dobishëm në këtë fushë. Shkrimi është në veprën “Halku el-Kur'an (krijimi i Kur'anit)”, të cilin e ka titulluar “faslun fi bëjani tariki mari-feti kelamihi xhel-le ve azze (Kreu: sqarimi i mënyrës së njohjes së fjalës së Tij të Lartësuar)”, ku shpreh tendencën e mutekeliminëve për dallim të fjalës hyjnore, sepse “çdo gjë që mund ta bëjë njeriu njësoj, ekzistenca e së njëjtit lloj nuk tregon se ajo është vepër e Allahut të Lartësuar dhe se të tjerët nuk mund ta bëjnë atë.”<sup>447</sup>

<sup>445</sup> Mahmud Muhammed Shakir, *Medahilu i'khazi el-Kur'anî*, Kajro, Metbeatu el-Medenijj, Xhide, Daru el-Medenij, botimi I, 2002, f. 87

<sup>446</sup> Po aty, f. 185. Këtu ka një studim të çmuar me titull “Mukaddimetun fi el-usuli el-fikrijjeti li el-belagati ve i'khazi el-Kur'anî (Hyrje në fondamentet ideologjike të stilistikës dhe të i'khazit të Kur'anit)”, Ahmed Ebu Zejd, Daru el-Eman, Ribat, botimi I, 1989, ku është shpalosur pika e përbashkët me studiues të stilistikës dhe të mutekel-liminëve në sferën e paraqites së i'khazit të Kur'anit Fisnik.

<sup>447</sup> Abdulkhebbar El-Kadi, *El-Mugni fi ebvabi et-tevhidi (halku el-Kur'anî)*, tekstin e rregulloi Ibrahim el-Ebjari, Kajro, Vezaretu eth-Thekafeti ve el-Irshadi el-Kavmiji, botimi I, 1961, f. 180

Mustafa Sadik Rafii e ka përbledhur teorinë e i'xhazit të Kur'anit në trajtën që "kthehet te fshehtësitë e gjendjes gjuhësore, të cilat referencë e kanë sqarimin e jetës së kuptimit përmes një formulimi të gjallë fjalësh që përputhen me ligjet e jetës: me shkrim të thukët, vendosje të matur (të fjalëve), pasqyrim estetik dhe me rregullim shumë të përshtatshëm."<sup>448</sup> Pastaj erdhi nxënësi i tij, Mahmud Muhamed Shakir, i cili e argumentoi fokusimin e i'xhazit vetëm në gjuhë dhe kjo pastaj e bëri të mbajë mendimin e ndalimit të përkthimit të Kur'anit, sepse kjo çon në prishjen dhe thyerjen e i'xhazit (mrekullisë).<sup>449</sup> Kur e publikoi veprën e vet, "Risaletun fi et-tariki ila thekafetina", e filloi me një studim për metodën e tij në qasjen ndaj poezisë së injorancës. Në kontekstin e hulumtimit të tij theksoi një thënie të Abdulkahir Xhurxhanit nga vepra "Er-risaletu esh-shafijeh", ku potencon se disa fjalëve njerëzore nuk u kuptohet qëllimi dhe as mund të kalohen e të lihen. Këto fjalë u ngjajnë fjalëve të mrekullueshme (i'xhazit). Abdulkahiri thotë se "gjëja më specifike që kërkohet këtu është kjo (i'xhazeti). Librat e shkruar në shkencat e ndryshme të reja, shohim se autorët kanë shkruar edhe më herët në disa sfera të kësaj fushe, si p.sh. përfjalën dhe kompozimin gjuhësor, por kjo i lodhi pasuesit e tyre të shkruajnë të njëjtat gjëra apo të sjellin diçka të ngjashme. Për këtë arsyе filluan të mos shtojnë asgjë më shumë, por vetëm t'i ruajnë ato siç janë dhe t'i kryejnë ato ashtu siç janë në sistemin e vet. Si për shembull, mendimi i Sibevezhit në fillim të veprës "El-Kitabu": "Sa u përket foljeve, ato janë shembuj të marrë nga emërtimet e ndodhive të emrave. Ato janë ndërtuar nga ajo që ka kaluar, që është dhe që ende nuk ka ndodhur..." Nuk dimë ende që dikush tjetër ta ketë sjellë diçka të ngjashme apo të për-

<sup>448</sup> Mustafa Sadik Rafii, *Tarihu adabi el-arabi*, Bejrut, Daru el-Kitabi el-Arabiiji, botimi II, 1974, vëllimi II, f. 156

<sup>449</sup> Shakir, *Medhihu l'xhazi el-kur'ani*, vep. e cit., f. 190

afërt me këtë përkufizim, bile as nuk i shkon ndërmend dikujt se mund ta bëjë.”<sup>450</sup>

Mahmud Muhamed Shakir, veprën e Abdulkahirit e ka komentuar me këto fjalë: “Ky imam i mrekullueshëm dhe i zgjuar, kur e trajton çështjen e mrekullisë (i’xhazit) të Kur'anit të madhërishëm dhe kur aplikon idenë e tij të cilën e kanë thënë edhe para tij, e që është problemi i “fjalës dhe i formulimit sintaksor (nadhm-it)”, gjëra që janë shtylla të drejtimit të tij në i’xhazin (mrekullinë) dhe belagën (stilistikën) e Kur'anit, nuk ka gjetur ndonjë vështirësi në aplikimin e idesë së i’xhazit brenda ndonjë përkufizimi të “foljes”, e që është përkufizimi që e regjistroi imami i gramatikës, Sibevejhi, dhe nuk ka nguruuar ta sjellë atë pranë fjalëve përbledhëse fisnike.”<sup>451</sup>

Kjo tendencë të cilën e paraqiti Xhurxhani dhe Shakiri në komentimin e disa momenteve të epërsisë letrare në krijimtarinë njerëzore, u keqkuptua. Në një studim që kërkon vetëdije kritike dhe që ngrihet mbi ndjenjën revolucionare katarzuese, Munxhi Ka’biu mendon se “i’xhazi nuk është specifikë vetëm e Kur'anit, ngase shprehjet arabe (janë të papërsëritshme) qysh në lashtësi, prandaj nuk mund të sjellin diçka më të arrirë se ato.”<sup>452</sup>

Ideja që i solli studiuesit deri në këtë përfundim është se mendimi i i’xhazit është mbështetur brenda pikëpamjeve fetare të cilat i’xhazin e bënë pjesë së besimit. Kjo pastaj i detyroi që të besojnë kategorikisht se “i’xhazi i Kur'anit është më madhështor se çdo lloj tjetër mrekullie që mund t’i afrohet.”<sup>453</sup> Kështu, Munxhi Ka’biu erdhi në përfundimin se “i’xhazi kur'anor është një çështje jashtë Kur'anit për shkaqe

<sup>450</sup> Abdulkahir Xhurxhani, *Er-Risaletu esh-shafijetu*, është publikuar brenda veprës “Delailul el-i’xhazi”, të cilën e ka lexuar dhe e komentuar Mahmud Muhamed Shakir, Kajro, Mektebetu el-Hanxi, botimi II, 1989, f. 604

<sup>451</sup> Mahmud Muhamed Shakir, *Risaletun fi et-tariki ila thekafetina*, Kajro, Kitabu el-Hilali, 1991, f. 13-14. Baza e këtij libri është një hyrje e shkëlqyer të cilën Mahmud Muhamed Shakiri e paraqiti në botimin e dytë të veprës së tij “El-Mutenebbi”, e botuar në vitin 1987

<sup>452</sup> Ka’bij, *Tetbiku nedharijjeti el-i’xhazi ala esh-shi’ri*, vep. e cit., f. 440

<sup>453</sup> Po aty, f. 436

fetare dhe për shkak të shpalljes, kurse stilistika sjell përfundime vetëm në pjesët e brendshme (gjuhësore) të tyre.”<sup>454</sup>

Munxhi Kabiu, shikuar nga këndi i natyrës së gjuhës kur'anore (mu'xhize), këto transformime i lidh me ritmin e transformimeve në epokën moderne. “Epoka jobesimore, në të cilën ka hyrë arabishtja moderne, i humbi arritjet burimore nga Kur'ani, nga suneti dhe nga trashëgimia poetike dhe prozaike para islame.”<sup>455</sup> Potencon disa lëvizje për rrënimin e sistemit gjuhësor dhe veçon faktin se “të krishterët e Libanit janë të parët që e kundërshtuan shenjtërinë fetare të gjuhës arabe, dhe atë nga mllefi që kishin ndaj Perandorisë Osmane. Pastaj, lëvizja e mërgatës vijoi me atakimin e lavdisë së gjuhës arabe dhe të stilistikës që përputhej me stilistikën kur'anore. Po ashtu, e atakonin edhe retorikën që lidhej me retorikën kur'anore, prandaj kështu (kjo pasuri) u bë pronë e tyre dhe jo e Kur'anit apo e arabëve muslimanë, sepse filluan ta zhvillojnë atë si pranarë të saj, por pa lënë praninë e tekstit fetare të shenjtë...”<sup>456</sup> Në këtë mënyrë, pas krejt kësaj, Munxhi Ka'biu arriti kulmin e teprisë, ku tha: “Në vlerësimin tonë duhet marrë një qëndrim të matur ndaj stilistikës arabe sot, qëndrim ku Kur'ani nuk është modeli i preferuar i saj (i stilistikës).”<sup>457</sup>

Më herët u theksua se Shukri Ajjadit, i cili është një nga studiuesit e përkushtuar në hollësitë e retorikës dhe stilistikës arabe, shtroi kërkesën që Kur'ani Fisnik të jetë modeli stilistik përbledhës nga i cili mund të dalë stilistika arabe. Gjithashtu, në këtë kontekst u theksua edhe dëshmia e Johan Fick, për meritën e epërsisë stilistike të gjuhës kur'anore. Nuk është gabim nëse këtu shtohet edhe thënia e Edvard Seidit për praninë dominuese të Kur'anit në kulturën arabe-

<sup>454</sup> Po aty, f. 436

<sup>455</sup> Po aty, f. 437

<sup>456</sup> Po aty, f. 437-438

<sup>457</sup> Po aty, f. 439

islame, ku thotë: "Një kulturë ku sundon letërsia dhe drejtësia fjala, është kulturë që bosht e ka gjuhën, siç është kultura arabe-islame e cila arriti ta përballojë gjithë këtë. Kjo na shtyn ta shohim praninë dominuese të efektit të Kur'anit si synim të veçantë. Pra, unë flas për Kur'anin si vepër gjuhësore, e cila ka gëzuar shtrirje në sferat tjera gjuhësore të gjuhës arabe. Gjuhët e mëdha popullore nuk janë thjesht tërësi e fjalëve, por, siç na mësojnë filologët që nga de Sosuri dhe deri te Benjamin Lee Whorf dhe Emile Benveniste, ato janë sisteme që dirigojnë të menduarin. Nuk ka mendim pa gjuhë, prandaj gjuha shihet si strukturë apo sistem që ka kushte të caktuara, e cila jo vetëm se e dirigjon të menduarit, por edhe i jep atij edhe karakterin e vet. Kështu, kultura në esencë është mendim që e jep potencialet e gjuhës. Sa i takon gjuhës arabe, medituesi nuk është e domosdoshme të jetë hulumtues arab apo musliman për të kuptuar presionin e madh shpirtëror që gjuha e manifeston te folësi i arabishës. Ky është presion, të cilin Kur'ani në cilësinë e një vepre ua jep të gjithëve, sepse ai është mishërim i plotë i gjuhës, pastaj edhe i të menduarit në atë gjuhë. Çdo shkrimtar që kontribuon në kulturën arabe, duhet ta pranojë këtë realitet. Kështu, gjuha konsiderohet e veçantë, sepse ajo është gjuhë e kësaj vepre themelore dhe me rëndësi absolute."<sup>458</sup>

Hulumtimi për karakterin e gjuhës fetare te Nasr Hamid Ebu Zejdi mbështetet në dallimin funksional mes dy gjuhëve: asaj fetare dhe të zakonshme. Sa i përket gjuhë fetare, ajo është gjuhë që "mban mbi kurrizin e vet barrën e të shprehurit të absolutes, mirëpo duke qenë se në strukturën e saj fondamentale është dukuri kulturore-sociale, atëherë ajo përmban shprehjen dhe artikulimin e relatives."<sup>459</sup> Nasr

<sup>458</sup> Edvard Seidi, *Mekalutun ve hivarutun*, i përgatitur dhe i redaktuar nga Muhammed Shahin, Bejrut, El-Muessesetu el-Arabijjetu li ed-Dirasati ve en-Neshri, botimi I, 2004, f. 49. Shih: Stetkevich, *El-Arabijjetu el-hadithetu*, f. 23

<sup>459</sup> Ebu Zejd, *En-Nessu, es-sultatu, el-hakikatu*, vep. e cit., f. 227

Hamid Ebu Zejdi, para se të hulumtojë karakterin e gjuhës fetare, hedh një hyrje të aprovuar në mesin e hulumtuesve, ku thotë “se gjuha e Kur'anit fisnik përfitohet nga gjuha arabe dhe nga korniza qarkulluese-historike në Gadishullin Arabik para ardhjes së Islamit në veçanti.”<sup>460</sup> Mirëpo, ky përfitim nuk e mohon faktin se “ajo është gjuhë me sistem të veçantë”<sup>461</sup> dhe se detyrë e studiuesve është zbulimi i tipareve të kësaj veçantie pa e shpërfillur bazën nga ku është përfshuar.

—Studiuesit e bazave të fikhut kanë potencuar se sheriati e ndryshoi gjuhën dhe tjetërsoi domethëniet e shumë fjalëve, si namazi, zeqati dhe lutja.<sup>462</sup> Me fjalën ndryshim, këtu synohet transformimi i tërësishëm i gjuhës nga fakti i të qenit një sistem “shenjash” në atë se ajo vetë është “shenjë” në sistemin kumtues të gjuhës fetare.<sup>463</sup>

Ky hulumtim përban një tip aventure, mirëpo te Nasr Hamid Ebu Zejdi është një aventurë e legjitimuar në kornizën e hulumtimit shkencor. Ajo ka bazë metodologjike në strukturën e tekstit kur'anor nga njëra anë, dhe në vetë procesin e “mësimit” në të cilin inkuadrohet lexuesi musliman i tekstit nga ana tjetër.<sup>464</sup>

Sa i përket themelit të saj metodologjik në Kur'an, krejt trashëgimia gjuhësore e mëparshme duke u cilësuar si një sistem shenjash, shndërrohet në shenja që në mënyra të ndryshme kumtojnë një realitet të vetëm absolut dhe gjithë-përfshirës. Sa i takon mekanizmit të transformimit në shenja, Abdulkahir Xhurxhani e ka sqaruar procesin e transformimit semantik që ndodh në figurat stilistike përmes idesë së “kuptimit të kuptimit”, të cilën Nasr Hamid Ebu Zejdi e quan si proces të semantizimit, i cili mëton ta kalojë gjuhën

<sup>460</sup> Po aty, f. 214

<sup>461</sup> Po aty, f. 216

<sup>462</sup> Muhamed bin Alij El-Mazerij, *Idahu el-mahsuli min burhani el-usuli*, i hulumtuar dhe i përgatitur për botim nga Amar et-Talibij, Bejrut, Daru el-Garbi el-Islamijji, botimi I, 2001, f. 155

<sup>463</sup> Ebu Zejd, *En-Nessu, es-sultatu, el-hakikatu*, vep. e cit., f. 216

<sup>464</sup> Po aty, f. 217

nga sfera e konvensionalizmit në sferën e argumentimit logjik, pra e transformon atë në një sistem shenjash jogjuhësor. Do të thotë, themel i shenjave gjuhësore është që kuptimi i tyre të ndërtohet në bazë të marrëveshjes (shoqërore) apo konvencionale, kurse te shenjat semantike nuk qëndron puna njësoj. Kjo u ngjan transformimeve të gjuhës së zakonshme, të cilat nga funksioni i tyre semantik dhe kumtues kthehen në një rend stilistik i cili dikton kuptime të logjikshme.<sup>465</sup>

Sa i takon pranuesit, lexuesi i Kur'anit është i përzgjedhur t'i logjikojë kuptimet e asaj që lexon dhe t'i meditojë ajetet (shenjat) e Allahut pa u ndalur vetëm te shenja gjuhësore, por të mendojë në atë që kuption çdo çështje e logjikshme. Është e ditur se koncepti i "shenjës" në Kur'an i kalon kufijtë e kozmosit dhe të historisë, d.m.th. sistemi i shenjave në tekst është i shumëllojshëm dhe e përvetëson edhe sistemin e gjuhën në strukturën e vet. Përmes këtij përvetësimi, i cili buron nga gërshtimi i tekstit me dispozitat dhe me botën, realizohet përvetësimi i plotë nga ana e lexuesit në kornizën e një referimi të vetëm, e ai është teksti kur'anor.<sup>466</sup> Ky lexim e jep mundësinë e të ndjehet i pavarur kundrejt leximeve tjera.

Në këtë studim, Nasr Hamid Ebu Zejdi zbuloi mekanizmat me të cilat teksti kur'anor e transformon krejt botën në një tufë shenjash me kuptime të unifikuara apo në një bërtathamë të vetme kuptimore. Gjithashtu, ka zbuluar mënyrën e marrëdhënieς së tekstit me gjuhën, ku nga kuptimi tekstual i drejtpërdrejtë e kthen në kuptim të kuptimit racional, apo e transferon atë nga sistemi i shenjave të gjuhës në sistem të shenjave semantike, ku gjuha e tekstit (gjuha fetare) e sundon gjuhën bazë dhe e kalon atë në sferën profesionale. Kështu, gjuha arabe kthehet në gjuhë fetare, kuptohet

<sup>465</sup> Po aty, f. 217-218

<sup>466</sup> Po aty, f. 218-219

pasi teksti ta ketë sunduar mirë atë dhe pasi ta ketë përvetësuar pothuaj tërësisht në anën e kuptimore profesionale.”<sup>467</sup>

Nisur nga ky botëkuptim për karakterin e tekstit fetar dhe qenien e tij si sistemi më i lartë i të menduarit dhe i vetëdijes në kulturën arabe-islame, Nasr Hamid Ebu Zejd bëri një ndalesë kritike-analitike te koncepti i gjuhës fetare në veprat e Muhamed Arkunit. Fillimisht i përmblodhi mendimet thelbësore të Arkunit rrëth karakterit të gjuhës fetare si në vijim. “Duket se Kur’ani shkaktoi një reformim kuptimor-semantik në mënyrën e përdorimit të alegorisë dhe në mënyrën e kësaj gjuhe alegorike, ku gjuha fetare e fiton simbolikën e saj, e cila çdoherë është e hapur përgjatë rrëthit të interpretimit.

